



## Paketa Mbështetëse e Sensibilizimit Për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) (PMSA 2003)



**SEESAC**

South Eastern Europe Clearinghouse for the  
Control of Small Arms and Light Weapons

---

**Agjensia e Europës Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta** (The South Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons SEESAC)<sup>1</sup> ka një mandat nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore (SPSEE) për të ofruar asistencë operacionale, asistencë teknike dhe informacion menaxhues në mbështetje të formulimit dhe zbatimit të koordinimit për KAVL<sup>2</sup>, kontrollit dhe masave zvogëluese, projekteve dhe aktiviteteve në mënyrë që të mbështetet Plani Rajonal i Zbatimit për Paktin e Stabilitetit, duke kontribuar, kështu në rritjen e stabilitetit rajonal dhe zhvillimin e mëtejshëm afatgjatë në Europën Juglindore.

---

Për më tepër informacion kontaktoni:

**Drejtuesi i Skuadrës SEESAC**  
**Internacionalnih Brigada 56**  
**11000 Beograd**  
**Serbi Mali i Zi**

**Tel: (+381) (11) 344 63 53**  
**Fax: (+381) (11) 344 63 56**  
**www.seesac.org**  
**E-mail: info@seesac.org**

### **PMSA - Paketa Mbështetëse e Sensibilizimit AVL, SEESAC, Beograd 2004**

#### **Falënderime**

Elementet bazë të PMSA u zhvilluan nga Laurence Desvignes dhe Simon Rynn. Seksioni i dokumentit që mbulon monitorimin dhe vlerësimin dhe si dhe mjetet e mbledhjes së informacionit të bashkangjitura janë së shumti punë e Jim Coe, që ka punuar për llogari të OJQ-së së bazuar në Angli, Safeworld. Autorët dëshirojnë të falenderojnë një grup të gjerë komentuesish për idetë e hedhura gjatë krijimit të PMSA. Ata përfshijnë më tepër se 30 zyrtarë qeveritarë, aktivistë OJQ-sh si dhe punonjës të programeve KAVL të UNDP të cilët kanë marrë pjesë në Outreach Workshop të Korrikut 2003 si dhe atyre prej grupit më të gjerë të aktorëve që punojnë për AVL në Europën Juglindore dhe më tutje të cilën komentuan për draftin gjatë Gushtit 2003. Një mirënjohje e thellë i shkon atyre që kanë qenë pionierë të sensibilizimit për KAVL në terren, shpesh në rrethana të vështira dhe pa terma drejtimi për praktikatat më të mira të punës apo burime të mjaftueshme. Ndonëse shumë për tu përmendur, përkushtimi i të gjithë këtyre individëve e ka bërë të mundur PMSA. SEESAC shpreson të ketë përfitimin e ideve dhe sugjerimeve të tyre në përgatitjen e versioneve të ardhshme.

Përkthimi në shqip i PMSA u mor përsipër nga Projekti i Edukimit për Paqe dhe Çarmatim në Shqipëri. Falenderojmë veçanërisht përkthyesit Genc Kojdheli dhe Gertjan Veshaj, redaktorin shkencor Ols Lafe, dhe koordinatorin e projektit Elton Skendaj.

---

#### **© SEESAC 2004 – Të gjitha të drejtat të rezervuara**

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim apo të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore. Përshkrimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë publikim nuk nënkuptojnë mendimin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim apo të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore në lidhje me statusin ligjor në ndonjë vendi, territori apo zone, të autoriteteve apo grupeve të armatosura, apo në lidhje me ravijëzimin e kufijve apo limiteve tokësore.

---

<sup>1</sup> Që këtej e tutje kësaj agjensie do ti referohemi me shkurtimin original në Anglisht SEESAC.

<sup>2</sup> Ky është shkurtimi në Shqip për SALWC (Small Arms Light Weapons Control) dhe forma e plotë e KAVL është Kontrolli mbi Armët e Vogla dhe të Lehta.



## Parathënie

SEESAC ka marrë mandatin për të dhënë këshillim teknik mbi çështjen kritike të Sensibilizimit mbi Amët e Vogla dhe të Lehta (AVL) në rajonin e Europës Juglindore (SEE)<sup>3</sup>. Gjatë konsultimeve fillestare me organet e interesuara rajonale gjatë 2003, SEESAC u sensibilizua si për nevojën e rritur për Sensibilizim për SAVL në EJT, ashtu edhe për mungesën e burimeve të gatshme për ata që dëshirojnë të zbatojnë programe të tilla.

Në fushën e re dhe në zhvillim të Sensibilizimit të AVL ekzistojnë krahasimisht pak shembuj model për praktikuesit. Deri më tani, nuk ka pasur ndonjë përpjekje sistematike për të identifikuar praktikat e mira (dhe të këqija) në nivelin operativ. Për ata që zbatojnë programet mungesa e eksperiencave dhe burimeve krijojnë implikime serioze. Programe të papërshtatshme të sensibilizimit të AVL mund që potencialisht – ose për shkak të mesazheve dhe materialeve të papërshtatshme, apo mungesës së sensibilitetit – të rrisin tensionet shoqërore, të përkeqësojnë perceptimin e komuniteteve përsa i përket sigurisë së tyre, apo të rezultojnë në viktima të padëshiruara. Si përfundim, ato mund të dështojnë në qëllimin e synuar dhe thjesht të harxhojnë fondet e projektit.

Për këto arsye SEESAC filloi një proces gjatë mesit të vitit 2003 që ka kulminuar në publikimin e “Paketës Mbështetëse të Sensibilizimit AVL” (PMSA). E përbërë nga një doracak dhe një CD-ROM, PMSA vendos principet dhe procedurat për programim të sigurtë dhe efektiv të Sensibilizimit të AVL, dhe paraqet një koleksion materialesh mbështetëse. Është menduar që të përdoret prej çdo organizmi që ndërmerr aktivitete për Sensibilizimin e AVL, qoftë ky qeveritar, jo-qeveritar apo ndërkombëtar. Qëllimet e PMSA mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Të përkufizojë, të zhvillojë vazhdimisht dhe të bëjë të gatshëm praktikat më të mira që dalin në lidhje me Sensibilizimin e AVL në EJT, duke maksimizuar në këtë mënyrë shanset që programet e ardhshme të jenë të sigurta dhe efektive;
- Të paraqesë mjete dhe metoda për të drejtuar programe që do të bëjnë më efektive projektet, duke kursyer kohë dhe burime;
- Të rrisë ekspertizën rajonale në lidhje me Sensibilizimin e AVL ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në aktivitete të tilla; dhe
- Të nxjerrë në pah mekanizma që mundësojnë programet për Sensibilizimin e AVL të kordinojnë me, apo të integrohen në, ndërhyrje për mikro-çarmatimin.

Për të siguruar vlerën e PMSA në terren, një version paraprak i paketës u rishikua në një workshop të përbashkët të RACVIAC/SEESAC në Korrik 2003 nga një grup përfaqësues i të interesuarëve (punonjës nga organizatat jo-qeveritare (OJQ-të) lokale dhe ndërkombëtare, organizmat ndërkombëtarë dhe qeveritë e EJT) përpara se të hidhej në qarkullim tek një grup më i gjerë komentuesish. Si rezultat i këtij procesi “Paravlerësimi” edicioni i parë i PMSA është një produkt hibrid që distilon pikëpamjet dhe eksperiencat e numrit më të gjerë të mundshëm të aktivistëve dhe praktikuesve të AVL.

Pas publikimit fillestar në Nëntor 2003, ky manual njëherazi do të testohet në terren dhe do të përkthehet në gjuhët vendase. Do të jetë i gatshëm pa pagesë sipas kërkesës dhe i gjetshëm në faqen internet të SEESAC. Ne parashikojmë se do të jetë një burim i gjallë, që do të rishikohet vazhdimisht në vitet e ardhshme për të reflektuar eksperiencat e atyre që punojnë në terren, dhe duke inkorporuar më përgjithësisht përparimin në mikro-çarmatimin dhe teorinë e komunikimit.

Ndërsa është e pamundur të parashikohet saktësisht se cilat do të jenë këto mësimë, realitetet e tanishme në mikro-çarmatim dhe komunikimin e zhvillimit sygjerojnë linja të hetimit të mëtejshëm. E para është sfida e të inkorporuarit të ndërhyrjeve të mikro-çarmatimit në programe të drejtuara tek zhvillimi ekonomik dhe social dhe reforma e sektorit të sigurisë.

Progresi në këtë drejtim pa dyshim që do të shtyjë përpara Sensibilizimin për AVL në mënyra të reja. Një drejtim i dytë lidhet me përdorimin e metodave pjesëmarrëse. Ndërsa PMSA promovon përdorimin e metodave

<sup>3</sup> SEE (South Eastern Europe) është shkurtimi Anglisht për Europën Juglindore dhe në do të përdorim shkurtimin Shqip EJT.



pjesëmarrëse gjatë etapave të ndryshme në ciklin e programit, ekziston mundësia për pjesëmarrje të plotë të komunitetit në çdo etapë të programeve për mikro-çarmatimin. Nëse teoria e nevojshme për të drejtuar këtë lloj ndërhyrje zhvillohet në vitet e ardhshme, përbërësi komunikim/sensibilizim i ndërhyrjeve të mikro-çarmatimit do të formojë domosdoshmërisht bërthamën e të gjitha ndërhyrjeve të tjera.

Sidoqoftë, deri atëherë prakticienët në terren kanë mjaftueshëm pengesa praktike për të kaluar. PMSA do të mbështetet përta i përket vlerës së saj tek mendimet e sjella vazhdimisht nga përdoruesit dhe përfituesit që punojnë në terren. Ne shpresojmë që PMSA të japë një kontribut në punën tuaj dhe kërkojmë ndihmën tuaj për ta përmirësuar e për të ngritur nivelin e saj.

Beograd, 01 Nëntor 2003

Adrian Wilkinson

Drejtues i Skuadrës SEESAC



## Përmbajtja

Parathënie .....	iii
Përmbajtja .....	iv
1 Hyrja .....	1
1.1 Çfarë është PMSA?.....	2
2 PMSA – Konceptet dhe përjasjet .....	4
2.1 Përkufizimi i Sensibilizimit AVL .....	4
2.1.1 Edukimi për rreziqet e AVL .....	5
2.1.2 Advokimi për AVL .....	5
2.1.3 (AVL) Informimi i Publikut .....	6
2.2 Përkufizimi i objektivave të programit të Sensibilizimit AVL .....	7
2.2.1 Objektivat e lidhura me Njohurinë .....	7
2.2.2 Objektivat e lidhura me Qëndrimin.....	7
2.2.3 Objektivat e lidhura me Sjelljen.....	8
2.2.4 Objektivat e lidhura me politikat institucionale dhe praktikat .....	8
2.3 Integrimi i Sensibilizimit për AVL me ndërhyrjet për mikro-çarmatim .....	8
2.3.1 Edukimi i Rreziqeve të Veçimit përkundrejt Sensibilizimit të AVL në mbështetje të mbledhjes së AVL ...	10
2.3.2 Lidhjet me legjislacionin për AVL, dhe aktivitetet për mbledhjen dhe shkatërrimin .....	13
2.4 Aktivitetet e bazuar në komunitet .....	14
2.4.1 Plani i Komunitetit më të Sigurtë.....	14
2.5 Çështjet e Sigurisë dhe detyrimi për Kujdesje .....	15
2.5.1 Mos-Përplasje e Edukimit për Rreziqet e AVL dhe Advokimi për AVL .....	16
2.5.2 Mos-Përplasje e Sensibilizimit për AVL dhe edukimit mbi rrezikshmërinë e minave.....	17
2.6 Integrimi i Sensibilizimit për AVL në aktivitete të tjera .....	18
2.7 Ndjekja e ciklit të programit .....	22
3 Mbledhja dhe menaxhimi i informacionit .....	25
3.1 Objektivat e mbledhjes dhe menaxhimit .....	25
3.2 Mbledhja e informacionit në kontekstin e iniciativave kombëtare të mikro-çarmatimit .....	25
3.3 Mbledhja e informacionit e të dhënave: një proces i vazhdueshëm i aktiviteteve për Sensibilizimin AVL .....	26
3.4 Metodatat për mbledhjen e informacionit .....	34
3.5 Mbledhja e informacionit si mjet për monitorim dhe vlerësim .....	35
3.6 Trajnimi i Stafit .....	36
3.7 Parimet dhe menaxhimi i Informacionit .....	36
3.7.1 Qartësia dhe transparenca në lidhje me qëllimin e mbledhjes së informacionit .....	36
3.7.2 Fleksibiliteti.....	37
3.7.3 Sasia dhe cilësia e informacionit .....	38
3.7.4 Saktësia .....	38
3.7.5 Krijimi i një rrjeti për mbledhjen e të dhënave mbi viktimat .....	38
3.7.6 Menaxhimi dhe ndarja e informacionit dhe të dhënave.....	39
3.7.7 Siguria.....	39



4	Analiza dhe planifikimi i strategjisë .....	41
4.1	Analiza e informacionit .....	41
4.1.1	Grupet e Shënjestruara.....	42
4.2	Planifikimi strategjik .....	43
4.2.1	Mbështetja institucionale.....	46
4.2.2	Struktura e njësisë së programit .....	46
4.2.3	Trajnimi i stafit .....	46
4.2.4	Koordinimi.....	46
4.3	Vendosja e qëllimit dhe abjektivave të programit.....	47
4.3.1	Objektivat afatshkurtër dhe SMART .....	48
5	Dizenjimi i mesazheve, aktiviteteve dhe materialeve, dhe zgjedhja e medias.....	49
5.1	Përpunimi i kurrikulave për Edukimin mbi Rreziqete AVL.....	49
5.1.1	Mesazhet në lidhje me kërcënimin dhe problemet e AVL.....	49
5.1.2	Mesazhet për reduktimin e rrezikut të AVL .....	50
5.2	Përpunimi i mesazheve për Advokimin e AVL .....	51
5.3	Përpunimi i mesazheve për Informimin e Publikut mbi AVL.....	51
5.4	Shembuj mesazhesh nga programe thelbësore për Sensibilizimin AVL.....	53
5.5	Zhvillimi i mesazheve thelbësorë .....	60
5.6	Zgjedhja e mjeteve të komunikimit .....	61
5.6.1	Komunikimi ndëraktiv përkundrejt atij njëanësor.....	61
5.7	Roli i mediave të ndryshme .....	66
5.8	Shembuj treguesish për monitorimin e mesazheve, aktiviteteve dhe materialeve.....	70
6	Testimi në terren .....	77
7	Zbatimi i Aktiviteteve .....	79
7.1	Plani i Komuniteteve të Sigurta i rishikuar.....	79
7.2	Aktivitete për fëmijët .....	80
7.3	Aktivitete për të rriturit .....	82
8	Monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve dhe materialeve .....	83
8.1	Zhvillimi i një përjasjeje të integruar.....	83
8.2	Nivelet e edukimit .....	84
8.3	Mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e zbulimeve: një përjasje pjesëmarrëse.....	85
8.4	Një kuadër i thjeshtë për monitorimin dhe vlerësimin: zgjedhja e mjeteve të verifikimit .....	85
8.5	Fuqitë dhe dobësitë e krahasuara të metodave të ndryshme të vlerësimit .....	87
	Annex A (Informativ) Termat dhe përkufizimet .....	89
	Annex B (Informativ) Impakti dhe pasojat i AVL .....	93
	Annex C (Informativ) Pyetësorët KAP, shpjegime dhe udhëzime.....	97
	Annex D (Informativ) Përdorimi i intervistave dhe grupeve fokusuese, shembuj dhe udhëzime .....	115
	Annex E (Informativ) Shembull i teknikave pjesëmarrëse (ushtrimi i shkallares) dhe udhëzime për përdorim.....	117
	Annex F (Informativ) Përdorimi i burimeve dytësore, shembuj dhe udhëzime.....	121
	Annex G (Informativ) Shembull i planit të punës për programin e Edukimit për Rrisqet e AVL .....	123

# PMSA - Paketa Mbështetëse e Sensibilizimit AVL

## 1 Hyrja

Shtimi dhe shpërdorimi i Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL)<sup>4</sup> ka një impakt të madh në shoqëritë përfaqë rruzullit. ALV përdoren për të vrarë me mijëra njerëz çdo vit, qoftë në konflikte të armatosura, krime apo aksidente tragjike.<sup>5</sup> E më shumë miliona njerëz terrorizohen, plagosen, përçudnohen apo detyrohen me forcë që të lenë shtëpitë për të jetuar si refugjatë apo persona të shpërngulur brenda vendit. Kur konflikti mbaron, kostot e shtimit dhe shpërdorimit të AVL vazhdojnë të qëndrojnë në kurriz të shoqërisë dhe veçanërisht të grupeve të prekshme e të dobta. Në disa vende nivelet e dhunës dhe kriminalitetit të lidhura me shpërdorimin e armëve mbeten të njëjtat, ose ngrihen, gjatë periudhës së “paqes” që pason konfliktin e hapur. Në raste të tjera dhuna e armatosur nuk lidhet drejtpërsëdrejti me konfliktin e hapur, por pasojat janë të ngjashme.

Vendet e Europës Juglindore (EJL) janë një shembull i shënueshëm i këtij fenomeni global, ku konfliktet e viteve të fundit, të kombinuar me përqindje të larta krimi dhe mbajtje tradicionale të armëve kanë sjellë si rezultat nivele të papranueshme dhe vdekjeprurëse të shtimit dhe shpërdorimit të AVL. Megjithëse natyra e problemit varion ndërmes rajonit, shtimi i AVL mendohet se:

- I kundërvihet ekzistencës së shtetit ligjor.
- Është kontribues në vdekjet e përditshme tragjike.
- Është nxitës për kriminalitetin dhe paqëndrueshmërinë.
- Është përkeqësues i tensioneve shoqërore.
- Është mohues i masave për ndërtimin e besimit në siguri; dhe
- Vepron si një pengesë për zhvillim.

Në kuadrin e sfidave të krijuara nga AVL në rajon, SEESAC, Zyra për Kontrollin e AVL në Europën Juglindore u krijua bashkërisht nga UNDP dhe Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore (SEE) për të dhënë mbështetje projektsh dhe asistencë teknike për të gjitha aktivitetet e kontrollit dhe ndërhyrjeve për AVL brenda SEE. Masat e kontrollit për AVL janë ato politika dhe aktivitete të cilat së bashku ndihmojnë në zgjidhjen e shtimit dhe shpërdorimit të AVL.<sup>6</sup> Ato përfshijnë:<sup>7</sup>

- Kontrolle kufitare të përmirësuara.
- Masa legislative dhe rregullative.
- Pyetësori për AVL.<sup>8</sup>
- Operacionet për mbledhjen e AVL.
- Operacionet për shkatërrimin e AVL.
- Menaxhimin dhe shkëmbimin e informacionit.

<sup>4</sup> Ka një shumëllojshmëri përkufizimesh në qarkullim për AVL dhe konsensusi ndërkombëtar për një përkufizim “korrekt” qëndron akoma për tu vendosur. PMSA adopton përkufizimin e përdorur nga Standartet Rajonale të Mikro-Çarmatimit të Marrëveshjes për Stabilizim Asocim, “Gjithë municionet vdekjeprurëse konvencionale të cilat mund të mbahen nga një luftëtar individual apo një makinë e lehtë, që gjithashtu nuk kanë nevojë për një kapacitet thelbësor logjistik dhe mirëmbajtjeje”.

<sup>5</sup> Shikoni Aneksin B për një trajtim më të detajuar mbi efektet e shtimit të AVL në EJL.

<sup>6</sup> Standartet Rajonale të Mikro-Çarmatimit (RDMS) janë zhvilluar nga SEESAC për të mbështetur veprimtaritë për AVL në secilën nga këto zona duke vendosur procedurat, praktikat dhe normat më të mira operative që janë zhvilluar vitet e fundit në lidhje me kontrollin e AVL. Shikoni RDMS 01.10 Guidë për Standartet Rajonale të Mikro-Çarmatimit dhe Masave të kontrollit të AVL. <http://www.seesac.org/resources/framework.htm>

<sup>7</sup> Shikoni RDMS 02.10 Tregues i termave dhe shkurtimeve të AVL.

<sup>8</sup> Një pyetësor AVL përkufizohet më mirë si një studim gjithëpërfshirës i situatës së AVL brenda një territori. Një numër pyetësorësh Kombëtarë të AVL të bërë në vendet e EJL gjatë 2003 kanë dhënë më në fund analizën e detajuar të nevojshme për të mbështetur pretendimet e bëra bashkërisht rreth natyrës së problemit të AVL në rajon duke ekzaminuar shpërndarjen e AVL në secilin vend si edhe rrjedhojat në impaktet mbi krimin, vdekjet, sigurinë dhe ekonominë. Shikoni seksionin 3.2 për më tepër informacion.

- Menaxhimin e stoqeve të AVL; dhe
- Programet për Sensibilizimin e AVL.

Paketa Mbështetëse për Sensibilizimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (PMSA) merret me të fundit prej këtyre masave dhe synon të përpunojë praktikatat më të mira në nivelin operacional për të ndihmuar praktikuesit e Sensibilizimit të AVL në terren.

PMSA është për tu përdorur nga të gjithë të interesuarit që përgatiten të zhvillojnë apo të marrin pjesë në programet e Sensibilizimit të AVL, qofshin këta pjestarë të shoqërisë civile, Autoritetet Kombëtare të AVL, organizatat ndërkombëtare, donatorët, apo forcat siguri/paqe ruajtëse<sup>9</sup>. Çdo grup duhet sigurisht ta përdori PMSA në mënyrë të ndryshme në varësi të nevojave të tija.

## 1.1 Çfarë është PMSA?

Paketa e PMSA përfshin:

- a) Doracakun operativ: Një sërë udhëzimesh të strukturuar logjikisht për ata që zbatojnë programet e Sensibilizimit të AVL, të ilustruara me shembuj nga terreni; dhe
- b) CD-ROM-in: me materiale mbështetëse dhe publikime, duke përfshirë:
  - Dokumenta të nevojshme për referencë.
  - Lidhje me adresa interneti me subjekte si:
    - Fëmijët dhe armët.
    - Teknikat e komunikimit.
    - Edukimi dhe puna me rininë.
    - OJQ-të ndërkombëtare që punojnë me çështje të AVL.
    - Organizatat ndërkombëtare.
    - Minat tokësore.
    - Ndihma programore të përgjithshme.
    - Organizatat kërkimore.
    - Ministritë kombëtare të lidhura me kontrollin e AVL.
    - Standartet Rajonale të Mikro-Çarmatimit në SEE (RDMS).
  - Prezantime Power-Point për përdorim nga aktivistët mbi:
    - Impaktet dhe rreziqet e AVL.
    - Llojet e Armëve.
    - Fakte dhe shifra të përgjithshme.
    - Mbledhjen, ruajtjen e sigurtë dhe shkatërrimin e AVL.
  - Galeri fotografike për Ndërgjegjësimin e AVL me shënime shpjeguese.
    - 'Aktivitete' galeri që përmbajnë fotografi me aktivistë që punojnë në terren.
    - 'Imazhe' galeri që përmbajnë logo dhe fotografi të përdorshme.
    - 'Materiale' galeri që tregojnë materiale të përdorura në fushata të ndryshme.
    - Galeria e Edukimit të Riskut të AVL që përmbajnë materiale shembuj që janë përdorur më përpara në fushatat e krijuara për të ulur sjelljen e rrezikshme me AVL.

<sup>9</sup> Rrekmandimet për donatorët që janë duke marrë në konsideratë mbështetje për programet e Sensibilizimit për AVL janë të përfshira në CD-ROM-in e PMSA, ashtu si edhe një tregues të dhënash për median.





- Prezantime për Njohjen e AVL: imazhe dhe shpjegime të armëve, municioneve dhe eksplozivëve më të përdorur në SEE.
- Galeria mbi mbledhjen e AVL.
- Galeria mbi shkatërrimin e AVL.
- Materiale për ngritjen e fondeve;
  - Udhëzime për krijimin e projekt-propozimeve për Sensibilizimin e AVL.
  - Udhëzime për donatorët që marrin në konsideratë mbështetjen për projekte për Sensibilizimin e AVL.
- Tregues të dhënash për median.



## 2 PMSA – Konceptet dhe përqsja

Ky seksion paraqet konceptet dhe principet thelbësore të gjetshme në PMSA . Ato janë si vijon:

- Konceptet e Sensibilizimit AVL dhe tre komponentët e tij të komunikimit:
  - Edukimi mbi Rreziqet e AVL.
  - Advokimi për AVL.
  - Informimi Publik për AVL.
- Rëndësia e vendosjes së objektivave të qarta programore për Sensibilizimin AVL.
- Integrimi i Sensibilizimit AVL me ndërhyrjet e mikro-çarmatimit.
- Ndërmarrja e dy tipeve programesh për sensibilizimin e AVL: Programet e veçuara të Edukimit për Rreziqet e AVL, dhe programet e Sensibilizimit AVL në mbështetje të mbledhjes së AVL.
- Përdorimi i aktiviteteve të bazuara në komunitet për të rritur ndërgjegjësimin (dhe në veçanti “Planet e Komuniteteve të Sigurta”).
- Problemet e sigurisë dhe Menaxherët e Programeve “Detyra për Kujdesje”.
- Integrimi i Sensibilizimit AVL me aktivitete të tjera; dhe
- Rëndësia e ndjekjes së ciklit të programit.

### 2.1 Përkufizimi i ndërgjegjësimit AVL

Koncepti bazë i përdorur në PMSA<sup>10</sup> është ai i një programi të Sensibilizimit AVL; një ndërhyrje programatike e krijuar për të ngritur ndërgjegjshmërinë shoqërore rreth çështjeve të AVL dhe për të ndikuar për ndryshime pozitive shoqërore. Një program Sensibilizimi AVL mund të përkufizohet si:


***“Një program aktiviteteve të ndërmarrja me qëllimin përfundimtar për të minimizuar, dhe atje ku është e mundur për të eliminuar, pasojat negative të kontrollit të pamjaftueshëm të AVL duke ndërmarrë një kombinim të saktë të Edukimit për Rreziqet e AVL, Advokimin e AVL dhe fushatat për Informimin Publik të cilat punojnë së bashku në bashkëpunim me programe të tjera të ndërhyrjes shoqërore për të ndryshuar sjelljet dhe për të lehtësuar zgjidhjet e duhura alternative në një periudhë afatgjatë.”***

Programet e e Sensibilizimit AVL mund të konsiderohen se kanë 3 komponentë komunikimi; 1) Edukimi mbi Rreziqet e AVL. 2) Advokimi për AVL. 3) Informimi Publik për AVL. Në fakt, do të ketë raste ku disa përbërës nuk janë të përfshirë në program (për shembull Programet e veçuara për Advokimin e AVL dhe ato të Edukimit për Rreziqet e AVL), por në raste të tjera, dhe veçanërisht në rastin e rëndësishëm të ndërhyrjeve kombëtare të mikro-çarmatimit, programet e Sensibilizimit të AVL duhet të përdorin të tri format e komunikimit.

<sup>10</sup> Një guidë e shkurtër për principet e AVL mund gjithashtu të gjendet në RDMS 06.10 Zhvillimi dhe Zbatimi i programeve për Sensibilizimin e AVL. [http://www.seesac.org/resources/current\\_eng.htm](http://www.seesac.org/resources/current_eng.htm)



**Diagrama 1: Tre komponentet e programeve të Sensibilizimit AVL**



Çdo komponent shpjegohet në mënyrë më të detajuar më poshtë, dhe objektivi i tij komunikativ do të përkufizohet. Përkufizime të plota jepen në Aneksin A.

### 2.1.1 Edukimi mbi Rreziqet e AVL

Edukimi mbi Rreziqet e AVL<sup>11</sup> mund të përkufizohet si:

*“Një proces që promovon adoptimin e sjelljeve më të sigurta nga grupet në rrezik dhe nga mbajtësit e AVL duke informuar njerëzit për rreziqet dhe kërcënimet e AVL dhe duke i edukuar ata për sjellje më të sigurta alternative.”*

Edukimi mbi rrisqet e AVL mund të zbatohet si një aktivitet i veçuar në kontekste ku asnjë program kombëtar AVL është duke u zbatuar. Nëse një program kombëtar zbatohet në një kohë të mëvonshme, rrjetet, sistemet dhe metodat e përdorura nga programi i Edukimit mbi Rreziqet mund të adoptohet për të mbështetur programin kombëtar. Në disa situata (për shembull regjistrimi i armëve apo ndërhyrjet për mbledhjen) Edukimi mbi Rreziqet e AVL mund të përdoret si një shtesë sigurie për të gjitha format e tjera të komunikimit për Sensibilizimin e AVL. (Shikoni Seksionin 2.5)

### 2.1.2 Advokimi për AVL

Advokimi për AVL përkufizohet si:

*“Një proces i cili synon të ngrejë problemet dhe çështjet e AVL me publikun e gjerë, autoritetet, median, qeveritë dhe institucionet e tyre për të arritur ndryshimet në nivelin institucional dhe/ose atë individual.”*

Shembuj specifikë do të përfshinin fushata për të vënë në dukje problemet e AVL dhe çështjet në komunitetet ku nuk i jepet rëndësia e duhur, apo ato që krijohen për njerëzit që të dorëzojnë apo regjistrojnë armët. Në rastit e fundit aktivitetet për Advokim do të ndërmerren në mbështetje të një ndërhyrjeje mikro-çarmatimi apo në vazhdim të iniciuar dhe administruar nga organizmat koordinative kombëtare. Sidoqoftë ashtu siç është theksuar, advokimi për AVL mund të synojë të promovojë masat për kontrollin e AVL atje ku ato mungojnë, apo kuptohet se mungojnë.<sup>12</sup>

<sup>11</sup> Termi ‘advokim’ mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme. Siç është përkufizuar këtu përfshin si metodat dhe mesazhet lartësisht të shënjestruara të nevojshme për të angazhuar vendim-marrësit (gjithashtu e njohur si lobim) dhe ‘fushatimin’ në të cilin programet e komunikimit shënjestrojnë publikun e gjerë me mesazhe më të thjeshta dhe metoda më të ndryshme.

<sup>12</sup> Shikoni për shembull fushatën për një Traktat Ndërkombëtar të Tregtisë së Armëve, e hapur bashkarisht nga IANSA, International Alert dhe Oxfam në Tetor 2003 – <http://www.controlarms.org>.



### 2.1.3 Informimi Publik (AVL)

Për qëllimin e PMSA, Informimi Publik (AVL) përkufizohet si:

*“Informacion që shpërndahe apo publikohet për qëllimin kryesor të mbajtjes së publikut plotësisht të informuar rreth kushteve ekzakte të një ndërhyrjeje AVL, duke përfituar kështu mirëkuptimin dhe mbështetjen e tij.”*

Në kontrast me veprimtaritë e Advokimit, veprimtaritë e Informimit Publik nuk ndërmerren për të nxitur por për të informuar. Meqenëse programet e mikro-çarmatimit mund të kenë shumë përbërës të ndryshëm, dhe të zbatohen në faza të ndryshme, përmbajtja e Informimit të Publikut si përbërës i Sensibilizimit për AVL do të ndryshojë në kohë, në varësi të çështjeve ligjore, kushteve të amnistive për AVL, modaliteteve të regjistrimit të AVL, mbledhjes dhe shkatërrimit si dhe shpërndarjes së skemave shtytëse. Në çdo rast qëllimi është mbajtja e publikur në informim të plotë.

Tabela e mëposhtme eksploron këto tre koncepte në mënyrë më të detajuar.

**Tabela 1: Tre përbërësit e komunikimit për Sensibilizimin për AVL në mënyrë të detajuar**

	EDUKIMI MBI RREZIQET AVL	ADVOKIMI PER AVL	INFORMIMI PUBLIK AVL
<b>Objektivat e komunikimit AVL</b>	<p>Të rrisë sensibilizimin për të bërë njerëzit që të mendojnë dhe ti informojë ata rreth rreziqeve &amp; kërcënimeve të sjella nga AVL</p> <p>Të ndryshojnë qëndrimet, sjelljet e individëve dhe/ose komuniteteve të prekura, rreth përdorimit të AVL</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të informojë njerëzit rreth masave të sigurisë në rastet e mbledhjes së armëve / aktiviteteve të amnistisë</li> </ul>	<p>Të marrë mbështetjen e publikut, rekomandime apo reklamë pozitive rreth problemeve dhe çështjeve të AVL dhe të nxisë ndryshime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në nivelin institucional (psh. politik, ligjor) dhe:</li> <li>Në nivelet individuale (psh. për të inkurajuar njerëzit që të dorëzojnë armët si pjesë e programeve të mbledhjes së AVL)</li> </ul>	<p>Të japë informacion në kohë, të saktë dhe të sigurtë mbi natyrën e ndërhyrjeve të AVL.</p>
<b>Grupet e Shënjestruara</b>	<p>Komunitetet e prekura (psh. fëmijët mbajtës të armëve, të afërmit e tyre)</p>	<p>Publiku i përgjithshëm, autoritetet, media, qeveritë, donatorët etj.</p> <p>Mbajtësit e armëve, agjentët mbledhës, grupet e shënjestruara sipas kontekstit (psh, fëmijët, gratë), njerëz me influencë në komunitet</p>	<p>Gjithë komuniteti</p>
<b>Zgjatja kohore</b>	<p>Afatgjatë</p>	<p>Në varësi të kontekstit dhe të programeve të mbledhjes së armëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Afatgjatë (Ndryshime Institucionale)</li> <li>Ndryshime individuale afatshkurtra ose afatgjata (psh. dorëzimi i armëve si pjesë e programeve të amnistisë)</li> </ul>	<p>Pak më përpara se të ndërhyet dhe gjatë ndërhyrjes.</p>



	EDUKIMI MBI RREZIQET AVL	ADVOKIMI PER AVL	INFORMIMI PUBLIK AVL
<b>Metodat</b>	Theks i veçantë tek aktivitetet e bazuar në komunitet për të mundësuar që komunitetet të zgjidhin problemet me të cilat përballen (psh. Planet e Komuniteteve më të Sigurta), por mnd të përdoren dhe metoda në stilin e Informimit Publik	Çfarëdo lloj Advokimi në varësi të strategjisë	Çfarëdo lloj strategjie mund të përdoret, megjithëse madhësia e publikut të shënjestruar favorizon përdorimin e medias, veçanërisht të asaj me mbulim të madh dhe me punë të vazhdueshme
<b>Shembuj Aktivitetesh</b>	Planet e Komuniteteve më të Sigurta me aktivitete të veçanta për grupe të veçanta (psh. diskutime në grup, fëmijë me fëmijë, teatër në komunitet, lojra me role, trajnime për mësuesit)  Shpërndarja e “kartave të sigurisë” tek agjentët e mbledhjes së armëve dhe publiku i gjerë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komisioni kombëtar</li> <li>• Iniciativat rajonale (psh. konferenca, seminare)</li> <li>• Grupet e diskutimit, programet radio dhe TV, intervistat</li> <li>• Artikujt e gazetave</li> <li>• Marshimet publike</li> <li>• Leksionet publike</li> <li>• Dëshmitë e viktimave</li> <li>• Mesazhet e shpërndara nga drejtues me eksperiencë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpërndarja e fletushkave të informimit publik nëpërmjet shërbimit postar</li> <li>• Lajmërimet në Shërbimin Publik (LSHP) në radio dhe TV</li> <li>• Shpërndarja e dokumenteve të “Procedurës Standarte të Veprimit ” për agjentët e mbledhjes dhe magazinimit duke i informuar ata për rregullat e ndonjë amnistie dhe për sjelljet që priten prej tyre</li> </ul>

## 2.2 Përkufizimi i objektivave të programit për Sensibilizimin e AVL <sup>13</sup>

Ndërsa qëllimi i përgjithshëm i një strategjie të Sensibilizimit për AVL mund të përshkruhet saktësisht si “të përmirësojë sigurinë në komunitete”, objektiva më precizë operacionale janë të nevojshëm për të formuluar një program të punueshëm. Çdo program Sensibilizimi AVL, qoftë i vetëm si Edukimi mbi Rreziqet apo Sensibilizim në mbështetje të ndërhyrjeve të tjera AVL ka shumë mundësi të ketë disa nga objektivat e mëposhtëm:

### 2.2.1 Objektiva të Lidhura me Njohurinë

- Sensibilizim më i lartë mbi problemet e AVL.
- Sensibilizim më i lartë mbi nevojën për sjellje të sigurta.
- Sensibilizim më i lartë i praktikave më të mira mbi sjelljet e sigurta.

### 2.2.2 Objektiva të Lidhura me Qëndrimin

- Një besim më i rritur për lidhjen mes sasisë së AVL dhe madhësisë së dhunës në shoqëri.
- Një besim më i rritur për faktin se diçka mund të bëhet nga komuniteti rreth problemit të AVL.
- Një dëshirë më e rritur për të vënë në pikëpyetje hegjemoninë e kulturës së armëve.
- Një sensibilizim më i rritur i pronësisë që ka komuniteti mbi problemet e AVL dhe mbi armët në vetvete (për shembull si një para-kërkesë për një program të sukseshëm të Armëve në Shkëmbim të Zhvillimit).

<sup>13</sup> Programi i Sensibilizimit për AVL duhet të mbështesë objektivat operacionale të ndërhyrjes së përgjithshme për AVL. Detaje të mëtejshme, dhe shembuj objektivash operacionale kombëtare mund të gjenden në RDMS 01.10.



### 2.2.3 Objektiva të Lidhura me Sjelljen

- Adoptim më masiv i sjelljeve të sigurta.
- Një reduktim në transferimin dhe tregëtinë e paligjshme të AVL në tregun e zi.
- Frekuencë më e madhe e mbledhjes së sigurtë nga komuniteti të AVL të vjedhura.
- Pjesëmarrje më e madhe në skemat e regjistrimit të AVL.
- Pjesëmarrje më e madhe në skemat e mbledhjes së AVL.

### 2.2.4 Objektiva të Lidhura me Politikat Institucionale dhe Praktikën

- Adoptimi nga autoritetet e rëndësishme lokale dhe kombëtare i politikave dhe praktikave që promovojnë alternativa përkundrejt kulturës së dhunës.
- Paraqitja dhe zbatimi i skemave të regjistrimit të AVL.
- Paraqitja dhe zbatimi i skemave të mbledhjes së armëve.
- Zhvillimi i normave kundrejt përdorimit të paligjshëm apo blerjes së AVL nga autoritetet e rëndësishme lokale dhe kombëtare.

Objektiva të ngjashme me këto më sipër do të zhvillohen si pjesë e një strategjie të përgjithshme programi, që do të rrjedhë nga një analizë e informacionit të mbledhur (Shikoni seksionet 3 dhe 4).

## 2.3 Integrimi i Sensibilizimit AVL me ndërhyrjet e mikro-çarmatimit

Iniciativat e çarmatimit AVL shpesh referohen si iniciativa të “mikro-çarmatimit” – për ti dalluar ato nga tentativat e reduktimit të sasisë së armëve të mëdha konvencionale. Në EJL, iniciativat kombëtare të mikro-çarmatimit deri më tani janë zbatuar në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi-Serbi. Mikro-çarmatimi mund të përkufizohet si vijon:

***“Monitorimi, mbledhja, kontrolli dhe shkatërrimi përfundimtar i armëve të vogla, municionit respektiv dhe eksplozivëve dhe armëve të lehta të luftëtarëve dhe shpesh edhe të popullsisë civile. Përfshin zhvillimin e programeve të përgjegjshme të menaxhimit të armëve.”***

Kudo që një iniciativë kombëtare mikro-çarmatimi ekziston apo është planifikuar, strategjitë e programit të Sensibilizimit AVL duhet të përgatiten me një synim për ti mbështetur ato dhe për të përfituar nga mundësitë e ofruara. Në disa raste përbërësi i Sensibilizimit të AVL i iniciativës kombëtare të mikro-çarmatimit do të jetë i vetmi në llojin e tij në shkallë kombëtare. Në raste të tjera disa agjenci (psh. OJQ, ministri qeveritare, UNICEF) mund të jenë tashmë të përfshira në aktivitete të Sensibilizimit të AVL si të tipit të Edukimit mbi Rreziqet apo ato të Advokimit.

#### **Kutia 1: Sensibilizimi AVL në Shqipëri, 1999**

Në Shqipëri, programi i mbledhjes së AVL u mbështet nga sensibilizim ndërkombëtar dhe kombëtar i çështjes së AVL. Mediat ndërkombëtare (BBC, CBS etj.) kanë transmetuar programe mbi çështjen dhe në nivel kombëtar, reklama janë transmetuar në TV, takime dhe konferenca janë organizuar për të sensibilizuar komunitetet mbi problemin. Mesazhi kryesor i transmetuar ishte rreth amnistisë për njerëzit që do të dorëzonin armët gjatë asaj periudhe. Programi i Sensibilizimit AVL tani përfshin fëmijët e shkollave nëpërmjet konkurseve, mësimeve mbi sigurinë, debate midis studentëve etj. Qëllimi është që të punohet me fëmijët për të ndikuar prindërit mbi mbajtjen e armëve. Projekte zhvillimi në këmbim të armëve janë zbatuar gjithashtu për të inkurajuar komunitetet që të dorëzojnë AVL e tyre.

Është detyrë e stafit të programit të Sensibilizimit për AVL që të synojë të identifikojë çdo veprimtari në vazhdim apo të saponisur në zonën e tyre të veprimit. Kjo përgjegjësi shtrihet tek të gjithë aktorët, qofshin këta duke



punuar të pavarur apo në bashkëpunim me të tjerët (psh. autoritetet kombëtare të AVL). Atje ku programe të Sensibilizimit AVL nuk kanë mbështetur në të kaluarën përpjekje çarmatimi më të gjera, një plan pune i integruar nga agjensitë e interesuara duhet të kërkohet në mënyrë që impakti i programit të mund të maksimizohet nëpërmjet koordinimit. Programet ekzistuese duhet të rishikojnë strategjinë e tyre për të marrë parasysh ndërhyrjet kombëtare (psh. mbledhjen apo regjistrimin e armëve), ndërsa planifikuesit e programeve kombëtare të Sensibilizimit AVL duhet të synojnë të mësojnë mësimet e programeve ekzistuese dhe të evitojnë përsëritjen. Një ndryshim strategjie do të thotë edhe një ndryshim në objektiva, metoda dhe mesazhe. Kështu përshembull, një programi Sensibilizimi për AVL që ka qënë ndërkaq në vazhdim do ti duhej në këtë rast që të shtonte në listën e objektivave të tij “të inkurajojë pjesëmarrjen e komunitetit në aktivitetet e mbledhjes së armëve”.

#### **Kutia 2: Rishikimi i strategjisë së programit për të marrë parasysh rrethanat që ndryshojnë**

Meqënëse ndërhyrjet AVL janë të ndjeshme kundrejt një numri faktorësh që variojnë nga nivelet e fondeve e deri tek moti dhe situata e sigurisë, Menaxherëve të Programit u kërkohet që të monitorojnë rrethanat ndryshuese dhe të ndryshojnë planet dhe objektivat sipas tyre. Aty ku planet e përgjithshme të programit të ndërhyrjes AVL ndryshojnë (psh. për shkak të një përkeqësimit të situatës së rendit publik) objektivat e programit të Sensibilizimit AVL duhet të ndryshojnë respektivisht.

Objektivat e programeve të Sensibilizimit AVL janë në çdo rast të lidhura ngushtë me ato të ndërhyrjeve kombëtare të mikro-çarmatimit<sup>14</sup>. Objektivat operacionalë në një ndërhyrje mikro-çarmatimi zhvillohen gjatë fazës së planifikimit të programit dhe mund të përfshijnë në përgjithësi:

- Një reduktim të numrit të AVL në dispozicion të kriminelëve.
- Një reduktim të numrit të aksidenteve si pasojë e përdorimit të armëve dhe municionit.
- Nevojës për të bërë publike lidhjen midis sasisë së AVL dhe sasisë së dhunës në shoqëri.
- Nevojës për të ndërtuar ndërgjegjësimin e komunitetit mbi problemin dhe rrjedhimisht solidaritetin e komunitetit.
- Reduktimin dhe shkatërrimin e transferimit dhe tregëtisë së paligjshme të AVL në tregun e zi.
- Kontrollin e armëve të ligjshme nëpërmjet legjislacionit kombëtar dhe regjistrimit.
- Mbledhjen e sigurtë nga komuniteti të AVL të vjedhura.
- Uljen e shikueshmërisë së hapur të armëve në komunitet dhe adresimin e kulturës së armëve.
- Zhvillimin e normave kundër përdorimit ose blerjes së paligjshme të AVL; apo
- Përdorimin e mikro-çarmatimit si një kuadër lançimi për ngritje kapacitetesh në të ardhmen dhe zhvillim të qëndrueshëm.


Në shumë raste një program mikro-çarmatimi do të ketë më shumë se një objektivi (shumica e atyre mësipër janë të përshtatshëm). Në këtë rast, Autoriteti kombëtar i AVL (njësia organizative të cilës i është caktuar të drejtojë programin kombëtar – shikoni fjalorthin) duhet të japë prioritet të qartë objektivave të programit.

Rrjedha logjike e programeve kombëtare të mikro-çarmatimit parashtrohet në diagramën që vijon. “Rrjedha e procesit” tregon se si pjesët e një programi tipik duhet të përkojnë me njëra-tjetrën, dhe rolin që luajnë programet e Sensibilizimit AVL.

<sup>14</sup> Sipas RMDS 05.10 dhe 05.20, transparenca do të jetë parimi bazë i programeve të mbledhjes dhe shkatërrimit të KAVL



Diagrama 2: Rrjedha e Procesit të Ndërhyrjes për AVL



### 2.3.1 Edukimi mbi Rreziqet i veçuar kundrejt programeve të Sensibilizimit AVL në mbështetje të mbledhjes së AVL.

Tërësia e objektivave të Sensibilizimit AVL të parashtruara më lart në Seksionin 2.2 shërbejnë për të treguar se shumë tipe programesh të Sensibilizimit AVL mund të ndërmerren. Në shoqëritë ku çështja e AVL ka një profil të ulët të pamerituar, fushata advokimi të veçuara të AVL mund të jenë të nevojshme për të trajtuar çështjen me publikun dhe autoritetet. Në rrethana të tjera mund të jetë më e këshillueshme që të zbatohen programe të Edukimit për Rreziqet e AVL të krijuara për të promovuar sjellje më të sigurta mes grupeve të rrezikuara. Së fundmi, atje ku Sensibilizimi për AVL duhet të ndërmerret në kontekstin e një programi mikro-çarmatimi, tërësia e objektivave të mikro-çarmatimit të rradhitura në Seksionin 2.3 krijon mundësi të shumta për çfarëdo lloj programi të Sensibilizimit AVL që mbështetet.

Në se ekzistojnë burime alternative për ata që dëshirojnë të ndërmarrin punë të veçuar për Advokimin e AVL<sup>15</sup>, dhe në kuadrin e nevojës së vazhdueshme për Edukimin mbi Rreziqet dhe çarmatimin efektiv në EJT, PMSA fokusohet në dy tipe programesh të Sensibilizimit për AVL; Edukimin mbi Rreziqet e AVL të veçuar, dhe Sensibilizimin mbi AVL në mbështetje të mikro-çarmatimit, (veçanërisht në fazën e mbledhjes së AVL). Tabela e mëposhtme eksploron këto tipe programesh në mënyrë më të detajuar.

<sup>15</sup> Shikoni “Veprimi kundër Armëve të Vogla. Një Doracak Burimor dhe Trajnimi”, nga Jim Coe dhe Henry Smith. (ISBN 085598497x) i publikuar nga International Alert, Oxfam GB dhe Safeworld. (i përfshirë në CD-ROMin e PMSA); si dhe burime të tjera të dhëna nga IANSA që përfshijnë “Jetë të Thyera, Rasti i Kontrollit të Fortë të Armëve Ndërkombëtare” gjendet në [www.iansa.com](http://www.iansa.com)



**Tabela 2: Edukimi mbi Rreziqet i veçuar Sensibilizimit për AVL në mbështetje të mikro-çarmatimit.**

	AKTIVITETET E SENSIBILIZIMIT AVL NË MBËSHTETJE TË MIKRO-ÇARMATIMIT	AKTIVITETET E SENSIBILIZIMIT AVL SI NJË AKTIVITET I VEÇUAR
<b>Zgjatja Kohore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Varion sipas zgjatjes kohore të programeve të mikro-çarmatimit – shpesh mund të jetë edhe afatshkurtër</li> <li>Në rastin e Sensibilizimit për AVL si një mbështetje për ndërhyrjet e mbledhjes së AVL, një periudhë ndërgjegjësimit<sup>16</sup> 2-3 mujore është e nevojshme përpara mbledhjes. Një periudhë minimumi 4-6 mujore është e rrekomandueshme për të shoqëruar një amnisti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendoset në një bazë afatgjatë</li> </ul>
<b>Mesazhet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Edukimi mbi Rreziqet (psh. në lidhje me masat e sigurisë që duhen marrë ndërsa përdoren armët)</li> <li>Advokimi (mbi problemet dhe çështjet, psh. inkurajimi i njerëzve që të dorëzojnë armët)</li> <li>Informimi Publik (në lidhje me ndërhyrjen e mikro-çarmatimit në vetvete)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Edukimi mbi Rreziqet (mbi rreziqet dhe kërcënimet e armëve dhe sjelljet më të sigurta), dhe/ose;</li> <li>Advokimi (mbi çështjet dhe problemet)</li> </ul>
<b>Metodat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Një përmbledhje e aktiviteteve të bazuara në komunitet të mbështetura nga Informimi Publik</li> <li>Edukimi mbi Rreziqet që do të jepet nëpërmjet një kombinimi stilesht të metodave të bazuara në komunitet dhe Informimit Publik</li> <li>Informimi Publik i veçuar vetëm në një rast emergjence</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktivitete të bazuar në komunitet të mbështetura nga Informimi Publik.</li> </ul>
<b>Grupet e Shënjestruara</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Do të vendosen nga analiza e informacionit të mbledhur (Shikoni Seksionin 3), por tipikisht përmbledh: mbajtësit e armëve, të afërmit e tyre, autoritetet, OJQ-të lokale, policinë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Varion nga strategjia dhe objektivat e programit</li> <li>Në rastet e Advokimit të krijuar për të ngritur profilin e çështjeve të AVL grupet e shënjestruara mund të përfshijnë median, autoritetet etj.</li> <li>Atje ku ndërmerret i veçuar Edukimi mbi Rreziqet, grupet në rrezik do të shënjestrohen mbi bazën e informacionit të mbledhur (shikoni Seksionin 3), psh. mbajtësit e armëve, djemtë adoleshentë</li> </ul>
<b>Çështjet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çështje të integritit dhe planifikimit kombëtar</li> </ul>	<p>Edukimi mbi Rreziqet e AVL mund të përdoret i izoluar për të reduktuar sjelljet mrrëzikshme të lartë, por gjithashtu edhe si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Një mjet advokimi drejt autoriteteve për projekte të ardhshme çarmatimi</li> <li>Një fazë përgatitore për fushata të mundshme çarmatimi</li> </ul>

<sup>16</sup> Përbërësi i programit të Sensibilizimit të AVL që ndodh pak më përpara se të fillojë amnistia për armët apo fushata e regjistrimit shpesh quhet “faza e ndërgjegjësimit”.



Advokimi për AVL mund të zbatohet si një aktivitet i veçuar për të rritur çështjet e AVL në kontekste ku ndërhyrjet e mikro-çarmatimit nuk janë planifikuar dhe ku nuk është duke u zbatuar punë për Edukimin mbi Rreziqet e AVL.

Atje ku programet e Sensibilizimit AVL janë krijuar për të mbështetur ndërhyrjet e mbledhjes së AVL, objektivat e komunikimit për çdo përbërës të Sensibilizimit të AVL ndryshojnë respektivisht:

- Komunikimi për Edukimin mbi Rreziqet nuk dizajnohet më thjesht për të rritur ndërgjegjësimin e rreziqeve dhe kërcënimeve që vijnë nga AVL, por gjithashtu për të siguruar që procesi i mbledhjes në vetvete të jetë një operacion pa rreziqe.
- Komunikimi për Advokimin krijohet dhe përshtatet për të inkurajuar dorëzimin e AVL.
- Komunikimi i Informimit Publik krijohet dhe përshtatet për ti dhënë publikut me saktësi dhe në kohë informacionin në lidhje me rregullat e sakta të një amnistie për armët, dhe specifikisht:
  - Datat e amnistisë për AVL.
  - Mënyrat dhe kohën e mbledhjes (psh. vizita pro-aktive nga agjentët e mbledhjes në vende të paracaktuara, apo bazim tek publiku për të vizituar pikat e vendosura të mbledhjes).
  - Organizatat e përfshira (psh. policia, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të).
  - Aspektet ligjore (çfarë mund dhe nuk mund të dorëzohet; alternativat e regjistrimit; dënimet).
  - Detaje në lidhje me çfarëdo përbërës që shërben si shtytjeje dhe që i bashkohet mbledhjes së AVL.

Në rastin e Edukimit për Rreziqet AVL të veçuar objektivat e komunikimit mbeten ato që janë parashtruar më lart.

### **Kutia 3: ‘Kruno Kuna’ – një program i Edukimit mbi Rreziqet e AVL në Kroaci**

Në Kroaci, kampioni kombëtar i sportit të qitjes Dubravko Gvozdanovic ka zbatuar një program të veçuar të Edukimit mbi Rreziqet e AVL për disa vite me rradhë si në klubet e armëve (duke i mësuar të rriturve sigurinë e mbajtjes së armës) ashtu edhe në shkolla. Figura qendrore e programit për fëmijët është seriali i filmave vizatimorë “Kruno Kuna” në të cilin një djalë i vogël mbaron me sukses kursin e Edukimit mbi Rreziqet e AVL në shkollë dhe më pas ndalon motrën e tij më të vogël që të luaj me armë. Mesazhet bazë për fëmijët në Kruno Kuna për fëmijët që bien në kontakt me AVL janë:

- Ndalo!
- Mos prek
- Largohu
- Lajmëro një të rritur

Këto mesazhe të thjeshta transmetohen nëpërmjet një varieteti mesazhesh përmbushëse, duke përfshirë postera, libra me tregime të ilustruara, bluza, libra për ngjyrosje si dhe letra informimi për prindërit e fëmijëve. Materialet përdoren gjatë mësimeve dhe ushtrimeve në klasë pas të cilave fëmijët i nënshtrohen një testimi mbi njohuritë e tyre për sjelljet e sigurta me AVL dhe fituesit shpërblehen me bluza. Gjatë 2003 rreth 700 fëmijë kanë kompletuar kursin.

*Burimi: Intervistë me Dubravko Gvozdanovic, President i Klubit të Qitjes Delta Practical*

## 2.3.2 Lidhja me legjislacionin AVL, dhe aktivitetet e mbledhjes dhe shkatërrimit

Ashtu siç tregon edhe Diagrama 2, një ndërhyrje mikro-çarmatimi ka përbërës dhe faza të ndryshme. Meqënëse faza e mbledhjes së informacionit në çdo ndërhyrje AVL është në çdo rast një pjesë përbërëse e përpjekjes për Sensibilizimin e AVL (shikoni Seksionin 3), pjesët e mbetura janë pjesët përbërëse të legjislacionit, mbledhjes dhe shkatërrimit. Në çdo rast do të ketë ngjarje të vlefshme për tu shënuar të cilat programuesit e Sensibilizimit të AVL duhet ti marrin në konsideratë për ti integruar në përpjekjet e komunikimit, për shembull:

- Mbledhja e AVL.
  - Përgatitjet për mbledhjet e AVL (psh. infrastruktura, rrugët, datat) si edhe për çfarëdo skemë nxitëse të lidhur (psh. vendosja e një konkursi për Nxitësit në Këmbim të Armëve).
  - Mbledhja faktike dhe magazinimi i përkohshëm i AVL.
  - Transporti i mëpasshëm në vende të sigurta.
  - Shpërndarja e nxitësve.
- Shkatërrimi i AVL.
  - Shkatërrimi fizik i armëve, municionit dhe lëndëve eksplozive të mbledhura dhe/ose me tepricë.
- Legjislacioni për AVL.
  - Zhvillimi i legjislacionit (përgatitja dhe kalimi nëpërmjet parlamentit).
  - Amnistia (deklarimi i amnistisë, si dhe datat e fillimit dhe mbarimit).
  - Rivendosja e ligjit dhe zbatimi i çfarëdo mase të re (psh. kontrollet, arrestimet dhe procedimet e shkelësve të ligjit.)

Të gjitha të mësipërmët janë në fakt ngjarje apo aktivete të vlefshme për tu shënuar që i paraqesin stafit të programit të Sensibilizimit të AVL materiale burimore të gatshme dhe lehtësisht të gatshme. Ato janë me dobi të veçantë për formatet e masmedias si lajmet e TV por gjithashtu mund të japin imazhe dhe statistika që mund të përdoren në treguesit e të dhënave për median, lajmërimet për shtyp, fletëpalosjet etj:

- a) si një rast i pastër 'informimi publik' (psh. në një rast mbi të cilin publiku mund të informohet në lidhje me procesin e përpjekjeve për mbledhje, kohën e mbetur, termat e dorëzimit etj);
- b) nënvizimi për publikun e shënjestruar i nevojës për të dorëzuar/mbledhur dhe shkatërruar armët, duke çuar kështu më përpara objektivat e Edukimit mbi Rreziqet dhe Advokimin;
- c) të provohet, (veçanërisht duke përfshirë shoqërinë civile në një rol monitorues),<sup>17</sup> se legjislacioni, proceset e mbledhjes dhe shkatërrimit janë transparente dhe të sigurta, duke rritur kështu besimin dhe interesin;
- d) të demonstron se si komunitetet dhe individët pjesëmarrës nuk duhet që të kenë frikë nga pjesëmarrja në skemat e mikro-çarmatimit (psh. procedimi apo kërcënimi pas dorëzimit të armëve) dhe që mundet edhe të shohin përfitime; dhe
- e) të paraqesin një shans për aktivitete të tjera të Sensibilizimit për AVL si psh. diskutimet publike.

### Kutia 4: Mungesa e transparencës rreth shkatërrimit të AVL

Transparenca dhe qartësia kundrejt komuniteteve janë jetësore për zbatimin me efikasitet të programeve të AVL. Ndërtimi i besimit me njerëzit është thelbësor gjatë zbatimit të projektit pilot të 1998 Armë në Shkëmbim të Zhvillimit (ASHZH) (Weapons in Exchange for Development) në Gramsh, Shqipëri. Ndonëse projekti pati një sukses të madh, mungesa e transparencës në lidhje me shkatërrimin e armëve krijoi probleme. Megjithatë Qeveria Shqiptare fillimisht premtoi të shkatërronte armët e mbledhura, kjo gjë nuk ndodhi. Shumë komentues kanë mendimin se kjo mundësi e humbur pengoi mbledhjen e mëtejshme të AVL.

*Burimi: Intervistë me stafin e UNDP të përfshirë në Projektin Pilot në Gramsh.*

<sup>17</sup> Sipas PMSA OS.10 dhe OS.20, transparenca do të jetë një parim kyç i programeve të mbledhjes dhe shkatërrimit të AVL.



Mbulimi nga masmediat për çdo përbërës të programit ka qenë i dobishëm në programe të mëparshme. Për shkak të originalitetit dhe impaktit viziv të mbledhjes dhe shkatërrimit faktik të AVL, mbulimi mediatic i këtyre ngjarjeve ka tendencën të ketë impaktin më të menjëhershëm me publikun e gjerë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme gjatë mesit të programeve kur publiku mund të sigurohet se veprimet e premtuara po ndodhin dhe se ata që marrin pjesë po përfitojnë. Pamje televizive të armëve që shkatërrohen dhe intervista me individët të cilët kanë dorëzuar armët dhe janë të përgatitur të veprojnë si avokatë për mbledhjen, janë shumë të këshillueshme. Në rastin e ndërhyrjeve për AVL të cilat lidhin veprime të veçanta me nxitës (psh. Armë në Shkëmbim të Zhvillimit (ASHZH), Armët në Konkurse për Zhvillim (AKZH), dhe Armët në Këmbim të Nxitësve (AKN), mbulimi mediatic i procesit të konkurseve dhe/ose dhënjes së çmimeve do të jetë gjithashtu një mjet thelbësor për të siguruar përsëri publikun se procesi ka qenë i drejtë, në kohë dhe sipas planit.<sup>18</sup>

## 2.4 Aktivitetet e bazuara në komunitet

Deri më tani, shumica e projekteve për Sensibilizimin e AVL të ndërmarra në EJL janë zbatuar në mbështetje të skemave kombëtare apo nën-kombëtare të mikro-çarmatimit. Ato janë mbështetur së tepërmi në përdorimin e metodave të Informimit të Publikut (postera, spote televizive, fletëpalosje) në përpjekjet e tyre për të rritur përqindjet e dorëzimit të armëve. Për fat të keq, meqenëse këto programe shumë rrallë janë vlerësuar sistematikisht, nuk është e mundur të vendoset se sa e suksesshme ka qenë mbështetja tek këto metoda. Ndërsa kjo përjasje ka qenë shumë e suksesshme në vende më të stabilizuara dhe më të zhvilluara si Australia dhe Mbretëria e Bashkuar, PMSA rekomandon me forcë përdorimin e aktiviteteve të bazuara në komunitet gjatë punës për Sensibilizimin e AVL në vendet e EJL për këto arsye:

- a) eksperiencia e gjatë e mbledhur nga specialistët e edukimit për rrezikun nga minat (ERRM) që kanë punuar në kultura dhe vende të ndryshme ka treguar se ndryshimet në sjellje arrihen shumë rrallë vetëm me përdorimin e teknikave të informimit publik (psh. duke printuar postera dhe duke shpërndarë fletëpalosje), ose edhe nëpërmjet prezantimeve dhe leksioneve direkte. Në vend të këtyre, përfshirja e komunitetit është çelësi për të ndryshuar pozitivisht njohurinë, qëndrimet dhe sjelljet e individëve dhe komuniteteve;
- b) në ambiente të pasigurta, post-konfliktuale apo të ndikuara nga kriminaliteti, pjesmarrja domethënëse e komunitetit kërkohet zakonisht për të ndryshuar sjelljet e krijuara dhe mbështetura nga këto kushte. Kjo mund të jetë sepse publikut i mungon besimi në institucionet shtetërore dhe median, apo sepse frika, e rrënjosur thellë për konflikte që mund të rifillojnë është e vazhdueshme, por cilado qoftë arsyeja, programet e Sensibilizimit të AVL që përballen me këto kushte duhet të bëjnë përpjekje të mëdha për të mbështetur çdo komunikim me aktivitetet e mbështetura në komunitet të drejtuara nga media/qeveria; dhe
- c) prania e vazhdueshme e armëve dhe lëndëve shpërthyesë të stilit ushtarak nëpër komunitete kërkon një element të fortë të Edukimit mbi Rreziqet e AVL në çdo program për Sensibilizimin e AVL. Si një formë e komunikimit për ndryshimin e sjelljes e krijuar për të promovuar adoptimin e sjelljeve më të sigurta, Edukimi mbi Rreziqet e AVL ka nevojë për një nivel domethënës të komunikimit të bazuar në komunitet dhe ndëraktiv nëse synon të arrijë qëllimet.

### 2.4.1 Plani i Komunitetit më të Sigurtë

Forma kyç e aktiviteteve të bazuara në komunitet e rekomanduar nga PMSA është Plani i Komunitetit më të Sigurtë<sup>19</sup>. Plani i Komunitetit më të Sigurtë është një metodë e krijuar për të vendosur nevojat dhe prioritetet e komuniteteve të ndikuara në qendër të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të kontrollit mbi AVL. Është një mjet pjesmarrës i krijuar për:

<sup>18</sup> Shikoni Shënimin 17.

<sup>19</sup> Koncepti është adoptuar nga ai i gjetur në "Planin e Fshatit më të Sigurt" i gjetur në Sensibilizimin mbi Minat, një shembull i të cilit mund të gjendet tek <http://www.icrc.org/web/Eng/siteeng0.nsf/iwplList543/5132954BCB164C14C1256B66005E7F86>. Ndonëse metodat e përdorura në Sensibilizimin për minat dhe Sensibilizimin për AVL janë të ngjashme, një Plan i Komunitetit më të Sigurtë që synon të lehtësojë problemet e AVL do të jetë në mënyrë domethënëse i ndryshëm nga ai i krijuar për të lehtësuar problemet nga minat e tokës, kjo pjesërisht për shkak të faktit se AVL marrin role dhe funksione sociale në një mënyrë që minat nuk e bëjnë.



- a) të ndihmuar stafin e programit në detyrën e vështirë të mbledhjes së informacionit rreth AVL në nivel komuniteti;
- b) të nxjerrë përvojë lokale e cila mund të përdoret për të përmirësuar analizën e informacionit të mbledhur; dhe
- c) të përfshirë vetë komunitetet në vendimet rreth masave të kontrollit mbi AVL.

Modeli i Planit të Komunitetit më të Sigurtë është i bazuar në shkëmbimin e informacionit mes stafit të programit dhe komunitetit, dhe në mes vetë komunitetit. Në këtë mënyrë është një ndihmë në mbledhjen e informacionit që ndihmon stafin e programit në çështjen thelbësore të kuptimit të modeleve të sjelljes në komunitetet e ndikuara dhe në efektet që shtimit/keqpërdorimit të AVL në nivelin lokal. Përfshirja e komunitetit më vonë ndihmon për të zbuluar se si dhe përse njerëzit sillen në mënyrën që ata sillen (psh. funksione të veçanta të armëve brenda komunitetit, faktorët ekonomikë, shqetësimet e sigurisë, presionit shoqëror, traditat etj.). Komunitetet mundet më vonë të përfshihen në procesin e vendimmarrjes rreth masave të mundshme të kontrollit të AVL në komunitetet e tyre (psh. pjesëmarrje në ASZH apo në zonat 'pa armë'). Në këtë mënyrë masat e kontrollit të AVL bëhen përfshirëse, të fokusuara në komunitet dhe sigurojnë maksimumin e përfshirjes të të gjitha seksioneve të komunitetit. Deri në momentin kur kërcënimet nga AVL mund të hiqen, komunitetet janë gjithashtu të përfshira në zhvillimin e strategjive specifike të përkohshme të sigurisë që promovojnë ndryshimet në sjelljen e individëve dhe komunitetit. Plani i Komunitetit më të Sigurtë shpjegohet në mënyrë më të detajuar në Seksionin 7.1.

## 2.5 Çështjet e sigurisë dhe detyrimi për kujdesje

Në ndërmarrjen e punës për Sensibilizimin e AVL, Menaxherët e Programeve si dhe stafi i tyre në terren marrin përsipër një 'detyrim për kujdesje' kundrejtë grupeve të shënjestruara, stafit të programit (shikoni Seksionin 3.6.7) si dhe përfituesve të synuar. Programet duhet që të drejtohen në mënyrë të tillë që të promovohen sjelljet e sigurt dhe që minimizohen rreziqet për ndodhje aksidentesh. Për dy çështjet e ekzaminuara në mënyrë të detajuar nga PMSA, detyrimet për kujdesje mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Edukimi mbi Rreziqet i veçuar: Detyrimi për kujdesje qëndron në krijimin e kurrikulave të Edukimit mbi Rreziqet që informon saktësisht njerëzit mbi rreziqet e njohura dhe lidhura me AVL, si dhe sjelljet që kanë më tepër shans për të ulur këto rreziqe (sjelljet e sigurt me AVL), dhe gjithashtu në zbatimin e programit të Sensibilizimit në mënyrë të sigurt dhe efektive. Informacioni mbi të cilin kurrikula është bazuar do të rrjedhojë pjesërisht nga praktikat universalisht të vlefshme mbi mbajtjen dhe magazinimin e AVL (psh. të mos magazinohen kurrë armë të mbushura në shtëpi)<sup>20</sup>, dhe pjesërisht nga informacioni i mbledhur në vend dhe në komunitet nëpërmjet pyetjeve rreth viktimave të AVL (shikoni gjithashtu Seksionin 3).<sup>21</sup>
- Sensibilizimi mbi AVL si mbështetje e mikro-çarmatimit: Detyrimi për kujdesje konsiston në promovimin e efektshëm të sjelljeve të kujdesshme përpara dhe gjatë zbatimit të programeve në mënyrë që të minimizohen rreziqet e viktimave mes grupeve që kanë më tepër probabilitet të përdorin armë, municione apo lëndë plasëse, apo që të vuajnë efektet e çfarëdo keqpërdorimi.

Mbledhja e AVL nga popullsia civile është një ndërmarrje në vetvete e rrezikshme. Deri më sot, programet e mbledhjes së AVL kanë ndodhur në shumë vende, dhe një numër domethënës dhe i panevojshëm viktimash ka ekzistuar midis civilëve ashtu si edhe agjentëve të mbledhjes. Në fakt, shumë pak mbledhje të AVL në botë kanë ndodhur pa pasur viktimë. Në çdo rast aksidentet janë shkaktuar ose nga keqmbajtja e armëve, municionit dhe eksplozivëve që ishin "më të sigurt për tu lëvizur", ose nga lëvizja e njësisve të pasigurta. Shanset që të tilla aksidente të ndodhin duhet të zvogëlohen nëpërmjet shpërndarjes së mesazheve të përshtatshme mbi procedurat e mbajtjes si dhe mospërdorimi i imazheve që portretizojnë, apo mund të inkurajojnë, sjelljet e pasigurta në materialet e Sensibilizimit.<sup>22</sup>

<sup>20</sup> Ndonëse ekziston një bërthamë grupesh të sjelljes mbi mbajtjen dhe magazinimin e AVL që duhet të adoptohen pavarësisht nga vendi dhe kultura (si në shembullin e dhënë), grupet e shënjestruara, konteksti lokal dhe kultura do të vendosin formën ekzakte të mesazheve të përdorura për të transmetuar këto sjellje bazë. Edukimi mbi Rreziqet e AVL konsiston në më shumë se dhënjën e mesazheve rreth mbajtjes dhe magazinimit të AVL, siç shpjegohet më poshtë.

<sup>21</sup> Referojuni Seksionit 5.1 për shembuj të kurrikulave të Edukimit mbi Rreziqet e AVL.

<sup>22</sup> Referojuni Kartave të Sigurisë për procedurat e uljes së rrezikut tek CD-ROM-i i SEESAC.



#### Kutia 5: Edukimi mbi Rreziqet gjatë mbledhjes së AVL – dy përjasje

Me përjashtim të ndërhyrjeve për mbledhjen e AVL në Shqipëri qysh prej 1999-2002 dhe Kosovë 2003, asnjë mbledhje e AVL në botë nuk ka ndodhur pa viktime civile. Në Bosnje dhe Hercegovinë, në 2003, një burrë u vra dhe një tjetër u plagos ndërsa po kthenin eksplozivë të pashpërthyer (UXO) tek SFOR. Shpërthimi ndodhi në derën e SFOR ndërsa dy burrat po mbanin kutinë me UXO. Mundësia që publiku do të lëvizë municion apo eksplozivë jo të qëndrueshëm gjatë amnistive për armët, është rrjedhimisht një problem kyç. Është një çështje në kompetencat e Menaxherit që të ekzekutojë detyrën e tij/saj për kujdesje, por të paktën dy përjasje të ndryshme janë përdorur në EJT deri më sot. Gjatë mbledhjes së administruar nga KFOR në Kosovë, popullsia u informua nëpërmjet posterave dhe Marrëveshjeve të Shërbimit Publik (MSHP) (Public Service Agreements) se lëvizja e eksplozivëve ishte shprehimisht e ndaluar. Publikut iu ofrua si zgjidhje një linjë e hapur telefonike për të raportuar këto armë. Ndonëse këto metoda kanë avantazhin e minimizimit të shanseve që lëndë të paqëndrueshme të lëvizin, gjithashtu ato komprometojnë anonimitetin e mbajtësit të armëve dhe mund të pritet që të ulin përqindjet e dorëzimit. Me këtë fakt në mendje SEESAC sygjeron një alternativë – shpërndarjen e “kartave të kujdesit” tek popullsia civile që lajmërojnë publikun rreth rrezikut, pa i ndaluar ata të lëvizin armë të dyshimta.

Në kohën kur janë shkruajtur, programe të mëparshme të Sensibilizimit të AVL në EJT, pa dashur kanë përdorur materiale sensibilizimi që mund të kenë inkurajuar sjellje jo të sigurta. Pika që duhet pasur kujdes përfshijnë fotografi, filma apo imazhe që tregojnë apo inkurajojnë:

- Mbjajtjen e armëve nga fëmijët.
- Shkatërrimin e AVL nga të rriturit, në vend të dorëzimit të sigurtë në pikat e autorizuara për mbledhjen.
- Aftësi jo të kujdesshme të mbajtjes së armëve nga agjentët e mbledhjes (psh. drejtimi i armës drejt njerëzve apo lënia e armëve të pakontrolluara në shesh).
- Njësi municioni dhe eksplozivësh të shpërndara dhe/ose të përziera dhe të grumbulluara bashkë.
- Skena në të cilat shikuesi shikon brenda tytës së pushkës, ndërsa ajo i drejtohet atij/asaj.
- Pikat e grumbullimit që janë të pasiguruara, afër godinave publike apo atje ku publiku është i mbledhur rreth njësisive të mbledhura.
- Pirja e duhanit pranë eksplozivëve.

#### 2.5.1 Mos-Përplasia e Edukimit për Rreziqet e AVL dhe Advokimi për AVL

Është e kuptueshme që programet e Edukimit mbi Rreziqet e AVL mund, nëse nuk krijohen siç duhet, të sjellin si pasojë që grupet e shënjestruara të jenë më pak të gatshëm të dorëzojnë armët e tyre gjatë një amnistie mbi armët. Kjo do të ishte si pasojë e faktit se Edukimi mbi Rreziqet e AVL është kaq i suksesshëm sa ata janë të frikësuar të mbajnë armë, por i pasuksesshëm sepse ata tani janë shumë të frikësuar ti çojnë armët në pikat e mbledhjes. Kjo gjë natyrisht që do ti prishte punë një tentative mikro-çarmatimi ku kishte nevojë për shënjestrimë për të arritur objektivat e programit (psh. rregjistrimi apo mbledhja e AVL). Në vendet me shtim të madh të AVL, një balancë duhet të arrihet në mënyrë që viktimat e përditshme të reduktohen por edhe mikro-çarmatimi të mbetet i mundshëm. Për të zgjidhur këtë problem të dyfishtë, gjithë programet e Edukimit mbi Rreziqet e AVL të cilat targetojnë të rritur, duhet që të venë theksin në pikat e mëposhtme kur edukojnë grupet e shënjestruara mbi mbajtjen dhe magazinimin e AVL.

- Eksplozivët, armët dhe municionet e paligjshme dhe/ose të stilit ushtarak asnjëherë nuk janë vërtet të sigurta. Municionet dhe eksplozivët janë në vetvehte të pasigurtë dhe lehtësisht të keqpërdorshëm apo të vjedhshëm. Paqëndrueshmëria rritet me kalimin e kohës dhe me kushte të dobëta magazinimi. Ndezja dhe shpërthimi spontan janë të zakonshëm. Armët e paligjshme janë një shkak i vazhdueshëm i plagosjeve të fëmijëve dhe meqënëse janë të pakontrolluara dhe lehtësisht të vjedhshme e të pagjetshme, ato janë mjete kryesor i përdorur nga krimi i armatosur dhe terrorizmi; dhe



- Si mbajtja ashtu edhe magazinimi i tyre janë të rrezikshme. Deri kur të ofrohet një rast amnistie për të eliminuar rrezikun përfundimisht, është e mundshme të reduktohet rreziku që vjen nga depozitimi i tyre në mënyra të veçanta dhe të sigurohet që të tjerët, veçanërisht fëmijët, të mos bien kurrë në kontakt me to<sup>23</sup>. Deri atëhere AVL nuk duhet asnjëherë që të hidhen në vende publike për shkak të rrezikut që ato përmbajnë për të tjerët, sidomos për fëmijët.

I shpjeguar dhe mësuar në këtë mënyrë, kurrikula e Edukimit mbi Rreziqet e AVL nuk bie në kundërshtim me mesazhet e Advokimit për AVL që do të shpërndahen në mbështetje të mbledhjes së armëve apo iniciativave të regjistrimit (shikoni Seksionin 5 për shembuj mesazhesh).

## 2.5.2 Mos-Përplasja e Sensibilizimit për AVL dhe edukimit mbi rrezikshmërinë e minave

Meqënëse të gjitha përkufizimet e AVL në përdorim përfshijnë minat, dhe disa artikuj të tjerë mund të përfshihen në kategorinë e Mbeturinave Eksplozive të Luftës (MEL) (Explosive Remnants of War), ekziston një mbivendosje natyrale midis Sensibilizimit për AVL dhe edukimit mbi rreziqet e minave (ERRM), ndonëse ERRM trajton rreziqe 'të fshehura' ndërsa AVL mund të jenë si të fshehura ashtu edhe të dukshme. Në disa raste, programet ERRM kanë zgjedhur në fakt që të përshijnë mesazhet rreth rrezikut të AVL si pjesë e kurrikulës së tyre sepse ndërsa mbledhin informacion rreth minave u bë e dukshme se AVL përbënin një kërcënim të ngjashëm. Kjo demonstron mbivendosjen natyrale mes dy fushave si dhe nevojën për zgjidhje të koordinuara. Shembulli i mëposhtëm është marrë nga kurrikula e ICRC-së mbi MEL në Irak.

### Kutia 6: Pjesë nga Seksioni i AVL i kurrikulës së ICRC-së mbi MEL, Irak

- Konfliktet e tanishme përdorin një numër të madh AVL të ndryshme dhe dekadat e fundit kanë parë një ngritje në tregtinë, prodhimin dhe mbajtjen e AVL në duart e individëve dhe grupeve jo ushtarake.
- AVL mundet lehtësisht të blihen, fshihen, mbahen dhe përdoren dhe kanë sjellë si pasojë një numër në rritje të incidenteve në situatë post-konfliktuale.
- Nëse shikoni një AVL në një ish-pozicion ushtarak, mos iu afroni kurrë vendit, lajmëroni të tjerët rreth afrimit dhe raportoni tek autoritetet.
- Kurrë mos mblidhni apo prekni AVL të cilat janë lënë në pozicione ushtarake. Përgjithësisht AVL, ashtu si edhe MEL, mund të jenë të paqëndrueshme e të pasigurta dhe si rrjedhojë shkaktojnë incidente. AVL mund të jenë lënë edhe me qëllim nga fraksionet ushtarake dhe mund të jenë edhe kurthe.
- Prindër: mos i lejoni fëmijët tuaj të mbledhin AVL apo luajnë/lëvizin pranë të AVL.

#### Pikat kryesore:

- AVL e braktisura janë jashtëzakonisht të rrezikshme për shkak të një shumëllojshmërie kërcënimesh.
- AVL mund të jenë të rrethuara me mina apo me kurthe.
- Mos iu afroni AVL dhe ndaloni të tjerët që t'ju afrohen.
- Kërkimi për përfitime i AVL mundet lehtësisht t'ju çojë drejt incidenteve.

Kjo gjë sjell përfitime për programet e AVL por gjithashtu edhe rreziqe, sepse mund të lindin konflikte midis programeve të vendosura apo të parashikuara të ERRM dhe programeve për Sensibilizimin e AVL. Ekziston rreziku që programe të suksesshme të Advokimit AVL që inkurajojnë (megjithëse) në një shkallë të vogël – rrezikun e mbajtjes së armëve, municioneve dhe eksplozivëve, mund në këtë mënyrë të gjenerojnë një konflikt me mesimet e programeve të ERRM dhe të shpërbëjnë ndryshimet pozitive në njohuritë/perceptimet/sjelljet e grupeve të shënjestruara në lidhje me MEL. Rasti më i dukshëm është mundësia që mbledhja e AVL mund të nxitë tentativa të qytetarëve për të dorëzuar minat, UXO-t apo të tjera MEL.

<sup>23</sup> Referojuni udhëzimeve të mëposhtme mbi "reduktimin e rrezikut" gjatë mbajtjes dhe magazinimit për mesazhet pasuese.



### Kutia 7: Një rast konflikti midis mikro-çarmatimit dhe aksioneve kundër minave, Republika e Kroacisë

Gjatë serisë përgjithësisht të suksesshme të mbledhjes së armëve në Republikën e Kroacisë gjatë viteve 90të, pasoja të pasyruara përfshinë raste ku qytetarë të patrainuar tentuan të pastronin pjesë të fushave të minuara dhe të transportonin minat – disa gati për ndezje – në vendet e mbledhjes së AVL. Kjo shërben për të vënë në dukje kontradiktën midis fushave të veprimit të veprimeve për AVL dhe për minat. Veprimet e këtyre individëve nuk ishin të rrezikshme thjesht për faktin se transportonin mina, por edhe për faktin se harta e fushave të minuara të njohura tani ishte prishur, duke penguar kështu çdo tentativë pastrimi. Me aq sa shikojmë çfarëdo lloj ndryshimi pozitiv në sjellje që iu ishte dhënë qytetarëve nga programet e ERRM ishte prishur, apo eliminuar tërësisht nga një program për Sensibilizimin e AVL që përndryshe ishte i suksesshëm.

*Burimi: Prezantim nga Z. Lav Kalda, ish punonjës i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kroacisë në Seminarin “Rritja e Sigurisë në Ballkan: Krijimi i Planit Rajonal Zbatues për Armët e Vogla në kuadrin e Paktit të Stabilitetit”, 24-25 Qershor 2002, bashkë-organizuar nga Safeworld dhe Qendra Ndërkombëtare për Ndryshim në Bon (Bonn International Center for Conversion).*

Ndonëse bashkimi sinergjik mes ERRM dhe Edukimit për Rrezikun e AVL është mëse i qartë, është e rëndësishme të diferencosh mes mesazheve bazë të ERRM (që përgjithësisht përfshijnë një pjesë që thotë “mos prek”) dhe aktiviteteve për kontrollin e AVL të cilat në përgjithësi: inkurajojnë dorëzimin e armëve, shpjegojnë masat e sigurisë për mbajtësit e armëve dhe/ose agjentëve të mbledhjes; informojnë njerëzit rreth sjelljeve të sigurta për veprimet rreth AVL; dhe/ose përfshijnë komunitetet e prekura në trajtimin e problemeve të AVL dhe për gjetjen e zgjidhjeve alternative për të përmirësuar sigurinë brenda komuniteteve. Ndërsa disa prej këtyre aktiviteteve të kontrollit të AVL nënkuptojnë mbajtjen e armëve (për përdoruesit e armëve dhe mbledhësit për shëmbull), disa mesazhe rreth sjelljeve të sigurta do të lidhen gjithashtu me “mos prekjen” e armëve (për shëmbull, informacioni i sjelljeve të sigurta për fëmijët).

Dy zgjidhje të mundshme për konfliktet e identifikuar më lart do të ofrohen këtu dhe duhet që të ndiqen në gjithë ndërhyrjet e kontrollit të AVL:

- Nxjerrja e “Kartave të Sigurisë” për popullsinë civile në të gjitha zonat ku ndodhin amnisti për armët, për ti dhënë qytetarëve këshilla për sigurinë fillestare mbi llojet e armëve, municioneve dhe eksplozivëve që janë të legjitimuar dhe të këshillueshëm për tu dorëzuar dhe cilat lloje nuk janë të sigurta për tu mbajtur apo prekur.<sup>24</sup>
- Përdorimi i termave ‘armë’, ‘municione’ dhe ‘eksplozivë’ për të veçuar mes llojeve të ndryshme të AVL dhe për të lejuar qartësimin mes sjelljeve të ndryshme që janë të përshtatshme për armët dhe shumicën e llojeve të municioneve në një anë, dhe të eksplozivëve/MEL/minave në anën tjetër.<sup>25</sup>
- Krijimi i kontakteve me çdo organizatë që bën<sup>26</sup> aktivitete të ERRM gjatë fazës fillestare të programit për Sensibilizimin e AVL, në mënyrë që të krijohen planet dhe sistemet për të parandaluar një konflikt në mesazhet apo aktivitetet e ardhshme.

## 2.6 Integrimi i Sensibilizimit për AVL në aktivitete të tjera

Duke mësuar nga eksperiencia e fushave të tjera, PMSA merr në konsideratë specififikimet teknike ashtu si edhe implikimet politike, sociale dhe ekonomike të AVL. Në situatat e shtimit të AVL, ekziston një nevojë shtypëse për të gjetur faktorët që rrisin kërkesën për AVL dhe shpërdorimin e tyre, për të zbuluar mentalitetin dhe presionin shoqëror që qëndron pas vetë armëve, dhe për të konsideruar zgjidhje dhe alternativa kundrejt AVL. Programet e Sensibilizimit të AVL janë thjesht vetëm një shëmbull i programeve të komunikimit të krijuara për të prodhuar

<sup>24</sup> Shikoni “Kartat e Sigurisë” në CD-ROM-in e SEESAC

<sup>25</sup> Si një armë e mbajtur prej njeriut që përmban eksploziv, mina është në fakt një tip AVL sipas gjithë përkufizimeve të momentit. Pasi janë vendosur në tokë dhe janë bërë gati për ndezje ato futen në kategorinë e MEL.

<sup>26</sup> Detajet e kontaktit për organizatat e rëndësishme në EJL për ERRM jepen në CD-ROM-in e PMSA, në seksionin e titulluar ‘Landmine links’ (Lidhjet mbi Minat tokësore).






ndryshime pozitive shoqërore. Shembuj të tjerë mund të gjenden në fusha si shëndeti publik (psh. edukata seksuale, Sensibilizimi për HIV/AIDS) dhe ERRM.

Rezultati i parë të çdo ndërhyrjeje të suksesshme komunikimi është ngritja e sensibilizimit mbi çështjen që trajtohet mes grupeve të shënjestruara. Kjo në vazhdim krijon një kërkesë për ndryshim social. Ekzistojnë modele të shumta për ndryshimin e sjelljeve, por qëllimi i tyre i përbashkët është që të tregojnë se si rritja e sensibilizimit paraqet një rrugë të hapur për individët dhe/ose komunitetet që t’ju largohen praktikave të sjelljes negative dhe të shkojnë drejt adoptimit të praktikave më pozitive.

**Diagrama 2: Harta treguese e ndryshimit të sjelljes<sup>27</sup>**



Një mësim që mund të nxirret nga përpjekjet e tjera për të komunikuar për ndryshime sociale është se është thelbësore që përfitimet e çfarëdo ndryshimi kulturor të bëhen të qarta për personat dhe/ose komunitetet e shënjestruara nga çdo program. Nje theks i veçantë duhet të vendoset mbi ato përfitime që do ti interesonin grupeve të veçanta të shënjestruara, spse njerëz të ndryshëm i kuptojnë kostot dhe përfitimet e kontrollit jo të përshtatshëm të AVL në mënyrë të ndryshme (biznesmenët mund të jenë të interesuar rreth prospekteve

<sup>27</sup> E modifikuar nga “Komunikimi për Ndryshimin e Sjelljes – Banka Botërore”. 1996 nga Cecilia Cabanero-Verzosa f.4- Figura2: dhe faqja internet e Family Health International: “Ndryshimi i Sjelljes: Një përmbledhje e katër teorive më të mëdha”: <http://www.fhi.org/en/hiv/aids/publications/index.htm>



për investimet, nënat rreth fëmijëve të tyre). Një mësim i mëtejshëm është se nëse programet e sensibilizimit/komunikimit nuk integrohen me aktorë dhe programe të tjera të cilët janë të aftë ti përgjigjen kërkesave që ngritja e ndërgjegjësimit krijon, grupet e shënjestruara bëhen të irrituara dhe të zhgënjyera. Kështu, ngritja e sensibilizimit në një komunitet në lidhje me imunizimin duhet që të ndiqet nga dhënja e vaksinave. Atje ku dëshira e mirë për të vepruar kështu, përgjigje të koordinuara duhet që të krijohen së bashku me institucionet dhe organizatat e interesuara në mënyrë që të promovohen dhe zbatohen zgjidhje të punueshme për shtimin dhe përdorimin e armëve. Mjeti kyç i rekomanduar nga PMSA – Plani i Komunitetit të Sigurtë, do të funksionojë vetëm nëse organizata të ndryshme bashkëpunojnë midis tyre në favor të komuniteteve që trajtohen dhe fillojnë të zgjidhin problemet e AVL të identikuara nga vetë komunitetet.

Për fat të mirë ekziston mundësia për të integruar Sensibilizimin e AVL në një sërë programesh ndërhyrjeje, duke përfshirë reformat në sektorin e sigurisë, parandalimin e konflikteve, punën për pajtimin dhe paqen, si edhe një sërë programesh të tjera sociale si ato kundër dhunës dhe puna me rininë. Integrimi ka shumë mundësi që të prodhojë përfitime të shumta:

- a) Ata që janë duke krijuar programe të Sensibilizimit të AVL do të jenë të aftë të mbështeten tek rrjete dhe struktura programore ekzistuese;
- b) Mesazhet e programeve të AVL kanë më shumë të ngjarë që të kenë më tepër efekt nëse zenë rrënjë dhe përforcohen me tema dhe aktivitete të tjera; dhe
- c) Kërkesa për ndryshim social që krijohet nga programe të suksesshme të Sensibilizimit për AVL mes të shënjestruarve mund të kanalizohet në mënyrë efektive në programe sociale që paraqesin një mjet për ndryshime të menjëhershme.

Një (jo-gjithëmbuluese) tipologji e zgjidhjeve dhe alternativave jepet në tabelën që vijon për të ilustruar mundësitë për integrim.

**Tabela 3: Një tipologji e zgjidhjeve dhe alternativave për mbajtjen/shpërdorimin e AVL**

ARSYE PËR MBAJTJEN/SHPËRDORIMIN E AVL	ZGJIDHJE/ALTERNATIVA TË MUNDSHME
<b>EKONOMIKE</b>	
Aktivitet ekonomik i ligjshëm (psh. për gjueti)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk kërkohet asnjë zgjidhje</li> </ul>
Për kërkesa profesionale (psh. policia)	
Me synimin për të trafikuar armët	<ul style="list-style-type: none"> <li>Masa anti-trafikimi</li> <li>Dhënja e alternativave ekonomike të ligjshme               <ul style="list-style-type: none"> <li>Psh. “Skemat e Punësimit të Shpejtë” dhe programe të tjera zhvillimore</li> </ul> </li> </ul>
Me synimin për të kryer krime me armë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Masa anti-krim               <ul style="list-style-type: none"> <li>Psh. trajnimi dhe ndihma për forcat policore</li> </ul> </li> </ul>
<b>SOCIALE KULTURORE</b>	
Sport	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk kërkohet asnjë zgjidhje</li> <li>Programe shoqërore për të promovuar normat e mosmbajtjes së armëve               <ul style="list-style-type: none"> <li>Psh. Klubet e Gjuetisë/Armëve</li> <li>Apele nga njerëz të famshëm (psh. yjet e kinemasë, këngëtarët pop)</li> <li>Grupe komunitare ku të eksplorohet ‘të qenit mashkull pa pasur armë’</li> </ul> </li> </ul>
Si dhuratë	
Si simbol i fuqisë/pranimit shoqëror/modës	
Përkatësi kulturore	
<b>POLITIKE/SIGURIE</b>	
Frika nga krimi/dhuna	<ul style="list-style-type: none"> <li>Masa anti-krim</li> <li>Programe sociale për të promovuar jo-dhunën dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve</li> <li>Mbledhjen dhe rregjistrimin e armëve</li> </ul>
Tension ndëretnik	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirësim i bashkëpunimit të komunitetit nëpërmjet trajnimeve për zgjidhjen e konflikteve</li> <li>Trajnime mbi diversitetin/tolerancën               <ul style="list-style-type: none"> <li>Psh. ndërhyrje për ndalimin e dhunës dhe edukimin për paqe nëpër shkolla</li> </ul> </li> </ul>
Frikë nga konflikti (psh. në zonat pas një konflikti)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Parandalimi i konflikteve</li> <li>Masa për besueshmërinë, ndërtimin e paqes dhe pajtimit</li> <li>Mbledhja e armëve, regjistrimi</li> </ul>
Mosbesimi tek forcat e rendit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Reformë e sektorit të sigurisë               <ul style="list-style-type: none"> <li>Psh. promovimi i policisë së bazuar në komunitet</li> </ul> </li> <li>Programe për të promovuar marrëdhëniet midis komunitetit dhe policisë</li> </ul>
Mbajtja e armëve nga ish-luftëtarët	<ul style="list-style-type: none"> <li>Procese të çmobilizimit, çarmatimit dhe ri-integrimit</li> <li>Masa për rritjen e besimit, ndërtimit të paqes dhe pajtimit</li> </ul>
Militantizmi politik	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pajtimi politik               <ul style="list-style-type: none"> <li>Psh. Plani Çoviç, Marrëveshja Kuadër e Ohrit</li> </ul> </li> </ul>



Në shumë raste zgjidhjet e mësipërme kërkojnë veprime dhe burime që tejkalojnë qëllimin e programeve për Sensibilizimin e AVL, apo çfarëdo ndërhyrjeje për kontrollin e AVL në qëllimet e tyre. Stafi i programit të Sensibilizimit të AVL mundet që me raste të kufizohet në dhënjen e zgjidhjeve “informative” për individët dhe komunitetet (psh. Programet e veçuara për Edukimin mbi Rreziqet). Një program i Sensibilizimit për AVL që nuk ka krijuar lidhjet ose me ndërhyrje më të gjera të kontrollit të AVL apo sektorë, agjensi apo reforma të tjera, për këtë arsye bëhet tepër i kufizuar në mundësinë e tij për të përmbushur çfarëdo kërkesë për ndryshim. Vendosja e lidhjeve është thelbësore sepse zgjidhjet më gjithëpërfshirëse për problemet e AVL tipikisht do të kenë nevojë për ekspertizën dhe burimet e organeve qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare për të zbatuar reforma politike, ligjore, ekonomike apo sigurie.

#### **Kutia 8: Projekti ‘Edukimi për Çarmatim dhe Kulturë Paqësore’ në Shqipëri**

Në shoqëri në konflikt apo të sapo dala nga konflikti, roli i zbatimit të ligjit prej forcave të policisë mund të ndryshojë dhe të sjellë mosbesimin nga komunitetet, ndjenja pasigurie dhe si pasojë, një kërkesë të madhe për armët. Në EJK, ashtu si edhe në pjesë të tjera të botës (psh. në Amerikën Qëndrore) shumë individë dhe biznese i janë përgjigjur këtyre ndryshimeve duke blerë armë apo duke punësuar kompani private sigurimi. Në situata të tilla reformat e sektorit të sigurisë dhe iniciativat si ‘policia e bazuar në komunitet’ mund të jenë një përbërës thelbësor i masave për kontrollin e AVL sepse ato përmirësojnë qeverisjen e forcave të rendit dhe si pasojë ulin kërkesën për AVL.

Gjatë Maj-Qershorit 2003 një projekt pilot inovator i njohur si Edukimi për Çarmatim dhe Kulturë Paqësore (EÇKP) (Disarmament Education and Peaceful Culture DEPC) u zbatua në katër shkolla në Tiranë dhe Shkodër, në Shqipëri. OJQ-të lokale, Shqipëria më e Sigurtë dhe Lëvizja për Çarmatim, u bashkuan me PNUD Shqipëri dhe me Drejtoritë e Edukimit dhe Policisë për të testuar një projekt i cili si qëllim kryesor kishte krijimin e strukturave për bashkëpunimin mes policisë dhe shkollave duke u përpjekur të ngrinte nivelet e besimit të komunitetit tek policia. Projekti përfshinte oficerë policie që u mësonin fëmijëve rreth çështjeve që lidhen me sigurinë njerëzore, si për shembull: rreziqet e AVL, drogave, prostitucionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore; roli dhe përgjegjësitë e policisë; rregullat e qarkullimit rrugor; çështjet e gjakmarrjes dhe zgjidhjen e konflikteve. Një numër i madh materialesh dhe aktiviteteve të ndryshme u përdorën, që nga diskutimet në klasa e deri tek konkurset dhe mbulimi mediatik. Anketimet vlerësuese treguan se një grup prej 200 fëmijëve të përfshirë në projektin e EÇKP kishin një nivel të lartë sensibilizimi për çështjet që kishin mësuar. Një raport i projektit është bërë i gatshëm dhe do të lejohet Drejtoritë e Edukimit dhe Policisë që të vendosin se si të procedojnë në të ardhmen.

*Burimet: Filozofia dhe Principet e Policisë së Bazuar në Komunitet, një raport i përbashkët i SEESAC/Safeworld dhe Raporti Final i Projektit Edukimi për Çarmatim dhe Kulturë Paqësore, PNUD Shqipëri Projekti SSSR, 2003*

## **2.7 Ndjekja e ciklit të programit**

Çdo ndërhyrje shoqërore e programuar mund të ndahet në një sekuencë hapash, secili që ndjek logjikisht parardhësin dhe duke u bazuar në atë që është mësuar deri tani. Programet e Sensibilizimit të AVL nuk duhet të bëjnë përjashtim nga ky rregull dhe kapitujt pasardhës tregojnë se si të ndiqet një program logjik i Sensibilizimit për AVL nga fillimi deri në fund, duke aplikuar konceptet e parashtruara më sipër në Seksionin 2. Rezultatet e ndjekjes së ciklit të programit janë të shumta në numër për tu rradhitur plotësisht, por avantazhet kryesore mund të përmbidhen si më poshtë:


- Kryerja e vlerësimeve të aplikueshmërisë dhe nevojave përpara se të tentohen ndërhyrje. Vendos aplikueshmërinë dhe dëshirueshmërinë e çdo ndërhyrjeje të propozuar për Sensibilizimin e AVL dhe le vend për vendosjen e formës së dëshiruar.
- Krijimi i strategjive për Sensibilizimin AVL me objektiva të qarta që vendosen mbi bazën e mbledhjes së informacionit të saktë maksimizon shanset që komunikimi do të jetë i vlefshëm për rrethanat lokale, dhe mjaftueshëm i efektshëm për të prodhuar ndryshime jetëgjata për njohuritë, qëndrimet dhe sjelljet e njerëzve.



- Krijimi i sistemeve të monitorimit dhe evaluimit i lejon programet të mos dalin nga rruga, të adaptohen me ndryshimin e rrethanave dhe të identifikojnë mësimet të vlefshme.

Seksioni 3 i doracakut PMSA fillon me fazën e parë të ciklit të programit – mbledhja dhe menaxhimi i informacionit.

**Diagrama 3: Cikli i programit**







## 3 Mbledhja dhe menaxhimi i informacionit

### 3.1 Objektivat e mbledhjes së informacionit dhe të dhënave

Mbledhja, analizimi dhe përdorimi i informacionit janë jetësorë për zbatimin me efikasitet të aktiviteteve për kontrollin e AVL, duke përfshirë këtu edhe ndërhyrjet për Sensibilizimin e AVL. Asnjë ndërhyrje AVL nuk duhet të ndodhë derisa stafi i programit të ketë studiuar kontekstin ku ata synojnë të punojnë. Një sasi e madhe dhe e ndryshme informacioni duhet të nxirret apo të mblidhet nga stafi i programit përpara se një kuptim i përshtatshëm i situatës të mund të nxirret, por qëllimi kryesor i gjithë këtij informacioni është që të lejojë stafin që të:

- Kuptojë natyrën e problemit të AVL në komunitete specifike, duke përfshirë edhe funksionet e AVL për grupe të veçanta si dhe kërcënimet që rrjedhin prej tyre, si edhe lidhjet dhe dinamikat e rëndësishme që duhet të merren parasysh kur krijohen përgjigje të përshtatshme;
- Përgatitet për monitorimin dhe vlerësimin e programit për të garantuar kështu transparencën dhe efektivitetin; dhe
- Marrë një pamje më të qartë të gjithë aktorëve të interesuar në mënyrë që të planifikojë një koordinim dhe bashkëpunim më të madh.

Mbledhja e informacionit ndodh në të gjitha nivelet – kombëtar, rajonal (EJL), nën-kombëtar, dhe në nivel komunitetesh. Tipet e informacionit për të cilat programet e Sensibilizimit të AVL janë të rradhitura më poshtë por qartësisht nuk janë gjithëpërfshirëse meqenëse kontekste të ndryshme mund të kishin nevojë për kategori shtesa.

### 3.2 Mbledhja e informacionit në kontekstin e iniciativave kombëtare për mikro-çarmatimin

Aktivistët e Sensibilizimit për AVL të cilët punojnë në kontekstin e një ndërhyrjeje kombëtare për mikro-çarmatim do të kenë mundësi, si një formë e praktikës më të mirë nga ana e Autoritetit<sup>28</sup> të krijuar kombëtar për AVL, të trajtojnë 'Anketimin mbi AVL' për të ndihmuar krijimin e programit të tyre. Një Anketim kombëtar AVL është një studim tërësisht gjithëpërfshirës e mbarëkombëtar. Qëllimi i tij është që:

*“Të përkufizojë natyrën dhe shtrirjen e shtimit të AVL dhe impaktin brenda një rajoni, kombi apo komuniteti në mënyrë që të paraqesë të dhëna dhe informacion të saktë për një ndërhyrje të sigurtë, efektive dhe efçente nga një organizatë e përshtatshme.”*

Ekzistojnë katër pjesë të një Anketimi kombëtar AVL gjithëpërfshirës:<sup>29</sup>

- Anketa e Shpërndarjes së Armëve të Vogla. Kjo mbledh të dhëna mbi tipin, sasinë, pronësinë, shpërndarjen dhe lëvizjen e AVL brenda vendit apo rajonit;
- Anketa për Impaktin e Armëve të Vogla. Kjo mbledh të dhëna mbi impaktin e AVL tek komunitetet dhe tek zhvillimi social dhe ekonomik;
- Anketa e Perceptimit të Armëve të Vogla. Kjo mbledh informacion cilësues mbi qëndrimet e komunitetit lokal në lidhje me AVL si dhe ndërhyrjet e mundëshme; dhe
- Anketa e Kapacitetit të Armëve të Vogla. Kjo adreson kapacitetet kombëtare për të zhvilluar kontroll të përmirësuar mbi AVL.

<sup>28</sup>Idealisht kjo duhet të jetë në një nivel kombëtar qeveritar, por në teori kushdo aktor i aftë mund të marrë këto përgjegjësi, psh. një 'Njësi Koordinimi' apo 'Komisioni i AVL' kombëtarisht e krijuar, apo OJQ e nën-kontraktuar. Deri tani anketime gjithëpërfshirëse kanë ndodhur vetëm në Maqedoni, ndërsa një tjetër është duke ndodhur në Mal të Zi. Në Shqipëri dhe Bosnje-Hercegovinë anketimet janë duke u marrë në konsideratë. Studime më pak gjithëpërfshirëse por tepër të dobishme janë kryer gjithashtu në Serbinë e Jugut, Kosovë dhe Bosnje Hercegovinë. Raporte të plota të anketimeve dhe një analizë e të dhënave mund të gjenden tek <http://www.seesac.org/reports/surveys.htm> apo nga njëسيا që i ka porositur këto anketime (në rastet e mësipërme zyrat e UNDP-së në këto vende).

<sup>29</sup>PMSA 05.80: Anketimi AVL, [http://www.seesac.org/resources/current\\_eng.htm](http://www.seesac.org/resources/current_eng.htm).



Për të zbatuar anketat, mjete të ndryshme mund të përdoren si për shembull:

- Pyetësorë shtëpi më shtëpi.
- Intervista me informatorët kryesorë.
- Grupet e fokusuara.
- Bankat e të dhënave kombëtare dhe akademike.
- Anketime të tjera të lidhura me çështjen që mund të jenë ndërmarrë tashmë.

Një Anketim kombëtar AVL është një detyrë e vazhdueshme, që duhet të kryhet me mbështetjen e autoriteteve kombëtare përpara se të fillojnë ndërhyrje të mëdha për AVL. Më pas do të rifreskohet vazhdimisht për të reflektuar rrethanat që ndryshojnë ndërsa programi vazhdon dhe situata zhvillohet (procesi i vlerësimit të AVL). Kjo i paraqet planifikuesve kombëtarë informacionin e nevojshëm për të vendosur objektiva operacionale për programet e tyre dhe më pas për të planifikuar të gjitha ndërhyrjet e kontrollit të AVL në mënyrë të detajuar. Në momentin kur përfundon, një Anketim mbi AVL paraqet të dhënat e mëposhtme për Menaxherët e Programeve të Sensibilizimit të AVL:

- a) Objektiva të qarta për programet kombëtare të mikro-çarmatimit me të cilat programet e Sensibilizimit të AVL mund të lidhen;
- b) Identifikon dhe promovon lidhjet mes mikro-çarmatimit (dhe strategjisë së tij të komunikimit dhe edukimit mbi reziqet) dhe çështjeve të zhvillimit më të gjerë dhe sektorit të sigurisë; dhe
- c) Në këtë mënyrë lejon planifikimin në vija të përgjithshme të strategjisë për Sensibilizimin e AVL dhe një udhëzues për çfarëdo Planesh të Komuniteteve të Sigurta që do të pasojnë.

Informacioni i mbledhur si pjesë e një Anketimi për AVL do të jetë lehtësisht i gatshëm për të interesuarit në një formë mjaftueshëm të detajuar për të lejuar bërjen e planifikimit fillestar. Sidoqoftë, Anketat Kombëtare të AVL synojnë që të japin një pamje të përgjithshme (zakonisht mbarëkombëtare) dhe jo informacion tepër të detajuar për situatën e çdo komuniteti apo fshati në vend. Vetëm një fraksion përfaqësues i komuniteteve në vend do të jenë studiuar në të gjitha detajet (psh gjatë anketave shtëpi më shtëpi) si pjesë e anketimit kombëtar, dhe të dhëna shtesë do të jenë shpesh të nevojshme, qofshin këto prej komuniteteve të rëndësishme apo nga institucione/struktura të përshtatshme. Nëse nuk është ndërmarrë një Anketim kombëtar, vlerësime të plota të nevojave dhe kapaciteteve do të vazhdojnë të jenë të kërkuara nga ata që planifikojnë programet e Sensibilizimit të AVL. Edhe në rastet kur rezultatet e Anketimit Kombëtar për AVL janë të gatshme, disa informacione lokale shtesë duhet që të mblidhen për të zhvilluar strategjinë e Sensibilizimit për AVL dhe për të suportuar më tutje çdo Plan të Komunitetit të Sigurtë. Lloji i informacionit që duhet të mblidhet dhe mënyrat për të arritur këtë gjë janë përshkruar më poshtë.

### **3.3 Mbledhja e informacionit dhe të dhënave: një proces i vazhdueshëm gjatë aktiviteteve për Sensibilizimin e AVL**

Mbledhja, analizimi dhe përdorimi i informacionit ndodhin në një bazë të vazhdueshme:

- a) Përpara se të përpunohet strategjia për Sensibilizimin e AVL, në formën e një studimi aplikueshmërie;
- b) Gjatë fazës përpunuese të strategjisë: vlerësimi i nevojave dhe kapaciteteve (përveçse kur një anketim ekzistues na e jep këtë informacion); dhe
- c) Si pjesë e zbatimit të ndërhyrjeve për Sensibilizimin e AVL: Plani i Komunitetit të Sigurtë





**Tabela 4: Nivelet e ndryshme të mbledhjes së informacionit**

	STUDIM I APLIKUESHMËRISË	VLERESIMI I NEVOJAVE DHE KAPACITETEVE	PLANI I KOMUNITETIT MË TË SIGURTË
<b>Përse?</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të parë se sa është e mundëshme që të mblidhet informacion mbi çështjet e AVL dhe rastet e vdekjeve</li> <li>Për të vlerësuar mundësinë për dhe aplikueshmërinë e ndërhyrjeve AVL</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të kuptuar nëse ekziston nevoja për Sensibilizim AVL.</li> <li>Nëse ekziston, të merret informacion i pështatshëm për të përmbushur këto nevoja dhe për të adresuar çështjet dhe problemet e AVL – hapi i parë përpara se të vendoset nëse do të tentohet Edukimi mbi Rreziqet AVL apo Advokimi për AVL</li> <li>Për të identifikuar se si të integrohen programet AVL në strategjinë kombëtare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të kuptuar problemet e AVL në komuniteteve specifike dhe për të identifikuar zgjidhje të pështatshme për këto probleme.</li> <li>Për të mbështetur komunitetet e interesuara në zbatimin e përgjigjeve të identifikuar me qëllimin për të përmirësuar sigurinë në komunitete.</li> </ul>
<b>Çfarë informacioni?</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Informacion i përgjithshëm rreth problemeve të AVL; të dhënat mbi viktimat.</li> <li>Ndërhyrje për AVL ekzistuese apo të planifikuara.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Informacion specifik rreth problemeve dhe kërcënimeve të AVL; njohuritë, qëndrimet dhe sjelljet e njerëzve kundrejt AVL; të dhënat për viktimat nga AVL.</li> <li>Informacion i detajuar në lidhje me zgjidhje/alternativa ekzistente apo të mundshme për problemet e AVL, duke përfshirë edhe ndërhyrjet AVL në vazhdim apo të planifikuar si dhe punë për paqen apo parandalimin e konflikteve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Informacion specifik rreth kërcënimit dhe problemeve aktuale të AVL në komunitet, duke përfshirë edhe vdekjet nga AVL; njohuritë, perceptimet, qëndrimet dhe sjelljet si edhe zgjidhjet ekzistuese dhe mekanizmat e trajtimit; ndërhyrje AVL dhe humanitare të sygjera; qëndrimet në lidhje me dorëzimin e armëve të ndryshme</li> </ul>
<b>Ku?</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në nivel kombëtar përgjithësisht me informacion të marrë nga aktivitetet në terren</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në nivel kombëtar, rajonal dhe nivel komuniteti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në komunitetet e prekura</li> </ul>
<b>Si?</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Diskutime dhe intervista me autoritetet dhe organizatat e interesuara; median; informacion i përgjithshëm i marrë nga programet në terren.</li> </ul> <p>Shikoni metodologjitë e përdorura në Seksionin 3.4</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Takime në nivelin qendror me Ministrinë e rëndësishme, organizatat dhe median</li> <li>Takime në nivel rajonal me departamentet e rëndësishme ministeriale dhe degët e organizatave</li> <li>Trajnim i stafit në terren për të drejtuar vlerësimet e komunitetit</li> <li>Vlerësimet e komunitetit në fshatra të përzgjedhur</li> <li>Analiza e informacionit dhe të dhënave</li> </ul> <p>Shikoni metodologjitë e përdorura në Seksionin 3.4</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Diskutime me komunitetet e prekura dhe autoritetet</li> <li>Aktivitete pjesëmarrëse që shënjestrojnë grupe në rrezik dhe përdoruesish.</li> </ul> <p>Shikoni metodologjitë e përdorura në Seksionin 3.4</p>



	STUDIM I APLIKUESHMËRISË	VLERESIMI I NEVOJAVE DHE KAPACITETEVE	PLANI I KOMUNITETIT MË TË SIGURTË
<b>Kur?</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pas identifikimit prej autoriteteve dhe organizatave të problemeve që vijnë nga shtimi i AVL</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pas studimit të aplikueshmërisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pas vlerësimit të nevojave dhe kapaciteteve dhe analizës së informacionit</li> <li>Pas një anketimi bazë mbi njohurinë, qëndrimet dhe praktikatat (Anketa NJQP) (<i>Knowledge, attitudes and practices KAP Survey</i>)<sup>30</sup></li> </ul>

Tabela e mëposhtme shpjegon se çfarë tipesh informacione planifikuesit e programeve të Sensibilizimit të AVL duhet të marrin gjatë periudhës së vlerësimit të nevojave dhe kapaciteteve të çdo programi. Nevojat për informacion duhet të ndryshojnë nëse programi i planifikuar i Sensibilizimit të AVL do të jetë i tipit të veçuar apo do të integrohet me një ndërhyrje mikro-çarmatimi. Rezultatet e mbledhjes së informacionit lejojnë analizimin e situatës nga stafi i programit, në bazën e së cilit mund të krijohet një strategji programi.

<sup>30</sup> Shikoni Seksionin 3.5

Tabela 5: Tipet e informacionit që nevojiten në faza të ndryshme të ciklit të programit.

	STUDIMI PËR ADAPTUESHMËRINË	VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE KAPACITETEVE	PLANI I KOMUNITIT MË TË SIGURTË	TË DHËNA TË MARRA NGA ANKETA KOMBËTARE TË AVL <sup>31</sup>
Analiza e vendit <input type="checkbox"/> Infrastruktura; statistikat e popullsisë, konteksti politik <input type="checkbox"/> Kapaciteti i organizatave të brendshme për të kryer aktivitetet <input type="checkbox"/> Plani Kombëtar për Kontrollin e AVL dhe Aktivitete ekzistues për kontrollin e AVL <input type="checkbox"/> Plan i zhvillimit për vendit dhe aktivitetet të gjithë agjensive dhe ministrive të përfshira <input type="checkbox"/> Situaata e vendit; burimet ekzistuese të gatshme lokalisht dhe nëpërmjet agjensive të tjera <input type="checkbox"/> Informacion gjeografik rreth vendit/rajonit, si psh. mundësia për të shkuar nëpër rajone, kushtet atmosferike <input type="checkbox"/> Festat kombëtare <input type="checkbox"/> Ndërrnyjet ndërkombëtare psh. programet e lidhura me kontrollin e AVL, investimet e huaja të planifikuara <input type="checkbox"/> Rregullat ligjore; psh. ligjet e punësimit, ligjet e rëndësishme <input type="checkbox"/> Sensibilizimi i qeverisë, autoriteteve e agjensive lokale mbi AVL <input type="checkbox"/> Perceptimi kulturor i të mbijetuarve nga AVL <input type="checkbox"/> Komunikimi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat tradicionale të komunikimit, dialektet e gjuhës, sistemi tradicional i edukimit, materiale e metoda të njohura nga populli.</li> <li>• Simbolizimi i ngjyrave, kuptimi i shenjave etj.</li> <li>• Ndonjë praktikë tradicionale e zgjidhjes së konflikteve dhe rolet e ndryshme të njerëzve (veçanërisht burrave dhe grave)</li> </ul> <input type="checkbox"/> Menaxhimi i kontakteve: kush janë komunikuesit kryesorë? Psh. profesorët, zyrtarët politikë, drejtuesit e opozitës, mësuesit, doktorët, kryetarët e bashkive etj. Si mund t'iu afrohemi atyre? Cilat janë mendimet e tyre rreth programeve të mundshme të AVL? <input type="checkbox"/> Hartimi i mediave: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aksesit tek mediat/Pamja politike e mediave</li> <li>• Publiku i shënjestruar nga mediat/ A ka një ligj për Informacionin Publik</li> <li>• Çmimi i spoteve televizive/Mbulimi gjeografik i mediave të ndryshme</li> </ul>	+ +  +    +	+ + + + + + + + + + +	+   + + + +	Përmbledhje  K  Përmbledhje K K  Përmbledhje/ K  K K P

<sup>31</sup> SH=(Anketa mbi Shpërndarjen e Armëve të Vogla); I = (Anketa mbi Impaktin e Armëve të Vogla); K = (Anketa mbi Kapacitetin e Armëve të Vogla); P = Anketa mbi Perceptimin e Armëve të Vogla



	STUDIMI PËR ADAPTUESHMIËRINË	VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE KAPACITETEVE	PLANI I KOMUNITETIT MË TË SIGURTË	TË DHËNA TË MARRA NGA ANKETA KOMBËTARE TË AVL
<p>Analiza e Problemit të AVL</p>				
(a) Çështjet e shpërndarjes/mbajtjes së armëve:	+	+		SH
<input type="checkbox"/> Tipet e AVL dhe gjatshmëria inë komunitete; tipet e AVL që shkaktojnë më tepër dëmtime brenda shoqërisë (psh. të ligjshme apo të paligjshme, të tipit sportiv apo ushtarak, eksplozivë apo armë të vogla?)				
<input type="checkbox"/> Njohuria mbi kushtet në të cilat merren AVL	+	+	+	SH
<input type="checkbox"/> Sasia e vlerësuar e armëve në qarkullim për popullsinë		+	+	SH
<input type="checkbox"/> Sasia në përqindje e komuniteteve/fshatrave të prekur	+	+		SH
<input type="checkbox"/> Rrugët e trafikimit dhe rrjetet për import, eksport, shitje		+		SH
<input type="checkbox"/> Çdo produkt lokal i AVL që mund të lidhet me shtimin/shpërdorimin		+	+	SH
(b) Impakti	+	+	+	I
<input type="checkbox"/> Vlerësimi i numrit të vdekjeve dhe plagosjeve nga AVL dhe kushtet në të cilat këto raste kanë ndodhur		+	+	I
<input type="checkbox"/> Përqindjet e zhvillimit të krimit, vrasjet, plagosjet		+	+	I
<input type="checkbox"/> Njohuri për forma të tjera të përdorimit/shpërdorimit të AVL, psh. raste të dhunës në shtëpi të lidhur me AVL, gjuajtjet me armë gjatë festimeve.		+	+	I
<input type="checkbox"/> Njohuri për probleme të tjera të lidhura me AVL, psh. përkeqësimi i tensioneve ndër-etnike, ndjenja e pasigurisë, dhunimet e të drejtave të njeriut nga ana e forcave të rendit	+	+	+	I/P
<input type="checkbox"/> Kostot që AVL sjellin për sistemin e shëndetit publik dhe ekonominë (turizmin, investimet, impaktin e konfliktit)		+		I
Analiza e njohurisë institucionale për AVL	+	+		Përmbledhje
<input type="checkbox"/> Mësimet e nxjerra nga iniciativa ekzistuese për AVL në vend		+		
<input type="checkbox"/> Mësime të nxjerra nga iniciativa të mëparshme për AVL në vend		+		
<input type="checkbox"/> Mësime të nxjerra nga iniciativa të mëparshme për AVL në vende të tjera		+		-
<input type="checkbox"/> Mësime të nxjerra nga iniciativa të tjera për zhvillimin/advokimin në vend, për shembull, iniciativat mbi shëndetin publik, ndërthurjet për çmimin		+		Përmbledhje
<input type="checkbox"/> Dokumente e marrëveshjeve ndërkombëtare (Psh. Marrëveshja e Dayton)		+		




Analiza e popullsisve të prekura	+	+	+	+	Pregled	
<input type="checkbox"/> Roli i burrave, grave dhe fëmijëve dhe grupeve të ndryshme etnike; liderat e komunitetit dhe anëtarë me influencë në komunitet; qëndrimet kulturore; besimet fetare; traditat; strukturat e pushtetit; niveli i edukimit (në nivelin e komunitetit ka nevojë për analizën e të interesuarve)					+	
<input type="checkbox"/> Informacion mbi vdekjet dhe plagosjet nga AVL: moshë, seksi, ushtarë apo civil, shkaku i plagosjes apo vdekjes, vendi, data, efekti					+	I
<input type="checkbox"/> Vlerësimi i sjelljeve të tanishme në lidhje me AVL: <ul style="list-style-type: none"> <li>Arsyet e ndryshme për mbajtjen e AVL dhe përdorimin/shpërdorimin sipas grupeve (psh. gjëti, varfëri, konflikt etnik, politika përjashtuese, gjakmarrje, identitete dhe vlera, vetëmbrojtje)</li> <li>Aktivitetet e ndikuara nga prania e AVL</li> <li>Aktivitetet ekzistuese të kontrollit të AVL brenda komunitetit?</li> <li>Çfarëdo strategji e pranisë lokale për AVL</li> <li>Sjellje e sigurta dhe të pasigurta</li> <li>Faktorët që shpjegojnë kërkesën për AVL (psh. cilat janë kushtet dhe faktorët që motivojnë njerëzit që të armatosen?)</li> <li>Kuptimi i roleve shoqërore të AVL (psh. cili është roli që AVL luajnë në komunitet?)</li> </ul>					+	P
<input type="checkbox"/> Vlerësimi i qëndrimeve dhe perceptimeve të problemit, (duke u kujtuar që të shikohet për dallime mes grupeve të rëndësishme shoqërore); <sup>32</sup> <ul style="list-style-type: none"> <li>Perceptime të ndryshme individuale dhe komunitare të sigurisë njerëzore</li> <li>Siguria e perceptuar dhe impakti i sigurisë nga heqja e armëve</li> <li>Perceptimi i komunitetit për problematikën e AVL</li> <li>Perceptimi i komunitetit mbi llojin e ndërhyrjes AVL (psh. mbledhja e armëve) që duhet të mbështetet prej individëve dhe komunitetit dhe se kush duhet ta kryejë atë (psh. organizata ndërkombëtare, forcat e policisë)</li> <li>Rëndësia/ritja e industrisë së sigurimit privat etj.</li> </ul>					+	P
<input type="checkbox"/> Vlerësimi i niveleve ekzistuese të Sensibilizimit dhe njohurisë mbi AVL (përsëri, shikoni për dallime mes grupeve shoqërore kyç): <ul style="list-style-type: none"> <li>Shtimi dhe shpërdorimi i AVL dhe efektet që pasojnë (vendet, tipi, rrezikët, a njihni ndonjë të mbijetuar?)</li> <li>Sjelljet e sigurta</li> <li>KSi lidhen AVL me grupet në rrezik dhe ato përdoruese (social-ekonomike, efekte psikologjike, çfarë impakti kanë AVL në jetën e tyre?)</li> <li>Zgjidhje alternative</li> </ul>					+	P
<input type="checkbox"/> Roli i grupeve specifike të shënjestruara (psh. gratë, drejtuesit fetarë në influencimin e sjelljeve) dhe qëndrimi kundrejt mbajtjes së armëve dhe çarmatimit; strukturat familjare (psh. klanet)					+	P
<input type="checkbox"/> Opinonet nga komunitetet mbi mënyrat dhe metodat më të mira për të çarmatosur; ndonjë pengesë për çarmatimin					+	P
<input type="checkbox"/> Perceptimet e njerëzve kundrejt medias, qeverisë, komunitetit ndërkombëtar dhe dhënësve kryesorë të sigurisë.					+	P

<sup>32</sup> Kurdoherë që të jetë e mundur është e domosdoshme të ndahet informacioni i mbledhur sipas kategorive sociale kryesive si klasa, race, etnia, seksi, besimi fetar dhe vendndodhja (veçanërisht diferencat mes zonave rurale dhe urbane). Kjo do të lejojë Menaxherët e Programit që të dinë nëse komunitetet dhe grupet e ndryshme sociale kanë njohuri, eksperiencë dhe qëndrim të ndryshëm në lidhje me AVL dhe për të përgatitur strategjinë e programit në përputhje me këto njohuri.




### Kutia 9: Përse njerëzit mbajnë armë zjarri

Në një numër anketimesh të ndryshme të ndërmarra në 2003, familje në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbinë e Jugut u pyetën se përse ata mendonin se njerëzit në komunitetet e tyre mbanin armë zjarri. Katër grafikët e mëposhtëm përmbledhin statistikën e marra. Në secilin rast përgjigjet ndryshonin sipas grupit shoqëror dhe vendndodhjes, por “vetëmbrojtja” del si një temë konstante. Anketimi i detajuar mund të gjendet në një formë të plotë në faqen internet: <http://www.seesac.org/reports/surveys.htm>.



- Për Mbrojtje Personale
- Për të mbrojtur pronën
- Për të mbrojtur komunitetin
- Për Siguri Politike
- ▨ Të mbetura nga lufta
- Për gjueti
- Për sport
- Për punë
- ▨ Si hobi/mbajtje me dëshirë
- Pjesë e Traditës
- ▨ Pronë me vlerë e familjes
- Për arrogancë
- Për të kryer krime/vrasje
- Për hakmarrje
- ▨ Sensibilizim i ulët/naivitet
- Të tjera
- Refuzuan të flisnin
- Nuk e dinin




- Mbrojtje Personale
- Mbrojtje e pronës
- Mbrojtje e Komunitetit
- ▨ Siguri politike
- Për gjueti
- ▨ Për sport
- Për punë
- Si hobi
- Pjesë e traditës
- Pasuri me vlerë e familjes
- Të mbetura prej krizës
- Refuzuan të përgjigjeshin
- ▨ Nuk e dinë




Kutia 9: Përse njerëzit mbajnë armë zjarri (e vazhduar)

Mal i Zi, Prill 2003



- Për mbrojtje personale
- Si traditë familjare
- Sport/Hobi
- Nuk di si të çarmatoset
- I bëjnë të ndihen më të fortë
- Për respekt
- Sepse është në modë
- Të tjera
- Nuk e dinë

Maqedoni, Korrik 2003



- Për mbrojtje personale
- Për të mbrojtur pronën
- Për të mbrojtur komunitetin
- Për siguri politike
- Të mbetura nga kriza
- Për gjueti
- Sport
- Për punë
- Pjesë e traditës
- Të tjera
- Refuzuan të flisnin
- Nuk e dinë



### 3.4 Metodatat për mbledhjen e informacionit

Metoda të ndryshme mund të përdoren për të mbledhur informacion. Këto metoda të përdorura varen nga informacioni i mbledhur dhe gjithashtu nga faktorët kontekstualë si niveli i aksesit tek grupet kyçe sociale, pengesat kohore, si dhe sensitiviteti i informacionit që do të mblidhet. Kështu për shembull, praktikatat shoqërore dhe kulturore do të pengojnë nivelet e aksesit tek grupet kyçe dhe dëshirën e tyre për të dhënë informacion, ndonjëherë duke e bërë të nevojshme mbledhjen e grupeve të diskutimit të të njëjtit sex apo të së njëjtës përkatësi etnike. Por metodatat e përdorura do të varen gjithashtu edhe nga tipi i informacionit që duhet të mblidhet:

- Nëse është informacion i përgjithshëm rreth vendit apo rreth njohurive institucionale (përgjithësisht i mbledhur në nivelin lokal); apo
- Informacion më specifik rreth popullsisë të ndikuara si përshembull perceptimi i tyre për problemet e AVL, qëndrimi i tyre kundrejt mbajtjes së armëve, opinionet e tyre rreth mënyrave të mbledhjes së armëve e kështu me rradhë (përgjithësisht i mbledhur në nivelin e komunitetit); apo
- Të dhëna mbi viktimat (të mbledhura si në nivelin qëndror ashtu edhe në atë komunitar)

#### **Kutia 10: Anketimi i perceptimit të AVL në Serbinë e Jugut**

Me qëllimin për të aftësuar zyrën e PNUD në Serbi dhe Mal të Zi për të vendosur se cila ndërhyrje AVL do të ishte e përshtatshme në Serbinë e Jugut, kompania e studimit të tregut e bazuar në Beograd “Strategic Marketing” (SMMRI) u kontraktuan në Korrik/Gusht 2003 për të mbledhur të dhëna rreth perceptimit të popullatës në tre bashkitë e prekura nga AVL në Bujanovc, Medvegjë dhe Preshevë. Dizenoja e anketës përdori mjete si pyetësorët shtëpi më shtëpi, intervistat e strukturuar dhe grupet e fokusuar për ta bërë mbledhjen e informacionit më fleksibël. Sidoqoftë ky ambjent me etnicitet të përzier, pas-konfliktual, dhe në disa raste tepër tradicional shfaqti vështirësi për kërkuesit. Eksperienca për tu përmendur përfshijnë:

- Një përqindje të lartë refuzimi mes të intervistuarve të shënjestruar në zonat e prekura direkt nga konflikti
- Vështirësi në gjendjen e personave që do të punonin në skuadra kërkimore Serbo-Shqiptare me dy persona për të anketuar komunitetet me etnicitet të përzier.
- Refuzime për regjistrimin e grupeve të fokusuar që të transkriptoneshin më vonë
- Vështirësi në krijimin e grupeve të fokusuar të përbëra vetëm nga gra të etnisë Shqiptare
- Një tendencë e përbashkët mes të shënjestruarve të intervistuar për të folur lirisht për një ose më shumë orë mbi një numër çështjesh të ndryshme nga AVL për të testuar synimet e kërkuesve.

*Burimi: Anketa për Perceptimin e Armëve të Vogla në Serbinë e Jugut, Shtator 2003, SMMRI.*

Metodat kryesore, si sasiore ashtu edhe cilësore, mund të rradhiten si më poshtë:<sup>33</sup>

- Anketime ilustruese.
- Anketime bazë mbi njohurinë, qëndrimet dhe praktikatat (Anketa NJQP).
- Diskutime me grupe të fokusuar.
- Intervista të thelluara.
- Intervista kapëse.
- Vëzhgimet.

<sup>33</sup> Shembuj të mjeteve më të përdorura, si dhe udhëzime për përdorimin e tyre jepen në Anekset C, D, E dhe F. Informacion më i detajuar mbi secilën metodë mund të gjendet në ‘Komunikimi në Programet e Sensibilizimit mbi Minat, Qendra Ndërkombëtare e Gjenezës për Çminimin Humanitar, 2002’





- Rishikimi i dokumenteve dhe të dhënave.
- Metodën e Vlerësimit të Shpejtë Pjesëmarrës.
- Rastet studimore.
- Metodën e anketimit trigonometrik.

Informacioni i nevojshëm mblidhet:

- Nga stafi i marrë në punë nga organizata përgjegjëse për ndërmarrjen e anketimit dhe/ose nga stafi dhe vullnetarët e programit për Sensibilizimin e AVL në rastin e një vlerësimi të nevojave dhe kapaciteteve; dhe
- Nga burime të ndryshme si autoritetet kombëtare/lokale (psh. ministritë, ushtria, policia, bashkitë, kryepelqët etj.) institucionet/shoqatat/OJQ lokale; organizatat ndërkombëtare; media; popullsia lokale (psh. viktimat, mësuesit, fermerët, prindërit, fëmijët, drejtuesit fetarë etj).


**Tabela 6: Shembuj të metodave të mbledhjes së informacionit**

TIPI I INFORMACIONIT	NIVELI I MBLEDHJES	SHEMBUJ TË METODAVE
Informacion i përgjithshëm (psh. kërcënime, specifikimet e vendit)	Në nivel qendror	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Takime dhe diskutime me ministritë e interesuara; autoritetet lokale; agjensitë e kontrollit të AVL si edhe agjensitë tjera humanitare; media lokale</li> <li>• Rishikimi i raporteve ekzistente</li> </ul>
Informacion specifik rreth njohurive, qëndrimeve, perceptimeve të komuniteteve të prekura	Në nivel komuniteti	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Anketimet NJQP</li> <li>• Takime dhe diskutime me autoritetet lokale psh. kryepelqët dhe me liderat fetarë, mësuesit e shkollave, grupet e grave etj. (si pjesë e Planit të Komunitetit të Sigurtë)</li> <li>• Rishikimi i raporteve të aktiviteteve nga agjensitë e zhvillimit që punojnë në ato zona specifike</li> <li>• Intervista me grupet në rrezik dhe përdoruesit e armëve</li> </ul>
Të dhëna mbi viktimat	Në nivel qendror dhe nivel komunitar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Statistika ekzistuese nga Ministria e Shëndetësisë apo çdo Ministri tjetër e rëndësishme.</li> <li>• Media</li> <li>• Takimet me organizatat e ndihmës shëndetësore dhe për viktimat</li> <li>• Shikimi i raporteve të aktiviteteve dhe statistikave</li> <li>• Formë e standartizuar e mbledhjes së të dhënave për viktimat AVL (nëse është e mundur)</li> <li>• Intervista me viktimat apo të afërmit e tyre</li> <li>• Intervista me përdoruesit e armëve</li> </ul>

### 3.5 Mbledhja e informacionit si një mjet për monitorimin dhe vlerësimin

Mbledhja e informacionit ndodh në të gjitha fazat e ciklit të programit që nga studimi i aplikueshmërisë e deri tek vlerësimi i aktiviteteve të AVL. Informacioni i mbledhur është esencial për monitorimin dhe vlerësimin e programit.

Për qëllime monitoruese dhe vlerësuese, është thelbësore që të ndërmerret një Vlerësim Bazë i Njohurive, Qëndrimeve dhe Praktikave (NJQP) në komunitetet e shënjestruara përpara zbatimit të çfarëdo ndërhyrjeje për Sensibilizimin e AVL (shikoni Aneksin C). Kjo do të lejojë organizatën zbatuese që të masë impaktin e ndërhyrjeve të AVL në komunitetet e shënjestruara duke krahasuar njohurinë, qëndrimin dhe praktikën përpara dhe pasi ndërhyrja të ketë ndodhur. Tregues të tjerë si niveli i vizibilitetit të AVL; numri i armëve të dorëzuara gjatë



mbledhjes së AVL; dhe shkalla e kriminalitetit mund të përdoren për të vlerësuar programet e ndërhyrjeve për AVL. Këto tregues, sidoqoftë, paraqesin probleme për vlerësimin e programeve të Sensibilizimit të AVL duke qënë se një numër i madh variablesh të ndryshme nga vetë aktivitetet e programit mund të ndikojnë mbi to.

### 3.6 Trajnimi i stafit

Do të jetë thelbësore që të trajnohen stafi dhe vullnetarët e atyre programeve që mundën në fakt të mbledhin informacion, si kur detyrat e tyre do të përfshijnë kërkimin duke përdorur burime dytësore (shikoni Aneksin F), apo kërkime parësore duke punuar brenda komuniteteve. Në rastin e fundit, një pjesë e stafit nga komunitetet e rëndësishme duhet të merren në punë si aktivistë dhe të trajnohen. Trajnimi i tyre duhet të mbulojë fusha si mjetet themelore për kërkim (Shikoni Aneksin C-F) dhe trajnimin në çështjet e AVL duke përfshirë dhe terminologjinë, njohjen e AVL, dhe çështjet e sensitivitetit. Rekrutimi dhe trajnimi i stafit lokal jo vetëm që do të ndërtojë besimin dhe do të ndihmojë mbledhjen e informacionit, por gjithashtu do të japë një mënyrë me anë të së cilës metodat e përdorura për mbledhjen e informacionit të mund të kritikohen dhe rregullohen sipas kushteve lokale. Së fundmi, përfshirja e njerëzve vendas është gjithashtu një hap drejt përfshirjes së komuniteteve të trajtuara si një trup i vetëm në aktivitetet e Sensibilizimit të AVL që do të pasojnë.

### 3.7 Parimet dhe menaxhimi i informacionit

#### 3.7.1 Qartësia dhe transparenca<sup>34</sup> në lidhje me qëllimin e mbledhjes së informacionit

Komunikimi i qartë dhe transparent me autoritetet, individët dhe komunitetet gjatë fazës së mbledhjes së informacionit në një program mikro-çarmatimi apo Sensibilizimi AVL është një parakusht për suksesin e kësaj faze të programit. Në përgjithësi qartësia dhe transparenca duhet të jepen në lidhje me:

- Qëllimet e programeve të AVL për të clat informacioni është duke u mbledhur.
- Tipi i informacionit që kërkohet.
- Si, kur dhe ku do të mblidhet.
- Prej kujt (në terma të përgjithshëm) do të kërkohet ky informacion.
- Kush do ta mbledhi informacionin (indentiteti i stafit në terren dhe organizatës së tyre).
- Përse nevojitet ky informacion.

Qartësia në lidhje me pyetjet e mësipërme është një hap esencjal për ti bërë njerëzit që jetojnë në komunitete të prekura nga AVL më të dëshiruar për të dhënë informacion. Kur trajtohet një çështje delikate si shtimi dhe shpërdorimi i AVL, çdo të intervistuar (me përjashtim të zyrtarëve që zgjedhin të jenë të "cituar") duhet përgjithësisht që ti jepet një garanci anonimiteti.

#### **Kutia 11: Transparenca dhe konfidencialiteti**

Si pjesë e Projektit Pilot në Gramsh, Shqipëri në 1998, OJQ-ja "Lëvizja për Çarmatim" ndërmori një projekt pilot që shënjestroi një shkollë fillore rurale, një shkollë tetëvjeçare urbane, dhe një shkollë të mesme (studentët nga 15-18 vjeç). Ideja kryesore ishte që të punohej me fëmijët për të influencuar prindërit që të dorëzonin armët. Si pjesë e këtij projekti, një anketim anonim u ndërmor me 900 nxënës shkollash duke i pyetur për armët në shtëpi. 20% e të intervistuarve u përgjigjën se ata kishin armë në shtëpi. Ndërsa ishte esenciale të qenurit transparent ndaj objektivave dhe dhe qëllimit si të projektit pilot ashtu edhe të vetë anketimit, ishte gjithashtu jetësore që anketimi të mbahej anonim në mënyrë që mbledhja e informacionit të ishte e suksesshme.

*Burimi: Intervistë me stafin e "Lëvizja për Çarmatim", partneri i UNDP i përfshirë në Projektin Pilot të Gramshit*

<sup>34</sup> Gjithashtu një nga parimet e programeve të mikro-çarmatimit, shikoni PMSA 01.10 [http://www.seesac.org/resources/current\\_eng.htm](http://www.seesac.org/resources/current_eng.htm)

### 3.7.2 Fleksibiliteti

Në disa kontekste, disa lloje informacioni mund të jenë delikate për tu mbledhur (psh. të pyesësh njerëzit se sa armë kanë ata në shtëpi) dhe ideja është që të krijohen çështjet në një mënyrë më pak të debatueshme (psh. të flitet më shumë në terma 'sigurie') apo të përqaset subjekti nëpërmjet çështjeve jo të debatueshme si shëndeti, impakti social-ekonomik, si shtimi i AVL ndikon prospektivat e vendit për paqe dhe zhvillim, apo mundësisht edhe roli i fëmijëve. Staf i programit duhet të jetë i gatshëm të adaptohet në situatat specifike dhe atje ku është e nevojshme të bëjë ndryshimet e duhura tek metodat e planifikuara për mbledhjen e informacionit, apo llojin e informacionit që kërkohet.

Ata gjithashtu duhet të jenë të gatshëm të nxjerrin konkluzione fillestare nga çdo stepje që ata shohin mes komuniteteve kur është rradha për të diskutuar çështjet e AVL. Stepja mund të lindë prej një numri arsyesh, duke përfshirë edhe frikën se njerëz të tjerë në komunitet nuk do të aprovojnë këtë diskutim (psh. anëtarët e familjes apo grupet e fuqishme); frikë nga forcat e rendit, mosbesim i përgjithshëm që lind prej niveleve ekstreme të tensionit dhe pasigurisë; frikë nga hetimi apo procedimi apo edhe një ndjenjë e përgjithshme se çështjet e AVL janë private. Kushdo qoftë arsyeja, duke krijuar një kuptim të arsyeve se përse njerëzit stepen për të diskutuar mbi AVL, stafi i programit do të fillojë të kuptojë më mirë komunitetin dhe funksionin e AVL.

Pavarësisht nga këto vështirësi të pritshme, është e rëndësishme të mbahet mend se AVL janë vetëm një çështje e ndjeshme midis shumë çështjeve dhe se programet e ndërhyrjes sociale mbi subjekte të tjera tabu si për shembull përdorimi i drogave, edukimi seksual, edukimi për gratë dhe HIV/AIDS kanë treguar se stepja mund të tejkalohet duke përdorur mjetet e duhura dhe pak durim e ndjeshmëri. Përdorimi i teknikave të 'dëgjimit aktiv' mund të ndihmojë marrjen e informacionit në një mënyrë jo-shtypëse dhe jo-urdhëruese.<sup>35</sup>


#### Kutia 12: Udhëzime mbi dëgjimin aktiv

Dëgjimi aktiv ka nevojë për përpjekje dhe përqëndrim dhe përfshin:

- Njohjen e barrierave për komunikimin efektiv; të cilat mund të jenë:
- Të brendshme (si për shembull lodhja apo stresi, ose vetë paragjykimet tuaja)
- Të jashtme (si për shembull zhurmat e ambientit apo akustika e dobët); ose
- Ndëraktivizuese (për shembull, se si gjuha mund të kuptohet apo interpretohet nga njerëz të ndryshëm)
- Të dëgjuarit për përmbajtjen e mesazhit për tu siguruar që ju dëgjoni pikërisht atë që thuhet
- Të dëgjuarit për ndjenjat – kjo mund të tregohet nga të dhënat jo verbale si qëndrimi trupor apo toni i zërit me të cilin thuhet fjalët
- Kontrollimi se të dhënat verbale dhe jo verbale janë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme
- Inkurajimi i folësit duke u përgjigjur nëpërmjet shprehjeve të fytyrës dhe gjestet trupore
- Reflektimi i gjërave që ju mendoni se keni dëgjuar duke i perifrazuar dhe duke bërë pyetje kontrolluese të shkurtra
- Përqëndrimi
- Patja e vëmendjes tek konteksti i përgjithshëm dhe temat e përgjithshme dhe mos shpërqëndrimi nga fakte të izoluara apo komente
- Të dëgjuarit e pikëpamjeve e opinioneve që bien në kundërshtim me tuajin, pa ndërprerë
- Zgjedhja e pyetjeve të duhura për të ndihmuar udhëheqjen e diskutimit

*Burimi: E adaptuar prej 'Komunikimi Personal në Punë', Open University Press, 1998*

<sup>35</sup> Termi 'Dëgjim Aktiv' i referohet si teknikave të komunikimit të përshkruara në Kutinë 12 ashtu edhe një lloji projekti për krijimin e paqes që ndodh në komunitete. Për më tepër informacion për këtë të fundit shikoni 'Dëgjimi dhe Organizimi Popullor', Walters, H. Rural Southern Voice for Peace, 1992.



### 3.7.3 Cilësia dhe sasia e informacionit

Informacioni i mbledhur përdoret për të krijuar dhe planifikuar një strategji të përshtatshme. Cilësia e informacionit është kyçe për krijimin e programit të adaptuar në kontekstin lokal dhe do të jetë gjithmonë e rëndësishme që të fokusoheni në cilësinë e informacionit që mblidhet. Sasia është njësoj e rëndësishme kur është puna për të planifikuar një strategji të përshtatshme por që mund të jetë e kufizuar në disa kontekste.

### 3.7.4 Saktësia

Aktivistët e programeve duhet të synojnë të sigurohen se ata po mbledhin informacion të saktë dhe të vërtetë. Në mënyrë që të maksimizohen shanset për këtë gjë, çdo informacion i mbledhur duhet që të krahasohet me burime të tjera të gatshme në mënyrë që të konfirmohet apo hidhet poshtë. Kontrollimi i dyfishtë i informacionit përpara planifikimit të strategjisë, dhe përpara se të ndahen rezultatet do të sigurojë që strategjia të jetë e vlefshme dhe me kuptim dhe do të evitojë gabime të panevojshme faktike.

### 3.7.5 Krijimi i një rrjeti për mbledhjen e të dhënave mbi viktimat

Të dhënat mbi viktimat janë të rëndësishme kur është puna për të identifikuar grupet në rrezik, për të kuptuar tipet dhe shkaqet e vdekjeve dhe plagosjeve dhe impaktin që AVL kanë mbi individët dhe komunitetet. Siqdoftë, të dhënat e detajuara mbi viktimat mund të jenë të vështira për tu marrë për një numër arsyesh, prandaj një duhet që të krijohet një rrjet kërkuesish për të mbledhur informacionin. Kur kërkoni të dhëna mbi viktimat do të jetë e nevojshme që ju:

- Ti shpjegoni autoriteteve lokale objektivat e mbledhjes së të dhënave dhe të merrni autorizime për tyre;
- Të identifikoni dhe kontaktoni organet e interesuara që mund të ndihmojnë në mbledhjen e informacionit psh. policia, strukturat shëndetësore, Shoqëria Kombëtare e Kryqit të Kuq, drejtuesit e fshatrave (kryepleqtë), përfaqësuesit e qeverisë, OJQ-të etj; apo që të rekrutoni një skuadër profesionistësh që të mbledhin infotmacionin, ose një kombinim i këtyre të dyjave;
- Të siguroheni që rrjeti është mjaftueshëm i përzier në termat e seksit, moshë, aftësive profesionale dhe përkatësisë etnike për të siguruar që antarë të përshtatshëm të jenë të gatshëm për grupe të ndryshme të shënjestruara. (psh. gratë të flasin me gratë, ish-luftëtarët me ish-luftëtarët);
- Të krijoni dhe trajtoni rrjetin e identifikuar në mbledhjen e të dhënave: dhe
- Të siguroheni që të dhënat të zërthehen aty ku është e mundur për të treguar çështje të rëndësishme si seksi, mosha dhe përkatësia etnike e viktimave të AVL – dhe nëse është e mundur, se cili ishte përgjegjës.

#### Kutia 13: Mbledhja e të dhënave mbi viktimat në Maqedoni

Gjatë një Anketimi kombëtar AVL në Maqedoni në 2003, informacioni u kërkua në 5 spitale që u menduan se përfaqësonin vendin në tërësi përsa i përket përkatësisë etnike, gjeografisë dhe efekteve të konfliktit. Kartelat mjeksore në të pestë spitalet u kontrolluan për një periudhë dymbëdhjetë-mujore gjatë së cilës ishin regjistruar 81 plagë me armë zjarri. 47% e gjithë plagëve ishin klasifikuar si “të lehta”, 41% si “të rënda” dhe 12% si “kritike”. Shumica e plagëve ishin marrë nga njerëz mbi 18 vjeç, por 50% e plagosjeve kritike ishin tek fëmijë nën 18 vjeç. 89% e viktimave ishin burra dhe 11% gra. Sidoqoftë, shumë komunitete me kombësi shqiptare në Maqedoni kishin shërbime mjekësore të panjohura nga qeveria dhe të cilave nuk u kërkohet të mbajnë të tilla të dhëna. Këto struktura nuk kishin dëshirën që të jepnin asnjë të dhënë mbi viktimat që ato mund të kishin të ruajtura kur atyre iu kërkua kjo gjë nga kërkuesit në këtë rast. Pavarësisht, mjekë dhe zyrtarë të intervistuar ishin të mendimit se plagët me armë zjarri trajtoheshin me siguri nëpër këto struktura.

*Burim: Raport i përkohshëm nga Anketa për Armët e Vogla, Gjeneva, për UNDP Macedonia, Korrik 2003*



Një numër i madh njerëzish mund të thirret për të marrë pjesë në mbledhjen e të dhënave dhe mund të kombinohet në rrjet me dy tipe të stafit për mbledhjen e informacionit: 'informatoret' të cilët marrin trajnim bazë, dhe 'mbledhësit e të dhënave' të cilët monitorojnë punën e informatoreve dhe për këtë marrin trajnim më të thelluar. Zgjedhja e 'informatoreve' është thelbësore për të arritur mbledhjen e informacionit të duhur dhe të saktë. Ata duhet, sa më tepër që të jetë e mundur, që të jenë njerëz brenda komunitetit të cilët janë të besueshëm, të motivuar dhe kanë lehtësi në marrjen e informacionit. Duke patur varësi tek konteksti dhe tek organizmat ekzistuese dhe baza-aftësore, një rrjet vullnetarësh mund të krijohet apo një skuadër e tërë mbledhësish informacioni mund të rekrutohet. Një kombinim i një skuadre profesionale me asistencën e vullnetarëve në terren mund të jetë gjithashtu një zgjidhje në disa situata, siç ishte për shembull rasti i mbledhjes së të dhënave mbi viktimat e minave në Bosnje-Hercegovinë.

#### **Kutia 14: Mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e të dhënave mbi viktimat e minave/UXO në Bosnje-Hercegovinë**

ICRC, në bashkëpunim të ngushtë me Shoqërinë e Kryqit të Kuq të Bosnje-Hercegovinës (RCSBiH), është e vetmja organizatë në Bosnje-Hercegovinë e cila sistematikisht mbledh dhe publikon të dhëna mbi viktimat e minave. Rrjeti i RCSBiH i përbërë nga staf dhe vullnetarë ndjekin gjithë raportet formale dhe jo formale mbi aksidentet e minave/UXO në komunitetet e tyre. Ata marrin të dhëna mbi viktimat, rrethanat e incidentit, vendngjarjen dhe informacione të tjera për t'ja kaluar koordinatoreve të Shoqërisë Kombëtare të cilët, më pas, ia kalojnë të dhënat ICRC-së. ICRC i shton informacionet në një bankë të dhënash që rifreskohet vazhdimisht. ICRC e përdor informacionin brenda organizatës për të planifikuar dhe zbatuar mesazhe direkte dhe të shënjestruara për disa grupe me rrezik të lartë dhe vendndodhjet e tyre në vend. Të dhënat ndahen me çdo organizatë me të cilën ICRC ka një lidhje në Bosnje-Hercegovinë, qoftë kjo formale apo jo formale. Duke vepruar kështu, ICRC kontribuon tek përpjekjet e përgjithshme humanitare për të reduktuar numrin e minave të tokës dhe pajisjeve të pashpërthyera në vend. ICRC dhe RCSBiH ndërmarrin anketime më të detajuara në Bosnje-Hercegovinë, vlerësojnë efektivitetin e programeve, dhe përkufizojnë fushatat dhe mesazhet efektive.

### **3.7.6 Menaxhimi dhe ndarja e informacionit**

Ndarja e informacionit me organet dhe autoritetet e interesuara është thelbësore për koordinimin e ndërhyrjeve të AVL ashtu edhe për aktivitete të tjera zhvilluese dhe ndihme psh. informacioni mbi viktimat mund të lejojë përkufizimin e nevojave të viktimave si mbështetja mjekësore dhe psikologjike. Do të jetë thelbësore që të ndahet ky informacion me organizatat të cilat mund të japin këtë lloj mbështetje.

Në disa kontekste, ndarja e të dhënave mund të kushtëzohet nga rregulli i konfidencialitetit. Për shembull, mund të duhet që të krijohen Memorandume Mirëkuptimi me organe të tjera për të siguruar konfidencialitetin (psh. në mënyrë që të dhënat mbi viktimat të mund të aksesohen dhe përdoren pa shpërndarë informacione personale). Informacioni rreth shpërndarjes së AVL në një komunitet do të jetë shpesh një çështje e ndjeshme, veçanërisht atëherë kur nivelet e posedimit janë të larta për shkak të frikës (psh. frikë nga forcat e rendit apo nga grupe etnike). Kujdes duhet treguar në ndarjen e çfarëdo lloji informacioni të marrë prej komuniteteve dhe transparenca duhet të jetë një shqetësim kyç.

### **3.7.7 Siguria**

Siguria e punonjësve në terren ka një rëndësi shumë të madhe, për ata si individë, për interesin e programit, si edhe për përfituesit përfundimtar të projektit. Informacioni në lidhje me shpërndarjen e AVL në komunitete të veçanta, grupet që i mbajnë ato, origjinat dhe lëvizjet e tyre është i tëri shumë i rrezikshëm për tu mbledhur, veçanërisht në zona ku AVL trafikohen apo janë të lidhura në ndonjë mënyrë me frikën për siguri të komuniteteve lokale. Në disa raste informacioni mbi impaktin e AVL mund të jetë i rrezikshëm për tu mbledhur. Punonjësit në terren mund të përballen me armiqësi apo abuzime gjatë punës së tyre, ndonëse skenarë që përfshijnë burgosje apo plagosje janë shumë të rralla. Në zonat post-konfliktuale punonjësit e terrenit mund të jenë të ekspozuar ndaj rreziqeve të MEL dhe AVL të pasiguruara. Punonjësit e terrenit dhe menaxherët duhet të sigurojnë së bashku adoptimin e disa masave bazë sigurie gjatë fazës së mbledhjes së informacionit të një programi për Sensibilizimin për të ndihmuar minimizimin e rrezikut. Punonjësit në terren duhet që:



- a) Marrin një trajnim për Edukimin mbi Rreziqet e AVL për sigurinë e tyre;
- b) Së bashku me zyrat qendrore të vendosin linja të qarta komunikimi dhe të jenë në kontakt të vazhdueshëm me zyrat qendrore;
- c) Ti përmbahen një planit të punës për të cilin është rënë dakort;
- d) Së bashku me zyrat qendrore të kërkojnë lejen nga qeveria dhe autoritetet qendrore;
- e) Të evitojnë udhëtimin vetëm, dhe preferueshmërisht të udhëtojnë me dikë që ka njohuri lokale; dhe
- f) Të vihen në dijeni të kushteve lokale të sigurisë dhe çfarëdo rreziku të mundshëm për ta (psh. nga MEL, grupet kriminale apo militante) përpara se të hyjnë në atë zonë.

Këto rreziqe ndikojnë stafin dhe programin në tërësi. Të mbajturit në kontakt me grupet e informuara si gazetarët, agjensitë e Kombeve të Bashkuara, OJQ-të humanitare, kontaktet kërkimore dhe OJQ-të lokale do ti lejojnë stafit që të vlerësojë rreziqet e terrenit dhe ti trajtojë ato. Përgjegjësia për sigurinë e stafit të programit (duke përfshirë këtu edhe vullnetarët) ndahet mes punonjësve në terren dhe pjesës tjetër të stafit, ndonëse të drejtat dhe detyrimet ekzakte të secilit do të varen nga situata.

## 4 Analiza dhe planifikimi i strategjisë


### 4.1 Analizimi i informacionit

Analizimi i informacionit të mbledhur në fillim të një programi për Sensibilizimin e AVL lejon planifikimin e një strategjie. Informacioni do të jetë si i përgjithshëm (psh. informacion për vendin, niveli i edukimit, kërcënimet, problemet etj.) ashtu edhe specifik në lidhje me perceptimin dhe qëndrimet e komunitetit, të dhënat mbi viktimat e kështu me rradhë. Analizimi i lejon aktivistët që të:

- a) Identifikojnë përjasjen që do të zbatohet: a do të jetë më me vlerë që të krijohen aktivitete për Advokimin apo për Edukimin mbi Rreziqet, apo të dyja? Kjo do të varet natyrisht nga aktivitete të tjera për kontrollin e AVL që po zbatohen apo planifikohen të zbatohen; dhe
- b) Planifikojnë një strategji të përshtatshme, duke vendosur qëllimin, objektivat, treguesit dhe mjetet e verifikimit për programin në mënyrë që:
  - Të përkufizohen grupet e shënjestruara;
  - Të identifikohen komunitetet e ndikuara;
  - Të vendosen mesazhet dhe informacioni që do të shpërndalet;
  - Të vendoset për aktivitetet që do të zbatohen dhe materialet që do të prodhohen si një mjet për të shpërndarë mesazhet dhe informacionet; dhe
  - Të planifikohet monitorimi dhe vlerësimi.

Një numër i ndryshëm mjetesh mund të përdoren si ndihmës për të analizuar informacionin e mbledhur, duke përfshirë përshebull, Analizën e të Interesuarve<sup>36</sup> e cila lejon analizimin e të interesuarve në një vend apo komunitet të caktuar në termat e rëndësisë që ata kanë për programin, si edhe shkallën e influencës që ata kanë mbi progresin e mundshëm të tij. Analiza ja vlen që të ndërmerret në çdo komunitet, dhe gjithashtu në nivel kombëtar. Mjete si Analiza e të Interesuarve mund gjithashtu të përdoren pasi të jenë formuluar objektivat e programit, për të kontrolluar se cilët nga të interesuarit do të mbështesin dhe cilët mund të pengojnë arritjen e objektivave të programit<sup>37</sup>.

Diagrama 4: Shembull i Analizës së të Interesuarve në nivel komuniteti



<sup>36</sup> Të interesuarit janë personat, grupet apo institucionet të interesuar në një projekt apo program të veçantë.

<sup>37</sup> Më tepër informacion sesi të ndërmerret një analizë e situatës, dhe si të bëhet një Analizë e të Interesuarve mund të gjendet tek <http://www.dfid.gov.uk/FOI/tools/>.



**Çelës:** 1 = Drejtuesit politikë, 2 = Ish-luftëtarët, 3 = Drejtuesit e biznesit, 4 = Fëmijët, 5 = Drejtuesit fetarë

**Shpjegim:** Të interesuarit në kutitë A, B dhe C janë të interesuarit kyç në një komunitet të imagjinuar. Ata në kutinë A kanë rëndësi të madhe për projektin (psh. si viktimat të shpërdorimit të AVL) por influencë të ulët – programi duhet që të dizajnohet për të arritur tek ta. Ata në kutinë B kanë një shkallë të lartë influence në lidhje me kontrollin dhe/ose Sensibilizimin e AVL dhe janë të rëndësishëm për suksesin e programeve të planifikuara – mbështetja e tyre do të duhet të fitohet. Ata në kutinë C janë me shumë influencë dhe mund të ndikojnë rezultatet e programit, por interesat e tyre nuk do të preken drejtpërdrejt – ata do të duhet që të angazhohen nga programi, të monitorohen dhe të konsultohen. Të interesuarit në kutinë D janë me prioritet të ulët.

#### 4.1.1 Grupet e shënjestruara

Mbi bazën e analizimit të informacionit të mbledhur mund të krijohet një strategji e programit. Grupet e shënjestruara do të identifikohen dhe do tu jepet prioritet si pjesë e strategjisë. Lista e grupeve të shënjestruara është potencialisht e pafundme dhe është e rëndësishme që të zbulohen se cilat grupe mund të jenë të rëndësishme në çdo vend e komunitet specifik në lidhje me Programin për Sensibilizimin e AVL që mund të krijohet. Një listë jo-gjithëpërfshirëse e grupeve të shënjestruara mund të përfshijë:

- Mbajtësit e armëve.
- Familjet e mbajtësve të armëve.
- Qeveria lokale.
- OJQ-të Lokale.
- Media.
- Oficerët e policisë.
- Meshkujt e rritur.
- Femrat e rritura.
- Djemtë adoleshentë.
- Vajzat adoleshente.
- Fëmijët nga 5 deri në 8 vjeç.
- Fëmijët nën 12 vjeç.
- Ish-luftëtarët.
- Figurat fetare.
- Figurat lokale të biznesit.
- Mësuesit.
- Ushtria.
- Donatorët.

#### Kutia 15: Fushat e Kryqit të Kuq Jugosllav ‘Për Jetën, Pa Armë’

Fushata gjithëvjeto e Kryqit të Kuq Jugosllav për Sensibilizimin e AVL ‘Për jetën, pa armë’ u përpoq të influenconte opinionin publik rreth mbajtjes së armëve mbi bazën e kostos humanitare të këtij veprimi. Sloganet u krijuan për të përçarur idenë se mbajtja i një arme çon tek pasiguria dhe viktimat, dhe jo tek siguria dhe paqja. Tre grupe specifikë u shënjestruan nëpërmjet mesazhesh dhe metodash të ndryshme:

- Adoleshentët e të dy sekseve (12-19 vjeç), veçanërisht në zonat urbane
- Meshkujt e rritur (20-35 vjeç)
- Meshkujt e rritur (35 vjeç e më të rritur)

Materiale shembull nga ky program janë të dhëna në CD-ROM-in e PMSA.





Grupet që do të shënjestrohen do të varen nga strategjia e sensibilizimit dhe nga nevojat e komuniteteve, të dyja të identifikuarat gjatë Anketimit kombëtar për AVL dhe/ose vlesërimit të kapaciteteve dhe nevojave. Mesazhet që do të shpërndahen do të duhet që të adaptohen për secilin nga grupet e shënjestruara. Siç u përmend edhe më lart, ngandongjëherë nuk do të jetë e lehtë që të arrihet tek grupe të veçanta për shkak të natyrës së ndjeshme të subjektit dhe/ose roleve sociale (psh. nganjëherë AVL shihen sikur të jenë ‘punë për burrat’, kështu që grupet e diskutimit me gratë janë të vështira për tu krijuar). Në të tilla raste stafi i programit mund të jetë fleksibël dhe të gjejë mënyra për të anashkaluar problemin (në këtë rast specifik ndoshta duke folur fillimisht me grupet e grave).

Është e rëndësishme të nënvizohet se mund të jetë e nevojshme që të përkufizohen disa ‘grupe të menjëhershme të shënjestruara’ për të arritur tek publiku final i shënjestruar (psh. për të inkurajuar burrat që të dorëzojnë armët e tyre), mund që të jetë e nevojshme që të arrihen fillimisht gratë dhe/ose fëmijët si një mënyrë për të nxitur burrat. Çdo strategji që përfshin përdorimin e grupeve ndërmjetëse do të ketë nevojë për objektiva të ndërmjetëm të lidhur me këto grupe të shënjestruara.

#### **Kutia 16: Burrat – një grup i shënjestruar kyç**

Në shumicën e aktiviteteve për Sensibilizimin e AVL, burrat si grup do të jenë një publik tepër i rëndësishëm sepse shumë shpesh ata do të jenë si viktimat të shpërdorimit të AVL ashtu edhe mbajtës të armëve. Prandaj është e rëndësishme që të punohet me median për të shënjestruar një publik specifikisht të përbërë nga burrat psh. programe në televizion për gjahun dhe sportin.

## **4.2 Planifikimi strategjik**

Analiza e informacionit të mbledhur lejon krijimin e strategjisë për Sensibilizimin e AVL, si edhe përkufizimin e objektivave të programit. Objektivat e programit duhet që të përkufizohen gjatë fazës së planifikimit në mënyrë që aktivitetet dhe materialet që shërbejnë për ti arritur ato të mund të krijohen, të mund të zgjidhen tregues të përshtatshëm për të matur progresin dhe impaktin dhe të mund të identifikohen sisteme për monitorimin dhe vlerësimin (shikoni Seksionin 8). Kështu për shembull, në një komunitet që vuan nga efektet e shtimit të AVL si pasojë e një konflikti të armatosur të ndodhur kohët e fundit:

- a) Informacion i përgjithshëm është mbledhur mbi natyrën e kërcënimit të AVL. Kjo, së bashku me informacionin sfond mbi historinë e konfliktit do ti lejojë planifikuesit e programeve që të vendosin se cili rajon i vendit është i ndikuar nga kontrolli i papërshtatshëm i AVL. Pasi të kenë analizuar këtë informacion planifikuesit e programit do ti japin prioritet punës së tyre në bazë të vendndodhjes së problemit dhe kërcënimeve; dhe
- b) Informacion specifik është mbledhur gjatë intervistave me komunitetin (si pjesë e vlerësimit të nevojave) duke treguar:
  - Një qëndrim të përbashkët mes adoleshentëve (djem dhe vajza) që është shumë ‘bukur’ (ose ndryshe, në modë) për djemtë që të mbajnë armë;
  - Të dhënat mbi viktimat kanë treguar qartë përqindjen e lartë të fëmijëve dhe adoleshentëve meshkuj të cilët plagosen apo vriten nga AVL; dhe
  - Shumica e fëmijëve të cilët janë plagosur nga AVL i kanë gjetur këto armë në shtëpi.

Kjo analizë na tregon se grupi kryesor i shënjestruar për programin e Sensibilizimit të AVL duhet të jenë fëmijët dhe adoleshentët. Mesazhe të ndryshme do të jenë të nevojshme në secilin rast për shkak të qëndrimeve dhe sjelljeve të ndryshme të shpalosura nga secili grup kundrejt AVL. Si rezultat, strategjia mund të krijohet, për shembull:

- a) Programi do të zbatohet kryesisht në zonën ku më përpara ka ndodhur konflikti, duke qënë se armët janë të përhapura vetëm në këtë zonë;



- b) Aktivitete interaktive do të zhvillohen me fëmijët duke trajtuar ç'është e sigurtë si lodër;
- c) Një Plan i Komunitetit më të Sigurtë do të zhvillohet me adoleshentët për të diskutuar se çfarë konsiderohet si qëndrim 'në modë', si dhe të eksplorojnë alternativat për djemtë adoleshentë që dorëzojnë armët;
- d) Trajnimi i mësuesve që do të zhvillohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit për të mbështetur Edukimin afatgjatë mbi Rreziqet e AVL për fëmijët dhe adoleshentët; dhe
- e) Plani i Komunitetit më të Sigurtë do të shënjestrojë gratë për të rritur mesazhet që i shkojnë fëmijëve të tyre.

Llojet e ndryshme të informacionit dhe të dhënave të mbledhura duhet që të trajtohen dhe analizohen fillimisht dhe më pas të kombinohen për të përkufizuar strategjinë (psh. nëse ju e dini që djemtë adoleshentë janë grupi më tepër i rrezikuar, do të jetë e rëndësishme të dihet se cilët janë anëtarët e komunitetit të cilët mund të influencojnë tek këta adoleshentë). Do të jetë gjithashtu e rëndësishme që të dihet cilat janë mjetet e komunikimit. Nëse organizata të tjera janë të përfshira, do të jetë jetësore që të koordinohet me to me qëllim që të njëjtat grupe të shënjestruara të mos arrihen disa herë dhe që mesazhet të koordinohen brenda komunitetit. Tabela e mëposhtme tregon se si do të duket strategjia e një programi në komunitetin fiktiv 'A', dhe se si kjo strategji buron nga analiza e informacionit të mbledhur.

Tabela 7: Si të planifikojmë një strategji duke përdorur informacionin e mbledhur.

INFORMACIONI DHE TË DHËNAT E MBLEDHURA	ANALIZA	PLANIFIKIMI I STRATEGJISË
<p><b>Rreziku i përgjithshëm nga AVL</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Armët janë të gjendshme përgjithësisht në Jug të vendit ku ka ndodhur një konflikt i brendshëm; ish-luftëtarët akoma i kanë armët e tyre dhe djemtë adoleshentë gjithmonë e më shumë mbajnë armë.</li> <li>• Një amnisti 3-mujore është planifikuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mesazhet e Edukimit mbi Rreziqet e AVL do të jenë të ndryshme në varësi të grupeve të shënjestruara.</li> <li>• Do të bëhet ndarja e prioriteteve për punën sipas vendndodhjes së rrezikut.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete të Edukimit mbi Rreziqet do të fokusohen në Jug të vendit.</li> <li>• Aktivitete ndëraktive duhet të zhvillohen me adoleshentët duke u fokusuar në rrezikun e mbajtjes së armëve.</li> <li>• Diskutime në grup me ish-luftëtarë mbi çështjet dhe rreziqet e AVL.</li> <li>• Mesazhe advokimi që duhet të shpërndahen në gjithë vendin, për të informuar njerëzit rreth amnistisë dhe për ti inkurajuar ata që të dorëzojnë armët.</li> </ul>
<p><b>Impakti tek komunitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmijët dhe adoleshentët (veçanërisht djemtë) janë plagosur sepse ata mendojnë se është 'bukur' që të luash me apo të përdorësh armët.</li> <li>• Niveli i kriminalitetit është rritur si rezultat i gjetjes me lehtësi të armëve në Jug të vendit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Grupet kryesore të shënjestruara janë fëmijët, adoleshentët (djemtë si përdoruesit potencialë të armëve dhe vajzat sepse ato mund të mbështesin rolet stereotipike të meshkujve) si dhe meshkujt e rritur, duke përfshirë dhe ish-luftëtarët.</li> <li>• Tipe të ndryshme mesazhesh do të përçohen për secilin nga grupet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete ndëraktive do të ndërmerren me fëmijët duke u fokusuar mbi çfarë janë gjërat e sigurta me të cilat mund të luhet.</li> <li>• Aktivitete me adoleshentët duke punuar mbi çështje si çfarë është 'bukur' dhe çfarë nuk është.</li> <li>• Trajnime me adoleshentët në mënyrë që mesazhet të përcillen në një afat të gjatë.</li> <li>• Plani i Komunitetit më të Sigurtë me njerëzit për të gjetur zgjidhje alternative për të përmirësuar sigurinë në komunitet.</li> </ul>



INFORMACIONI DHE TË DHËNAT E MBLLEDHURA	ANALIZA	PLANIFIKIMI I STRATEGJISË
<p>Përfshirja e aktorëve të tjerë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Një OJQ lokale ka nisur aktivitete advokimi në një komunë.</li> <li>Qeveria po planifikon një amnisti tre mujore për të lejuar mbledhjen e armëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Një organizatë është përfshirë tashmë në komunikimin e mesazheve rreth çështjeve të AVL por mbulon vetëm një pjesë të vogël të zonës.</li> <li>Një strategji komunikimi duhet që të zhvillohet për të mbështetur programin e mbledhjes së armëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mesazhe për Edukimin mbi Rreziqet dhe Advokimin do të koordinohen me OJQ-në Lokale.</li> <li>Aktivitete Advokimi do të zhvillohen për të rritur ndërgjegjësimin e njerëzve rreth rreziqeve të AVL. Mesazhe për të inkurajuar komunitetet që të dorëzojnë armët. Koordinim me të tjerët, veçanërisht me Autoritetin Kombëtar të AVL janë të nevojshme për të zbuluar objektivat specifike dhe planet e amnistisë si edhe çfarëdo strategji komunikimi dhe aty ku është e mundur të mbështetet kjo strategji.</li> </ul>
<p>Mënyrat e komunikimit, përqindjet e analfabetizmit, shkollimi etj.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shumica e njerëzve kanë radio por TV është përgjithësisht i pranishëm nëpër qytete.</li> <li>Shumica e njerëzve në zonat rurale janë analfabetë</li> <li>Shumica e adoleshentëve në zonat rurale nuk shkojnë më në shkollë dhe ndihmojnë prindërit e tyre në aktivitetet e tyre të përditshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mesazhet e Edukimit mbi Rreziqet dhe Advokimin mund të shpërndahen nëpërmjet radios por TV nuk është një mjet eficient për njerëzit që jetojnë në zonat rurale.</li> <li>Prodhimi i materialeve mbështetëse me vizatime e fotografi të përshtatura për ambjentin në vend që të përdoret tekst i shkruajtur.</li> <li>Aktivitetet jashtëshkollore duhet që të kërkohen për të shënjestruar adoleshentët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njoftimet në radio do të prodhohen duke shënjestruar fëmijët, adoleshentët dhe ish-luftëtarët si dhe rreziqet e AVL.</li> <li>Emision radiofonik që duhet të lidhet me aktivitetet e komunitetit për të mbështetur Planin e Komunitetit më të Sigurtë</li> <li>Reklamat televizive do të prodhohen duke u fokusuar tek amnistia dhe dorëzimi i armëve.</li> <li>Materiale mbështetëse do të prodhohen duke reflektuar idetë dhe nevojat e secilit grup.</li> </ul>
<p>Perceptimi i problemit prej komunitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shumica e grave i shohin armët si një burim frike dhe rreziku për fëmijët e tyre; ato e shohin çarmatimin si një mënyrë për të ulur kriminalitetin.</li> <li>Burrat duan ti mbajnë armët si një mënyrë për të mbrojtur familjet e tyre</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gratë janë gjithmonë të ndërgjegjshme për rreziqet që paraqesin armët për familjet dhe komunitetin e tyre. Ato duhen përdorur që t'ja përcojnë këtë mesazh burrave.</li> <li>Mbajtësit e armëve duhen ftuar në diskutim për të folur mbi sigurinë personale dhe alternativat në vend të armëve, municionit/eksplzivëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani i Komunitetit më të Sigurtë do të zhvillohet si me gratë ashtu edhe me burrat.</li> <li>Materialet për rritjen e Sensibilizimit dhe për të informuar rreth sjelljeve të sigurt do të prodhohen dhe shpërndahen prej grave për të mbështetur aktivitetet e tyre.</li> </ul>
<p>Sjelljet e rrezikshme brenda komuniteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Fëmijët kanë gjetur armë në shtëpitë e tyre dhe kanë luajtur me to.</li> <li>Djemtë adoleshentë gjithmonë e më tepër kanë përdorur armët që ju janë dhënë prej babait të tyre</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mesazhet duhet të zhvillohen sipas sjelljeve me rrezik të secilit grup.</li> <li>Baballarët duhet që të shënjestrohen për të parandaluar përdorimin e armëve nga fëmijët dhe adoleshentët, sidomos djemtë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani i Komunitetit më të Sigurtë ku burrat trajtojnë çështjet e adoleshentëve që mbajnë armë.<sup>38</sup></li> <li>Mbështetja e grave dhe mësuesve për të zhvilluar ndëraktivitete me fëmijët mbi rrezikun e luajtjes me armët.</li> </ul>



INFORMACIONI DHE TË DHËNAT E Mbledhura	ANALIZA	PLANIFIKIMI I STRATEGJISË
<p>Mjetet e komunikimit brenda shoqërisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gratë janë burimi kryesor i informacionit brenda familjes.</li> <li>• Drejtuesit fetarë respektohet dhe shpesh u kërkohet mendimi për këshillime</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gratë dhe drejtuesit fetarë duhet të përdoren si vektorë për të dhënë informacion tek fëmijët, adoleshentët dhe burrat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Plani i Komunitetit më të Sigurtë me një vendosje theksi tek përdorimi i focus grupeve për të përfshirë gratë në dizajnimin e mesazheve për fëmijët dhe burrat.</li> <li>• Zhvillimi i një kurrikule me drejtuesit fetarë. Prodhimi i materialeve për të mbështetur aktivitetet e tyre.</li> </ul>

#### 4.2.1 Mbështetja institucionale

Në shumë, ndoshta në shumicën e rasteve nuk do të jetë e mundur që të zbatohet cilado strategji e vlefshme për Sensibilizimin e AVL pa miratimin e zyrtarëve të qeverisë. Mbështetja institucionale është e nevojshme në nivelet kombëtar, rajonalë dhe komunitar. Në rastin e një programi të veçantë të Edukimit mbi Rreziqet dhe Sensibilizimin e AVL në mbështetje të ndërhyrjeve kombëtarisht të planifikuara për mikro-çarmatimin, komunikimi i hapur rreth programit dhe kontakte të rregullta do të lehtësojnë mbështetjen në të gjitha nivelet. Në ndryshim, atje ku po planifikohet një program i veçantë i Advokimit për AVL, mbështetja qeveritare nuk mund të hamendësohet paraprakisht dhe mund të varet nga çështjet që po promovohen si dhe nga mënyra se si ato po paraqiten.

#### 4.2.2 Struktura e njësisë së programit

Tipi dhe madhësia e njësisë së programit do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë madhësinë dhe burimet organizative ekzistuese, organizatat partnere, nevojat e komuniteteve të prekura si dhe hapsirën gjeografike që do të mbulohet. Së bashku këto dhe të tjerë faktorë do të vendosin numrin e stafit që do të përfshihet dhe do të rekrutohet (psh. a do të rekrutojmë personel, do të punojmë me vullnetarë nga komuniteti apo të dyja?). Aktivitetet e Edukimit mbi Rreziqet e AVL si dhe zbatimi i Planeve të Komuniteteve të Sigurta do të kërkojnë në çdo rast përfshirjen e komunitetit si dhe ndjekje të vazhdueshme, duke rritur kështu nevojat për staf (kostot mund të mbahen në minimum duke përdorur vullnetarët).

#### 4.2.3 Trajnimi i stafit

Trajnimi i stafit të rekrutuar është i nevojshëm dhe duhet që të planifikohet. Anëtarët e stafit duhet që të trajnohen jo vetëm mbi çështjet e AVL (terminologjinë, llojet, ndjeshmërinë) por gjithashtu edhe sesi të zbatojnë, monitorojnë dhe raportojnë për aktivitetet e ndërmarra. Një shkallë trajnimi duhet të jetë dhënë më përpara prej asaj pjese të stafit që ka marrë pjesë në aktivitetet e mbledhjes së informacionit (shikoni seksionin 3.6). Do të jetë e nevojshme që të zhvillohen procedura dhe materiale konsistente trajnimi duke përdorur informacionin e mbledhur në anketimet kombëtare apo analizimin e nevojave të programit si dhe analizën strategjike që është zhvilluar prej këtij informacioni.

#### 4.2.4 Koordinimi

Koordinimi me autoritetet në nivelin qendror, rajonal dhe komunitar, si dhe me organizata të tjera humanitare dhe zhvillimi është thelbësor për të evituar dyzimin e aktiviteve dhe për të siguruar një përqasje të përbashkët dhe të sinkronizuar. Vëmendje e veçantë duhet që ti kushtohet koordinimit me organizatat që zbatojnë aktivitete për ERRM për shkak se ekziston rreziku që mesazhet dhe aktivitetet të bien në konflikt (shikoni Seksionin 2.5.2). Integrimi i aktiviteve të Sensibilizimit të ALV me ndërhyrje të tjera për kontrollin e AVL dhe/ose operacione zhvillimi/humanitare do të sigurojnë që nevojat e komuniteteve të marrin përgjigjen e duhur. Nevojat e komuniteteve mund të identifikohen duke përdorur Planin e Komunitetit më të Sigurtë (shikoni Seksionet 2.6 dhe 7.1).

<sup>38</sup> Edukimi mbi Rreziqet e AVL për adoleshentët është potencialisht problematik sepse të rinjtë janë në vetvete një grup që ndërmerr rrisqe, veçanërisht megjithëse jo përjashtimisht burrat. Vendosja e theksit tek rreziku nga armët mund të mos i dekurajojë disa individë që ti marrin dhe ti përdorin ato. Në këtë rast strategjia e programit sygjeron një Plan të Komunitetit më të Sigurtë në mënyrë që fillohet diskutimi dhe që të gjenden zgjidhje të tjera përveç atyre që thjesht komunikojnë rrezikun e armëve.

### 4.3 Vendosja e qëllimit dhe objektivave të programit

Objektivat vendosen herët gjatë programit për Sensibilizimin e AVL, pasi të jetë mbledhur informacioni dhe të jetë analizuar, dhe ndërsa planifikohet strategjia. Një grup i zgjedhur i objektivave të programit për Sensibilizimin e AVL jepet më lart në Seksionin 2.2. Nëse i arrin këto objektiva një program për Sensibilizimin e AVL do të ndikojë pozitivisht mbi njohurinë, sjelljet, qëndrimet apo politikat në komunitetet e shënjestruara. Ky sukses më pas duhet që të mbështesë objektivin kryesor të çdo ndërhyrjeje për mikro-çarmatimin, gjithashtu të parashtruar më lart. Duke marrë tabelën shembull në Seksionin 4.2, strategjia dhe objektivat e mëposhtme mund të zhvillohen për Komunitetin 'A':

Tabela 8: Objektivat e programit për komunitetin 'A'

QËLLIMI: TË PËRMIRËSOHET SIGURIA NË KOMUNITETIN 'A'	
OBJEKTIVAT	STRATEGJIA E PLANIFIKUAR
<p><b>Objektivi 1</b></p> <p>Të lehtësohet një proces nëpërmjet të cilit grupet e rrezikuara të komunitetit (adoleshentët, fëmijët dhe meshkujt e rritur duke përfshirë ish-luftëtarët) të analizojnë sjelljet e tyre dhe të adoptojnë sjellje më të sigurta.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete ndëraktive do të zhvillohen me adoleshentët (vajza dhe djem) duke u fokusuar tek rreziku i mbajtjes së armëve</li> <li>• Diskutime në grup me ish-luftëtarët mbi çështjet e AVL si dhe gjetshmërinë e armëve në komunitet.</li> <li>• Aktivitete ndëraktive do të zhvillohen me fëmijët për të trajtuar se çfarë është e sigurt për tu përdorur si lodër.</li> <li>• Trajnime me mësuesit në mënyrë që mesazhet të jepen në një afat të gjatë kohor.</li> <li>• Mbështetja e grave dhe burrave në zhvillimin e ndëraktiviteteve me fëmijët mbi rreziqet e të luajturit me armët.</li> <li>• Mesazhe të Edukimit mbi Rreziqet/Advokimin do të koordinohen me OJQ-të lokale dhe Autoritetin Kombëtar të AVL.</li> <li>• Lajmërime në radio do të prodhohen duke shënjestruar fëmijët, adoleshentët dhe ish-luftëtarët mbi rreziqet e AVL.</li> <li>• Materiale mbështetëse do të prodhohen duke reflektuar idetë dhe nevojat e secilit grup.</li> <li>• Materialet për rritjen e Sensibilizimit dhe për të informuar rreth sjelljeve të sigurta do të prodhohen dhe shpërndahen prej grave për të mbështetur aktivitetet e tyre.</li> </ul>
<p><b>Objektivi 2</b></p> <p>Ndryshime në perceptimet e komunitetit për AVL si një mjet mbrojtës dhe, veçanërisht për djemtë dhe burrat si status</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Plani i Komunitetit më të Sigurtë me burrat dhe gratë për të gjetur zgjidhje alternative për të përmirësuar sigurinë në komunitet; Plani i Komunitetit më të Sigurtë me burrat për të trajtuar çështjen e djemëve adoleshentë që mbajnë armë; Plani i Komunitetit më të Sigurtë me theksin tek përdorimi i focus grupeve për të përfshirë gratë në krijimin e mesazheve për fëmijët dhe burrat.</li> <li>• Emisione në radio që do të lidhen me aktivitetet e komunitetit që mbështesin Planin e Komunitetit më të Sigurtë.</li> <li>• Materiale mbështetëse që do të prodhohen duke reflektuar idetë dhe nevojat e secilit grup.</li> <li>• Mesazhe të Edukimit mbi Rreziqet/Advokimin e AVL do të koordinohen me OJQ-të lokale dhe Autoritetin kombëtar të AVL.</li> <li>• Zhvillimi i kurrikulave me drejtuesit fetarë. Prodhimi i materialeve që do të mbështesin aktivitetet e tyre.</li> </ul>
<p><b>Objektivi 3</b></p> <p>Mbështetja e amnistisë duke rritur ndërgjegjësimin mbi rreziqet e AVL dhe rrjedhimisht duke inkurajuar dorëzimin e armëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mesazhe advokimi do të shpërndahen në gjithë vendin, për të informuar njerëzit mbi amnistinë dhe për ti inkurajuar ata që të dorëzojnë armët. Informacione dhe mesazhe do të koordinohen me strategjinë kombëtare të komunikimit të zhvilluar nga autoriteti kombëtar i AVL.</li> <li>• Aktivitete advokimi do të zhvillohen për të rritur sensibilizimin e njerëzve rreth rreziqeve të AVL; mesazhe për të inkurajuar komunitetet që të dorëzojnë armët.</li> <li>• Reklama televizive do të prodhohen duke u fokusuar tek amnistia dhe dorëzimi i armëve.</li> <li>• Materiale mbështetëse do të prodhohen duke reflektuar idetë dhe nevojat e secilit grup.</li> </ul>



QËLLIMI: TË PËRMIRËSOHET SIGURIA NË KOMUNITETIN 'A'	
OBJEKTIVAT	STRATEGJIA E PLANIFIKUAR
<p><b>Objektivi 4</b></p> <p>Informimi i publikut me informacion të fundit dhe të saktë rreth termave të saktë të ndërhyrjes së planifikuar kombëtare për mikro-çarmatimin</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Një seri mesazhesh me qëllim të përgjithshëm do të zhvillohen për tu përdorur me të gjithë grupet në faza të ndryshme gjatë programit. Mesazhet do të japin informacione në kohë dhe të sakta në lidhje me termat e saktë të ndërhyrjes, duke përfshirë dhe periudhat e amnistisë, mjetet nxitëse etj.</li> <li>Do të prodhohen materialet që do të përçojnë mesazhet në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur edhe lajmërimi Pyetje-Përgjigje, fletëpalosje për informimin publik (për shpërndarje me postë) si dhe nëpërmjet Lajmërimeve të Shërbimit Publik (LSHP) (Public Service Announcements PSA) në radio dhe televizion.</li> <li>Materialet do të shpërndahen/transmetohen në mënyrë strategjike për të arritur numrin më të madh të mundshëm të qytetarëve në kohën e duhur.</li> <li>Trajnime me stafin e programit për të transmetuar në mënyrë korrekte mesazhet e Informimit Publik së bashku me mesazhet e Edukimit mbi Rreziqet dhe Advokimin gjatë intervistave, vizitave në komunitete dhe takimet me zyrtarët.</li> </ul>

#### 4.3.1 Objektivat afatshkurtër dhe SMART

Gjithë provat na tregojnë se ndryshimet shoqërore ndodhin në afate të gjata. Prandaj planifikuesit e programeve duhet të tregohen realistë rreth shpejtësisë së ndryshimeve kur vendosin objektivat. Objektivat afatshkurtër janë të dobishëm për të identifikuar hapat në rrugën për të arritur objektivat dhe qëllimet përfundimtare të projektit dhe për ta bërë monitorimin e motivimit më të lehtë.

Një gjë e rëndësishme për tu marrë në konsideratë është se sa 'SMART' (smart në Anglisht do të thotë Të Zgjuara) janë objektivat e programit. 'SMART' është një shkurtim për:

Specifikë	të Matshëm	të Arritshëm	të Rëndësishëm	të Tregueshëm
(Specific)	(Measurable)	(Achievable)	(Relevant)	(Timetabled)

Kur vendosni objektiva, i bëni ato sa më SMART që të jetë e mundur në mënyrë që progresi të mund të matet. Dhe ndërsa programi zhvillohet dhe më tepër informacion bëhet i gatshëm, jini gati që të rishikoni objektivat e vendosur më përpara. Pasi qëllimi dhe objektivat janë vendosur dhe është përfunduar strategjia, aktivitetet dhe materialet, ashtu si edhe mesazhet që do të përdoren për të mbështetur këto aktivitete mund të shikohen dhe të rafinohen në mënyrë më preçize.

Në disa raste, objektivat e ndërmjetëm do të nevojiten që të vendosen për të arritur më mirë objektivat përfundimtarë të programit. Shembuj të zhvillimit progresiv të programit duke përdorur grupet e shënjestruara dhe objektiva të ndërmjetme janë ato programe që fillimisht tentojnë të rrisin sensibilizimin e grave dhe autoriteteve përpara se të shënjestrojnë mbajtësit e armëve, apo programet që fillojnë me programe të veçuara të Edukimit mbi Rreziqet në një tentativë për të sensibilizuar komunitetet përpara se të ndërmarrin punë më sfiduese si Advokimi.

#### Kutia 17: Përdorimi i ndërmjetësve për të shënjestruar grupet në rrezik

Në Brazil djemtë e rinj në moshën 15-29 vjeç kanë 24 herë më shumë mundësi të vdesin nga armët e zjarrit sesa gratë e së njëjtës grupmoshë. Si pjesë e punës së vazhdueshme për Sensibilizimin e AVL të bërë nga OJQ-ja VIVA RIO, u dizenua një strategji e fushatës me qëllimin për ti dhënë grave informacionin dhe argumentat që atyre u nevojiteshin për të promovuar çarmatimin në komunitetet e tyre, mes djemve dhe burrave të tyre. Në një ceremoni të shkatërrimit të armëve gratë bënë paradë me parulla me sloganin e fushatës 'Zgjidhni Mosmbajtjen e Armës: Ose Armën tënde ose Mua'.



## 5 Krijimi i mesazheve, aktiviteteve dhe materialeve, dhe zgjedhja e mediave

Pasi është mbledhur informacioni dhe është analizuar, dhe objektivat e programit janë vendosur, mund që të përgatiten mesazhet për secilin grup të shënjestruar, si dhe të zgjidhen metodat e përshtatshme për të përcuar këto mesazhe. Grupet e shënjestruara të identifikuar duhet që të përfshihen në këtë proces për të siguruar që informacioni dhe mjetet e shpërndarjes të jenë të përshtatshme për kushtet lokale.

Në këtë seksion mesazhet e Edukimit mbi Rreziqet, Advokimit dhe Informimit Publik janë marrë në konsideratë veç e veç. Veçanërisht gjatë punës për mikro-çarmatimin në terren këto mesazhe, materiale dhe aktivitete të përdorura mund të përziejnë tre llojet e mesazheve. Kjo nuk ka nevojë që të jetë problematike mjafton që objektivat e komunikimit të mbeten të qarta. Është gjithashtu thelbësore që të koordinohet krijimi i mesazheve me organizata të tjera që punojnë në të njëjtën fushë aktiviteti në mënyrë që të shpërndahet informacion koherent tek komunitetet.

### 5.1 Përpunimi i kurrikulave për Edukimin mbi Rreziqet e AVL

Në mënyrë që të arrihen grupet e shënjestruara të identifikuar me informacionin e përshtatshëm dhe mesazheve të këshillimit (psh. sjellje të vlefshme kyç për të reduktuar rreziqet e AVL) një kurrikul i Edukimit mbi Rreziqet e AVL duhet që të vendoset. Ekziston nevoja për të krijuar kurrikula të ndryshme për secilin nga grupet kyç të shënjestruara me të cilin stafi do të ndërmarrë aktivitete për Edukimin mbi Rreziqet e AVL. Informacioni i mbledhur gjatë fazës së vlerësimit të nevojave do të japë informacion për dizenjimin e kurrikulës, por shembuj të kurrikulave për grupet kyçe të shënjestruara jepen më poshtë. Ky kurrikul do të duhet të prodhohet si pjesë e një trajnimi fillestar për Edukimin mbi Rreziqet e AVL për antarët e rëndësishëm të stafit. Idealisht këta anëtarë të stafit duhet që të përfshihen në ndërmarrjen e vlerësimit të nevojave në mënyrë që gjatë kursit të trajnimit ata të mund të përdorin informacionin e mbledhur për të indentifikuar mesazhet specifike të këshillimit për secilin nga grupet e shënjestruara. Gjatë procesit të mbledhjes së informacionit, grupet e shënjestruara janë identifikuar dhe janë marrë në intervistë në lidhje me çështje si perceptimi i tyre mbi rreziqet e AVL, ndjeshmëritë dhe nevojat e tyre, si dhe dëshirën e tyre për të dorëzuar armët. Mesazhet pastaj mund të krijohen duke përdorur këtë informacion, dhe nëpërmjet këtij procesi, grupet e shënjestruara do të kontribuojnë në përpunimin e mesazheve për veten e tyre.

#### Kutia 18: Tipi i mesazheve

Kur zbatohen aktivitetet, tipi i mesazheve që do të transmetohet do të varet nga nevojat e komunitetit psh. disa nga grupet e shënjestruara mund të kenë njohuri tashmë mbi disa nga çështjet dhe nuk do të jetë e nevojshme që tu jepet atyre të gjitha mesazhet e përfshira në kurrikul. Lloji i mesazheve që do të jepen do të identifikohet gjatë diskutimeve me komunitetin si pjesë e Planit të Komunitetit më të Sigurtë.

Mesazhet për Edukimin mbi Rreziqet e AVL mund të ndahen në dy kategori bazë: mesazhe që lidhen me kërcënimin, problemet dhe rreziqet që vijnë nga AVL; dhe mesazhe në lidhje me sjelljet që duhet të përdoren për të minimizuar rreziqet e AVL. Në vazhdim, informacion mbështetës rreth AVL mund gjithashtu të jepet për të dhënë njohuri dhe kontekst shtesë, duke ndihmuar procesin e edukimit. Aneksi B i PMSA-së dhe CD-ROMi japin materiale të përshtatshme. Kurrikulat e Edukimit mbi Rreziqet e AVL dhe Advokimit për AVL do të ndryshojnë së tepërmi, por disa prej mesazheve mund të jenë të ngjashëm (psh. informacion i përgjithshëm rreth AVL mund të mbështesë të dyja llojet e komunikimit).

#### 5.1.1 Mesazhet që lidhen me kërcënimet dhe problemet e AVL

Këto mesazhe shënjestrojnë qytetarët dhe përfshijnë:

- a) Informacion për njohjen e AVL: Mësimi për të njohur llojet kryesore të AVL do të jetë shpesh hapi i parë drejt sjelljeve më të sigurta. Diskutimi i AVL në këtë nivel shumë asnjëanës dhe teknik mundet gjithashtu të jetë një hapës i dobishëm debatesh. (Shikoni prezantimet për Njohjen e AVL në CD-ROMin e PMSA dhe dokumentat për klasifikimin e armëve).



- b) Impakti i shtimit/shpërdorimit të AVL: (Shikoni gjithashtu Aneksin B në CD-ROM). Ato mesazhe mund gjithashtu të përdoren për qëllime Advokimi.
- c) Mesazhe në lidhje me sjelljet e rrezikshme që janë identifikuar më përpara (veçanërisht nëpërmjet analizës së informacionit të mbledhur) dhe si rrjedhim duhet që të evitohen, për shembull:
- Ndërmarrja e rrezikut pa dashje:
    - Kurioziteti.
    - Për të luajtur.
    - Mbajtja për la lëvizur prej një vendi për të mbrojtur të tjerët apo për ta hedhur poshtë.
    - Mbajtja si pasojë e padijes.
    - Keqpërdorimi gjatë përdorimit të zakonshëm (psh. gjatë gjuetisë).
    - Mbajtja thjesht 'për qejf' (djemtë adoleshentë/burrat e rinj bëjnë qejf duke luajtur si gangsterë, duke qëlluar shënjestra etj.) apo si një 'mjet mode' (psh. për tu dukur bukur).
    - Si pjesë e ngjarjeve tradicionale (psh. gjuajtja gjatë festimeve).
    - Magazinimi i pasigurtë.
  - Ndërmarrja e rreziku me qëllim:
    - Për vetëmbrojtje
    - Për përfitim ekonomik (duke përfshirë peshkimin me eksplozivë, aktivitetet kriminale (si trafikimi, marrja peng e personave).
    - Pathyeshmëria/kërkuesit e aventurave (veçanërisht djemtë adoleshentë dhe burrat e rinj).
    - Dhuna.
    - Kriminaliteti.
    - Plagosjet/vdekjet e vetë-shkaktuara.

#### Kutia 19: Marrja në konsideratë i ekspozimit ekzistues të fëmijëve tek AVL

Shpesh njerëzit e rinj në moshë (veçanërisht djemtë), tregojnë një dashuri të madhe për AVL, qoftë kjo sepse armët janë çështje tabu apo sepse ata i shikojnë armët të portretizuara në një mënyrë të madhërishtme, të pasigurtë dhe mashtruese nëpër filma, në televizion dhe nëpër lojra elektronike. Mes fëmijëve mjaftueshëm të rritur për të qenë të ekspozuar tek këto materiale, rezultati mund të jetë një perceptimi i përdorimit të armëve si një eksperiencë e mrekullueshme, veçanërisht në lidhje me stilin e jetës madhështor të kriminalitetit. Sidoqoftë, ajo me të cilën fëmijët nuk përballen kurrë është impakti tragjik i shpërdorimit të AVL në jetën e vërtetë – dhimbje, humbje e jetës dhe familje të traumatizuara. Për këtë arsye është e rëndësishme që të flitet me ta rreth diferencave mes armëve dhe dhunës në media dhe lojra si dhe mënyrës se si armët ndikojnë tek njerëzit në jetën e përditshme. Fëmijët janë gjithashtu kuriozë për nga natyra. Kjo i bën ata të ndjeshëm ndaj gjithë llojeve të AVL, sepse ndërsa ata luajnë ata mund të kërkojnë AVL, apo të përpiqen të merren me kurthe eksplozivë apo armë të braktisura dhe eksplozivë të gjendur përjashta. Çdo kurrikul për Edukimin mbi Rreziqet e AVL duhet që të marrë parasysh këta faktorë. Duhet që ti japë fëmijëve njohurinë, sjelljet dhe qëndrimet që duhet të kenë për të qenë të sigurtë rreth AVL, duke filluar me njohjen bazë të AVL.

### 5.1.2 Mesazhet për reduktimin e rreziqeve të AVL

Këto mesazhe shpjegojnë sesi të mblidhet vetvetja dhe të tjerët duke adoptuar sjellje që ulin rreziqet e paraqitura nga AVL. Këto mesazhe do të variojnë sipas grupit të shënjestruar dhe lidhjes drejt dhe perceptimit të AVL (psh. fëmijët kundrejt mbajtësve të ligjshëm të armëve kundrejt atyre që mbajnë armë të tipit ushtarak). Shembuj paraqiten në Seksionin 5.4 më poshtë.



## 5.2 Përpunimi i mesazheve për Advokimin e AVL

Punë për Advokimin e AVL nuk ka nevojë për një kurrikul të së njëjtës mënyrë si Edukimi mbi Rreziqet e AVL, ndonëse mësimet e Edukimit mbi Rreziqet do të jenë përgjithësisht mbështetëse të shumë objektivave të Advokimit në kuptimin që ata i tregojnë grupeve të shënjestruara rreziqet e mbajtjes/shpërdorimit të AVL. Po kështu shumë mesazhe të tipit të Advokimit do të kenë tendencën të mbështesin përpjekjet për Edukimin mbi Rreziqet (psh. fakte dhe të dhëna të përgjithshme rreth AVL).

Lloji i Advokimit për AVL që është marrë në konsideratë është ai që ndërmerret për të mbështetur një program mikro-çarmatimi me objektiv komunikimi mobilizimin e grupeve të shënjestruara për të mbështetur, apo për të marrë pjesë aktive, në aktivitetet e mbledhjes së AVL. Në këtë rast mesazhet e Advokimit janë ato që janë krijuar specifikisht për të mbështetur mbledhjen e armëve. Ashtu si dhe me të gjitha mesazhet e Sensibilizimit të AVL, mesazhet e Advokimit duhet që të krijohen mbi bazën e mbledhjes së informacionit, analizës dhe planifikimit strategjik, dhe grupet bazë duhet që të shënjestrohen në linjë me objektivat e programit. Sidoqoftë, mesazhet bazë mund të kenë nevojën që të ndryshohen apo të shtohen nëpër komunitete specifike. Arsyet për mbajtjen, shpërdorimin dhe gjetsshmërinë e AVL do të ndryshojnë nga komuniteti në komunitet, dhe mesazhet e Advokimit që mbështesin mbledhjen e armëve duhet ti përgjigjen këtij fakti.

Advokimi për AVL mundet gjithashtu të përfitojë nga përdorimi i pakteve dhe shifrave të përgjithshme rreth AVL në të njëjtën mënyrë si Edukimi mbi Rreziqet, (shikoni më lart).

### Kutia 20: Sloganet e fushatës – shembuj dhe sugjerime për tu përdorur

Sloganet e fushatave kanë tendencën të jenë shembuj tipikë të mesazheve të Advokimit. Shpesh një fjalë apo frazë e vetme përdoret për të identifikuar një Program për Sensibilizimin e AVL dhe në të njëjtën kohë për të përmbledhur objektivak kryesorë. Një slogan është gjithashtu një mundësi për të trajtuar problemet e AVL në një mënyrë pozitive. Për shembull në Bosnje-Hercegovinë, aktivistët e Kryqit të Kuq që punonin me ERRM i kanë shtuar mesazhit 'mos prek' sloganin "Ju mbijetuat nga lufta, tani i mbijetoni paqes":

- Bëni apel për temat e përgjithshme, bazë që njihen dhe marrin përgjigje nga një grup i madh njerëzish
- Testojeni sloganin me grupet e shënjestruara siç do të bënit me mesazhet e tjera
- Sigurohuni që nuk bie në kundërshtim me mesazhet tuaja bazë
- Përpiquni të krijoni diçka që tingëllon bukur dhe kini mendjen tek domethënia kulturore
- Mos përdorni të njëjtin slogan si fushatat e kaluara. Përpiquni të bëheni krijues – kjo do të kapi vëmendjen e njerëzve

Sloganet e mëposhtme janë përdorur tashmë në programet për Sensibilizimin e AVL në Europën Juglindore. Disa janë negativë, disa të tjerë pozitivë:

- Për një të Nesërme më të Mirë (Maqedoni, 2003)
- Lamtumirë Armë (Kroaci, vitet 90-të)
- Për Jetën, Pa Armë (Serbi, 2000/2001)
- Mos Ma Vrit Lirinë (Kosovë, 2003)
- Respektoni Jetën, Ktheni Armët (Mal i Zi, 2003)

## 5.3 Përpunimi i mesazheve për Informimin e Publikut mbi AVL

Në kontekstin e një ndërhyrjeje për AVL, objektivi i informimit publik është që të mbajë publikun të informuar plotësisht rreth termave të saktë të ndërhyrjes. Prandaj mesazhe specifike duhet ti jepen komuniteteve duke u kaluar informacion të saktë dhe në kohë në lidhje me:



- Datat e amnistisë për AVL.
- Mënyrat dhe koha e mbledhjes (psh. vizita proaktive nga agjentët e mbledhjes në vende të paravendosura, apo mbështetja tek publiku për të vizituar pikat e piketuara për mbledhjen e armëve).
- Organizatat e përfshira (psh. policia, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të).
- Aspektet ligjore (çfarë mund dhe nuk mund të dorëzohet; mundësitë e regjistrimit; dënimet).
- Detaje rreth çdo komponenti nxitës të asociuar me mbledhjen e armëve.
- (Në rastin e mbledhjes dhe magazinimit të AVL, agjentët dhe forcat normale të rendit). Informacion se si të sillen gjatë periudhës së çfarëdo amnistie dhe mbledhjeje.

Për shkak të natyrës së detajuar të këtij informacion, ai përçohet më mirë duke përdorur metoda dhe materiale që sigurojnë vazhdimësinë e shpërndarjes (psh. lajmërimet e shërbimit publik, dokumentat e 'procedurave standarte të veprimit', fletëpalosje dhe vizita në komunitete nga stafi i trajnuar).

#### **Kutia 21: Vështirësitë e transmetimit të mesazhe komplekse të informimit publik**

Projekti i UNDP-së Shqipëri, për Kontrollin e AVL (SALWC) filloi në Shkurt të 2002 dhe synoi të promovoi dhe ndihmoi përpjekjet për mbledhjen e armëve në pesë prefektura. Përbërësi i informimit publik të fushatës për Sensibilizimin e AVL u përqëndrua në termat e sakta të amnistisë, duke përfshirë edhe datën e planifikuar të përfundimit në 4 Gusht 2002, si dhe temat e skemës shoqëruese nxitëse (Armët në Shkëmbim të Zhvillimit). Pas përpjekjeve të zgjeruara për të publikuar këtë informacion, UNDP kërkoi bërjen e një anketimi për impaktin deri në mesin e fushatës në pesë prefekturat në Shtator 2002 për të matur efektivitetin e Programit për Sensibilizimin e AVL. Për shkak të zgjerimit të madh të aktiviteteve dhe mediave të përdorura në projektin SALWC 90% e të anketuarve u përgjigjën se ata kishin dijeni për projektin. Sidoqoftë, rreth 40% e tyre nuk kishin dëgjuar për aspektin e konkurrimit. 87.2% e të pyeturve e dinin gjithashtu datën 4 Gusht si përfundimin e amnistisë midis të cilëve ata me moshën nga 40 deri në 60 vjeç ishin më të mirëinformuarit. Lajmet në television ishin burimi më i lartë i informimit (52%), me reportazhet e Televizionit në 29%, posterat me 8.2%, fjalët gojë më gojë me 8.8% dhe takimet publike me 1.7%. Në shkallë të përgjithëshme, personat nën 18 vjeç treguan sensibilizimin më të ulët për detajet e projektit.

*Burimi: Raport i Periudhës së Parë, Projekti SALWC, UNDP Tiranë, Shtator 2002.*

## 5.4 Shembuj mesazhesh nga programe thelbësore për Sensibilizimin AVL<sup>39</sup>

Tabela 9: Mezashe për programet e veçara të Edukimit mbi Rreziqet e AVL

LLOJI I MESAZHIT TË EDUKIMIT MBI RREZIQET E AVL	
GRUPET E SHËNJESTRUARA	
<b>(a) INFORMACION PËR NJOHJEN E AVL</b>	
Çfarëdo/të gjithë grupet.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shikoni prezantimet për Njohjen e AVL dhe dokumentat e klasifikimit të armëve në CD-ROM-in shoqëruar</li> </ul>
<b>(b) INFORMACION PËR IMPAKTIN E AVL</b>	
Çfarëdo/të gjithë grupet	<p><b>Impakti i përgjithshëm</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në të gjithë Europën Juglindore shtimi dhe mbajtja e pakontrolluar e AVL po: i kundërvihet shtetit ligjor; shkakton vdekje tragjike çdo ditë; ndihmon krimin dhe paqëndrueshmërinë; rrit tensionet; mohon masat për sigurinë dhe ndërtimin e besueshmërisë; dhe vepron si një pengesë për zhvillimin.<sup>40</sup></li> </ul> <p><b>Impakti fizik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>AVL mund të vrasin apo plagosin një person. Çdo minutë një person vritet nga një armë. Mos njihni ndonjërin prej tyre? <sup>40</sup></li> <li>Referojuni gjithashtu edhe materialeve të Edukimit mbi Rreziqet në CD-ROM-in e PMSA, psh. 'Si ndodhin Vrasjet'.</li> </ul> <p><b>Impakti psikologjik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të plagosesh nga një AVL është një përjekje e përditshme. Nëse gjytohesh, mund të jetë e vështirë të vazhdosh aktivitetet e përditshme dhe të marrësh një rrogë; mund të jetë një betejë që të pranoresh në shoqëri dhe të kesh një jetë normale. Viktimat mund të humbasin mbështetjen e familjes së tyre. Familja mund të jetë e paaftë që të merret me vështirësitë emocionale dhe financiare të mbajtjes së një të gjymtuari. Vetë i gjymtuari mund të jetë i paaftë të durojë pasojat e aksidentit. Viktimat e AVL mund të humbasin krenarinë dhe besimin në vetveten dhe mund të bien në depression. Për më tepër mbajtësi i armës gjithashtu mban një barrë – atë të pailigshmërisë dhe frikës – ai duhet të jetojë me frikën se ai dhe arma e tij janë një rreziq për jetën. Pasi hiqet arma ai është më i lirë për të jetuar një jetë më të shëndetshme.</li> </ul> <p><b>Impakti lokal</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Do të varet nga informacioni i mbledhur në nivelet qendrore dhe komunitare.</li> </ul> <p><b>Të tjera</b> (psh. ekonomike, përqindjet e krimit, statistikat e mbledhjes dhe shkatërrimit, tregtia e armëve). Burime të mundshme përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Aneket B dhe F</li> <li>Banka e të dhënave të SEESAC mbi statistikën e mbledhjes e shkatërrimit të armëve (<a href="http://www.undp.org.yu/salw/reppar2.aspx">http://www.undp.org.yu/salw/reppar2.aspx</a> dhe <a href="http://www.undp.org.yu/salw/reppar3.aspx">http://www.undp.org.yu/salw/reppar3.aspx</a>)</li> <li>Informacioni i mbledhur në fillim të ciklit të programit dhe veçanërisht nga çfarëdo Anketim kombëtar për AVL (të gjetshme tek <a href="http://www.seesac.org/reports/surveys.htm">http://www.seesac.org/reports/surveys.htm</a>).</li> </ul>

<sup>39</sup> Mesazhet e programit do të zhvillohen në bazë të kërimit të bërë si psh. anketave për AVL si dhe një vlerësim të nevojave të programit – shembujt e mëposhtëm nuk synojnë që të jenë universalisht të aplikueshme.

<sup>40</sup> Ky është 'mesazhi bazë' i vetë SEESAC në lidhje me impaktin e AVL në rajon.

<sup>41</sup> Një statistikë e ofruar nga IANSA, <http://www.iansa.org>.



LLOJI I MESAZHIT TË EDUKIMIT MBI RREZIQET E AVL	
GRUPET E SHËNJESTRUARA	II INFORMACION NË LIDHJE ME SJELLJET E RREZIKSHME
Grupet e rrezikuara	<ul style="list-style-type: none"> <li>Do të bazohen në informacionin e mbledhur</li> </ul>
MESAZHET PËR REDUKTIMIN E RRIKUT TE AVL	
Të përgjithshme	<p><b>Armët</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjithë armët krijohen që të vrasin. Ato kërkojnë trajnim specialistësh për tu përdorur në mënyrë të sigurtë. Nëse ju nuk keni të tillë trajnim ju nuk duhet të tentoni të mbani një armë.</li> <li>Armët e stilit ushtarak janë veçanërisht të rrezikshme për këdo. Për arsye shumë të mira është e paligjshme që ti zotërosh.</li> </ul> <p><b>Municionet dhe eksplozivët</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjithë municionet dhe eksplozivët (M &amp; E) janë potencialisht vdekjeprurës, ato përmbajnë materiale shpërthyes dhe janë të afta të vrasin apo plagosin në distanca të mëdha.</li> <li>Ato mund të shpërthejnë edhe me preken më të vogël.</li> <li>Nëse jetoni në një zonë të prekur nga lufta më përpara, mos u fusni në zona të njohura si të rrezikshme.</li> <li>Mos prekni dhe mos iu afroni M &amp; E për asnjë arsye.</li> <li>Mos godisni asnjëherë M &amp; E apo çdo objekt të dyshimtë.</li> <li>Mos u përpiqni që të spastroni vetë M &amp; E.</li> <li>Mos u përpiqni të spastroni zonën nga M &amp; E duke i vënë zjarrin zones.</li> <li>Mos mblidhni M &amp; E apo pjesë të M &amp; E.</li> <li>Edhe nëse M &amp; E nuk është hedhur apo aktivizuar kjo nuk do të thotë që është e sigurt.</li> <li>Nëse dikush ka lëvizur M &amp; E kjo nuk do të thotë që është e sigurtë.</li> <li>Jini të vëmendshëm për rreziqe të mundshme dhe qëndroni larg prej tyre.</li> <li>Gjithmonë respektoni tabelat paralajmëruese dhe shenjat e rrezikut.</li> </ul>



Mbajtësit e Armëve	Të përgjithshme
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Armët, municionet dhe eksplozivët janë gjithmonë të rrezikshme, gjithmonë një barrë dhe asnjëherë të sigurt për ju dhe familjen tuaj.</li> <li>• Çdo përfitim shtesë nga mbajtja e një arme varet shumë nga marrja e trajnimit të saktë dhe kuptimit të qartë të procedurave të sigurisë dhe magazinimit nga ana e pronarit. Mbajtja e një arme zjarri për të mbrojtur familjen nuk ka kuptim nëse ve në rrezik anëtarët e familjes, të ftuarit apo komunitetin.</li> <li>• Është e mundur që të mbash dhe përdorësh në mënyrë të sigurtë armët e sportit apo gjuetisë, por nuk është e mundur që ta bësh këtë gjë me eksplozivët dhe/ose armët e tipit ushtarak. Këto armë janë zakonisht të paligjshme sepse ato nuk janë kurrë të sigurt.</li> <li>• Armët e paligjshme, për shkak se janë të pakontrolluara janë më lehtësisht të vjedhshme nga kriminelët dhe terroristët dhe shkaktojnë shumë dëmtime për fëmijët.</li> <li>• Mbajtja apo përdorimi i tyre mund të jetë i rrezikshëm për ju dhe për të tjerët.</li> <li>• Mbajtja e tyre në shtëpi ju vendos juve, familjen tuaj dhe komunitetin në rrezik të madh – i bën ato të pasigurtë, jo të sigurtë.</li> <li>• Mos i braktisni armët në vende publike sepse vini të tjerët, sidomos fëmijët në rrezik. Armët e braktisura vrasin çdo vit mijëra njerëz të pafajshëm, sidomos fëmijë.</li> <li>• Çdo amnisti e ardhshme apo mbledhje armësh do të jetë rasti juaj i vetëm për të liruar përfundimisht vetveten nga ku rrezik.</li> <li>• Deri atëherë, ju mundeni vetëm që të reduktoni rrezikun e këtyre armëve duke i magazinuar ato në disa mënyra dhe duke u siguruar që të tjerët, sidomos fëmijët, të mos bien në kontakt kurrë me to.</li> </ul> <p><b>Trajtimi i sigurtë për armëmbajtësit<sup>42</sup></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sa herë që merrni në dorë një armë, mendoni sikur të jetë e mbushur dhe e rrezikshme.</li> <li>• Kur mbani një armë, kontrolloni drejtimin e tytës në çdo moment; mos i drejtoni kurrë një armë dikujt qoftë arma e mbushur apo jo.</li> <li>• Jini të sigurtë mbi shënjestrën tuaj, djepi se çfarë është, çfarë qëndron mes jush dhe shënjestrës dhe çfarë ka pas saj. Mos qëlloni kurrë kundër diçkaje që nuk e keni identifikuar ende.</li> <li>• Mos e prekni kurrë këmbëzën derisa ti keni sytë tek shënjestra; siguresa duhet të jetë në pozicionin E SIGURTË deri në momentin kur ju të jeni gati të hapni zjarr.</li> </ul> <p><b>Mesazhe bazë për sigurinë<sup>43</sup></b></p> <p><u>Çfarë është 'siguresa' e një arme zjarr?</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumica, por jo gjithë armët e zjarrit janë të pajisuara me një mekanizëm për të reduktuar shanset e një shkrepe aksidentale. Kjo mund të jetë në formën e një rrëshkitësi, leve apo butoni në anë apo në majë të armës. Siguresa mendohet se nuk është "e vënë" kur arma është e aftë të qëllojë nëse tërhiqet këmbëza.</li> <li>• Pozicioni i sigurisë mund të tregohet në mënyrat e ndryshme si vijon: "Zjarr" (Fire) apo "E Sigurtë" (Safe) apo "F" dhe "S"; "Ndezur" (On) apo "Fikur" (Off); një pikë e zezë apo e bardhë tregon se arma është e sigurtë, ose pika e kuqe tregon se arma mund të shkrepet. Disa armë mund të përdorin një zero (0) të bardhë/zezë apo shënjën e një plumbi me një vizë mes tij në vend të pikës së lartpërmendur.</li> <li>• Armët e zjarrit të afta për zjarr të përzgjedhur mund të përdorin shkronjat "A" për plotësisht automatike dhe "R" për zjarr gjysëm automatik.</li> </ul> <p><u>Sa e sigurtë është 'siguresa' e një arme zjarr?</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mos e merrni kurrë të mirëqenë faktin se përdorimi i mekanizmit të sigurisë në një armë do të parandalojë shkrepen aksidentale. Disa tipe armësh janë në mënyrë famëkeqe të pasigurt, disa armë të vjetra për shembull, dhe mund të shkrepin nëse bien nga dora apo goditen fortë. Gjithashtu, tek armët shumë të përdorura, siguresa mund të halet/prishet deri në atë pikë sa të mos parandalojë shkrepen.</li> </ul> <p><u>Si mund ta dimë nëse një armë zjarr është e mbushur?</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përveçse kur jeni njaft i mësuar me përdorimin e një modeli të veçantë arme, gjithmonë merrni të mirëqenë faktin se arma është e mbushur dhe e rrezikshme.</li> </ul> <p><u>A është një armë e sigurtë për tu përdorur nëse kam tërhequr këmbëzën dhe asgjë nuk ka ndodhur?</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Municioni nuk është kurrë 100% i besueshëm, veçanërisht kur është i vjetër, është prishur sepse është lënë nën ndikimin e agjentëve atmosferikë, apo është krijuar nga një amator. Prandaj, tërheqja e këmbëzës jo domosdoshmërisht do të ndezë plumbin. Kjo krijon një situatë të rrezikshme që quhet ngecje apo zjarr i varur.</li> </ul>

<sup>42</sup> Referojuni gjithashtu dokumentit të SEESAC 'Katër rregulla mbi Sigurinë e Armës' në CD-ROM.

<sup>43</sup> Të marra nga 'Mbajtja e Armëve të Vogla, Udhëzime për Mbajtjen, Transportin dhe Magazinimin e Sigurtë', Qendra Ndërkombëtare për Ndryshim në Bon (Bonn International Center for Conversion).



GRUPET E SHËNJESTRUARA	LLOJI I MESAZHIT TË EDUKIMIT MBI RREZIQET E AVL
<b>Mbajtësit e Armëve</b>	<p>A mund të vazhdojë të punojë një armë e mbuluar me ndryshk apo me llucë/baltë?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Disa armë të vogla si AK47 (Kalashnikov) janë krijuar specifikisht për të vazhduar veprimin pavarësisht nga kushtet e motit apo vitet e përdorimit. Çdo armë zjarri do përdorur sikur të ishte e aftë të qëllonte. Vetëm një mjeshtrë armësh apo ndonjë tjetër ekspert armësh mund të tregojë nëse një armë është e sigurtë dhe/ose e përdorshme.</li> </ul> <p><b>Magazini që ul rreziqet<sup>44</sup></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Për fëmijët tuaj si dhe anëtarë të tjerë të familjes, është më e sigurtë që të mos mbani armë në shtëpi. Nëse doni të veproni kështu (psh. të mbani armë gjahu apo sportive), ju lutemi që të siguroheni për sa më poshtë:</li> </ul> <p><u>Armët<sup>45</sup></u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Është përgjegësia juaj që të parandaloni fëmijët dhe të rriturit e pa-autorizuar të kenë akses tek armët që ju mbani.</li> <li>Gjithmonë hiqni plumbat dhe pastroni armët e gjahut me kujdes dhe plotësisht nëse ju i mbani ato në shtëpi.</li> <li>Mos mbushni kurrë një armë në shtëpi.</li> <li>Duhet të jeni absolutisht të sigurtë që armët në shtëpi të mbahen larg gjetjes nga fëmijët. Mbani mend, fëmijët janë kuriozë nga natyra, ata do të kërkojnë nëpër shtëpi për objekte interesante dhe mund të luajnë me atë që gjejnë, kështu që kyçja e armëve në një sirtar apo në një kasafortë është me rëndësi të madhe.</li> <li>Gjithmonë i mbani armët dhe municionet larg nga njëra-tjetra. Përsëri, përdorni një vend të kyçur që fëmijët të mos mund ta gjejnë.</li> <li>Shumë aksidente ndodhin kur anëtarët e familjes marrin hua një armë dhe e kthejnë tek vendi i ruajtjes të mbushur – kështu që rikontrolloni armët që të jenë të sigurta kur ti ktheni në vendin e magazinimit.</li> <li>Shtëpia juaj është është aq e sigurtë sa ju zgjidhni që ajo të jetë. Mos harroni, nuk ka armë “të sigurta” në shtëpi.</li> </ul> <p><u>Municionet dhe eksplozivët</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjithmonë i mbani armët dhe municionet larg nga njëra-tjetra në një sirtar të mbyllur.</li> <li>Municionet dhe eksplozivët janë në vetvehte të paqëndrueshëm. Ato mund të shpërthejnë spontanisht kur ato vjetërohen. Nëse keni eksplozivë dhe municione të vjetra dhe të ndryshkura duhet që të lajmëroni autoritetet përpara se të ndodhi ndonjë aksident.</li> <li>Mos mbani asnjëherë materiale ushtarake si granatat e dorës dhe eksplozivët në shtëpitë tuaja. Nëse ju vendosni të vazhdoni të vini familjen dhe komunitetin tuaj në rrezik duke mbajtur këto materiale, i fusni ato jashtë shtëpisë në një vend të sigurtë dhe të thatë.</li> </ul>
<b>Dorëzimi i sigurtë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shikoni tabelën 10 më poshtë. Nuk ka asnjë arsye në parim që praktikat e dorëzimit të sigurtë të mos mësohen si pjesë e një programi të veçantë të Edukimit mbi Rreziqet, ndonëse i duhet dhënë prioritet informacioneve të tjera.</li> </ul>
<b>Prindërit</b>	<p>Shikoni informacionet e mësipërme për mbajtësit e armëve. Gjithashtu:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Jini një shembull pozitiv për fëmijët tuaj. Fëmijët plagosen shpesh duke u përpjekur të imitojnë prindërit e tyre.</li> <li>Mos harroni, fëmijët nga natyra janë kuriozë – një armë në shtëpi nuk është kurrë “e sigurtë”.</li> </ul>
<b>Fëmijët</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Armët mund të plagosin këdo, disa fëmijë janë plagosur sepse nuk kishin dijeni për rreziqet dhe nuk silleshin siç ishin mësuar.</li> <li>Armët nuk janë për të bërë qejf. Ju nuk duhet të luani me to.</li> <li>Mos u mundoni të silleni si të rriturit apo si ushtarët.</li> <li>Nëse shikoni një armë, plumba apo eksplozivë – ndaloni, mos i prekni, largohuni prej atje dhe lajmëroni një të rritur.</li> <li>Mos kërkonte armë për të luajtur, ato janë të rrezikshme dhe shpesh vendet ku ato gjenden janë gjithashtu të rrezikshëm</li> <li>Kurrë mos mblidhni plumba apo eksplozivë të vjetër sepse ato nuk janë lodra dhe mund t’ju plagosin.</li> <li>Ndihmoni miqtë dhe shokët tuaj duke i thënë që të mos i prekni kurrë armët.</li> </ul>

<sup>44</sup> Mesazhet për magazinimin me rrezik të ulët duhet të shpërndahet mbajtësve të armëve në një situatë kur nuk është planifikuar ndonjë amnisti apo mbledhje armësh. Kur një amnisti tu japë mbajtësve të armëve të tipit ushtarak një rast për ti dorëzuar ato, është gjë me mënd që përkohësisht të ndalohet ky lloj Edukimi mbi Rreziqet në mënyrë që të evitohet ndonjë lloj konfuzioni i mesazheve.


<sup>45</sup> Informacione të marra nga ‘Përgjegësia për Armët e Zjarrit në Shtëpi’, Fondacioni Kombëtar për Sportet e Gjuetisë, [www.nssf.org](http://www.nssf.org)

## MESAZHET PËR EDUKIMIN MBI RREZIQET E AVL

<p><b>Dorëzimi i sigurtë</b><sup>46</sup></p> <p>(Mesazhet do t'i transmetohen atyre që mund të marrin pjesë aktive në mbledhjen e armëve, duke përfshirë dhe mbajtësit e mundëshëm të AVL, dhe agjentët e mbledhjes si policia dhe OJQ-të)</p>	<p><b>Dorëzimi i armëve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mos i drejtoni kurrë një armë dikujt qoftë kjo e mbushur apo jo. Duhet ta konsideroni si të mbushur deri në momentin që është provuar e kundërta.</li> <li>Mbajtësja e sigurtisë (siguresa) ose leva e sigurtisë duhet të jetë gjithmonë në pozicionin E SIGURTË.</li> <li>Sigurohuni që karikatorët nuk janë të futur në armë kur ju i dorëzoni për magazinimin të sigurtë.</li> <li>Sigurohuni që të armët të mos jenë të mbushura dhe mos të ketë municion në 'gøjën' e armës.</li> <li>Në rastin që municioni të ketë ngecur brenda armës, stafi teknik duhet që të lajmërohet menjëherë. Arma duhet të shënohet qartësisht si armë që ka brenda municion.</li> <li>Arma duhet që të lajmërohen si të zbraza tek personi i përgjegjshëm për ti pranuar tek magazinimi i sigurtë.</li> <li>Mos i lejoni kurrë fëmijët që të përdorin armët gjatë mbledhjes së armëve.</li> </ul> <p><b>Dorëzimi i municioneve dhe eksplozivëve.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjithë llojet e municioneve duhen mbajtur me kujdes. Ato nuk duhen rrëzuar, të hapen apo të luhet me to.</li> <li>Detonatorët duhet që të mbahen në konteniër të ndarë nga çfarëdo lloji municioni apo lloji tjetër eksploziv.</li> <li>Municionet dhe eksplozivët duhet që të mbahen në konteniër të mbyllur.</li> <li>Municionet dhe eksplozivët NUK duhet të mbahen në të njëjtin vend me karburante apo çfarëdo lloji tjetër lëndë djegëse që merr zjarr lehtësisht.</li> <li>Siguresat e granatave duhet që të lidhen me ngjitës në pozicionin E SIGURTË për të parandaluar heqjen aksidentale.</li> <li>Municioni që gjenden në natyrë nuk duhet që të merret për tu dorëzuar. Stafit teknik duhet që të lajmërohet për vendndodhjen e tij, dhe ata do të marrin masa që një skuadër të Heqjes së Heqjes së Mjetit Shpërthyes (Explosive Ordnance Disposal EOD) që të vijë dhe të sigurohet se municioni është "i sigurtë për tu lëvizur".</li> <li>Mos i lejoni kurrë fëmijët që të mbajnë municione ose eksplozivë gjatë mbledhjes së armëve.</li> </ul>
<p><b>Magazinimi i përkohshëm</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Referojuni Kartës së Sigurtisë të SEESAC 'Magazinimi i përkohshëm i municionit në situata emergjente', në CD-ROM.</li> </ul>
<p><b>Të tjera</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Edukimi mbi Rreziqet e AVL që nuk është specifik për amnistinë e armëve dhe mbledhjen e tyre mund të vazhdohet duke përdorur mesazhet si ato në tabelën e mëpatshme numër 9.</li> </ul>

<sup>46</sup> Mesazhe të marra nga 'Kartat e Sigurtisë' të SEESAC, shikoni CD-ROM-in e PMSA





<p><b>Të përgjithshme</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjithë armët, municionet dhe eksplozivët janë të rrezikshme.</li> <li>Ato janë krijuar për të vrarë.</li> <li>Rreth gjysëm milioni njerëz mbeten viktime të armëve të vogla çdo vit në të gjithë botën. Ndërsa ne po flasim, 2 njerëz janë vrarë nga armët e vogla: ndoshta dikush që ti e njeh?</li> <li>Rreth gjysëm milioni njerëz mbeten viktime të armëve të vogla çdo vit në të gjithë botën. Në vitet 90të dy milionë fëmijë janë vrarë nga armët dhe rreth 50 milionë njerëz kanë mbetur të plagosur. Prandaj mendoni se sa me të vërtetë ju nevojitet një armë? A e vendosni veten tuaj dhe njerëz të tjerë rreth jush një një situatë shumë të rrezikshme sesa në një situatë të sigurtë?</li> <li>Armët ushtarake në komunitete po vendosin në rrezik komunitetin dhe vendin tuaj – ndihmoni që kjo të ndryshojë.</li> <li>Armët janë të rrezikshme, ato vrasin femrat, fëmijët dhe janë një faktor destabilizimi për gjithë vendin.</li> <li>Ato po gjenerojnë dhunë brenda familjeve, dhe viktimat janë përgjithësisht gratë dhe fëmijët.</li> <li>Armët po gjenerojnë dhe stimulojnë krimin. Me qindra njerëz janë vrarë në rajonin tuaj; shumë qindra të tjerë janë plagosur apo janë bërë të paafte.</li> <li>Zgjidhni paqen, stabilitetin dhe një jetë më të mirë – dorëzoni armët.</li> <li>Bëni diçka të dobishme për veten tuaj dhe vendin tuaj – dorëzoni armët.</li> <li>Ju keni të drejtë të jetoni në një ambient të sigurtë, në një mjedis pa armë.</li> <li>Armët ushtarake në duart e civilëve po venë në rrezik komunitetin dhe vendin tuaj – ndihmoni që kjo të ndryshojë.</li> </ul>
<p><b>Fëmijët</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Armët mund t'ju marrin mamanë, babain, vëllain, motrën – përgjithmonë. Tregojni prindërve tuaj se sa të dëshpëruar do t'ju bënte kjo gjë.</li> <li>Ju meritoni një të ardhme më të mirë që është pa armë. Kërkojini prindërve tuaj që ta ndërtojnë këtë të ardhme.</li> <li>Thuajuni prindërve tuaj se ju dëshironi një jetë të sigurtë.</li> <li>Kërkojini prindërve që të mendojnë për ju dhe të dorëzojnë armët.</li> </ul>
<p><b>Prindërit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mendoni se sa shumë me të vërtetë ju nevojitet një armë – ju vendos në rrezik juve dhe familjen tuaj në vend që t'ju mbrojë.</li> <li>Fëmijët tuaj meritojnë një të ardhme më të mirë – jepni ndihmën tuaj për ta ndërtuar këtë të ardhme duke dorëzuar armët.</li> </ul>
<p><b>Gratë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Armët në shtëpi mund t'ju vrasin fëmijët tuaj dhe shpresën tuaj për një të ardhme më të mirë. Flisni me fqinjët dhe miqtë tuaj dhe ndihmoni që të shpërndahet ky mesazh.</li> <li>Ju mund të luani një rol shumë të madh në familjen tuaj për të bindur fëmijët tuaj, vëllezrit tuaj, dhe burrat tuaj për të dorëzuar armët.</li> <li>Shpëtoni jetë – i thoni jo armëve.</li> <li>Armët janë bërë për të vrarë jetën – ju doni që ta ndërtoni atë.</li> <li>Ju keni lindur fëmijët tuaj dhe ju e dini më mirë se si ta mbroni jetën e tij/saj.</li> <li>Flisni me fqinjët apo me miqtë tuaj në mënyrë që të përhapet ky mesazh.</li> <li>Beteja për një jetë më të mirë fitohet pa armë .</li> </ul>
<p><b>Djemtë adoleshentë / burrat e rinj</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Luftëtarët duken bukur vetëm nëpër filma. Jeta nuk është një film; njerëzit me të vërtetë vriten prej armëve .<sup>45</sup></li> <li>Ju doni që të jeni dikush, të viheni re dhe të respektoheni. Nëse ju mendoni se një armë do të bëjë këtë gjë të mundur atëherë e keni gabim – njerëzit do të qeshin dhe do të thonë se ju jeni i dobët dhe fshiheni prapa armës.</li> <li>Disa akoma mendojnë se është shumë bukur të kesh një armë, por koha e pistolerave ka mbaruar. Shikoni rreth e rrotull – ne jemi në Europë, dhe Europa nuk ka nevojë për ata që mbajnë armë personale.</li> </ul>

<sup>47</sup> Shumë prej mesazheve të mëposhtëm janë adoptuar nga materialet e prodhuara nga projekti për kontrollin e AVL të UNDP Shqipërisë (SALÉC), ndërsa shumica e mesazheve të tjerë janë krijuar për këtë manual.






MESAZHET E ADVOKIMIT TË AVL	
<b>Mësuesit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ju keni një rol vital për të luajtur duke dhënë mësimet mbi tolerancën dhe jo-dhunën tek të rinjtë.</li> <li>U mësoni fëmijët që të mos luajnë me armët; ja shpjegoni atyre që t'ja mësojnë fëmijëve të tjerë.</li> <li>Roli juaj është që tu mësoni nxënësve dhe studentëve tuaj që ti mos pranojnë armët.</li> <li>U mësoni fëmijëve që ti mësojnë prindërrve të tyre që të dorëzojnë armët.</li> </ul>
<b>Policia</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Funksioni juaj është thelbësor për të informuar njerëzit rreth mbajtjes së AVL në shtëpi; për tu mësuar fëmijëve që të mos prekin AVL nëse gjejnë një të tillë, që ta lënë atje ku e gjetën dhe të raportojnë pranë rajonit më të afërt të policisë, një të rrituri apo tek autoritetet.</li> <li>Mesazhe/trajtime rreth dorëzimit të sigurtë dhe magazinimit të sigurtë (referojuni 'Kartave të Sigurisë' të SEESAC).</li> </ul>
<b>Media<sup>48</sup></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njerëzit kanë nevojë për informacion të sigurtë prej jush dhe rreth dëmit që armët po shkaktojnë dhe rreth fushatave kundër armëve.</li> <li>Raportime sporadike dhe sensacionale nuk do të ndihmojnë që të ndryshohet mentaliteti.</li> </ul>
<b>OJQ-të</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kjo është sfida më e madhe për shoqërinë tonë – ne kemi nevojë për ndihmën tuaj për të rritur sensibilizimin e njerëzve kundrejt reziqeve të AVL.</li> <li>Më pak armë do të përmirësojnë mundësinë që ju të keni projekte zhvillimi.</li> <li>Armët e vogla vrasin – veproni kundër tyre kurdoherë që të keni mundësi.</li> </ul>
<b>Qeveria lokale dhe qendrore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Më tepër siguri, më shumë investime – më tepër zhvillim i vendit pa armë.</li> <li>Investimet e huaja nuk do të vijnë nëse njerëzit të armatosur shkatërrojnë rendin publik dhe krijojnë paqëndrueshmëri.</li> <li>Qytetarët tuaj kanë të drejtë për një ambient të sigurtë pa armë.</li> <li>Që të pranoheni nga Europa dhe nga bota e jashtme, ne duhet të kemi shtet ligjor, më pak kriminalitet dhe një imazh më të mirë – armët na pengojnë të gjithë ne që ti arrijmë këto.</li> <li>Prandaj është thelbësore që të informohen komunitetet rreth reziqeve të mbajtjes dhe shpërdorimit të armëve.</li> <li>Prandaj është thelbësore që të informohen komunitetet rreth reziqeve të mbajtjes dhe shpërdorimit të armëve.</li> </ul>
MESAZHET E INFORMIMIT PUBLIK (AVL)	
<b>Gjithë komuniteti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Një amnisti kombëtare për armët është në fuqi deri në 9 Prill 2003.<sup>49</sup></li> <li>Ju mund të legalizoni armët e paregjistruara, apo të dorëzoni armët e paligjshme në rajonin më të afërt të policisë apo bazën ushtarake gjatë kësaj periudhe.</li> <li>Ju nuk do të arrestoheni/dënoheni për mbajtje të paligjshme të armës nëse raportoni këtë gjë gjatë kësaj periudhe.</li> <li>Ju mund të legalizoni: armët e gjahut, sportit apo armët simbolike/tradicionale; pisqollat; revolverët; pushkët me pompë (shotgun); karabinat.</li> <li>Juve nuk mund të legalizoni: armët automatike dhe gjysëm automatike; mitralozët; minat tokësore, eksplozivët, granatat e dorës, lëshuesit e raketave (bazukat), mortajtat dhe municionet respektive.</li> <li>Për informacion të mëtejshëm kontaktoni stacionin më të afërt të policisë apo faqen Internet të Ministrisë së Brendshme.</li> <li>(SHËNIM: Në rastet kur ka nxitës si ofertë për të inkurajuar dorëzimin e armëve (ASHZH, AKZH, AKN) mesazhe shtesë do të jenë të nevojshme për të informuar qytetarët dhe komunitetet se si të marrin pjesë).</li> </ul>
<b>Agjentët e mbledhjes dhe magazinimit të AVL dhe forcat e rendit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Si shtesë e mesazheve dhe materialeve të Edukimit mbi Reziqet, ata që marrin pjesë në aktivitetet për mbledhjen e AVL duhet fillimisht të marrin informacion sesi të sillen për shkak të kushteve specifike të çfarëdo amnistie dhe planeve të mbledhjes. Konferencat e shtypit me pyetje/përgjigje dhe dokumentat e 'Procedurat e Operimit Standard' mundet që të përdoren për të transmetuar mesazhe si 'Çfarë të bëni nëse kapni një qytetar duke mbajtur një armë në një kontroll rutinë në postbllok'.</li> </ul>

<sup>48</sup> Media nuk duhet parë vetëm si një transmetues i informacionit por edhe si një grup i shënjestruar për fushatat.

<sup>49</sup> Shembulli i marrë nga fletëpalosjet e informimit publik të Ministrisë së Jashtme të Serbisë të shpërndara në të gjitha shtëpitë gjatë amnistisë së AVL 2003.



## 5.5 Zhvillimi i mesazheve thelbësore

Çdo program për Sensibilizimin e AVL do të zgjedhë për të shënjestruar disa grupe kyçe si pjesë e strategjisë së tyre. Audiencat/grupet e rradhitura në tabelën e mësipërme dhe në Seksionin 4.1.1 janë thjesht disa prej shënjestrave të mundëshme për programet e Sensibilizimit të AVL. Në varësi të rrethanave dhe strategjive të adoptuara, mund të identifikohen të tjera<sup>50</sup>.

Pasi të jenë identifikuar problemet kryesore të AVL në një komunitet, dhe grupet kyçe të shënjestruara për një program Sensibilizimi, mund të zhvillohen mesazhet për tu përdorur në një sërë aktiviteteve të ndryshme të krijuara për të sjellë rreth ndryshimeve pozitive në sjellje. Mesazhe specifike mund të krijohen, dhe të testohen për efektshmërinë dhe vlerën në mënyrë që të sigurohet që secili grup të marrë komunikimin në mënyrë të përshtatshme. Siç shënohet në Seksionit 2.6, mesazhet e përdorura duhet të vendosin theksin tek përfitimet dhe kostot e ndryshimit të sjelljes për grupin apo individin e veçantë të shënjestruar.

Duke kombinuar mesazhet për grupet e ndryshme mund të krijohet një listë mesazhesh të programeve 'thelbësore', si në nivelin kombëtar dhe komunitar. Duke vendosur mesazhet bazë të programit në këtë mënyrë, stafi i programit mund të jetë i sigurtë për një shkallë të lartë vazhdueshmërie kur jep mesazhet nëpërmjet një varieteti aktiviteteve dhe materialeve të ndryshme, nga diskutimet e deri tek koncertet rock apo posterat sipas dëshirës (shikoni Seksionin 5.4 dhe Seksionin 5 për informacione mbi krijimin e aktiviteteve dhe materialeve). Do të rezultojë si më e lehtë që të merret një grup fillestar mesazhesh thelbësore në nivel kombëtar që mundet më pas të shtohet dhe të ndryshohet nga stafi i programit që punon me komunitetet.

Ndërsa programi zhvillohet apo rrethanat ndryshojnë, disa prej mesazheve thelbësore mund gjithashtu të kenë nevojë për ndryshim. Kurdoherë që të jetë e mundur, mesazhet duhet që të koordinohen me aktorë të tjerë për të maksimizuar impaktin. Kur zbatoni një program kombëtar, veçanërisht në kontekstin e një iniciative kombëtare për mikro-çarmatimin, të paktën disa mesazhe duhet që të mbështesin objektivat operacionale të asaj iniciative.

Është e rëndësishme sidoqoftë që të mbahet mend se mesazhet në vetvehte nuk janë të mjaftueshëm. Çka do të shkaktojë një ndryshim në sjellje është një kombinim i:

- Vetë mesazheve.
- Metodatat dhe qëllimet e përdorura për ti përcjatur këto mesazhe.
- Procesi i ndarjes së informacionit me komunitetet e prekura dhe përfshirja e tyre (psh. nëpërmjet aktiviteteve ndëraktive); dhe
- Paraqitja e informacionit, aftësive dhe alternativave të përshtatshme si dhe elementët social-ekonomik, ligjorë, politikë dhe teknikë për të inkurajuar dhe promovuar sjelljet e sigurta (shikoni Seksionin 2.6).

### Kutia 22: Mesazhet për ish-luftëtarët

Ish-luftëtarët si një grup tentojnë të mos kenë probleme për të mbajtur armë, municione dhe eksplozivë. Trajnimi i tyre mund të jetë në fakt i papërshtatshëm në këtë drejtim por meqenëse kanë luftuar në luftë shumë prej tyre nuk ndihen në vështirësi për të përdorur AVL dhe mund të jenë edhe krenar për njohuritë që ata kanë për to. Ka shumë mundësi që ish-luftëtarët ti përgjigjen pak ofertës vetëm për Edukimin mbi Rreziqet. Një mënyrë e mirë për ti afruar ata është që ti flitet rreth rreziqeve të armëve në komunitetet sesa mbi rreziqet e vetë armëve, apo të përdoren ish-luftëtarët të tjerë për t'ju afruar. Në disa raste mund të jetë e mundur të rekrutohen ish-luftëtarët në programet e kontrollit dhe Sensibilizimit të AVL për shkak të njohurisë që ata kanë (le të mos harrojmë sidoqoftë që policia dhe oficerët ushtarakë shpesh praktikojnë sjellje të pasigurta rreth AVL. Eksperienca e gjatë nuk është garanci për kompetencën!).

<sup>50</sup> Për më tepër informacion, shikoni 'Përmirësimi i Komunikimit në Programet për Sensibilizimin mbi Minat, një Doracak Operacional', Qendra Ndërkombëtare e Gjenevës për Çminimin Humanitar, Maj 2002.



### Kutia 23: Krijimi i imazheve

Kur krijohen imazhet për një program për Sensibilizimin e AVL, shumë prej konsideratave që aplikohen për mesazhet janë gjithashtu të rëndësishme:

- A janë të sigurta sjelljet dhe mesazhet e përçuara nga imazhi? (Shikoni Seksionin 2.5)
- A çojnë imazhet një mesazh që shtyn më tej objektivat e programit?
- A përçojnë ato sjellje të sigurta rreth armëve, municioneve dhe eksplozivëve?
- A mund të kenë ato ndonjë nënkuptim negativ apo të padëshirueshëm për grupet e shënjestruara?
- A janë ato të përshtatshme lokalisht? (Mbani mend që të mos mendoni vetëm rreth kulturës lokale, por edhe rreth llojit të AVL në zonën e ndërhyrjes – mos përdorni imazhe të armëve që nuk ndodhen në atë zonë)

## 5.6 Zgjedhja e mjeteve të komunikimit<sup>51</sup>

Për të përçuar mesazhet e programeve të AVL, mund të përdoren media, materiale dhe aktivitete të ndryshme. Ka shumë gjëra për tu marrë në konsideratë kur të vendoset se çfarë përzjerje metodash do të përdoren. Pika fillestare për vendim-marrësit, sidoqoftë, duhet të jetë strategjia dhe konteksti i programit. Çështjet që duhen marrë në konsideratë përfshijnë:

- Tipin dhe numrin e grupeve të shënjestruara.
- Nivelin ekzistues të njohurive/aktivizmit të tyre.
- Mjetet ekzistuese të komunikimit si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë komunitar.
- Kulturën lokale.
- Nivelin e aksesit tek “kanale” të ndryshme në komunitetet e ndikuara.
- Niveli i besimit tek mediat e ndryshme.
- Faktin nëse një media e veçantë është e përshtatshme për mesazhit tuaj.

### 5.6.1 Komunikimi ndëraktiv përkundrejt atij njëanësor

Është e dobishme që të bëhet një dallim midis dy tipeve të komunikimit: atij ndëraktiv dhe komunikimit njëanësor. Çdo strategji komunikimi duhet që të përdorë një përzjerje të metodave për të shpërndarë mesazhin e vet përreth, për të përforcuar mesazhet në mënyra të ndryshme në kohë të ndryshme dhe të përpiqet të arrijë sasinë e përshtatshme të grupeve të cilët janë zgjedhur si të shënjestruara. Pasi themi këtë gjë, eksperiencia na tregon se format ndëraktive të komunikimit (aktivitete që në një mënyrë ose në një tjetër janë pjesëmarrëse, i.e. ato përfshijnë një shkëmbim dy-krahësh të informacionit) dhe kanë nevojë për komunikim ndërpersonal (komunikim person me person) janë zakonisht mjetet më efektive për të përçuar mesazhet e krijuara për të ndryshuar sjelljet e njerëzve. Mendimi i tanishëm në fushat e komunikimit zhvillues dhe ERRM është se ndërhyrjet e suksesshme shoqërore janë ato që kombinojnë median dhe kanalet ndërpersonale të komunikimit.<sup>52</sup> Ndërsa përdorimi i medias në masë dhe medias në shkallë të vogël (veçanërisht masmedia) është i rëndësishëm për ngritjen e Sensibilizimit rreth çështjeve dhe madje edhe për fillimin e diskutimeve rreth atyre çështjeve të paeksponuara ndaj mesazhit, mësimi shoqëror dhe vendim-marrja përfshin shumë më tepër sesa vetëm marrje mesazhesh. Shkëmbimi i mundësive me të tjerët nëpërmjet rrjeteve shoqërore, komunikimit me të ngjashmit dhe kontakti me punonjësit në terren ka meritën për pjesën më të madhe të suksesit.<sup>53</sup>

<sup>51</sup> Seksioni i mëposhtëm ka marrë pjesën më të madhe nga: ‘Përmirësimi i Komunikimit në Programet për Sensibilizimin mbi Minat, një Doracak Operacional’, Qendra Ndërkombëtare e Gjenezës për Çminimin Humanitar, Maj 2002.

<sup>52</sup> Flay B.R dhe Burton. D “Strategjitë Efektive të Komunikimit në Masë për Fushatat Shëndetësore”, C. Atkin dhe Wallack. L (redaktorë), “Komunikimi në Masë dhe Shëndeti Publik” (1990); dhe Hornik R.C. “Efektiviteti i Kanaleve të Komunikimit në Programet e Komunikimit të Zhvillimit”, në Rice. R.E. dhe Atkin C.K. (editorë) Fushatat e Informimit Publik, Edicioni i 2<sup>is</sup>, (faqe 309-330), (1989).

<sup>53</sup> Rogers. E.M., Vaughan. P.W., Swahela, R.M.A., Rao, N., Svenkerud, P. dhe Sood, S. ‘Efektet e një Argëtimi – Soap Operat Edukuese në Radio mbi Planifikimin Familjar në Tanzani’, Studime mbi Planifikimin Familjar, 30 (3), 193-211, (1999); dhe Mitta, R. dhe Simmons, R. ‘Shpërndaja e një kulture mbi kontrceptivët: Efektet e Programit mbi Gratë e Reja në Zonat Rurale në Bangladesh’, Studime mbi Planifikimin Familjar, 26 (1), 1-13 (1995).



Tabela 11: Krahasimi i metodave të komunikimit ndëraktiv me komunikimin njëanësor

SHEMBUJ	AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
<b>AKTIVITETET NDËRAKTIVE DHE PËRDORIMI I MEDIAS</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Lojrat</li> <li>Konkurset</li> <li>Shfaqet ndëraktive kukulla/teatër</li> <li>Diskutimet/takimet</li> <li>Lojrat me role</li> <li>Programet në TV/Radio (kur kërkohet pjesëmarrja e publikut)</li> <li>Demonstrimet/Marshimet</li> <li>Peticionet</li> <li>Workshopet e artit në komunitet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kur jepet nga njerëz të cilët mund të marrin respektin e grupeve të shënjestruara, ka besueshmëri të madhe.</li> <li>Lejon që të diskutohen çështje me rëndësi.</li> <li>Jep mendime të menjëhershme mbi idetë, mesazhet dhe praktikatat</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Konsumon jashtëzakonisht shumë kohë.</li> <li>Kontakt ndërpersonal me intensitet të lartë.</li> <li>Arrin të prekë vetëm një numër të vogël njerëzish.</li> <li>Punonjësit në terren duhet që paraprakisht të marrin trajnim dhe mbështetje të vazhdueshme.</li> <li>Kualifikimet, seksi, etnia, moshja dhe të tjera karakteristika personale vendosin kufizime se kush do të përfitojë respektin e grupeve të shënjestruara.</li> </ul>
<b>AKTIVITETET E NJËANSHME TË KOMUNIKIMIT DHE PËRDORIMI I MEDIAS</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Leksionet</li> <li>Ekspozitat</li> <li>Shfaqet teatrale/me kukulla (kur nuk kërkohet vazhdueshmëri)</li> <li>Reklamat dhe programet në Radio dhe television</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kur jepet nga njerëz të cilët mund të marrin respektin e grupeve të shënjestruara, ka besueshmëri të madhe.</li> <li>Mund të përçojë informacion tek një publik më i gjerë.</li> <li>Mund të trajtojë në thellësi një çështje specifike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi i shpërndarjes së informacionit mund të jetë i vështirë.</li> <li>Nga publiku nuk ka përgjigje të menjëhershme.</li> <li>Pjesëmarrja e publikut është e kufizuar ose nuk ekziston aspak.</li> <li>Mund të jetë e mërzitshme.</li> </ul>

Çfarëdo lloj kanali të zgjidhet për të shpërndarë mesazhin, mbani mend se përsëritja është thelbësore, përndryshe njerëzit mund ta humbasin mesazhit tërësisht. Madje edhe ata që e marrin atë ka shumë të ngjarë që të kenë nevojë për përfundim të mesazhit. Gjithashtu, mbani mend që të monitoroni marrjen e mesazhit dhe medias suaj ndërsa programi vazhdon dhe i adaptoni ato në përputhje me ndryshimet. Më poshtë do të gjeni një listë të mediave, materialeve dhe aktiviteteve. Nuk është gjithë përfshirëse, por jep një ide të gjërave që mund të përdoren.

Tabela 12: Avantazhet dhe Disavantazhet e llojeve të ndryshme të aktiviteteve të komunikimit

AKTIVITETE/PËRDORIMI I MEDIAS	AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
Lojrat	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndëraktive</li> <li>Është e lehtë t'iu kalohet mesazhi fëmijëve – të mësuarit duke bërë.</li> <li>Lejon përsëritjen e mesazheve pa mërziur publikun (nëpërmjet lojrave të ndryshme)</li> <li>Shumëllojshmëri</li> <li>Përforco mesazhin në komunitet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Është më e vështirë për tu përdorur me të rriturit.</li> <li>Një numër i vogël njerëzish përfshihet në të njëjtën kohë.</li> <li>Nëse bëhet në mënyrë jo të saktë, mund të shpërndajë mesazhin e gabuar (psh. AVL janë të bukura dhe të mira).</li> </ul>
Konkurset	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mënyrë e mirë për të punuar me fëmijët</li> <li>Aktivitet në shkallë të madhe, gjithëkombëtare që përfshin shumë njerëz.</li> <li>Përfshin në mënyrë indirekte grupe të tjera, të ndryshme nga publiku i shënjestruar psh. mësuesit, autoritetet, prindrit, median.</li> <li>Mund të përforcojë mesazhet brenda komunitetit.</li> <li>Rezultatet e konkursit mund të përdoren për aktivitete të tjera (psh. konkurs për posterat: posterit fitues mund të përdoret për të prodhuar një poster apo një fletëpalosje për fushatën).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi i mesazheve dhe i publikut të shënjestruar (psh. mënyra sesi ato e kanë marrë informacionin) mund të jetë i vështirë.</li> </ul>
Shfaqjet e lëvizshme dhe shfaqet në publik (psh. shfaqet me kukulla, teatrot, teatrot ndëraktiv) <sup>54</sup>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të jenë ndëraktive, psh. pjesëmarrje e publikut apo aktorët dhe publiku ndërrojnë vendet me njëri tjetrin.</li> <li>Mënyrë e mirë për të arritur grupe të shënjestruara të ndryshme, psh. fëmijët por edhe prindërit.</li> <li>Mënyrë e mirë për të përfshirë mësuesit në aktivitetet vazhduese.</li> <li>Mund të organizohet filmimi dhe transmetimi në televizion i aktiviteteve.</li> <li>Përforcon mesazhet brenda komunitetit.</li> <li>Argëtuese – tërheq dhe mban vëmendjen e njerëzve.</li> <li>Mund të përdorë njerëz vendas/lokalë prandaj është e qëndrueshme.</li> <li>Nuk kushton shumë</li> <li>Stimulon diskutimet</li> <li>Mund ti vendosi mesazhet në kontekstin, traditat dhe zhargonin lokal.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vazhdueshmëria e aktivitetit konsumon tepër kohë dhe kërkon trajnim të përshtatshëm.</li> <li>Mund të arrijë një publik të madh në të njëjtën kohë por kërkon skuadra të lëvizshme.</li> <li>Mund të jetë e vështirë të arrihen mesazhe konsistentë dhe të saktë, veçanërisht kur ka ndarje gjuhësore dhe kulturore.</li> </ul>
Ekspozitat	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mënyrë e mirë për të shënjestruar grupe të ndryshme.</li> <li>Përfshijnë autoritetet lokale dhe median.</li> <li>Pjesëmarrje e publikut të shënjestruar në organizimin e ekspozitave.</li> <li>Përforcim i mesazhit brenda komunitetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Është komunikim i njëanshëm dhe pjesëmarrja e vizitorëve është e kufizuar.</li> </ul>

<sup>54</sup> Shikoni për shembull Augusto Boal 'Teatri i të Shtypurve', www.format.org.



AKTIVITETE/PËRDORIMI I MEDIAS	AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
Dramat dhe lojrat me role	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mënyrë e mirë ndëraktive për të punuar me fëmijët.</li> <li>Përforsim i mesazhit brenda komunitetit.</li> <li>Mund të jetë një mënyrë për të përfshirë mësuesit.</li> <li>Shpërndarje e mesazhit nëpërmjet fëmijëve duke e përçuar tek fëmijët e tjerë.</li> <li>Përfshirje e të rriturve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Një numër i vogël njerëzish mund të marrin pjesë në të njëjtën kohë.</li> <li>Përgatitja konsumon mjaft kohë.</li> </ul>
Radio dhe Televizioni	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shikoni më poshtë.</li> <li>Aktivitete ndëraktive nëse njerëzit përfshihen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shikoni më poshtë.</li> <li>Strategji e njëanëshme komunikimi.</li> </ul>
Transmetimi i filmave (psh. Bowling for Columbine apo City of God)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të shënjestrohet publik i gjerë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Komunikim i njëanshëm.</li> <li>Marrja e mendimit të njerëzve mund të jetë e vështirë për tu organizuar.</li> <li>Mesazhe të njëjta për të gjitha grupet.</li> </ul>
Leksionet, prezantimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mesazhe të ndryshme dhe çështjet mund të trajtohen në thellësi.</li> <li>Relativisht mund të arrihet publik i madh.</li> <li>Mund të formohen grupe që të shënjestrohen me mesazhe të ndryshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Komunikim i njëanshëm.</li> <li>Pjesëmarrje e kufizuar nga ana e publikut.</li> <li>Mund të bëhet e mërzitshme nëse mënyrat e komunikimit nuk janë të përshtatshme.</li> </ul>
Kurset e trajnimit (trajnimet për aftësitë, trajnimi i mësuesve etj.)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Strategji afatgjatë: anëtarët e komunitetit trajnohen që të shpërndajnë informacionin tek anëtarë të tjerë të komunitetit.</li> <li>Nuk ka nevojë për skuadra të lëvizshme apo për anëtarë të skuadrës që të kthehen për të dhënë informacionin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Konsumon shumë kohë përpara i përket vazhdueshmërisë.</li> <li>Motivimi i trajnimit mund të jetë i ulët dhe aktivitetet nuk do të zbatohen apo ndihen më pas.</li> </ul>
Koncertet (si një mënyrë për të përdorur si shembull njerëzit e famshëm)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shënjestrohet publik i gjerë.</li> <li>Ka interes nga mediat.</li> <li>Përfshihen autoritetet locale.</li> <li>Mënyrë e mirë për të përçuar mesazhe tek rinia.</li> <li>Përdoren njerëz të famshëm që janë të besueshëm në mesazhet që ata shpërndajnë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shpërndahen mesazhe bazë.</li> <li>Opinion/mendimet nga publiku janë të vështira për tu mbledhur – monitorimi i mesazheve është gjithashtu i vështirë.</li> </ul>
Dëshmitë e viktimave	<ul style="list-style-type: none"> <li>Besueshmëria e mesazheve.</li> <li>Mund të shënjestrohen të gjitha grupet.</li> <li>Historitë personale kanë një impakt shumë të madh.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Duhen gjetur mënyra të përshtatshme për të përçuar mesazhet pa tronditur publikun</li> <li>Kini kujdes që të mos shpërdorohet informacioni nga ana e medias.</li> </ul>
Fjalime të / diskutime me njerëz me influencë (psh. drejtues fetarë)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Besueshmëria e mesazheve.</li> <li>Mund të shënjestrohet publik i gjerë (psh. në rastet e drejtuesve të komunitetit gjatë fjalimeve)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vetëm disa grupe shënjestrohen (psh. drejtuesit fetarë)</li> <li>Monitorimi është i vështirë.</li> </ul>

AKTIVITETE/PËRDORIMI I MEDIAS	AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
Ambasadorët e Vullnetit të Mirë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Besueshmëria e mesazheve.</li> <li>Mund të tërhiqen dhe shënjestrohen audiencia të gjera.</li> <li>Mund të shënjestrohen të gjitha grupet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi është i vështirë.</li> </ul>
Përdorimi i njerëzve të famshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të tërhiqen dhe shënjestrohen audiencia të gjera.</li> <li>Mund të shënjestrohen të gjitha grupet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi është i vështirë.</li> <li>Ka nevojë për mbështetje të individëve.</li> <li>Shpenzime (psh, udhëtimi)</li> </ul>
Marshimet Publike/ Demonstrimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi është i vështirë.</li> <li>Mund të shënjestrohen të gjitha grupet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi është i vështirë.</li> </ul>
Peticionet, shkrimi i letrave	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të marrin pjesë audiencia të mëdha.</li> <li>Mund të trajtohen çështje specifike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Qenia e sigurtë se vepron më pas është e vështirë, psh. mund të merret peticioni por të mos ketë ndonjë veprim në vazhdim.</li> </ul>
Seminaret, Konferencat, Workshopet, Tavolinat e rrumbullakta.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nëpërmjet mediave, informacioni mund të shpërndahet dhe të ngrihen çështjet.</li> <li>Aktivitete që venë në dukje çështjen brenda shoqërisë civile.</li> <li>Merr mendim/opinion të menjëhershëm.</li> <li>Mësohen mësimet e nxjerre</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vetëm grupe specifike janë të shënjestruara.</li> <li>Publik i shënjestruar i vogël.</li> <li>Ndjekjet e mëpasshme të nevojshme nuk zbatohen gjithmonë.</li> </ul>
Takimet dhe diskutimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Publik i gjerë nëse transmetohen.</li> <li>Përfshirëse për pjesëmarrësit ndëraktivë.</li> <li>Ngre shqetësimet, çështjet dhe mënyrat për të përmirësuar gjërat.</li> <li>Mund të nxirren në pah mësimet e marra.</li> <li>Opinion/mendimi i menjëhershëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Publik i vogël përveçse kur transmetohen në television.</li> <li>Vazhdimi nuk bëhet gjithmonë.</li> </ul>
Vigiljet simbolike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Imazhe të fuqishme dhe paqësore.</li> <li>Relativisht me kohë të gjatë në krahasim me aktivitete të tjera.</li> <li>Ndërton solidaritet dhe moral mes pjesëmarrësve – mund të rekrutojë të tjerë që bashkohen me çështjen.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të vështira për tu organizuar dhe për tu koordinuar.</li> <li>Mund të kenë nevojë për leje zyrtare.</li> </ul>
Workshopet me art nga komuniteti	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndëraktivë – anëtarët e komunitetit procesin krijues.</li> <li>Opinion/mendimi i menjëhershëm</li> <li>Diskutime të grupeve të përziara dhe planifikim i aktiviteteve për problemet e komunitetit të cilat identifikohen gjatë workshopit, kështu që jep rast për veprime.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pak pjesëmarrje.</li> <li>Vazhdimësia e mesazheve mund të jetë e vështirë për tu siguruar.</li> <li>Rezultatet janë të vështira për tu parashikuar.</li> </ul>
Komunikimi ballë për ballë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndëraktiv.</li> <li>Opinion/mendimi i menjëhershëm</li> <li>Shans për të rekrutuar.</li> <li>Mund të jetë shumë bindëse dhe efektive në varësi të mesazheve dhe stafit që përdoret .</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Konsumon tepër kohë.</li> <li>Vazhimi nuk bëhet gjithmonë.</li> <li>Suksesi varet nga raporti mes individëve.</li> </ul>
Qendrat e shpërndarjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>Komuniteti është përgjegjës nëpërmjet përfshirjes së anëtarëve të komunitetit.</li> <li>Strategji afatgjatë.</li> <li>Shënjestrohen të gjitha grupet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vazhdimi dhe monitorimi janë të vështirë për tu bërë.</li> <li>Ka nevojë për trajnime.</li> <li>Shpenzime administrative dhe menaxheriale.</li> </ul>



#### Kutia 24: Disa këshilla për përdorimin e kanaleve të komunikimit të medias

- Vendosni për dy apo tre mesazhe kyç të cilat mbështesin objektivat e programit tuaj.
- Përdorni gjuhë të thjeshtë dhe fjali të shkurtra, evitoni shkurtime aty ku është e mundur (përdorni shkurtime që mund të shqiptohen, nëse ju është e pamundur që ti hiqni).
- Ofroni këshilla specifike dhe praktike.
- Organizojeni informacionin në mënyrë të qartë dhe logjike.
- Përsëriteni informacionin.
- Mbani kontakte të rregullta e të vazhdueshme me median.

## 5.7 Roli i mediave të ndryshme

Tabela e mëposhtme eksploron karakteristikat më të rëndësishme të mediave që përdoren zakonisht. Edhe një herë, është e këshillueshme që të përdoret një miks i 'kanaleve', por mësimi më i rëndësishëm i mësuar në forma të tjera komunikimi është se – kur përdoret vetëm, operacionet mediatike/fushatat e informimit publik nuk janë një mjet efektiv për të ndryshuar sjelljet. Kjo është vënë veçanërisht re në rastet e mediave të vogla. Pa mbështetje nga aktivitete të tjera operacionet mediatike/fushatat e informimit publik përgjithësisht kanë pak impakt mbi publikun e shënjestruar.

#### Kutia 25: Vlerësimi i impaktit të edukimit mbi rreziqet e minave të zbatuar nga ICRC Ballkan

Për shembull, ICRC ndërmori një vlerësim të impaktit të programeve të saja të ERRM në Ballkan (Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci dhe IRY/Kosovë). Ky vlerësim zbuloi se niveli i mbulimit në tre vendet në lidhje me shpërndarjen e informacionit për sensibilizimin mbi minat është shumë i lartë. Si në zonat e prekura ashtu edhe në ato të paprekura nga minat virtualisht të gjithë njerëzit, të rritur e fëmijë janë ekspozuar ndaj aktiviteteve të sensibilizimit mbi minat, në një mënyrë ose në një tjetër, në vitet e fundit. Kjo është veçanërisht për shkak të prevalencës së medias dhe aksesit tek televizioni dhe radios. Vlerësimi tregon se masmedia ka qenë shumë efektive në lajmërimin e popullatës me informacione mbi ERRM por nuk kanë krijuar drejtpërsëdrejti ndryshime të sjelljes dhe qëndrimit. Këto ndryshime ndodhën si pasojë e një kombinimi metodash dhe mënyrash të përdorura si pjesë e programit të ERRM.

Prandaj rregullat e arta për aktivistët që janë duke marrë në konsideratë përdorimin e mediave të komunikimit janë:<sup>55</sup>

- a) Sigurohuni që përdorimi i medias nga ana juaj të ketë një qëllim specifik;
- b) Integroji me kujdes planet tuaja mediatike në aktivitete të tjera;
- c) Përdorni formate interaktive të medias atje ku është e mundur (psh. programe radio me telefonata dhe konkurse); dhe
- d) Mbani mend, operacionet mediatike duhet të luajnë një rol mbështetës për aktivitetet e tjera të programit – posterat dhe t-shirtet (bluzat) nuk do të ndryshojnë sjelljen e njerëzve!

<sup>55</sup> Për më tepër këshilla mbi përdorimin e medias, duke përfshirë edhe se si të përdoren lajmërimet për shtyp, paketat me informacion për mediat dhe konferencat, si të jepen intervistat dhe të shkruhen artikuj, shikoni 'Aksioni kundër Armëve të Vogla, një Doracak Burimor dhe Trajnimi', Jim Coe dhe Henry Smith, International Alert, Oxfam GP, Safeworld 2003.



Tabela 13: Përmbajtja e formave të ndryshme të komunikimit me masmedia

MEDIUMET	AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
<b>MASMEDIA</b>		
TV (psh. dokumentarët, spotet televizive, diskutimet, lajmet, intervistat, telenovelat, shfaqjet me diskutime, lajmërimet që flasim për amnistinë e armëve)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arrijnë një numër të madh njerëzish</li> <li>• Mund të shënjestrojnë grupe specifike nëpërmjet programeve specifike</li> <li>• Programet janë të përsëritshme</li> <li>• Mund të arrijnë grupet analfabete</li> <li>• Mund të përforcojnë mesazhet e shpërndara nga metoda më pjesëmarrëse</li> <li>• Efekt shumë dimensional</li> <li>• Mund të nxitin diskutime të hapura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programet janë shpesh të shumë të kushtueshme për tu bërë</li> <li>• Nuk është mirë për trajnimet mbi aftësitë praktike</li> <li>• Njerëzit mund të mos besojnë disa kanale në varësi të përkatësisë politike</li> <li>• Planifikimi dhe frekuenca e transmetimit janë thelbësore për suksesin dhe arritjen e grupeve të shënjestruara</li> <li>• Të paparashikueshme</li> </ul>
Radio (psh. lajmet, intervistat, dramet, radionovelat, spotet e radios, dokumentarët e radios, revistat radiofonike, lajmërimet që flasim për amnistinë e armëve)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arrijnë një numër të madh njerëzish</li> <li>• Mund të shënjestrojnë grupe specifike nëpërmjet programeve specifike</li> <li>• Janë të përsëritshme</li> <li>• Mund të arrijnë grupet analfabete</li> <li>• Programet janë të lira, të shpejta dhe të lehta për tu bërë</li> <li>• Dëgjimi i radios është shpesh aktiviteti grupi, gjë kjo që inkurajon diskutimin e çështjeve edukimore pas transmetimit. Kjo është një fazë e rëndësishme në procesin e ndryshimit të sjelljeve</li> <li>• Mund të përforcojë mesazhet e dhëna nga materiale dhe aktivitete të tjera</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk është mirë për trajnimet mbi aftësitë praktike</li> <li>• Planifikimi dhe frekuenca e transmetimit janë thelbësore për suksesin dhe arritjen e grupeve të shënjestruara</li> <li>• Të paparashikueshme</li> </ul>
Telekomunikacionet (psh. interneti, SMS-të në telefonat celularë)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arrijnë një publik shumë të gjerë në gjithë botën, jo vetëm brenda vendit</li> <li>• Përgjigje e menjëhershme është e mundur (psh. mendime/opinione nga njerëz të tjerë nëpërmjet komunikimit telematik chat)</li> <li>• Shpesh nuk kushton shumë</li> <li>• Është shumë popullore mes të rinjve</li> <li>• Është një sektor që po rritet shpejt</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• E vështirë për tu monitoruar</li> <li>• I paaksesueshëm në disa vende</li> <li>• Përdorimi ka nevojë për trajnim</li> <li>• Nuk mund të garantojë një fushatë të organizuar</li> <li>• Përgjithësisht është për përdorim personal</li> </ul>
Gazetat/revistat (psh. dhënia e lajmeve, edicionet speciale, letrat tek botuesi, reklamat) ...	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpesh janë më të respektuara se mediat e tjera</li> <li>• Shumica e publikimeve kanë audiencë të identifikueshme. Publikimet speciale mund të kapin grupe kyçe (mësues, policë, fermerë)</li> <li>• Artikujt mund të përmbajnë informacion të detajuar</li> <li>• Mund të përforcojë mesazhet e dhëna nga metoda më përfshirëse</li> <li>• Pikëpamja politike mund të jetë një avantazh</li> <li>• Shpejtësi në shpërndarjen e informacionit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arrin vetëm grupet që dijnë të lexojnë</li> <li>• Pikëpamja politike e disa gazetave/revistave mund të jetë një disavantazh</li> <li>• Arritja e vendosjes së duhur të artikullit apo reklamës suaj është e rëndësishme për suksesin.</li> </ul>



#### **Kutia 26: Përdorimi i metodave komerciale për të shpërndarë median e vogël**

Duke punuar së bashku me UNDP, autoriteti kombëtar i AVL dhe OJQ të tjera, OJQ-ja maqedonase Shoqërore dhe partnere Pax Christi filloi shpërndarjen e materialeve reklamuese në mbështetje të programit kombëtar për Sensibilizimin mbi AVL 'Për një të Ardhme më të Mirë' i cili mbështeti një amnisti kombëtare të AVL në Nëntor 2003. Një marrëveshje u arrit me stafin menaxhues të dyqaneve sportive Diesel dhe Mango, dhe menaxhimin e Stacionit të Autobusave Intercity, që bënte të mundur shpërndarjen e mbi 14,000 stampave në javë vetëm në stacionin e autobuzit, pa shpenzime për stafin e programit.

*Burimi: Korrespondencë e-maili me Civil, 2 Tetor 2003*

#### **Kutia 27: Tërheqja e fondeve dhe reklamës nëpërmjet sponsorizimit**

Sponsorizimi nga korporatat mund të shtojë fonde të vlefshme për çdo program. Në Brcko, Bosnje dhe Hercegovinë, dhe në Maqedoni në 2003, u zbatuan skema të mbledhjes së armëve në të cilat publiku mori një biletë llotarie në këmbim të armëve të dorëzuara. Bileta i lejonte ata të cilët dorëzonin armët që të kishin shansin për të fituar çmime tërheqëse, në rastin e Brcko, një makinë të re. Në të dyja rastet kjo i lejoi sponsorët privatë që të rrisnin fondet e projektit dhe i dha një publicitet shumë të nevojshëm programeve. Sponsorizimi mund të arrihet gjithashtu për përpjekjet e ngritjes së sensibilizimit. Që prej Korrikut deri në Shtator 2002 koalicioni kundër-SIDA-s në Bullgari shënjestroi të rinjtë me ngjarje publike duke përfshirë koncerte dhe shfaqje. Sponsorizimi u dha nga prodhuesit vendas të profilaktikëve 'Mars Vending' të cilët treguan dhe shpërndanë profilaktikë nëpër ngjarjet publike.

*Burimet: Faqja Internet e UNDP Bullgari; SFOR*

#### **Kutia 28: Edukimi-argëtues në Peru dhe Brazil**

Format popullore të argëtimit me mas media (psh. telenovelat) shpesh përmbajnë mesazhe negative apo sensacionale rreth AVL. Prapëseprapë arritja unike dhe përmbajtja argëtuese e këtyre formave mediatike ka çuar tek zhvillimi i 'Edukimit-Argëtues'. Qysh prej 1969 shfaqja "Thjesht Maria" (Simplemente Maria) në televizionin Peruan ka pasur një efekt pozitiv të paqëllimshëm kur karakteri kryesor – një vajzë shtëpiake me emrin Maria – e kthehu qëndisjen dhe klasat kundër analfabetizmit në një modë të çmendur mes të varfërve duke shkuar ajo vetë në ekran në shkollat e natës. Qysh atëherë HIV/SIDA, edukimi seksual, planifikimi familjar dhe Sensibilizimi për AVL janë thjesht disa prej fushave ku ndërhyrjet e Edukimit-Argëtues janë provuar me sukses duke përdorur muzikën, radionovelat dhe videot muzikore. Në Shtator të 2003, aktorët në telenovelën popullore Braziliene 'Gra në Dashuri' shpenzuan një javë të tërë duke diskutuar nëse ata do të bashkoheshin me një demonstratë të organizuar nga OJQ-ja Viva Rio që bënte thirrje për ndalimin e shitjes së armëve në vend. Marshimi ndodhi në fakt javën e ardhshme. Shfaqja gjithashtu prezantoi një paraqitje nga prindrit e një vaje adoleshente, e vlarë nga një plumb qorr në Mars 2003. Pasi lëshuan peticionin në mbështetje të ndalimit të shitjes së armëve gjatë shfaqjes, pridërit e saj morën rreth 40.000 firma në 24 orë.



Tabela 14: Përmbajtja e formave të ndryshme të komunikimit me media të vogla

MEDIUMET	AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
<b>MEDIAT E VOGLA</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Postera</li> <li>• T-shirte (Bluza)</li> <li>• Tabela</li> <li>• Stampa</li> <li>• Stilolapsa</li> <li>• Shkrepëse</li> <li>• Banderola</li> <li>• Kutitë e sheqerit</li> <li>• Transparenti</li> <li>• Autobuzët</li> <li>• Kutitë me kokoshka në kinema</li> <li>• Çakmakë</li> <li>• Kapele</li> <li>• Kalendarë</li> <li>• Blloqe shënimesh</li> <li>• Vizatimet e fëmijëve</li> <li>• Të tjera</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Materiale të dobishme mbështetëse për një sërë të madhe aktivitetsh dhe llojesh të ndryshme komunikimi ndërpersonal</li> <li>• Mund të krijohen për të përforcuar mesazhet kyçe dhe të shërbejnë si një kujtues i vazhdueshëm i mesazheve</li> <li>• Mund të shpërndahen kudo</li> <li>• Mund të jenë vizualisht tërheqëse</li> <li>• Të dobishme si ndihmesa vizuale në workshope, diskutime dhe mësim</li> <li>• Shpërndajnë informacion të saktë dhe të standartizuar në një format të lëvizshëm dhe të ri-përdorshëm</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programet janë shpesh shumë të kushtueshme për tu bërë dhe për tu shpërndarë (por jo gjithmonë)</li> <li>• Kërkojnë aftësi speciallistësh për të krijuar dhe prodhuar shëmbuj efektivë (ndonëse ekzistojnë edhe përjashtime)</li> <li>• Jetëgjatësia e tyre është e shkurtër</li> <li>• Duhet që të adaptohen për secilin nga grupet etnike apo situatat</li> <li>• Nuk duhet që të përdoret me grupe të cilët nuk janë mësuar më mësimin duke përdorur materialet e shkruara dhe vizuale, edhe pse mund të dijnë të lexojnë</li> </ul>


Këshilla për mediat e vogla<sup>56</sup>:

- Krijimtaria i dizenjtorëve vendas duhet të përdoret sa më shumë që të jetë e mundur.
- Përdorimi i dizenjtorëve të komunitetit mund të ketë një impakt pozitiv (psh. vizatimi i një fëmije mund të përdoret si poster).
- Mesazhet e përdorura me mediat e vogla duhet që të lidhen me fushatën në masmedia, nëse ekziston një e tillë.
- Media e vogël mundet shpesh që të tërheqi masmedian.
- Nëse gjuhë të ndryshme përdoren në vend, vetëm një gjuhë duhet të përdoret në secilin material.
- Çdo grup i shënjestruar duhet të arrihet me media të vogla që përfshijnë gjuhën e tyre.
- Merrni në konsideratë nivelet e analfabetizimit të grupit të shënjestruar.
- Produktet mediatike mund të prodhohen vetëm për një komunitet apo rajon specifik. Nuk ka nevojë që të shpërndahen në nivel kombëtar.

Mbani mend, është informacioni i mbledhur gjatë një programi (gjatë vlerësimit të nevojave, testimeve në terren, aktivitetet e Planit të Komunitetit më të Sigurtë etj.) që vendos sesi do të shpërndahen mesazhet e programit për secilin nga grupet e shënjestruara. Mbani mend që:

- a) Tipet e aktiviteteve që do të zbatohen varen nga grupet e shënjestruara dhe nga mesazhet që do të përçohen;
- b) Në shkëmbim këto mesazhe duhet të krijohen për të mbështetur objektivat operacionalë të programit.
- c) Mediat e vogla (materialet) përdoren si një mbështetje për, dhe jo një zëvendësues i aktiviteteve të bazuara në komunitet, për të përçuar mesazhet dhe përforcuar mesazhet e marra nëpërmjet mjeteve të tjera.

<sup>56</sup> Shikoni Nëntëmbëdhjetë Parime për të Dizenuar Materiale të Shtypura në 'Komunikimi në Programet për Sensibilizimin mbi Minat', Qendra Ndërkombëtare e Gjenezës për Çminimin Humanitar, 2002.



- d) Masediat dhe mediat e vogla duhet të përdoren në kombinime të ndryshme në varësi të situatës dhe sipas asaj që është mënyra më efiçente për të shpërndarë informacionin në një kontekst të caktuar. Ato janë veçanërisht të rëndësishme për qëllimet e Informimit Publik si dhe për programe emergjente të Edukimit mbi Rreziqet e AVL gjatë mbledhjes së armëve (shikoni Seksionin 2.1.3) sepse ato i lejojnë një popullatë të tërë që të informohet në një periudhë të shkurtër kohore.
- e) Masediat lokale mund të jenë një aleat i rëndësishëm në përpjekjet për të promovuar aktivitetet dhe masat për kontrollin e AVL. Mediat ndërkombëtare janë gjithashtu mjete thelbësore për të promovuar aktivitete të tilla mes komunitetit ndërkombëtar, donatorëve dhe qeverive ashtu edhe për të influencuar opinionin publik në lidhje me shtimin dhe shpërdorimin e AVL.

#### Kutia 29: Mbani mend!

Në të gjitha rastet është thelbësore që të mos 'kopjohen dhe përdoren' shembuj nga ky doracak apo ndonjë burim tjetër para se të adaptohen ato me kontekstin dhe komunitetin specifik në të cilin ju jeni duke punuar në bazë të informacionit që ju keni mbledhur.

Duke përdorur gjithë informacionin e mësipërm, duhet që të jetë e mundur të zgjidhen mesazhet, materialet dhe aktivitetet të cilat së bashku do t'ju ndihmojnë juve të arrini objektivat e programit. Është tepër e dëshirueshme që të mendohet paraprakisht në një fazë të mëparshme rreth treguesve dhe mënyrave të verifikimit që do të përdoren për secilin aktivitet dhe/ose mesazh, dhe për të lidhur të gjithë bashkë për qëllim monitorimi dhe vlerësimi dhe për të përgatitur testimin në terren.

## 5.8 Shembuj treguesish për monitorimin e mesazheve, aktiviteteve dhe materialeve<sup>57</sup>

Një tregues është një pjesë faktike që tregon se sa mirë (apo sa keq) ju jeni duke i arritur objektivat e programit tuaj. Treguesit duhet të jenë të lidhur me objektivat që ju keni vendosur. Vendosja e treguesve për një projekt apo një aktivitet të planifikuar nënkupton qartësimin e asaj që ju do të masni dhe marrjen e vendimit se si ju do të mblidhni informacionin që do t'ju nevojitet për të bërë atë matje. Për secilin nga objektivat e programit tuaj do t'ju duhet të mendoni të paktën një tregues. Nëse e keni të vështirë që të mendoni për një tregues për atë objektivi, kjo ndoshta është sepse objektivi juaj nuk është mjaftueshëm SMART<sup>58</sup>, dhe në këtë rast do t'ju duhet ta bëni më të qartë dhe më specifik. Është shumë e mundshme që ju të mund të mendoni për më shumë se një tregues për secilin objektivi. Sidoqoftë, mos shkoni shumë larg – shënjestrat arbitrare për treguesit (si përshtetja një rënie 30% në krimet e dhunshme) janë të padobishme. Shpesh një informim i thjeshtë për ndryshimin do të jetë i mjaftueshëm (një rënie e vazhdueshme në krimet e dhunshme). Për çdo objektivi është e rëndësishme që të merrni në konsideratë:

- a) cilat janë pjesët provë të rëndësishme që do të tregojnë nëse objektivi është arritur, apo jo? (midis të tjerash treguesit); dhe
- b) si mund ta mblidhni ju këtë informacion – cilat janë burimet dhe teknikat kryesore që ju do të përdorni? (midis të tjerash mënyrat e verifikimit).

Pasi të jenë identifikuar treguesit, etapa pasuese është që të lihet vend në planin e programit për të bërë matje duke përdorur këto tregues. Treguesit mund të përdoren si për të monitoruar progresin ndërsa programi zbatohet, ashtu edhe për të vlerësuar sukseset dhe dështimet e tij më pas.

<sup>57</sup> E aplikuar nga 'Aksioni Kundër Armëve të Vogla', nga Coe dhe Smith.

<sup>58</sup> SMART – Specifikë, të Matshëm, të Arritshëm, Realistë dhe të Tregueshëm. Gjithë objektivat e mirë janë SMART



### Kutia 30: Treguesit pjesëmarrës

Në projektet të cilat synojnë të ndikojnë tek qëndrimet dhe sjelljet e një grupi të shënjestruar, pjesëmarrja e antarëve të atij grupi në krijimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit është mënyra më e mirë për të maksimizuar impaktin. Në mënyrë që të ndërmerret një monitorim dhe vlerësim pjesëmarrës anëtarët e një grupi të shënjestruar duhet që të përfshihen në momentin kur vendosen treguesit. Kjo ka shumë të ngjarë që të kthehet në një proces që konsumon shumë kohë dhe që është tepër i komplikuar, kështu që, ndonëse përfitimet mund të jenë të konsiderueshme, do të këtë nevojë që ato të vendosen në një ekuilibër kundrejt limiteve të programit si koha dhe burimet.

Tabela 15: Shembuj të mesazheve, aktiviteteve dhe treguesve për programet e Sensibilizimit të AVL në komunitetin 'A'

OBJEKTIVI 1: TE MUNDËSOHET NJË PROCES NËPËRMJET TË CILIT GRUPET NË RREZIK BRENDA KOMUNITETIT (DJEMTË ADOLESHENTË, FËMIJËT DHE MESHKUJT E RRIUR DUKE PËRFSHIRË DHE ISH-LUFTËTARËT) TË ANALIZOJNË SJELLJET E TYRE DHE TË ADOPTOJNË SJELLJE MË TË SIGURTA	
<b>Përmbledhja e strategjisë së planifikuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktivitete ndëraktive do të zhvillohen me adoleshentët (djemtë, dhe vajzat si një rrugë për tek djemtë) duke u fokusuar tek rreziqet e mbajtjes së armëve</li> <li>Diskutime në grup me ish-luftëtarët mbi çështjet dhe rreziqet e AVL</li> <li>Aktivitete ndëraktive do të zhvillohen me fëmijët duke u fokusuar mbi atë që është e sigurtë që të përdoret si lodër</li> <li>Trajnim i mësuesve në mënyrë që mesazhet të transmetohen në mënyrë afatgjatë</li> <li>Të mbështeten gratë dhe mësuesit në zhvillimin e aktiviteteve ndëraktive me fëmijët mbi rreziqet e të luajturit me armët</li> <li>Mesazhe të Edukimit mbi Rreziqet/Advokimin do të koordinohen me OJQ-të lokale</li> <li>Të krijohen mesazhe në radio mbi rreziqet e KAVL duke pasur parasysh fëmijët, adoleshentët dhe ish-luftëtarët</li> <li>Materialet mbështetëse do të prodhohen duke reflektuar idetë dhe nevojat e secilit grup</li> <li>Materialet për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe informimin mbi sjelljet e sigurta do të prodhohen dhe shpërndahen tek gratë për të mbështetur aktivitetet e tyre</li> </ul>
<b>Shembuj të mesazheve bazë<sup>59</sup></b>	<p><b>Djemtë Adoleshentë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbajtja e një arme nuk ju bën të dukeni bukur; jeta nuk është një film</li> <li>Është e rrezikshme për ju dhe për familjen tuaj që ju të mbani armë me vete</li> <li>Bëhuni një shembull për fëmijët dhe mos mbani armë</li> <li>Sigurohuni që fëmijët ta dinë rrezikun e mbajtjes/ të luajturit me armët</li> </ul> <p><b>Fëmijët</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Armët nuk janë për të luajtur, ato mund të vrasin vëllain, motrën, babain, mamanë tuaj</li> <li>I thoni prindërve dhe vëllait tuaj më të rritur se ju keni frikë nga armët meqenëse ato janë shumë të rrezikshme</li> <li>I thoni shokëve tuaj të mos prekin armët dhe se loja me to mund ti vrasë ata, juve apo dikë në komunitetin apo familjen tuaj</li> </ul> <p><b>Burrat</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Armët e pakontrolluara po venë në rrezik komunitetin dhe vendin tuaj; ju mund tndihmoni që kjo gjë të ndryshojë</li> <li>Armët mund të shkatërrojnë jetët e gjeneratave më të reja</li> <li>Bëhuni një shembull për adoleshentët dhe sigurohuni që ata kanë dijeni mbi rreziqet dhe nuk tentohen për të mbajtur një armë</li> </ul> <p><b>Spote radiofonike për fëmijët, ish-luftëtarët dhe adoleshentët</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të njëjtat mesazhe si ato të përdorura si pjesë e aktiviteteve që shënjestrojnë këto grupe duhet të përdoren në spotet radiofonike në mënyrë që të përforcohet mesazhi i dhënë në komunitete</li> </ul> <p><b>Ish-luftëtarët</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Armët ushtarake në komunitet po vendosin në rrezik komunitetin dhe vendin tuaj; ju mund të ndihmoni që kjo gjë të ndryshojë</li> <li>Armët mund të shkatërrojnë jetët e gjeneratave më të reja</li> <li>Bëhuni një shembull për adoleshentët dhe sigurohuni që ata kanë dijeni mbi rreziqet dhe nuk tentojnë për të mbajtur një armë</li> </ul>

<sup>59</sup> Për shkak të mungesës së hapsirës shembujt e mesazheve janë kryesisht mesazhe të tipit Advokues. Merret si i mirëqenë fakti që mesazhe të Edukimit mbi Rreziqet dhe Informacionin Publik do të shpërndahen gjithashtu.



**OBJEKTIVI 1: TE MUNDËSOHET NJË PROCES NËPËRMJET TË CILIT GRUPE TË RREZIK BRENDA KOMUNITETIT (DJEMTË ADOLESHENTË, FËMIJËT DHE MESHKUJT E RRRITUR DUKE PËRFSHIRË DHE ISH-LUFTËTARËT) TË ANALIZOJNË SJELLJET E TYRE DHE TË ADOPTOJNË SJELLJE MË TË SIGURTA**

AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	TREGUESIT E PASOJAVE	MËNYRAT E VERIFIKIMIT
Diskutime pjesëmarrëse me secilin nga grupet (meshkujt e rritur, adoleshentët dhe fëmijët)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i diskutimeve të mbajtura</li> <li>• Numri i njerëzve që kanë marrë pjesë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova që grupe të ndryshme të shënjestruara (meshkujt e rritur, djemtë adoleshentë dhe fëmijët) i kuptojnë më mirë problemet dhe rreziqet që lidhen me AVL</li> <li>• Prova të një uljeje në dëshirën mes grupeve të shënjestruara për të praktikuar sjellje të rrezikshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tipe diskutimesh në grupe të fokusuar me fëmijët, adoleshentët dhe meshkujt e rritur</li> <li>• Diskutime dhe intervista me prindërit</li> <li>• Statistika nga spitalet/qendrat mjekësore apo burime të tjera dytësore (psh. policia, media)</li> <li>• Pyetësorët</li> </ul>
Konkurse kuiz dhe ekspozita që përgatiten nga adoleshentët	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i aktiviteteve të përgatitura nga adoleshentët për fëmijët</li> <li>• Numri i fëmijëve të arritur prej tyre</li> <li>• Njohja nga fëmijët e mesazheve kyçe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndryshimit të sjelljeve mes grupeve të ndryshme të shënjestruara (psh. fëmijët nuk luajnë më me armë apo djemtë adoleshentë nuk mbajnë më armë me vete)</li> <li>• Dëshmi të ndonjë dukurie positive në numrat e vdekjeve dhe dëmtimeve nga KAVL sipas grupeve të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tipe diskutimesh në grupe të fokusuar me fëmijët, adoleshentët</li> <li>• Diskutime dhe intervista me prindërit</li> <li>• Statistika nga spitalet/qendrat mjekësore apo burime të tjera dytësore (psh. policia, media)</li> <li>• Pyetësorët</li> </ul>
Trajnime në aktivitetet nga adoleshentët tek fëmijët, në mënyrë që adoleshentët të kalojnë mesazhin tek fëmijët e shkollave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i aktiviteteve të përgatitura nga adoleshentët për fëmijët</li> <li>• Numri i fëmijëve të arritur prej tyre</li> <li>• Njohja nga fëmijët e mesazheve kyçe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëshmi të ndonjë dukurie positive në numrat e vdekjeve dhe dëmtimeve nga KAVL sipas grupeve të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tipe diskutimesh në grupe të fokusuar me fëmijët, adoleshentët</li> <li>• Statistika nga spitalet/qendrat mjekësore apo burime të tjera dytësore (psh. policia, media)</li> <li>• Pyetësorët</li> </ul>
Takime me Ministrinë e Arsimit për zhvillimin e një plani veprimi për kurse trajnimi për mësuesit, dhe përfshirjen e trajnimeve mbi AVL në kurrikulat kombtare	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i takimeve me Ministrinë e Arsimit</li> <li>• Hierarkia e zyrtarëve të përfshirë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndonjë ndryshimi në politikat apo praktikat ministeriale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Evidenca dokumentare nga takimi</li> <li>• Deklarata politikash, komente të medias etj.</li> </ul>
Zhvillimi i kurseve të trajnimit për mësuesit me mësues kyç të zgjedhur	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tipi dhe sasia e materialeve të prodhuara me mësuesit</li> <li>• Numri i mundësive të trajnimit që u janë dhënë mësuesve</li> <li>• Numri i mësuesve të trajnuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndryshimit të sjelljeve mësimore mes të trajnuarve që kanë ndjekur kurset</li> <li>• Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes fëmijëve të mësuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Intervista me mësuesit e trajnuar</li> <li>• Tipe diskutimesh në grupe të fokusuar me fëmijët</li> </ul>



AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	TREGUESIT E PASOJAVE	MËNYRAT E VERIFIKIMIT
Gjatë kësaj kohe, zhvillimi i aktiviteteve ndëraktive në shkolla, psh. lojrat me role, shfaqjet teatrale, dhe lojrat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri dhe tipi i aktiviteteve të zhvilluara</li> <li>• Numri i fëmijëve të arritur</li> <li>• Si janë parë aktivitetet prej fëmijëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes fëmijëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Intervista me mësuesit e trajnuar</li> <li>• Tipe diskutimesh në grupe të fokusuara me fëmijët</li> </ul>
Diskutime me mësuesit për të zhvilluar materialet si një mbështetje për aktivitetet shkollore mbi AVL	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i takimeve të vazhdueshme me mësuesit, numri i mësuesve që kanë marrë pjesë</li> <li>• Numri dhe tipi i materialeve të prodhuar</li> <li>• Numri i fëmijëve të arritur</li> <li>• Si janë parë këto materiale prej fëmijëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes fëmijëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Intervista me mësuesit e trajnuar</li> <li>• Tipe diskutimesh në grupe të fokusuara me fëmijët</li> </ul>
Diskutime me gratë mes komunitetit për të gjetur zgjedhjet e duhura për të rritur sigurinë e fëmijëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i grave të përfshira në aktivitete të Sensibilizimit të AVL për fëmijët</li> <li>• Tipi i aktiviteteve të organizuara dhe zbatuara prej grave</li> <li>• Numri i fëmijëve të arritur</li> <li>• Si janë parë këto aktivitete nga fëmijët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndonjë kuptimi të përmirësuar mes grave mbi problemet dhe mënyrat e përballjes me to</li> <li>• Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes fëmijëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutime dhe intervista me gratë</li> <li>• Tipe diskutimesh në grupe të fokusuara me fëmijët</li> </ul>
Zhvillimi i shfaqjeve teatrale ku përfshihen gratë dhe mësuesit dhe që shënjestrojnë fëmijët	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i shfaqjeve teatrale</li> <li>• Numri i fëmijëve të arritur</li> <li>• Si është parë shfaqja prej fëmijëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes fëmijëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutime dhe intervista me ata që janë përfshirë në prodhimin e shfaqjes dhe me ata që e kanë parë</li> <li>• Skenari i teatrit, raport i aktivitetit mbi shfaqjen</li> </ul>
Prodhimi i materialeve mbështetëse për fëmijët që të shpërndahen dhe përdoren pas shfaqjeve teatrale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri dhe tipi i materialeve të prodhuara nga gratë</li> <li>• Numri i njerëzve të arritur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes fëmijëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raport statistikor mbi materialet e prodhuara dhe të shpërndara</li> <li>• Tipe diskutimesh në grupe të fokusuara me fëmijët</li> </ul>
Mblidhen ide nga komuniteti dhe dizajnohen, testohen në terren dhe prodhohen materiale shtesë për secilin nga grupet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Niveli i përfshirjes së komunitetit</li> <li>• Numri dhe tipi i materialeve të prodhuara</li> <li>• Numri i njerëzve të arritur</li> <li>• Si janë parë këto materiale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes grupeve të shënjestruara</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vëzhgim dhe monitorim i komunitetit</li> <li>• Materialet e prodhuara</li> </ul>



AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	TREGUESIT E PASOJAVE	MËNYRAT E VERIFIKIMIT
Takime me shoqatat e veteranëve për të diskutuar problemet dhe zgjidhjet, dhe për të përfshirë këto organizata në konkurset dhe ekspozitat e organizuara prej fëmijëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i takimeve me veteranët</li> <li>Tipi dhe numri i aktiviteteve të organizuara prej veteranëve për adoleshentët</li> <li>Numri i adoleshentëve të arritur</li> <li>Si janë parë këto aktivitete prej adoleshentëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes adoleshentëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi që veteranët i bëjnë aktiviteteve të tyre</li> <li>Takime vazhdimësie me veteranët, gratë dhe mësuesit</li> <li>Tipe diskutimesh në grupe të fokusuara me adoleshentët</li> </ul>
Zhvillimi i tre spoteve për radion që shënjestrojnë fëmijët, adoleshentët dhe ish-luftëtarët mbi rreziqet e AVL	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i spoteve në radio/television që janë prodhuar</li> <li>Numri i transmetimeve dhe koha e transmetimeve</li> <li>Numri i njerëzve të arritur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes atyre që kanë parë/dëgjuar mesazhet mediatike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raporte nga media mbi transmetimin e spoteve në radio/television</li> <li>Pyetësorë</li> </ul>
Zhvillimi i një radionovele duke mbledhur idetë nga komuniteti	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i njerëzve të komunitetit të përfshirë në zhvillimin e radionovelës</li> <li>Numri i transmetimeve</li> <li>Numri i njerëzve të arritur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes atyre që kanë parë/dëgjuar mesazhet mediatike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raporte nga media mbi transmetimin e spoteve në radio/television</li> <li>Pyetësorë</li> </ul>
Takime me OJQ-të për të rënë dakort mbi aktivitetet, mesazhet dhe materialet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i takimeve me OJQ-të dhe planet mbi të cilat është rënë dakort</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndonjë ndryshim në politikën apo praktikën e OJQ-ve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raport i aktiviteteve të organizatave të tjera mbi planet e veprimit dhe aktivitetet e kryera</li> </ul>

**OBJEKTIVI 2: TË NDRYSHOHET PERCEPTIMI I KOMUNITETIT PËR AVL SI NJË BURIM SIGURIE APO, VEÇANËRISHT PËR BURRAT DHE DJEMTË, SI STATUS**

<b>Përmbledhja e strategjisë së planifikuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani i Komunitetit më të Sigurtë si me burrat dhe me gratë për të gjetur zgjidhje alternative për të përmirësuar sigurinë në komunitet; Plan i Komunitetit më të Sigurtë me burrat për të trajtuar temën e djemve adoleshentë që mbajnë armë; Plan i Komunitetit më të Sigurtë që vendos theksin mbi grupet e fokusit për të përfshirë gratë në krijimin e mesazheve për fëmijët dhe burrat</li> <li>Radionovelat do të lidhen me aktivitetet e komunitetit për të mbështetur Planin e Komunitetit më të Sigurtë</li> <li>Materiale mbështetëse do të prodhohen duke reflektuar idetë dhe nevojat e secilit grup</li> <li>Mesazhe të Edukimi mbi Rreziqet/Advokimin do të koordinohen me OJQ-të lokale</li> <li>Zhvillimi i një kurrikule me drejtuesit fetarë. Prodhimi i materialeve për të mbështetur aktivitetet e tyre</li> </ul>
---	--





<p><b>Shembuj të mesazheve bazë</b></p>	<p><b>Të rriturit (burra, gra)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Armët janë të rrezikshme dhe ato destabilizojnë komunitetin dhe vendin tuaj</li> <li>• Ato po krijojnë dhunë nëpër komunitete dhe po stimulojnë krimin</li> <li>• Ndhimoheni komunitetin tuaj për ta bërë fshatin më të sigurtë; cilat janë zgjidhjet?</li> </ul> <p><b>Gratë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Armët në shtëpi mund të vrasin fëmijën tuaj apo të shkatërrojnë të ardhmen tuaj. Ato përdoren shpesh në mënyra të dhunshme ndaj grave</li> <li>• Beteja për një jetë më të mirë fitohet pa armë</li> <li>• I thoni fëmijëve tuaj se prekja/loja me një armë mund të vrasë ata dhe do t'ju dëshpërojë shumë</li> </ul> <p><b>Drejtuesit fetarë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ju keni një rol jetësor për të luajtur në ngritjen e sensibilizimit të njerëzve për rreziqet e AVL</li> <li>• I thoni burrave dhe djemve adoleshentë që ti mbajnë armët larg fëmijëve; të jenë një shembull për gjeneratat më të reja</li> </ul>
---	--

**OBJEKTIVI 2: TË NDRYSHOHET PERCEPTIMI I KOMUNITETIT PËR AVL SI NJË BURIM SIGURIE APO, VEÇANËRISHT PËR BURRAT DHE DJEMTË, SI STATUS**

AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	TREGUESIT E PASOJAVE	MËNYRAT E VERIFIKIMIT
Diskutime me nëngrupet (burra dhe gra) brenda komunitetit për të gjetur zgjidhje të përshtatshme për të ulur nivelin e kriminalitetit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i diskutimeve me secilin nga nëngrupet dhe numri i pjesëmarrësve</li> <li>• Tipet e zgjidhjeve alternative të identifikuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tipi dhe numri i aktiviteteve të zbatuara nga çdo nëngrup për të ulur kriminalitetin në komuniteti</li> <li>• Standartet në numrin e aktiviteteve kriminale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Intervista me gratë, burrat dhe drejtuesit fetarë në komunitet</li> <li>• Raportet nga policia mbi aktet kriminale</li> <li>• Diskutime me antarët e policisë</li> <li>• Tipe diskutimesh në grupe të fokusuara me burrat dhe gratë</li> </ul>
<p>Diskutime me gratë mbi tipet e mesazheve dhe aktiviteteve që duhet ti jepën burrave. Prodhimi i materialeve mbështetëse.</p> <p>Mblidhni ide nga gratë mbi tipin e materialeve që duhen prodhuar dhe përfshirja e tyre në dizejnimin dhe prodhimin e materialeve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Niveli i pjesëmarrjes së grave</li> <li>• Numri dhe tipi i materialeve dhe aktiviteteve të prodhuara</li> <li>• Numri i burrave të arritur</li> <li>• Si janë parë këto materiale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tipi dhe numri i aktiviteteve të zbatuara nga çdo nëngrup për të ulur kriminalitetin në komunitet</li> <li>• Standartet në numrin e aktiviteteve kriminale</li> <li>• Standartet në numrin e vdekjeve dhe plagosjeve të lidhura me AVL</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raporte statistikore mbi materialet e prodhuara dhe shpërndara</li> <li>• Intervista me gratë, burrat dhe drejtuesit fetarë</li> <li>• Raporte nga policia mbi aktet kriminale</li> <li>• Diskutime me anëtarët e policisë</li> <li>• Materialet e prodhuara</li> </ul>
Takime me agjensitë e rëndësishme për të diskutuar problemin e AVL në komunitet dhe për të kërkuar veprime përmirësuese.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i takimeve me agjensi të tjera mbi problemet dhe planin e veprimit për të cilin është rënë dakort</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndonjë ndryshim në politikën apo praktikën e agjensive të tjera</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raportet e aktiviteteve nga agjensitë e tjera</li> </ul>
Diskutime me drejtuesit fetarë dhe zhvillimi i një kurrikule. Kurse trajnimi për drejtuesit fetarë gjatë të cilëve do të bihet dakort për materialet mbështetëse. Prodhimi i këtyre materialeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i drejtuesve fetarë të trajnuar dhe përfshirë në aktivitete</li> <li>• Tipi dhe numri i aktiviteteve dhe materialeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prova të ndryshimit në sjellje mes drejtuesve fetarë në mënyrën sesi ata i trajtojnë AVL-të</li> <li>• Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes komuniteteve në përgjithësi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raporte statistikore mbi materialet e prodhuara dhe shpërndara</li> <li>• Monitorimi nga drejtuesit fetarë</li> <li>• Intervista të grave, burrave dhe drejtuesve fetarë</li> </ul>



OBJEKTIVI 3: MBËSHTETJA E AMNISTISË DUKE NGRITUR SENSIBILIZIMIN MBI RREZIQET E AVL PËR TË INKURAJUAR DORËZIMIN E AVL			
<b>Përmbledhja e strategjisë së planifikuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mesazhet e Advokimi për AVL do të shpërndahen në gjithë vendin, për të informuar njerëzit rreth amnistisë dhe për të inkurajuar dorëzimin e armëve</li> <li>Aktivitetet advokimi do të zhvillohen për të rritur sensibilizimin e njerëzve rreth rreziqeve të AVL; mesazhe për të inkurajuar komunitetet që të dorëzojnë armët</li> <li>Spote televizive do të prodhohen duke u fokusuar mbi amnistinë dhe dorëzimin e armëve</li> <li>Materiale mbështetëse do të prodhohen duke reflektuar idetë dhe nevojat e secilit grup</li> </ul>		
<b>Shembuj të mesazheve bazë</b>	<p><b>Të rriturit (burra, gra)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Armët janë të rrezikshme dhe ato destabilizojnë komunitetin dhe vendin tuaj</li> <li>Ato po krijojnë dhunë nëpër komunitete dhe po stimulojnë krimin</li> <li>Zgjidhni paqen dhe stabilitetin dhe inkurajoni komunitetin për të dorëzuar armët</li> </ul> <p><b>Gratë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Armët në shtëpi mund të rrezikojnë jetën dhe sigurinë tuaj. Ato mund të vrasin fëmijën tuaj dhe nganjëherë përdoren në mënyra të dhunshme ndaj grave</li> <li>Inkurajoni burrin, djemtë adoleshentë, dhe antarë të tjerë të komunitetit tuaj për të dorëzuar armët</li> </ul> <p><b>Media</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Spote Radiofonike dhe televizive: këtë vit, armët kanë vrarë XXX njerëz në vendin tuaj. Ndoshta dikush i afërm me ju, dikush që ju njihni?</li> <li>Ato do të vazhdojnë të vrasin nëse asnjë nuk bëhet për to. Ju lutem mbroni veten tuaj dhe familjen tuaj për të inkurajuar komunitetin tuaj për të dorëzuar armët, për një jetë më të sigurtë</li> <li>Qeveria do të sigurojë sigurinë dhe mirëqenien tuaj. Ndhimoheni qeverinë që t'ju ndihmojë juve</li> </ul>		
DETAJET E AKTIVITETEVE, MATERIALET DHE PËRDORIMI I MEDIAS	TREGUESIT E REZULTATEVE	TREGUESIT E PASOJAVE	MËNYRAT E VERIFIKIMIT
Takime me OJQ-të për të rënë dakort mbi aktivitetet, mesazhet dhe materialet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i takimeve me OJQ-të dhe plani i veprimit për të cilin është rënë dakort</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndonjë ndryshim në politikën dhe praktikën e OJQ-ve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raportet e aktivitetit nga OJQ-të e tjera dhe planet e veprimit</li> </ul>
Diskutime me burrat për të gjetur zgjidhje të përshtatshme mbi mbajtjen e armëve nga djemtë adoleshentë. Takime me burrat të cilët kanë dalë vullnetarë për të zbatuar aktivitetet që shënjestrojnë adoleshentët	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i takimeve me burrat dhe zgjidhjet mbi të cilat është rënë dakort</li> <li>Numri dhe lloji i aktiviteteve të zhvilluara nga burrat për adoleshentët</li> <li>Numri i adoleshentëve të arritur</li> <li>Si janë parë aktivitetet nga adoleshentët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes adoleshentëve</li> <li>Niveli i pjesëmarrjes në amnisti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Grup fokusi me burrat</li> <li>Intervjui s tinejdžerima</li> <li>Intervista me adoleshentët</li> </ul>
Plani i Komunitetit më të Sigurtë me gratë për ti përfshirë ato në shpërndarjen e informacionit për djemtë adoleshentë dhe burrat e tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tipi dhe niveli i aktiviteteve të zbatuara nga gratë me burrat dhe djemtë e tyre</li> <li>Sasia e informacionit të shpërndarë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes adoleshentëve</li> <li>Niveli i pjesëmarrjes në amnisti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Diskutime dhe intervista me gratë, burrat dhe adoleshentët</li> <li>Prova dokumentare të niveleve të pjesëmarrjes në amnisti</li> </ul>
Takime me mediat lokale dhe zhvillimi i spoteve radiofonike në nivel qendror. Zhvillimi i spoteve televizive mbi amnistinë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani i transmetimit të spoteve radiofonike dhe televizive</li> <li>Numri i njerëzve të arritur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prova të ndonjë ndryshimi në njohuritë, sjelljet, apo qëndrimin mes atyre që kanë parë apo dëgjuar transmetimet</li> <li>Niveli i pjesëmarrjes në amnisti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raportet e medias mbi transmetimet</li> <li>Prova dokumentare të niveleve të pjesëmarrjes në amnisti</li> </ul>



## 6 Testimi në terren

Testimi në terren i mesazheve, aktiviteteve dhe materialeve<sup>60</sup> dhe puna me median është një hap thelbësor i cili i lejon stafit të programit që të kontrollojë nëse mesazhet, aktivitetet dhe materialet janë të përshtatshme për kontekstin dhe të rëndësishme për publikun e shënjestruar. Të gjitha materialet dhe aktivitetet duhet që të testohen në terren dhe më pas të ripunohen sipas testimit, duke u bazuar tek rezultatet e testimit në terren. Metoda të ndryshme mund të përdoren që të testohen mesazhet,<sup>61</sup> materialet<sup>62</sup> dhe aktivitetet dhe duhet që të ndërmerren vetëm nga personeli i përfshirë në zbatimin e aktiviteteve për Sensibilizimit e AVL:

- Pyetësorët.
- Vëzhgimet.
- Seminaret me grupet e shënjestruara.
- Diskutimet në grup.
- Tavinat e rrumbullakëta.
- Shpërndarja e mësimëve tek grupet e shënjestruara nëse një manual trajnimi duhet që të testohet në terren.

Aspekte kyç që duhet të testohen në terren përfshijnë:<sup>63</sup>

### Mesazhet dhe materialet:

- A janë mesazhet teknikisht dhe kulturalisht korrekte?
- A është materiali tërheqës?
- A janë stili, paraqitja dhe tipi i materialeve tërheqës dhe interesantë?
- A janë imazhet dhe ilustrimet të qarta dhe të kuptuara saktësisht?
- A munden njerëzit të gjejnë një lidhje me imazhet dhe ilustrimet?
- A munden njerëzit të lexojnë dhe kuptojnë mesazhet e shkruara?
- A janë mesazhet e shkruara të sakta?
- A janë ato të ndjeshme ndaj kulturës?
- A munden njerëzit të kuptojnë lidhjen mes imazheve dhe fjalëve?
- Cila është rëndësia e mesazheve për jetët e përditshme të njerëzve?
- A kanë njerëzit ndonjë sugjerim për ndryshime?
- A ka ndonjë problem për të arritur tek grupe të ndjeshme, (psh. si mund të arrihen gratë në zona më tradicionale/rurale?)

<sup>60</sup> Shikoni Rishikimi dhe para-testimi i materialeve të komunikimit, 'Komunikimi në Programet e Sensibilizimit mbi Minat', Qendra Ndërkombëtare e Gjenezës për Çminimin Humanitar, 2002.

<sup>61</sup> Për më tepër informacion, shikoni Rishikimi dhe para-testimi imesazheve dhe materialeve, 'Përmirësimi në Programet e Sensibilizimit mbi Minat', Qendra Ndërkombëtare e Gjenezës për Çminimin Humanitar, 2002.

<sup>62</sup> Për më tepër informacion, shikoni Rishikimi dhe para-testimi i materialeve të komunikimit, 'Komunikimi në Programet e Sensibilizimit mbi Minat', Qendra Ndërkombëtare e Gjenezës për Çminimin Humanitar, 2002.

<sup>63</sup> Pjesërisht e marrë nga Udhëzime Ndërkombëtare për Edukimin mbi Sensibilizimin për Minat e tokës dhe Pajisjet e Pashpërthyer, UNICEF.



### Kutia 31: Testimi në terren në Shqipëri

Në Shqipëri, një program edukimi emergjent për Minat/UXO-t u zbatua në veri pas shpërthimit të konfliktit në Kosovë. Intervistat paraprake me gratë dhe burrat nga të gjitha grupet e moshave u ndërmorën për të mbledhur idetë për krijimin e fletëpalosjeve. Një projekt-draft i fletëpalosjes u prodhua më vonë dhe u tregua njerëzve në kampet e refugjatëve përpara se prodhohej, për të vlerësuar vlerën e saj. Njerëzit kishin nënvizuar më përpara nevojën për të treguar artikujt e rrezikshëm që mund të takoheshin në veri në vendit (municionet e grumbulluara) dhe të shtoheshin një shpjegim i shkurtër se çfarë ato ishin dhe rreziqet që lidheshin me to. Gjatë testimit në terren, njerëzit shprehën nevojën për të ilustruar rrezikun në një mënyrë më të qartë duke shtuar një shenjë pranë fotografisë së municioneve të grumbulluara. Stafi i programit bëri ndryshimet e nevojshme përpara se të bëhej prodhimi i plotë i fletëpalosjeve.

#### Aktivitetet:

- A janë materialet të rëndësishme për secilin nga grupet e shënjestruara?
- A janë ato të ndjeshme ndaj kulturës?
- A janë aktivitetet ndëraktive dhe interesante për njerëzit?
- A kanë njerëzit ndonjë sugjerim për ndryshime?

#### Një listë për tu plotësuar për testimin në terren të materialeve dhe mediave:<sup>64</sup>

- Studioni gjithë materialet dhe informacionin e rëndësishëm që keni në dispozicion.
- Përgatisni pyetësorët, materialet e testimit, format e vlerësimit etj.
- Trajtoni stafin.
- I prezantoni materialet tek grupi i shënjestruar.
- Vlerësoni përgjigjet.
- Analizoni dhe diskutoni gjetjet e bëra.
- Bëni korrigjime, shtesa dhe ndryshime të tjera të rëndësishme.
- Testoni në terren materialin e ndryshuar.
- Bëni ndonjë ndryshim të nevojshëm.
- Përsërisni dy hapat e fundit nëse është e nevojshme.

<sup>64</sup> E bazuar në Udhëzime Ndërkombëtare për Edukimin mbi Sensibilizimin për Minat e tokës dhe Pajisjet e Pashpërthyer, UNICEF.

## 7 Zbatimi i aktiviteteve

Pasi stafi i rëndësishëm të jetë trajnuar dhe aktivitetet e materialet të jenë përcaktuar, është e mundur që të fillojë programi. Mbani mend sidoqoftë që gjatë zbatimit të programit, është thelbësore të monitorohen aktivitetet sipas qëllimit dhe objektivave të vendosur gjatë fazës së planifikimit (Shikoni Seksionet 3.3, 3.5 dhe 8).

### 7.1 Plani i Komunitetit më të Sigurtë i rishikuar

Ashtu siç u tha edhe më lart, shpërndarja e materialeve dhe/ose leksioneve nuk janë të mjaftueshme për të ndryshuar sjelljet, është gjithashtu themelore që të përfshihen komunitetet në të gjithë procesin. Metoda e Planit të Komunitetit më të Sigurtë mund të përdoret si në programet e veçuara për Edukimin mbi Rreziqet e AVL dhe ndërhyrjet e mikro-çarmatimit në mënyrë që të përfshihen komunitetet në identifikimin e problemeve dhe zgjidhjeve të kërcënimeve nga AVL.

Një Plan i Komunitetit më të Sigurtë fillon me një vizitë një ditore tek komunitetet e shënjestruara (psh. një fshat apo një lagje e një qyteti). Zhvillohet një takim me drejtuesin e fshatit për të shpjeguar qëllimin e vizitës dhe qëllimet e programit dhe për të kërkuar mbështetje në punën me komunitetin. Më vonë organizohen takime me grupet e ndryshme të komunitetit dhe mblidhet informacion nga komuniteti nëpërmjet diskutimeve për të gjetur se cili është saktësisht problemi me AVL, se si ndikon tek jetët e njerëzve në rutinën e tyre të përditshme dhe tek aktivitetet e tyre sezonale, cilat janë nevojat e tyre dhe cilat janë zgjidhjet e identifikuar nga grupet në përgjigje të këtyre nevojave. Pasi të jetë krijuar besimi (për këtë mund të duhen disa vizita dhe shumë durim), pjesëmarrësit nga komuniteti përgatisin një profil të komunitetit të prekur nga AVL e parë nga një perspektivë AVL. Përmbytja zakonisht do të përmbyjë, megjithëse mund të mos mjaftohet me:

- a) një hartë që tregon se cilat pjesë të komunitetit janë të prekura nga shtimi i AVL;
- b) grupet kryesore të përfshira;
- c) shkaqet dhe modelet e vdekjeve dhe plagosjeve;
- d) njohuritë, sjelljet dhe qëndrimet e njerëzve;
- e) funksionin shoqëror të armëve dhe rregullat brenda komunitetit për përdorimin e armëve; dhe
- f) profilin e viktimave, profilin e përdoruesve.


Mbi bazën e profilit, mbahen diskutime për të zhvilluar Planin e Komunitetit më të Sigurtë. Fokusi do të vendoset tek ndryshimi i sjelljeve, identifikimi i sjelljeve të rrezikshme, efektet negative dhe shikimi për alternativa. Grupe specifike të shënjestruar më vonë identifikohen në lidhje me nevojat e komunitetit (nevojat identifikohen gjatë diskutimeve) dhe programe të Sensibilizimit të AVL zhvillohen me seicilin nga grupet sipas nevojave që ato kanë. Komunitetit i kërkohet të identifikojë një vullnetar i cili do të trajnohet në fillimin dhe/ose facilitimin e aktiviteteve të AVL. Ky person do të jetë përfaqësuesi i Sensibilizimit të AVL për komunitetin dhe do të vazhdojë zhvillimin dhe monitorimin e Planit të Komunitetit më të Sigurtë dhe aktiviteteve pasuese të Sensibilizimit të AVL në lidhje me nevojat specifike brenda komunitetit. Vullnetari duhet të jetë me eksperiencë, të jetë i njohur nga komuniteti dhe të ketë reputacion si i besueshëm. Më shumë se një vullnetar mund të caktohet nëse dinamikat e komunitetit e kërkojnë një gjë të tillë. Vullnetari dhe komuniteti do të mbështeten nga organizatat e interesuara gjatë zbatimit të zgjidhjeve të identifikuar. Do të jetë gjithashtu e rëndësishme që të organizohet një vazhdim i iniciativave nëpërmjet takimeve të rregullta me vullnetarët/përfaqësuesit e fshatit.

#### **Kutia 32: Integrimi me aktivitete dhe aktorë të tjerë**

Mbani mend, që të funksionojë Plani i Komunitetit më të Sigurtë duhet që të bashkëpunojnë organizata të ndryshme për të përbushur kërkesat e komunitetit në fjalë. Referojuni Seksionit 2.6.



Diagrama 5: Plani i Komunitetit më të Sigurtë si pjesë e ciklit të programit



### Kutia 33: Puna drejt Planit të Komunitetit më të Sigurtë në Maqedoni

Në Maqedoni, gjatë përgatitjes për një Amnisti kombëtare për AVL në Nëntor – Dhjetor 2003, aktivistët e OJQ-ve ndërmorën diskutime të bazuara në komunitet në zonat ku kishte pasur konflikt gjatë muajve përpara amnitisë. Sipas OJQ-ve partnere Pax Christi/Civil, banorët e fshatrave ishin relativisht të hapur dhe të interesuar për të folur rreth problemeve dhe nevojave të komunitetit përfshirë edhe shtimin e AVL – shumë më ndryshe nga ç’pritej. Strategjia e dyfishtë për të hapur diskutime duke pyetur komunitetet mbi problemet e tyre, në vend që ti jepeshin leksione, dhe ndërfutja e çështjes së AVL mes diskutimesh më të përgjithshme rreth çështjeve ekonomike, të sigurisë dhe politikës dolën mjaft të suksesshme. Në këtë rast, ekzistenca e një marrëveshjeje kombëtare për paqe (Marrëveshja për Paqe e Ohrit) paraqitën një fokus të gatshëm për diskutimet. Debatet u filluan fillimisht duke kontaktuar kryepleqtë e fshatrave dhe më vonë duke u takuar me ta për të ndërtuar një marrëdhënie dhe për të shpjeguar planet e OJQ-ve. Drejtuesit e komuniteteve më pas zakonisht do të caktonin një kontakt i cili do të siguronte takime të tjera dhe do të sigurohej për pjesëmarrjen. Gjatë diskutimeve stafi i OJQ-ve arriti të shpërndante pjesën më të madhe të informacionit rreth amnitisë së ardhshme për AVL dhe për të ndezur debatet e komunitetit mbi pro-të dhe kundra-t e çarmatimit. Gjithashtu, pasi kontaktoi Autoritetin kombëtar të AVL, forcat e sigurisë së EUFOR dhe OJQ të tjera që punonin me problemet e besueshmërisë dhe paqebërjes, aktivitetet dhe planet e punës së Pax Christi/Civil mund të koordinoheshin më mirë. UNDP Maqedoni tani shpreson të ndjekë rrugën e punës së organizatave si Pax Christi/Civil dhe të punojë me Autoritetin Kombëtar të AVL dhe njerëzit lokalë për të zhvilluar Planin e Komunitetit më të Sigurtë gjatë 2004.

Burimi: Intervistë me Kristina Naceva, Pax Christi, 29 Shtator 2003

## 7.2 Aktivitete për fëmijët

Të punosh me fëmijët është zakonisht më e lehtë se të punosh me të rriturit; fëmijët janë zakonisht të motivuar dhe tregojnë interes për të mësuar dhe për të ndërmarrë aktivitete të reja. Sidoqoftë, që fëmijët të jenë të aftë



të mësojnë dhe të ruajnë mesazhet rreth AVL, është jetësore që ata të marrin pjesë në aktivitete. Përdorimi i metodave ndëraktive si për shembull konkurset, kuizet, shfaqet teatrale dhe me kukulla, vizatimet dhe lojrat janë thelbësore për të transferuar mesazhe këshilluese dhe informacione.

Ashtu si me të gjithë grupet e shënjestruara, mesazhet dhe materialet për fëmijët duhet të jenë specifike për nevojat dhe rrethanat e tyre. Duke përdorur materiale dhe aktivitete të aksesueshme të cilat i lejojnë fëmijëve të eksplorojnë lidhjet mes AVL dhe çështjeve të tjera ka shumë mundësi që të përmirësojë ruajtjen e mesazheve bazë. Ka qenë shpesh efektive përdorimi i një karakteri lokal të mirënjohur për të shpërndarë këshillat tek fëmijët nëpërmjet teatrit, librave komikë, posterat dhe materialet të ngjashme nëpër shkolla. Një listë jo gjithëpërfshirëse e aktiviteteve që mund të ndërmerren me fëmijët mund të përfshijë:

- Mediat tradicionale (psh. teatri në komunitet, tregimi i historive, këngët dhe vallet).
- Prezantimet (psh. leksionet, dramet, këngët, materialet audio-vizuale dhe grafike).
- Konkurset dhe kuizet shkollore.
- Shfaqjet teatrale dhe me kukulla.
- Diskutimet fëmijë më fëmijë apo fëmijë me të rritur.
- Lojrat, shfaqet me role, vizatimet.
- Vende të sigurta të lojës – dhënia e alternativave të sigurta në vend të luajtjes me/rreth AVL.
- Përdorimi i materialeve: librat komikë, posterat, fletëpalosjet, stikerat (letrat ngjitëse), stilolapsat, paketat ushqimore etj.
- Përdorimi i mediave: video, spote dhe programe televizive.
- Njerëzit e famshëm, figura të mirënjohura publike, aktivistët e paqes.

Në varësi të sjelljeve dhe nivelit të njohurisë të gjetur mes fëmijëve të shënjestruar, mesazhe të ndryshme mund të duhen që të përpunohen për vajzat dhe djemtë. Sidoqoftë, ashtu si edhe u shpjegua më lart në Seksionin 5 mesazhet e transmetuara tek fëmijët gjatë aktiviteteve duhet gjithmonë që të vendosin theksin tek shprehja 'mos prek'. Stafi i programit mund të vendosi gjithashtu që të përdorë fëmijët si një vektor për të shpërndarë informacionin tek moshatarët e tyre apo tek të rriturit nëpërmjet aktiviteteve si psh. edukimi 'nga fëmija tek fëmija'.

#### **Kutia 34: Disa pika që duhen mbajtur mend kur punohet me fëmijët**

1. Në mënyrë që të vendoset theksi tek mesazhi 'mos prek' për fëmijët, është e rëndësishme të mos mbahen armët, municionet apo eksplozivë kur tentojmë ti edukojmë ata rreth rreziqeve. AVL fallco, duke përfshirë edhe minat, gjithashtu nuk duhet të preken. Është më mirë që kur përdoren modele demonstruese që ato të mbahen brenda kutive transparente plastike.
2. Mbani mend që të veproni me kujdes kur punoni me fëmijët. Ata tremben me shumë lehtësi nga teprica e informacionit negative dhe mund të bëhën shumë të frikësuar nëse shumë theks vendoset tek rreziqet personale për ta. Sigurohuni që të bëni pushime të rregullta, përzieni mesazhe dhe aktivitete të kënaqshme me ato negative, dhe shikoni me kujdes që të jeni të sigurtë se ata nuk po frikësohen apo nuk po mbingarkohen me informacion.
3. Ndikimi më i madh në të mësuarin e të gjithë fëmijëve nuk është shkolla, por jeta e tyre në familje. Për këtë arsye është thelbësore që të mos lihen pas dore prindërit si një grup i shënjestruar për të maksimizuar shanset që mesazhet që i transmetohen fëmijëve të përforcohen në vend që të anashkalojnë apo kundërshtohen në shtëpi.



### 7.3 Aktivitete për të rriturit

Puna me të rriturit është shpesh më sfiduese sesa puna me fëmijët. Kjo është veçanërisht e vërtetë me grupe si mbajtësit e armëve dhe ish-luftëtarëve të cilët përgjithësisht mendojnë se tashmë dinë gjithçka rreth problemeve të AVL dhe rreth sjelljeve të sigurta për tu praktikuar. Fitimi i respektit të të rriturve, duke provuar se njohuria juaj mbi çështjet dhe mbi rrethanat lokale në mënyrë që të krijohet besueshmëria mundet shpeshherë të jetë e vështirë dhe t'ju konsumojë shumë kohë. Prandaj trajnimi dhe përgatitja e duhur (ashtu si edhe me fëmijët) është thelbësor. Në shumë raste kualifikimet, seksi, mosha dhe etnia e punonjësve në terren do të jetë gjithashtu një faktor thelbësor për tu marrë në konsideratë dhe duhet marrë parasysh gjatë rekrutimit.

Sidoqoftë, shumë prej konsideratave që janë të vlefshme për fëmijët janë gjithashtu të rëndësishme kur trajtohen të rriturit. Për shembull, zhvillimi i aktiviteteve ndëraktive për të rriturit është një mënyrë jetësore për ti përfshirë ata. Shënjestrimi i prindërve dhe të rriturve të tjerë (veçanërisht i viktimave të shpërdorimit të AVL) është i rëndësishëm sepse ata mund të jenë një vektor për të shpërndarë informacionin tek të rriturit e tjerë dhe tek fëmijët. Të rriturit mundet gjithashtu të përfshihen në ndërhyrjet që shënjestrojnë adoleshentët dhe fëmijët duke filluar dhe organizuar aktivitete sensibilizimi. Një listë jo gjithëpërfshirëse e aktiviteteve që janë të përshtatshme për të rriturit mund të përfshirë të mëposhtmet:

- Diskutime në grup.
- Takime, tavolina të rrumbullakta.
- Hartimi i komunitetit.
- Mediat tradicionale (psh. teatri i komunitetit, tregimi i historive, këngët dhe vallet).
- Prezantimet (psh. leksionet, dramet, këngët, materialet audio-vizuale dhe grafike).
- Grupe Fokusi
- Ngjarje sportive dhe kulturore
- Ekspozitat dhe ngjarje të tjera të komunitetit.
- Prodhimi dhe/ose përdorimi i materialeve dhe mediave (psh. prodhimi i një dokumentari që përfshin histori të vërteta).
- Pjesëmarrja në programet lokale të televizionit/radios, artikujt e gazetave mbi çështjet e AVL.
- Organizimi dhe vazhdimi i aktiviteteve për grupe të tjera psh. gratë i përgatisin për burrat apo fëmijët; ish-luftëtarët/burrat i përgatisin për djemtë adoleshentë.
- Përdorimi i aktivistëve të paqes; persona të njohur nga zona, njerëz të njohur ndërkombëtarë etj.
- Përdorimi i shërbimeve publike (psh. autobuzët publikë) për të transmetuar mesazhet e sigurisë.





## 8 Monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve dhe materialeve

Kjo pjesë e PMSA përqëndrohet në çështjen themelore të monitorimit dhe vlerësimit të impaktit të programeve të Sensibilizimit të AVL. Përkufizon qëllimin kryesor të sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit (M&V) të programit të Sensibilizimit të AVL si:

*“Të sigurojë nëse ato grupe të përfshira brenda një programi të Sensibilizimit të AVL kanë, si rezultat i një ndërhyrjeje, ndryshuar sensibilizimin dhe qëndrimet e sjelljet ndaj AVL, sipas objektivave të caktuara të programit.”*

Monitorimi dhe vlerësimi janë të dyja forma të mbledhjes së informacionit. Ato përfshijnë teknika të njëjta, të cilat mund të përmbliidhen duke përfshirë katër metoda:

- a) pyetsorët dhe anketimet për gjetjen e informacionit;
- b) intervistat dhe diskutimet në grupe fokusi;
- c) teknikat pjesëmarrëse; dhe
- d) analizat e provave nga burimet dytësore.<sup>65</sup>

M&V është një pjesë përbërëse e ciklit të programit. Siç është përshkruar në Seksionin 3, është thelbësore që të vendosen sistemet e M&V gjatë fazës së planifikimit të çdo programi. Një dallim i dobishëm mes monitorimit dhe vlerësimit mund të bëhet si më poshtë:

Tabela 16: Dallimi mes monitorimit dhe vlerësimit

	ÇFARË NËNKUPTON	KUR NDODH GJATË CIKLIT TË PROGRAMIT
<b>Monitorimi</b>	Kontrollimi i progresit drejt përbushjes së objektivave, në mënyrë që të identifikohet se çfarë po funksionon dhe çfarë nuk funksionon dhe aq mirë, duke lejuar një nivel adaptueshmërie në strategjinë dhe taktikat ashtu siç është e nevojshme.	Bëhët gjatë gjithë programit
<b>Vlerësimi</b>	Një process më formal dhe më i strukturuar i rishikimit të arritjeve, në mënyrë që të bëhen gjykime rreth efektivitetit të deritanishëm dhe për të mësuar nga eksperiencia për të përmirësuar praktikën në të ardhmen.	Në kohë të caktuara – për projekte që zgjasin më shumë se 18 muaj, kjo të do përfshinte normalisht një rishikim në mes të afatit programor ashtu edhe një vlerësim i kryer në përfundim të projektit.

### 8.1 Zhvillimi i një përqsasjeje të integruar

Çdo kornizë M&V duhet të zhvillohet në lidhje me objektivat e vendosura brenda programit. Kundrejt këtyre objektivave, matës kyç të progresit drejt arritjes së objektivave (treguesit) duhet që të identifikohen, ashtu si edhe burimet e informacionit (mënyrat e verifikimit) që mund të përdoren për të bërë vlerësimin (Shikoni Tabelën 15 në Seksionin 5.8 për shembuj se si treguesit mund të lidhen me mesazhet, aktivitetet dhe materialet).

Sistemet e M&V, treguesit dhe mënyrat e verifikimit duhet të vendosen në të njëjtën kohë që janë vendosur objektivat e programit (psh. në fillim të programit të Sensibilizimit të AVL). Vetëm atëherë do të jetë e mundur të mblidhen të dhënat që nevojiten.

Përfitimet e një përqsasjeje të tillë të integruar janë që:

- a) nëse sistemet M&V fiksohen që në fillim, të dhënat bazë mund të mblidhen, duke e bërë shumë më të lehtë vlerësimin e progresit në kohë dhe për të matur çfarë ka ndryshuar si rezultat i një ndërhyrjeje të veçantë. Nëse një Anketë kombëtare për AVL ndërmerret dhe përditësohet, disa të dhëna do të jenë

<sup>65</sup> Teknika të ngjashme mund të përdoren gjithashtu në fazat e zhvillimit dhe planifikimit të një ndërhyrjeje – shikoni Seksionin 3 dhe në vijim.



tashmë të gatshme për aktivistët e programit për qëllimet e M&V;<sup>66</sup>

- b) mbledhja e informacionit gjatë gjithë zgjatjes të programit paraqet një rast për mësim të vazhdueshëm dhe për të testuar logjikën dhe efektivitetin e një përqasjeje të veçantë në një bazë të vazhdueshme;
- c) çdo problem dhe dobësim brenda programit që është vendosur mund të dalë në dritë dhe të trajtohet – programi mund të adaptohet sipas gjetjeve të bëra dhe përqasjeve të ndryshme mund të adoptohen atje ku është e vlefshme dhe e përshtatshme;
- d) vlerësimi mund të ndihmojë facilitimin e procesit të mësimin nga gabimet dhe gjithashtu për të identifikuar shembujt e praktikave të mira dhe për të tërhequr vëmendjen drejt iniciativave të suksesshme të cilat mund të përsëriten në vende të tjera; dhe
- e) nëpërmjet mbledhjes, analizimit dhe interpretimit të informacionit, një kuptim më i mirë i mjedisit operacional mund të arrihet; kur planifikohen aktivitete të Advokimit, raportet vlerësuese mund të jenë një mjet për të tërhequr vëmendjen tek çështjet apo situatat e veçanta (për shembull duke inkurajuar gjetjet e bëra nga OJQ të tjera që punojnë në zonë).

#### Kutia 35: Monitorimi për programin ‘Për Një të Nesërme më të Mirë’ në Maqedoni

Programi i Sensibilizimit të AVL ‘Për një të Nesërme më të Mirë’ i drejtuar nga UNDP Maqedoni përdori një kombinim të teknikave të medias, punës me komunitetet lokale dhe dialog në nivel qeveritar në mbështetje të Mbledhjes së AVL që zgjati 45 ditë në Nëntor-Dhjetor 2003. Spote televizive dhe radiofonike, lajmërimi në gazeta, fletëpalosje, stampa, postera, koncerte, karvanë dhe marshime u përdorën të gjitha për të përçarur mesazhet e programit. Në nivel komuniteti u krijuan 123 komisione lokale në bashkëpunim me shtatë OJQ të ndryshme, stafi i të cilave krijoi aktivitetet dhe grupet e diskutimit që të fillonin drejt Planit të Komunitetit më të Sigurtë. Një numër sistemesh të ndryshme monitorimi u krijuan. Struktura kombëtare e komisioneve siguroi një rrjedhje të rregullt të informacionit për stafin e programit ndërsa Agjensia Maqedonase e Informacionit dhe ndihmesën e saj me monitorimin e medias dhe Gallup ndërmori anketime tremujore të opinionit publik.

*Burimi: Korrespondencë me Alain Lapon, UNDP SACIM Oficer i Sensibilizimit të Publikut.*

## 8.2 Nivelet e vlerësimit

Siç u përmend edhe më sipër, sistemet e M&V duhet që të zhvillohen në lidhje me objektivat e vendosura brenda programit. Kjo mund të kërkojë që programi të konsiderohet në një sërë nivelesh të ndryshme:

Tabela 17: Nivelet e vlerësimit

NIVELI VLERËSIMIT	QËLLIMI	PYETJET THEMELORE QË DUHET TË TRAJTOHEN
<b>Aktivitetet</b>	Të vlerësohet niveli në të cilin programi është organizuar dhe burimet janë përdorur më eficientë më të madhe.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A janë mesazhet që po promovohen ato të duhurat?</li> <li>• A po arrihen njerëzit e duhur prej mesazheve që po promovohen?</li> </ul>
<b>Rezultatet</b>	Të identifikohen ndryshimet në njohurinë, qëndrimet dhe praktikave që mund të atribuohen arsyeshëm në program mes grupeve të ndryshme të shënjestruar.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A ka ndonjë shenjë që njohuritë, qëndrimet dhe besimet janë duke ndryshuar?</li> <li>• A ka ndonjë shenjë të ndryshimit në praktikë apo sjellje?</li> </ul>

<sup>66</sup> Kudo që ekziston një Anketim kombëtar për AVL, aktivistët e Sensibilizimit të AVL do të kenë akses të hapur tek një sferë e madhe informacioni në lidhje me shpërndarjen, efektet dhe perceptimet shoqërore mbi AVL. Meqënëse anketimi do të jetë ndërmarrë përpara ndërhyrjeve kombëtare për mikro-çarmatimin ajo do të paraqesë të paktën disa të dhëna bazë. Nëse Anketimi kombëtar përditësohet rregullisht, ajo do të paraqesë gjithashtu informacion mbi ndryshimet që kanë ndodhur gjatë ndërhyrjes.



NIVELI VLERËSIMIT	QËLLIMI	PYETJET THEMELORE QË DUHET TË TRAJTOHEN
<b>Impakti</b>	Të eksplorohet se si një program i veçantë ndërhyrës mund të ketë shaktuar një ndryshim aktual dhe të qëndrueshëm në jetët e grupeve specifike të njerëzve, për shembull në termat e niveleve të përmirësuar të sigurisë fizike?	<ul style="list-style-type: none"> <li>Cili ka qenë impakti i ndërhyrjes, në termat e ndryshimit të situatës së sigurisë, uljen e viktimave, etj.?</li> </ul>

Shpesh objektivat e ndryshëm programorë do të shtrihen përgjatë të tre niveleve, por me shumicën e programeve afatmesme, është më me vend të shikohet se cilat rezultate janë arritur.

### 8.3 Mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e zbulimeve: një përfaqje pjesëmarrëse

- Meqënëse informacioni i marrë mbi efektivitetin e programit do të vijë fillimisht nga komunitetet e ndikuara, është jetësore që ata të cilët zhvillojnë programe për Sensibilizimin e AVL të përfshijnë përfaqësues nga këto komunitete për të krijuar kornizën e M&V. Atje ku sistemet e M&V nuk janë zhvilluar në lidhje me komunitetet lokale të ndikuara si pjesë e një procesi më të gjerë të vazhdueshëm përfshirjeje, ka shumë të ngjarë që cilësia e informacionit të mbledhur të jetë shumë e dobët;
- Në mbledhjen dhe analizimin e informacionit, ata që zbatojnë programet do të kenë nevojë të dëgjojnë me shumë kujdes perspektivat e të tjerëve dhe duhet të jenë të përgatitur të i interpretojnë informacionin në mënyrë objektive, edhe pse, ose ndoshta veçanërisht kur, të dhënat dhe informacioni i mbledhur nuk korrespondon me pikëpamjen e tyre dhe eksperiencat e tyre;
- M&V ka një rol shumë të rëndësishëm për të luajtur në forcimin e partneriteteve mes organizatave zbatuese dhe komuniteteve lokale, dhe mes organizatave zbatuese dhe agjensive dhe institucioneve aktive nëpër komunitetet e rëndësishme. Një funksion kyç i vlerësimit është qenia e sigurtë se të gjithë këta aktorë të ndryshëm të kenë një shans për të shprehur opinionet dhe vlerësimet e tyre mbi aktivitetet e agjensisë zbatuese si dhe mbi pasojat e këtyre aktiviteteve;
- M&V nuk ka të bëjë vetëm me informacionin e mbledhur dhe me analizimin e tij; në mënyrë më thelbësore ka gjithashtu të bëjë shumë me shpërndarjen e informacionit. Prandaj sistemet duhet të krijohen që nga fillimi jo vetëm për të qenë të aftë të mësojmë nga zbulimet e bëra brenda programit por edhe për të komunikuar rezultatet me të tjerë që do të përfitonin nëse do të merrnin këtë informacion. Ky parim është i aplikueshëm si për aktivistët e Sensibilizimit për AVL ashtu edhe për Autoritetet kombëtare të AVL të cilat duhet të monitorojnë dhe vlerësojnë iniciativat për mikro-çarmatimin që ata koordinojnë, dhe që ti bëjnë rezultatet publike ashtu siç kërkohet për rezultatet e Anketimit kombëtar për AVL; dhe
- Vlerësimi është një mjet kyç për të përforcuar përgjegjësinë përpara të interesuarve, duke përfshirë edhe përfituesit e synuar, donatorët dhe organizatat partnere.

### 8.4 Një kuadër i thjeshtë për monitorimin dhe vlerësimin: zgjedhja e mjeteve të verifikimit

Një parim kyç i vlerësimit është se sistemet e M&V duhet të mbahen sa më të thjeshtë që të jetë e mundur. Vetëm gjërat e rëndësishme duhen matur, (jo domosdoshmërisht gjërat që janë të lehta për tu matur), për të ndihmuar në krijimin e një grupi provash që një program ka kontribuar në ndryshimet e njohurive, qëndimeve dhe sjelljeve të një individi dhe në varësi të strategjisë së programit, dhe gjithashtu ndryshime në politikat dhe praktikat institucionale.

Sidoqoftë, ka shumë pak të ngjarë që çfarëdo mjeti vlerësues i vetmuar do të paraqesë informacionin e kërkuar apo do të paraqitet i vetmuar pa asnjë lloj paragjykimi. Pothuajse në të gjitha rastet, një përzierje informacioni cilësor dhe sasior do të jetë e nevojshme:



Tabela 18: Krahasimi i informacionit cilësor me atë sasior

TIPI I INFORMACIONIT	SHEMBUJ TË TEKNIKAVE	KUR PËRDOREN	KOMENTE
<b>Cilësor</b>	Intervista dhe workshope, vëzhgime	Per të eksploruar qëndrimet, besimet, ndjenjat dhe sjelljet	Informacioni i mbledhur paraqet një kuptim më të thellë të situatës por është subjektiv dhe ka nevojë të interpretohet me shumë kujdes
<b>Sasior</b>	Pyetësorë dhe Anketime	Për të matur statistikisht opinionet apo të dhëna të tjera	Kur ndërmerret me korrektesë mund të mbledhi informacion nga grupe të gjera por shpesh jep vetëm një pamje sipërfaqësore të situatës së vërtetë

Një kuadër i thjeshtë për të identifikuar burime potenciale të informacionit paraqitet më poshtë (Shikoni gjithashtu Aneksat C dhe F):

Tabela 19: Burime potenciale të informacionit për verifikim

MËNYRAT E VERIFIKIMIT	KUR TË PËRDOREN	BURIMET QË NEVOJITEN
<b>Pyetësorë dhe anketime për gjetje informacioni</b>	Këto mund të përdoren për të mbledhur të dhëna statistike në lidhje veçanërisht me njohuritë, qëndrimet, praktikatat dhe sjelljet e grupeve të shënjestruara (si në anketën KAP të paraqitur në Aneksin C)	Kërkon një numër të madh punonjësish në terren dhe supervizim nga specialistët. Kostot mund të jenë shumë të larta nëse kërkohen të dhëna statistike të forta, por nëse mjaftojnë provat treguese, kostot ulen.
<b>Intervista dhe diskutime në grupe fokusi</b>	Teknika të tilla zbatohen më mirë për të eksploruar në një thellësi më të madhe kuptimin dhe ndjenjat rreth problemeve, zgjidhjeve, dhe progresit të arritur ashtu si edhe pengesat për arritjet e së ardhmes në grupet e shënjestruara	Kërkon përfshirjen e praktikuesve, të cilët janë të aftësuar në interpretimin e përgjigjeve dhe në analizimin e rezultateve. Kostot kanë tendencën të jenë të larta apo të mesme për shkak të natyrës kohë-intensive të përjasjes.
<b>Teknikat pjesëmarrëse</b> Këto do të përfshinin, për shembull: <ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime klasifikimi dhe shënimi</li> <li>Pamje dhe harta si një pikë fillimi për të stimuluar diskutimet në komunitet</li> <li>Historitë e treguara</li> </ul>	Zhvillimi dhe zbatimi i një Plani të Komunitetit më të Sigurtë varet nga pjesëmarrja e komunitetit; në këtë situatë në veçanti, do të jetë e rëndësishme të përdoren teknikat pjesëmarrëse për të ndihmuar vlerësimin se sa mirë po ecën projekti dhe masën në të cilën objektivat janë duke u arritur	Praktikuesit e aftësuar kërkohet që të përfshihen dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen e komunitetit. Kostot kanë tendencën të jenë të larta apo të mesme për shkak të natyrës kohë-intensive të përjasjes.
<b>Analizë e provave nga burime dytësore</b> Këto burime përfshijnë për shembull: <ul style="list-style-type: none"> <li>Statistika të viktimave dhe të dhëna të tjera të rëndësishme</li> <li>Studime akademike</li> <li>Raporte nga agjensi të tjera</li> <li>Analizë të informacionit se si media po paraqet çështjen e AVL, dhe se si kjo po ndryshon, nëse po ndryshon, me kalimin e kohës</li> </ul>	Informacionet e mbledhura brenda komunitetit të prekur mund të shtohen nga një sërë informacionesh dhe të dhënash të tjera të gatshme nga burime të tjera që mund të paraqesin sfond dhe kontekst të rëndësishëm	Varet nga burimet e përdorura dhe nga gadishmëria/gjetshmëria e tyre

## 8.5 Fuqitë dhe dobësitë e krahasuara të metodave të ndryshme të vlerësimit

Ashtu siç tregon tabela e mëposhtme<sup>67</sup>, përjasjet e ndryshme të përmbledhura më poshtë kanë secila pikat e tyre të forta dhe të dobëta. Për të ndihmuar bërjen e vlerësimit sa më informativ dhe të dobishëm që të jetë e mundur, është normalisht e rëndësishme që të krijohen një sërë mjeteve të ndryshme verifikimi. Gjykimet rreth ekuilibrit midis teknikave të ndryshme mund të bëhen sipas rëndësisë relative të kriterëve të ndryshme të vlerësimit të rradhitura më poshtë (psh. kur vlerësohet pjesëmarrja, më shumë theks i duhet vënë teknikave cilësore, por kur kërkohet vetëm shifra të thjeshta, fokusi do të bjerë mbi anketat dhe pyetsorët). Në të gjitha rrethanat, sidoqoftë, përjasja më e mirë është që të përfshihet një përzierje si e teknikave cilësore ashtu edhe e teknikave sasiore.

Table 20: Fuqitë dhe dobësitë e metodave të ndryshme të vlerësimit

KRITERET E METODAVE <sup>68</sup>	PYETËSORET	INTERVISTAT DHE GRUPET E FOKUSIT	TEKNIKAT PJESËMARRËSE
Mbulimi	E lartë	E mesme	E mesme
Përfaqësueshmëria	E lartë	E mesme	E mesme
Lehtësia në agregimin dhe sintetizimin e të dhënave	E lartë	E mesme	E mesme / E ulët
Aftësia për të kapur informacion cilësor	E ulët	E lartë	E lartë
Aftësia për të kapur proceset shkakësore	E ulët	E lartë	E lartë
Aftësia për të kuptuar proceset komplekse	E ulët	E mesme	E mesme
Aftësia për të kapur diversitetin në perceptime dhe për të nxjerrë në dritë pikëpamjet e grave dhe të grupeve në disavantazh	E ulët	E mesme / E lartë	E mesme / E lartë
Aftësia për të kapur impaktet e papritura apo negative	E lartë	E lartë	E lartë
Aftësia për të identifikuar dhe artikuluar nevojat e ndjera	E ulët	E lartë	E lartë
Niveli i inkurajuar i pjesëmarrjes	E ulët	E lartë	Shumë e lartë
Shanset për të rritur përgjegjshmërinë tek përfituesit e synuar	E ulët	E lartë	E lartë
Potencialët për të kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të grupeve të interesuara	E ulët	E lartë	Shumë e lartë

<sup>67</sup> E adaptuar nga [www.microfinancegateway.org/impact/method/tool1\\_2\\_1.doc](http://www.microfinancegateway.org/impact/method/tool1_2_1.doc)

<sup>68</sup> Kjo tabelë nuk tregon se si burimet dytësore i përmbushin kriteret, sepse në çdo rast përgjigjet do të ndryshojnë në varësi të faktit se cili është burimi i informacionit.



## Annexi A (Informativ) Terma dhe përkufizime

### A.1.1

#### advokimi

mbështetje publike, rekomandime apo publicitet pozitiv me synimin për të eliminuar, apo të paktën reduktuar, kërcënimin nga, dhe impaktin e AVL-ve.

### A.1.2

#### përfshirja e komunitetit

në kontekstin e AVL termi i referohet: një procesi të dizenuar për të vendosur nevojat dhe prioritetet e komuniteteve të prekura në qendër të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të kontrollit të AVL dhe sektorëve të tjerë.

Shënim: Përfshirja e komunitetit bazohet në një shkëmbim informacioni dhe përfshin komunitetet në procesin e vendim-marrjes në mënyrë që të vendosë prioritetet për kontrollin e AVL. Në këtë mënyrë kontrolli i AVL synon të jetë përfshirës, i fokusuar në komunitet dhe të sigurojë maksimumin e përfshirjes në të gjitha seksionet e komunitetit. Kjo përfshin planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e përbashkët të projekteve.

Shënim: Përfshirja e komunitetit gjithashtu punon me komunitetet për të zhvilluar strategji sigurie specifike dhe të përkohshme që promovojnë ndryshimet në sjellje të individëve dhe komunitetit. Kjo është dizenuar për të reduktuar impaktin e AVL mbi individët dhe komunitetet deri në kohën kur një rrezik i tillë të jetë eliminuar.

Shënim: Ky do të jetë një nga parimet më madhorë strategjike të mikro-çarmatimit.

### A.1.3

#### vlerësimi

një proces që synon të përkufizojë sa më sistematikisht dhe objektivistisht që të jetë e mundur meritën, vlerën, rëndësinë dhe impaktin e një ndërhyrjeje.

### A.1.4

#### mikro-çarmatimi

monitorimi, mbledhja, kontrolli dhe shkatërrimi përfundimtar i armëve të vogla, municioneve përkatës dhe eksplozivëve si dhe armët e lehta të luftëtarëve dhe shpesh edhe të popullatës civile. Përfshin zhvillimin e programeve të përgjegjshme për menaxhimin e armëve.

### A.1.5

#### monitorimi

në kuadrin e mikro-çarmatimit, termi i referohet: vëzhgimit të autorizuar nga personel i kualifikuar i terreneve, aktiviteteve apo proceseve pa marrë përgjegjësi për atë që po vëzhgohet. Kjo kryhet zakonisht për të kontrolluar konformitetin me ndërmarrjen, procedurat apo praktikat standarte dhe shpesh përfshin regjistrimin dhe raportimin e elementëve, dhe një ridrejtim të mundshëm të aktiviteteve.

### A.1.6

#### autoriteti kombëtar

në kuadrin e AVL, termi i referohet departamenteve të qeverisë(ve), organizatës(ave) apo institucionit(ve) në një vend që është ngarkuar me rregullimin, menaxhimin dhe koordinimin e aktiviteteve të AVL.



### A.1.7

#### informimi i publikut

informacion që shpërndahet apo publikohet me qëllimin kryesor për të mbajtur publikun plotësisht të informuar rreth termave të sakta të një ndërhyrjeje për AVL, duke fituar kështu mbështetjen dhe mirëkuptimin e tij.

Shënim: Në kuadrin e një ndërhyrjeje AVL, objektivi i informimit të publikut është që ta mbajë publikun plotësisht të informuar rreth termave ekzakta të asaj ndërhyrjeje.

Shënim: Informimi i Publikut është një përfaqje e mobilizimit të masave që shpërndan informacion mbi problemin e AVL.

Shënim: Në një situatë emergjente, për shkak të kufizimeve kohore dhe mungesës së të dhënave të sakta është mënyra më praktike për të komunikuar informacion mbi sigurinë. Në situata të tjera, Informimi i Publikut mund të mbështesë lidhjen/mbështetjen e komunitetit.

### A.1.8

#### faza e sensibilizimit

periudha e çdo programi për Sensibilizimin e AVL e cila integrohet me një skemë të mbledhjes apo regjistrimit të armëve dhe ndodh përpara fillimit aktual të amnistisë apo të fushatës së regjistrimit. Qëllimi i fazës së sensibilizimit është ‘sensibilizojë’ publikun mbi nevojën për dorëzimin apo për regjistrimin e armëve.

### A.1.9

#### Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL)

gjithë municionet vdekjeprurëse konvencionale të cilat mund të mbahen nga një luftëtar individual apo një makinë e lehtë, që gjithashtu nuk kanë nevojë për një kapacitet thelbësor logjistik dhe mirëmbajtjeje (përkufizimi i SEESAC).

Shënim: Nuk ekziston ndonjë përkufizim i gjithëpranuar për AVL. Një alternativë e zakonshme në vend të përkufizimit të SEESAC është ai i një raporti nga një panel ekspertësh të Kombeve të Bashkuara nga viti 1997, i cili konsideron AVL si armë me kalibër më të vogël se 100mm dhe përkufizon armët e vogla si ato që janë krijuar për qëllime personale, dhe armët e lehta si ato që janë krijuar për përdorim nga shumë persona që shërbejnë si një njësi. Prandaj armët e vogla përfshijnë revolverët, pistoletat vetë-mbushëse, pushkët, automatikët, pushkët e sulmit, karabinat, mitralozët e lehtë. Armët e lehta përfshijnë të mësipërmet gjithashtu edhe mitralozët e rëndë, lëshuesit e granatave, gjuajtësit e lëvizshëm kundër aeroplanëve, gjuajtësit e lëvizshëm kundër-tank, bazukat, gjuajtësit e lëvizshëm të raketave anti-tank dhe sistemet e raketave, gjuajtësit e lëvizshëm të sistemeve të raketave kundër-ajrore, dhe mortajat me kalibër më të vogël se 100mm. Municionet dhe eksplozivët e përdorur nga armët e vogla dhe të lehta bien gjithashtu nën termin “AVL” dhe përfshijnë plumbat për armët e vogla, predhat dhe raketat për armët e lehta, granatat kundër ushtrisë dhe kundër tankeve, minat e tokës, eksplozivët, dhe mbajtësit e lëvizshëm me raketa, apo predha për system veprimi unik kundër-ajrore apo kundër-tank.

### A.1.10

#### Advokimi AVL

një program aktivitetesh që synon të ngrejë problemet dhe çështjet e AVL me publikun e përgjithshëm, autoritetet, median, qeverinë dhe institucionet e tyre për të arritur ndryshime si një nivelin institucional ashtu edhe në nivelin individual.

Shënim: Këto tipe aktivitetesh gjithashtu përfshijnë fushata që vendosin theksin tek problemet dhe çështjet e AVL me qëllimin që të inkurajohen njerëzit për të dorëzuar armët. Kjo ndërmerret përgjithësisht si një mbështetje e programeve për mbledhjen e armëve.

### A.1.11

#### Sensibilizimi për AVL (programi)

një program aktivitetesh i ndërmarrë me qëllimin e përgjithshëm për të minimizuar, dhe atje ku është e mundur për të eliminuar, pasojat negative të kontrollit të papërshtatshëm të AVL duke ndërmarrë një kombinim të përshtatshëm të Edukimit mbi Rreziqet e AVL, Advokimit për AVL dhe fushatave të Informimit të Publikut të cilat punojnë së bashku në bashkëpunim me programet e ndërhyrjes shoqërore për të ndryshuar sjelljet dhe për të lehtësuar zgjidhjet e përshtatshme alternative për një periudhë afatgjatë.





**Shënim:** Kudo që ekzistojnë, objektivat operacionale të një iniciative për kontrollin kombëtar të AVL do të diktojnë tipin e përshtatshëm të aktiviteteve për Sensibilizimin e AVL.

**Shënim:** Sensibilizimi i AVL është një përjasje e mobilizimit masiv që shpërndan informacion mbi kërcënimet, çështjet dhe zgjidhjet e AVL. Mund të marrë formën e edukimit formal ose jo-formal dhe mund të përdorë teknikat e medias.

#### **A.1.12**

##### **Edukimi mbi Rreziqet e AVL**

një proces që promovon adoptimin e sjelljeve të sigurta nga grupet e rrezikuara dhe nga mbajtësit e AVL duke informuar njerëzit mbi rreziqet dhe kërcënimet e AVL dhe duke i edukuar ata rreth sjelljeve më të sigurta si alternativa.

**Shënim:** Edukimi mbi Rreziqet e AVL mund të zbatohet si një aktivitet i veçuar, në kuadrin ku nuk është duke u zbatuar një mbledhje armësh. Nëse do të krijohet një amnisti në një fazë të mëvonshme, aktivitetet e Edukimit mbi Rreziqet duhet të zbatohen për të arritur sigurinë e të gjithë aktorëve të përfshirë. Këto aktivitete do të lejojnë gjithashtu përbërës të tjerë të fushatës për Sensibilizimin e AVL të zbatohen me efikasitet, duke përdorur rjetet, sistemet dhe metodat e krijuara si pjesë e një programi për edukimin mbi rreziqet dhe duke adaptuar përmbajtjen në përputhje me të.

**Shënim:** Edukimi mbi Rreziqet e AVL është një përbërës esencial i kontrollit të AVL.

#### **A.1.13**

##### **anketa (Anketa AVL)**

një proces sistematik dhe logjik i përdorur për të përkufizuar natyrën dhe shtrirjen e shtimit dhe impaktit të AVL brenda një rajoni, kombi apo komuniteti në mënyrë që të japi të dhëna të sakta dhe informacion për një ndërhyrje të sigurtë, efektive dhe efikente nga një organizatë e përshtatshme.

#### **A.1.14**

##### **Anketa për Shpërndarjen e Armëve të Vogla (ASHAV)**

përbërësi i anketës së AVL që mbledh të dhëna mbi tipin, sasinë, pronësinë, shpërndarjen dhe lëvizjen e AVL brenda një vendi apo një rajoni, së bashku me një analizë të burimeve vendase të gatshme për t'ju përgjigjur problemit.

#### **A.1.15**

##### **Anketa për Impaktin e Armëve të Vogla (AIAV)**

përbërësi i anketimit të AVL që mbledh të dhëna mbi impaktin e AVL mbi komunitetin dhe zhvillimin shoqëror dhe ekonomik.

#### **A.1.16**

##### **Anketa për Perceptimin e Armëve të Vogla (APAV)**

përbërësi i anketimit të AVL që mbledh informacion sasior dhe cilësor, nëpërmjet grupeve të fokusit, intervistave, dhe anketave nëpër shtëpi, mbi qëndrimet e komunitetit lokal kundrejt AVL dhe ndërhyrjeve të mundëshme.

#### **A.1.17**

##### **Eksplzivët e Pashpërthyer (UXO)**

materiale eksplozive të cilët janë përgatitur, lidhur, bërë gati për shpërthim apo janë përgatitur në ndonjë mënyrë tjetër për përdorim apo që janë përdorur tashmë. Ato mund të jenë qëlluar, lëshuar, hedhur, apo projektuar po prapë ngelen të pashpërthyer për shkak të keqfunksionimit apo dizenjës ose për ndonjë shkak tjetër (Fjalorthi IMAS).

#### **A.1.18**

##### **Armët më Konkruese për Zhvillim (AKZH)**

lidhja direkte mes dorëzimit vullnetar të armëve të vogla dhe të lehta duke vënë në konkurim komunitetet në shkëmbim të një proporcioni për të cilin është rënë dakort të zhvillimit të infrastrukturës në shkallë të vogël nga ana e qeverisë vendore, një organizatë ndërkombëtare apo një OJQ.



#### **A.1.19**

##### **Armët në Shkëmbim të Zhvillimit (ASHZH)**

lidhja indirekte mes dorëzimit vullnetar të armëve të vogla dhe të lehta nga komuniteti si një shkëmbim i plotë për dhënjen e zhvillimit të qëndrueshëm të infrastrukturës nga ana e qeverisë vendore, një organizate ndërkombëtare apo një OJQ.

#### **A.1.20**

##### **Armët në Shkëmbim të Nxitësve (AKN)**

lidhja direkte mes dorëzimit vullnetar të armëve të vogla dhe të lehta nga komuniteti në shkëmbim të dhënjes së materialeve të përshtatshme nga ana e qeverisë vendore, një organizate ndërkombëtare apo një OJQ.



## Aneksi B

### Informacione rreth efekteve dhe pasojave të Armëve të vogla dhe të lehta

Disa qindra kompani në botë janë të përfshira në industrinë e prodhimit të armëve të vogla dhe rreth 98 vende të ndryshme kanë kapacitete industriale për t'i prodhuar ato dhe municionet përkatëse. Sipas një studimi mendohet se numri i armëve në qarkullim (ato legale dhe jo-legale së bashku) në të gjithë botën janë rreth 600 milion. Çdo vit këto armë shkaktojnë rreth 500.000 mijë të vrarë nga të cilët 200.000 mijë banojnë në vende "paqësore".<sup>69</sup> Disa lloje statistikash janë të vështira për ti përpunuar dhe shpesh herë për nga natyra e tyre jo-shumë të besueshme. Sidoqoftë as madhësia, as natyra e këtij problemi nuk mund të vihet në diskutim. Ekzistojnë sot disa qindra milion armë të vogla dhe të lehta të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në konfliktet e ndryshme, dhunën dhe pasigurinë në botë. Duke mos mjaftuar këto armët e zjarrit përdoren gjithashtu dhe për të plagosur, gjymtuar, terrorizuar dhe shpërngulur miliona njerëz të tjerë. Sidoqoftë kostot humane, sociale dhe ekonomike të shkaktuara nga armët e vogla dhe të lehta janë të vështira për tu matur saktësisht. Efektet dhe pasojat në mënyrë të përgjithshme mund të përshkruhen si më poshtë:

#### 1. Për të kuptuar dhe parë zhvillimin dhe ecurinë në një vend, rajon apo komunitet të caktuar

- Sasi monetare të shpenzuara për sigurimin dhe armatimin të cilat nuk janë në dispozicion të zhvillimit;
- Investimet e huaja, të bashkangjitura rezervave buxhetore qeveritare të cilat janë të kushtëzuara për tu përdorur;
- Rënia e turizmit për shkak të këtyre problemeve;
- Sistemi i transporteve dhe i mundësisë për të qënë afër nevojave themelore, prodhimi bujqësor dhe industrial janë të çorientuar;
- Organizatat dhe agjensitë e zhvillimit e ngushtojnë shumë rrethin e tyre për shkak të shkaqeve të sigurisë;

#### 2. Ritja e dhunës, pasigurisë dhe jo-stabilitetit nga

- Duke rënduar akoma më shumë gjendjen e dhunës, grabitjeve me armë, agresioneve, vrasjeve, plagosjeve, rëmbimeve; Ritjen e tensioneve midis komuniteteve të ndryshme, inkurajimin e konflikteve sesa të zgjidhjes së problemeve në rrugë paqësore;
- Ritjen e nivelit të trafikimit dhe bandave;
- Keq-kuptimi dhe keq-përdorimi i termit "Shtet ligjor" dhe aftësisë për të ruajtur paqen.
- Duke rritur rreziqet e terrorizmit;
- Duke lehtësuar tregëtinë e drogës, tregti e cila nuk mund të bëhet pa përdorimin dhe implikimin e armëve të tilla. Si për shembull, tregëtia e heroinës midis kufijve të Pakistanit dhe Afganistanit është i lidhur ngushtë dhe me tregëtinë e armëve.

#### Kutia B.1: Niveli i bandave në Nikaragua

Duke u krahasuar dhe me shtetet e tjera të Amerikës Qëndrore, shtete të cilat kanë dalë nga këto konflikte të gjata, Nikaragua ka vuajtur dhe po vuan shumë nga aktiviteti i këtyre grupeve të armatosura dhe të organizuara si dhe bandave rurale. Këto grupe janë të përfshira në krime, vjedhje, grabitje, rrëmbime personi dhe shpesh here dhe në ndërhyrjen në politikat e brendshme të ndonjë shteti tjetër.

<sup>69</sup> Botimi vjetor mbi studimin e armëve të vogla, 2002. Shiko gjithashtu dhe "Humanizmi nën Kërcënim".



### 3. Mbështetja dhe kontributi në lidhje me thyerjet Drejtave të Njeriut dhe Ligjit Humanitar Ndërkombëtar

- Objektivat civilë dhe diskriminimi i tyre gjatë konflikteve të armatosura përbëjnë një thyerje të rëndë të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar. Principet bazë të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar ofrojnë mbështetje për civilët (jo-luftuesit) gjatë konflikteve dhe ndalon përdorimin e cdo lloji arme mbi ta. (Konventa e Gjenevës, 1949 dhe Protokollet e vitit 1977).<sup>70</sup>
- Mundësia për të siguruar armë të vogla dhe të lehta përbën një rrezik të drejtpërdrejtë për të Drejtat bazë të Njeriut, sic janë të Drejta e jetës, e lirisë, e sigurisë së personave. (Artikulli 3, Deklarata e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara).

#### Kutia B.2: Të Drejtat e Njeriut në Kolumbi

Në Kolumbi armët e zjarrit kanë kontribuar në një rritje të thyerjeve të të Drejtave të Njeriut. Vetëm në 9 muajt e parë të vitit 1999 ka patur 309 raste zhdukjesh personash pa gjurmë dhe rrëmbimesh. Gjithashtu ka pasur dhe 2,946 raste vrasjesh në po këtë vit.

*Burimi i Informacionit: "Humanizmi nën Kërcënim". Raporti Special i studimit vjetor mbi armët e vogla*

### 4. Shkaktimi i dëmtimeve psikologjike në individë dhe prona, si shkak i efekteve psiko-sociale

- Vdekshmëria foshnjore, gjymtimet trupore, plagosjet kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të gjithë familjen, me kapacitetet prodhuese të individëve ashtu si dhe të komuniteteve. Janë një barrë më shumë për të gjithë sistemin mjekësor në të gjitha nivelet: (ndihma e shpejtë, operacionet, mjekimi, rehabilitimi). Në shumë raste konfliktet kthehen dhe në një çështje shëndetësore publike.
- Efektet psikologjike tek të mëdhenjtë ose të vegjël të cilët kanë qënë dëshmitarë ose të përfshirë në linjën e parë në akteve të dhunës.
- Vetëvrasjet; Ka një lidhje midis mbajtjes së një arme në shtëpi, punë etj., si dhe vdekjeve nga këto armë me qëllim (dëshirë). Dhe plagosjet në këto raste janë shumë të shpeshta si shkak i konflikteve ndër-personale.
- Një presion psikologjik të vazhdueshëm përbëjnë dhe prezenca e ekspozivëve dhe municioneve me probleme në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

#### Kutia B.3: Ekspozivë dhe municione me probleme në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Në vitin 2000, në El Salvador një depo armësh dhe municionesh shpërtheu. Shpërthimi plagosi 40 persona dhe shkatëroi 725 shtëpi të cilat ndodheshin në tre lagjet përreth. Raste të tilla janë të shpeshta në vende të ndryshme të botës dhe cdo vit ndodhin në një shkallë të madhe

*Burimi i Informacionit; Efekti i Armëve të vogla në Amerikën Qëndrore, Studimi i Armëve të Vogla, Tetor 2002*

### 5. Shkaktimi i lëvizjeve demografike

- Në situata të ndryshme përdorimi i armëve dhe dhuna kanë shkaktuar dhe efekte dytësore siç është migrimi i detyruar (brenda dhe jashtë kufijve). Në Kolumbi ka një korelacion të fuqishëm midis masakrave të ashtuquajtura "vrasje politike" dhe migrimeve të detyrura.<sup>71</sup>

<sup>70</sup> Shiko gjithashtu "Përdorimi i armëve dhe situatat në të cilat gjenden civilët në konfliktet e armatosura".



## 6. Anashkalimi i Tregut Legal të Armëve

- Si rezultat i prodhimit dhe shpërndarjes në mënyrë të jashtëligjshme të armëve të vogla dhe industria e biznesit legal e ka ndier shumë sepse kërkesa ndaj tyre ka rënë. Mendohet se numri i armëve të vogla dhe të lehta që qarkullon në mënyrë të paligjshme në Pakistan është 18 milion copë. Si për shembull, fabrikat e prodhimit të armëve në rajonet tribale në kufirin veri-perëndimor të provincës së “Darra Adam Khlel” kanë zënë pjesën më të madhe të shitjeve të armëve duke i shkaktuar një humbje të madhe kompanive të lincsuara lokale.<sup>72</sup>

## 7. Kanë një efekt të shumfishtë në komunitet dhe shpesh midis shteteve

- Individët dhe komunitete të ndryshme blejnë ose sigurojnë më shumë armë për qëllime vetë-ruajtjeje. Gjithashtu dhe në Europën Jug-Lindore njerëzit e përkeqësuan shumë situatën duke marrë dhe fshehur secili prej tyre armë të tilla ose dhe duke kontraktuar me kompani të jashtëligjshme për prodhimin dhe furnizimin e tyre me armë.<sup>73</sup>
- Mundësia për të siguruar kaq lehtë armë të tilla kanë ndikuar në ngritjen dhe forcimin e një “kulture të armëve” dhe duke inkurajuar kulturën e dhunës dhe duke krijuar efekte të shumfishta negative në komunitet. Në shumë vende armët janë shpërndar nga vendet në konflikt (El Salvador, Guatemala, Nikaragua), në vendet përreth si për shembull (Kosta Rika, Honduras, Meksikë, Panama).<sup>74</sup>

<sup>71</sup> Burimi i Informacionit; “Humanizmi nën Kërcënim, Efekti i Armëve të Vogla, Studimi mbi armët e vogla, Qershor 2001.

<sup>72</sup> Korrespondenca me Zahid Hussein, Fondacioni për Rezervat e Qëndrueshme, Islamabad, Gusht 2003.

<sup>73</sup> Diskutime me SEESAC (Kontrolli i Armëve të Vogla në Europën Jug-Lindore), Qershor 2003.

<sup>74</sup> Matja e Efektit të Armëve të Vogla në Amerikën Qëndrore, Studimi mbi armët e vogla, Tetor 2002.





## Aneksi C

### Pyetësorët KAP, Shpjegime dhe Udhëzime

Pyetësori KAP<sup>75</sup> të cilin ne do ta shikojmë pak më poshtë është një shembull i mirë për tu përdorur si mjet për mbledhjen e informacioneve gjatë çdo faze të fushatës sensibilizuese të armëve të vogla dhe të lehta. Ky është dhënë si një shembull i mirë por patjetër që ka nevojë për ndryshime sipas specifikave të vendit, kulturës, konfliktit dhe në varësi se në ç'fazë është fushata sensibilizuese. Në çdo rast ky pyetësor më parë ka nevojë për tu testuar, për të parë që e gjithë struktura është e ndjeshme me ambientin kulturor dhe me historinë e komunitetit.

Emri i të Intervistuarit _____ Profesioni _____
Bashkia / Komuna _____ Data ___ / ___ / ___ / Koha e fillimit të pyetësorit _____
Koha e mbarimit të pyetësorit _____

*Prezanto veten, organizatën për të cilën punon dhe qëllimin e këtij pyetësori. Shpjego që të gjitha përgjigjet do të jenë konfidenciale.*

#### 1. Duke e krahasuar me një vit më parë, si mendoni se ka ndryshuar niveli i sigurisë në komunitetin tuaj?

- Niveli i sigurisë është rritur
- Niveli i sigurisë ka qëndruar i pandryshuar
- Niveli i sigurisë është ulur
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

#### 2. A mendoni se mbajtja e një arme ju bën të ndiheni më shumë apo më pak të sigurt?

##### Ju si individ

- Më shumë të sigurt
- Më pak të sigurt
- Asnjë ndryshim
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

##### Ju si familje

- Më shumë të sigurt
- Më pak të sigurt
- Asnjë ndryshim
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

##### Ju si komunitet

- Më shumë të sigurt
- Më pak të sigurt
- Asnjë ndryshim
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

#### 3. A mendoni se prezenca e armëve në komunitetin tuaj ndikon në ndonjë mënyrë në zhvillimin ekonomik apo në standartin e jetës në komunitetin tuaj?

- Ka nxitur zhvillimin ekonomik dhe mbi të gjitha ka rritur standartin e jetës
- Nuk ka asnjë ndikim
- Ka ulur zhvillimin ekonomik dhe mbi të gjitha ka ulur standartin e jetës
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

<sup>75</sup> KAP është sigla për "Knowledge, Attitudes, Practices": Përkthimi: Njohuritë, Zakonet dhe Praktika.



4. Keni dëgjuar në lidhje me problemin e armëmbajtjes dhe përdorimit të tyre gjatë vitit të fundit në ndonjë nga këto raste në komunitetin tuaj

- Në ndonjë debat/zënkë në komunitet
- Miq apo të njohurit tuaj ju kanë folur
- Debate/zënka të nxitura nga lider fetarë
- Debate/zënka të nxitura nga organizatat humanitare që punojnë në zonë
- Keni dëgjuar në media
- Tjetër

Specifiko \_\_\_\_\_

5. Çfarë mendimi keni dëgjuar të ekzistojë në lidhje me armët e vogla dhe të lehta në komunitet? Jepni një shpjegim tuajin në lidhje me këtë rast

\_\_\_\_\_

6. A ka ndonjë lidhje ajo që keni dëgjuar me ndonjë nga mesazhet e mëposhtme?

- Rreziku nga armët
- Efekti që armët kanë në lidhje me zhvillimin në komunitet
- Efekti i vetmbrojtjes kur disponon një armë të tillë
- Të mirat që mund të nxjerrë komuniteti kur merr pjesë në skemat vullnetare të dorëzimit
- Data e fillimit dhe mbarimit të amnistisë në lidhje me armët e vogla dhe të lehta

7. Nëse keni dëgjuar mesazhe të tilla, cilat nga këto specifikisht mund të kenë qënë?<sup>76</sup>

		Po	Jo	Nuk jam i sigurt
A	<i>“Të gjitha llojet e armëve, municioneve dhe eksplozivëve janë të rrezikshme, ato janë prodhuar enkas për të vlarë”</i>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
B	<i>“Mos lini kurrë armë në vende publike ato mund të jenë shumë të rrezikshme sidomos kur fëmijët mund të luajnë me to”</i>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
C	<i>“Armët nuk janë prodhuar për të bërë humor/qejf. Ju s[duhet të luani më to”</i>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
D	<i>“Çdo herë që ju merrni një armë në dorë, kujtohuni për rrezikun ekstrem të saj”</i>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E	<i>“Fëmijët tuaj po përpiqen të ndërtojnë një të ardhme të re. I ndihmoni ata të kenë sukses në të ardhmen e tyre”</i>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
F	<i>“Disa mendojnë se është modë të kesh një armë personale, por koha e tyre tani ka perënduar”</i>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
G	<i>“Armët në shtëpinë tuaj mund të vrasin dhe fëmijët tuaj. Flisni me fqinjët dhe shpërndajeni këtë mesazh në komunitet”</i>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
H	<i>“Midis 1 Marsit dhe 30 Shtatorit do të ketë një amnisti të përgjithshme për të lejuar të gjithë njerëzit t’i dorëzojnë armët pa probleme ligjore”</i>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
I	<i>“Për të marrë një biletë që të lejon të marrësh pjesë në llotarinë që Projekti i Mbledhjes së Armëve të Vogla dhe të Lehta po organizon, duhet të paktën të dorëzosh një armë”</i>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

<sup>76</sup> Nga A –D janë mesazhet edukative të projektit, nga E-F mesazhe mbështetëse për fushatën dhe G-H paraqesin fushatën informative të Projektit të Grumbullimit dhe Shkatërrimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta.





**8. Sa mendoni se është numri i armëve në komunitetin tuaj?**

- Duket sikur çdo person ka një armë
- Shumë persona kanë në përdorim një armë
- Pak persona kanë në përdorim një armë
- Vështirë se një armë
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

**9. Cilët persona mbajnë një armë në shtëpi në komunitetin tuaj?**

- Burrat dhe gratë njësoj, të rinjtë dhe të rriturit
- Të gjithë burrat
- Vetëm burrat në moshë të madhe
- Vetëm djemtë e rrinj
- Gratë kanë armë kur nuk kanë burra në shtëpi

**10. Duke e krahasuar me një vitë më parë mendoni se numri i armëve në komunitetin ka ndryshuar?**

- Numri i tyre është ulur
- Numri i tyre është ngritur
- Sasia e armëve ka mbetur e pandryshuar
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

**11. Nëse do dëgjosh një lajmërim për një amnisti e cila do të lejojë mbledhjen vullnetare të armëve pa u dënuar nga ligji, a do të mendoni se kjo iniciativë do të ketë ndonjë nga këto efekte?**

- Ka shumë mundësi të jetë e sukseshme
- Mund të ketë një sukses të vogël
- S'besoj se do të ketë sukses
- Varet (nga situata dhe skema e mbledhjes së armëve)
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

<b>Seksi i të Intervistuarit</b>	<input type="checkbox"/> M	<input type="checkbox"/> F				
<b>Mosha e të Intervistuarit</b>	<input type="checkbox"/> 13-19	<input type="checkbox"/> 20-29	<input type="checkbox"/> 30-39	<input type="checkbox"/> 40-49	<input type="checkbox"/> 50-59	<input type="checkbox"/> Mbi 60
<b>Shtetësia e të Intervistuarit</b>	Normalisht nuk ka nevojë të bëhet kjo pyetje sepse nga gjuha e të intervistuarit ose nga vendbanimi i tij mund të kuptohet. Sidoqoftë duhet të dihet në fund të çdo pyetësi se i çfarë shtetësie është i intervistuari					
<b>Vendi</b>	Shëno ku u bë intervista, emrin e bashkisë/komunës dhe prefekturën përkatëse.					

*Pyetësi tani ka mbaruar. Falënderojeni të intervistuarin tuaj dhe largohuni.*



## Shënime dhe sqarime rreth pyetësorëve të tillë

Ky lloj pyetësori është ndërtuar duke marrë parasysh një projekt i cili do të kishte të njëjtat objektiva. Pyetësori pason çdo fazë të tij duke i dhënë një mbështetje dhe duke promovuar mesazhin e mëposhtëm të grupit së përzgjedhur.

OBJEKTIVAT	GRUPI E PËRZGJEDHUR	MESAZHI QË KËRKOHEM TË TRASMETOHEM <sup>77</sup>
Të lehtësojmë procesin duke ndihmuar grupet më në rrezik (si psh adoleshentët, dhe fëmijët e vegjël). Përpiqemi ti ndihmojmë ata të analizojnë situatën e tyre, të identifikojnë faktorët dhe të ndërtojnë një bashkëpunim të mirë me Projektin e Çarmatimit dhe të Grumbullimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta.	Komuniteti, në mënyrë të veçantë grupet më në rrezik (fëmijët dhe adoleshentët)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Armët nuk janë për të bërë qejf. Qëndrojeni larg atyre sepse ato janë të rrezikshme për jetën tuaj.</li> <li>• Disa mendojnë se është në modë të kesh një armë por kohëra të tilla kanë përfunduar me kohë.</li> <li>• Të mos kesh armë është në modë, kjo tregon konfidencë tek vetja jote.</li> <li>• Nuk mund të jesh tip gazmor e në modë e njëkohësisht të mbash armë.</li> </ul>
Të përpiqemi t'ju tregojmë alternativa të tjera përveç se ajo e "Kulturës së Dhunës"	Mund të punohet me të gjithë komunitetin.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjitha armët e municionet janë të rrezikshme. Ato janë prodhuar për të shkaktuar dëme të mëdha.</li> <li>• Mos merrni një armë tjetër nëse ju e keni një të tillë. Mos i përdorni ato.</li> <li>• Mos i lini armët në vende publike. Fëmijët mund të jenë në shumë rrezik.</li> </ul>
Të inkurajojmë dhe organizata të tjera për tu fokusuar në problemin e sensibilizimit të rrezikut nga armët	Organizatat humanitare dhe organizata që ndihmojnë zhvillimin.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Armët mund të vrasin. Vepro kundër tyre. Ky është ndryshimi më i madh për shoqërinë tuaj. Ne kemi nevojë për ndihmën tuaj.</li> <li>• Trego që e do familjen dhe vendin tënd duke u bashkuar në luftën kundër armëve të jashtëligjshme.</li> </ul>
Të sensibilizojmë në lidhje me problemin e armëve komunën A dhe pastaj të risim informacionin në lidhje me ruajtjen me kujdes të tyre	Mbajtësve të armëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kurdo që të prekni një armë mendoni që ajo është e mbushur dhe e rrezikshme. Mos tërhiqni këmbëzën.</li> <li>• Mbani fëmijët tuaj larg nga arma. Armën mbaji të zbrazur dhe të mbyllur në një vend më çelës mundësisht.</li> </ul>
Të sensibilizojmë për rrezikun e mbajtjes së armëve në shtëpi dhe të influencojmë në dorëzimin vullnetar të tyre.	Gratë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Armët në shtëpi mund të vrasin fëmijët tuaj, burrin tuaj. Armët mund të vrasin të ardhmen tuaj</li> </ul>
Të mbështesim drejtues dhe udhëheqës lokalë në fushatën e sensibilizimit kundër armëve	Udhëheqës fetar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Liderat shpirtëror lokal kanë një detyrë për të përmbushur. Edhe ata duhet të luajnë një rol të madh në fushatën kundër tyre.</li> <li>• Të gjithë udhëheqësit fetarë promovojnë paqen dhe dashurinë. Ndiemoni komunitetin të dorëzojë armët e të ndihet i sigurt.</li> </ul>
T'i ofrojmë publikut herë pas here informacione të zgjeruara mbi gjendjen aktuale dhe suksesin e arritur të fushatës në mbledhjen e armëve	I gjithë komuniteti.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Midis datës 1 Mars dhe 30 Shtator do të ketë një amnisti nacionale dhe ju mund të dorëzoni armët tuaja vullnetarisht.</li> <li>• Që të merrni pjesë në llotarinë e organizuar nga Projekti i Grumbullimit i armëve të vogla dhe të lehta, dorëzoni një armë dhe merrni një biletë llotarie.</li> </ul>

<sup>77</sup> Të gjitha pyetjet që gjenden në pyetësor janë bazuar në modelin e mësipërm, duke menduar se ky model është zgjedhur për të ndërtuar fushatën e sensibilizimit në një zonë të caktuar. Në bazë të specifikave të zonës, ndërtohet strategjia dhe në bazë të strategjisë, ndërtohet pyetësori.



çdo program mbi sensibilizimin e armëve do të ketë specifikat e tij, do të ketë objektivat e tij dhe mënyrën e tij për të matur suksesin. Çdo program do të ketë grupin e tij të veçantë të cilit i drejtohet dhe do të operojë në rrethana të veçanta. Sidoqoftë për përcaktuar efiçencën dhe efikasitetin e çdo projekti që ka lidhje me sensibilizimin e armëve pyetja themelore mbetet, si mund të jemi të ngjashëm dhe të proçedojmë të gjithë njësoj në çdo rast?

#### **Aktivitete**

1. A janë mesazhet e duhura ato të cilat ne përpiqemi të promovojmë?
2. A arrijnë mesazhet e promovuara tek grupet që ne kishin synim?

#### **Pritshmeria**

3. A ka ndonjë sinjal, që niveli i dijeve, zakoneve apo besimeve po ndryshon?
4. A ka ndonjë sinjal po ndryshon praktika e përditshme?

#### **Efekti**

5. Cilat kanë qënë efektet e kësaj ndërhyrjeje. A ka ndryshuar siguria në komunitet, a ka rënë numri i rasteve problematikë?

Duke u bazuar në nevojën për tu përgjigjur këtyre 5 pyetjeve themelore, tabela e mëposhtme do të na sqarojë pse janë përdorur ato lloj pyetjesh në pyetësorin tonë. Duke i venë vetëm nga një shenjë fushës specifike të cilës pyetja tenton ti japë përgjigje, tabloja në tërësi jep një panoramë të plotë të pyetjeve dhe të përgjigjeve. Të gjitha këto shërbejnë për tu marrë në konsideratë gjatë procesit të monitorimit dhe të vlerësimit.



	AKTIVITETE		PRITSHMËRIA		EFEKTI
	<i>A janë mesazhet e duhura ato të cilat ne përpiqemi të promovojmë?</i>	<i>A arrijnë mesazhet e promovuara tek grupet që ne kishin synim?</i>	<i>A ka ndonjë sinjal, që niveli i dijeve, zakoneve apo të besimeve po ndryshon?</i>	<i>A ka ndonjë sinjal që po ndryshon praktika e përditshme?</i>	
1. Duke pasur parasysh një vit përpara, si mendoni se ka ndryshuar niveli i sigurisë në komunitetin tuaj?				◆	◆
2. A mendoni që duke patur një armë ju ndiheni më të sigurt apo më pak të sigurt?			◆		
3. A mendoni se prezenca e armëve në komunitetin tuaj ndikon në ndonjë mënyrë në zhvillimin ekonomik apo në standartin e jetës në komunitetin tuaj?			◆		
4. Keni dëgjuar në lidhje me problemin e armëmbajtjes dhe përdorimit të tyre gjatë vitit të fundit në ndonjë nga këto raste në komunitetin tuaj?		◆			
5. Çfarë mendimi keni dëgjuar të ekzistojë në lidhje me armët e vogla dhe të lehta në komunitet? Jepni një shpjegim tuajin në lidhje me këtë rast	◆	◆			
6. A ka ndonjë lidhje ajo që keni dëgjuar me ndonjë nga mesazhet e mëposhtme?	◆	◆			
7. Nëse keni dëgjuar mesazhe të tilla, cilat nga këto mund të kenë qënë?	◆	◆			
8. Sa mendoni se është numri i armëve në komunitetin tuaj?				◆	
9. Cilët njerëz mbajnë një armë në shtëpi në komunitetin tuaj?				◆	◆
10. Duke e krahasuar me një vit më parë mendoni se numri i armëve në komunitetin ka ndryshuar?				◆	◆
11. Nëse do të dëgjoje për një amnisti, sa sukses mendon se do të ketë ajo?		◆	◆	◆	



## Kur mund të përdoren pyetësorët

- Kur punohet me komunitetin, asnjë nga informacionet e mbledhura nuk duhet të shikohet dhe të studiohet i veçuar sepse rrezikon që rezultati të jetë i një niveli të ulët. Të tilla teknika duhen përdorur gjithmonë, në bashkëpunim të madh me komunitetin dhe përfaqësuesit e tij. E gjithë kjo strategji duhet të bëhet sa më gjithëpërfshirëse.
- Pyetësorët mund të përdoren në çdo fazë të mbledhjes së informacionit, nga studimi fillestar deri tek monitorimi dhe vlerësimi i tij. Me gjithë informacionin në dispozicion ju herë pas here mund të kontrolloni strategjinë që keni zgjedhur, mënyrën se si ajo po perceptohet dhe njëkohësisht keni mundësinë për të bërë ndryshimet përkatëse nëse është e nevojshme.
- Asnjë teknikë e përdorur për të mbledhur informacion dhe për ta analizuar atë nuk do t'ju ndihmojë nëse ju e konsideroni atë të veçuar nga gjithë informacionet e tjera. Çdo informacion i mbledhur duhet të përdoret në funksion të informacioneve të përgjithshme (si atyre sasiorë ashtu dhe për ato cilësorë).

## Udhëzues për përdorimin e pyetësorëve<sup>78</sup>

Një udhëzues i vogël për mbledhjen e informacioneve dhe teknikave të përdorura do ta shikoni më poshtë. Ai është i ndarë në tre faza: strukturimi, mbledhja dhe analiza.

### 1. Faza e strukturimit

- Duke u bazuar në objektivat dhe indikatorët e projektit tuaj vendosni se ç'loj informacioni do t'ju duhet për të mbledhur.
- Shkruani pyetjet duke patur parasysh edhe këshillat e mëposhtme gjatë ndërtimit të tyre:

<sup>78</sup> Është shumë e vështirë për të ndërtuar dhe venë në zbatim pyetësorë statistikorë të vlefshëm (Shih tabelën e mësipërme). Alternativa e përdorur më sipër përpiqet që të nxjerr informacione sa më të detajuara dhe mundësisht ti konfirmojë ato me informacione të gjetura nga burime të tjera.



KINI PARASYSH	DUHET TË KËNI KUJDES QË;
1. Kini parasysh që pyetjet tuaja duhet të mbulojnë gjithë hapësirën për të cilën ju keni nevojë për informacion	Si në pyetëtorin e mësipërm, bëni pyetje të cilat do t'ju ndihmojnë tu përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>• A janë mesazhet e duhura ato të cilat ne përpiqemi të promovojmë?</li> <li>• A arrijnë mesazhet e promovuara tek grupet që ne kishin synim?</li> <li>• A ka ndonjë sinjal, që niveli i dijeve, zakoneve apo të besimeve po ndryshon?</li> <li>• A ka ndonjë sinjal që po ndryshon praktika e përditshme?</li> <li>• Cilat kanë qënë efektet e kësaj ndërhyrjeje. A ka ndryshuar siguria në komunitet, a ka rënë numri i rasteve problematikë?</li> </ul>
2. Përdor të njëjtin pyetësor për të gjitha grupet e përzgjedhura	Edhe kur projekti ynë ka në plan të zbatoj strategji të ndryshme, në grupe të ndryshme dhe mesazhe të ndryshme për secilin prej tyre këshillohet që të përdorni të njëjtin model pyetjesh për të gjitha rastet. Tek faza e analizimit, pyetjet mund të ndahen sipas grupeve të ndryshme të përzgjedhura dhe rezultatet të krahasohen dhe studiohen
3. Ndërtoni një pyetësor sa më të shkurtër që të jetë e mundur	Nëse pyetëtori është i gjatë njerëzit do të lodhen për t'iu përgjigjur pyetjeve. Nëse pyetëtori bëhet në rrugë, nga 5 deri 10 minuta, ndoshta është shumë i gjatë. Ndërsa ulur në një mjedis komod, 45 minuta është maksimumi.
4. Bëjini pyetjet sa më të fokusuar dhe jo pyetje të përgjithshme (të hapura)	Megjithëse pyetjet e përgjithshme lejojnë intervistuesit të shprehin mendimin e tyre, pyetjeve të fokusuar ata u përgjigjen më shpejtë dhe më me lehtësi. (Bëhet fjalë për përgjigjet me Po ose Jo, ose pyetjet me zgjedhje) Dhe pyetjet e përgjithshme mund të analizohen por ato kërkojnë një specializim më të madh.
5. Bëni kujdes që pyetjet të mos japin idenë që ju keni paragjykime	Eliminoni pyetjet të cilat të çojnë vetë drejt përgjigjes ose japin vlerësime. Bëni kujdes që të mos përdorni fjalë apo epitete diskriminuese ose paragjykuese.
6. Bëhuni sa më specifike që të mundeni kur ndërtoni pyetjet	Në vend që të pyesni “A ka ndryshuar situata”, pyesni “Në lidhje me një vit më parë a e ndieni veten më të sigurt”. Është e rëndësishme të përdorni një masë kohore krahasuese.
7. Pyetjet duhet të jenë të thjeshta dhe në asnjë rast të mos përmbajnë më shumë se një çështje të fokusuar	Si për shembull mos pyesni kurrë: A mendoni se ata që mbajnë një armë e kanë marrë më seriozisht çështjen e dorëzimit të tyre dhe tani do të ishin më të gatshëm ta dorëzojnë se një vit më parë?
8. Përfshini gjithmonë pyetje kontrolluese	Në pyetjen 7 intervistuesit i bëhet një kontroll, i jepen mesazhe të reja që ai të jetë më bindës dhe më specifik. Duke i futur këto në pyetësor mund të kuptojmë sa të sinqerta kanë qënë përgjigjet e tij. Niveli i njohjes së tij në këtë mesazh mund të krahasohet me nivelin e njohjes së dhënë në përgjigjet e mësipërme. Ne mund të themi se mesazhi që donim të trasmetonim ka arritur objektivin tonë nëse niveli i njohjes është më i madh për mesazhet e përdorura në program sesa ato që s'janë përdorur ndonjë herë.
9. Evitoni të bëni pyetje të cilave personat mund t'ju mos t'ju tregojnë të vërtetën.	Edhe gjatë pyetësorëve anonimë njerëzit tentojnë të japin përgjigje që janë “të dëshiruara nga komuniteti”. Bëni kujdes se ka disa fusha sensitive që përgjigjet e tyre do të jenë ato që ju doni të dëgjoni ose ato që komuniteti pret prej tyre
10. Evitoni pyetje të ngritura mbi paragjykime sepse ato mund të mos gjejnë mbështetje të gjerë	Për shembull mos pyesni: “A mendoni se ka alternativa që ne mund të përdorim për të ndryshuar kulturën e dhunës?”. Kjo pyetje presupozon që ekziston një kulturë dhune dhe ne duhet ta evitojmë. Shumë njerëz mund të distancohen nga kjo pyetje.
11. Evitoni të bëni pyetje, përgjigjja e të cilave do të ishte e paqartë	Për shembull, përgjigjuni pyetjes: “A mendoni se iniciativa e mbledhjes së armëve ishte në nivelin që ju prisnit?”. Kjo pyetje nuk ka kuptim për sa kohë ne nuk njohim nivelin e pritshmërisë të të intervistuarit.

- Duhet të identifikoni një grup që të përfaqësojë sa më gjerësisht komunitetin të cilin ju doni të intervistoni.
- Vendosni për numrin e të intervistuarve. Sa më i madh të jetë ky numër aq më i saktë do të jetë rezultati i përgjithshëm.



- Përzgjedhja e grupit mund të bëhet si më poshtë;
  - Përzgjedhje statistikore (për shembull një shtëpi në çdo dhjetë prej tyre).
  - Përzgjedhje me kuota (kur çdo intervistuesi i jepet një numër i caktuar për çdo lloj duke i ndarë në bazë të sexit, moshës, racës, punës etj).

## 2. Mbledhja e të dhënave

- Kontrolloni anketimin për të parë nëse pyetjet kanë qënë të përzgjedhura dhe të kuptuara nga të intervistuarit në mënyrën që ato kanë qënë projektuar. Kontrolloni nëse gjuha e përdorur, koherenca, ambienti kulturor është i njëjti me të grupit të intervistuar. Kontrolloni kohën që ju duhet për të plotësuar një pyetësor. Nëse ka nevojë bëni ndryshimet e nevojshme.
- Siguroheni që intervistuesit të kenë mundësi të komunikojnë më të intervistuarit. Nëse mendoni se është me mirë, zgjidhni që një grua të intervistojë një grua, një djalë i ri të intervistojë një djalë të ri, etj.,
- Përgatitni intervistuesit që të jenë sa më profesionalë gjatë intervistës.
- Përpara se të dilni për të plotësuar pyetësorin ju duhet të keni ndërtuar disa lidhje me komunitetin në të cilin do ta zhvillonit atë. Duhet të testoni gadishmërinë e tyre dhe ti përgatitni pjesërisht ata për pyetësorin në fjalë.
- Në fillim i siguroni të intervistuarve se identiteti i tyre do të mbetet sekret dhe i gjithë ky pyetësor do të shërbejë për të qënë sa më efektivë me projektin në komunitetin e tyre.
- Plotësoni pyetësorët.

## 3. Faza e analizës

- Në rast se do të punësoni një firmë eksperte në përpunimin e të dhënave, problemi është i zgjidhur, por nëse do ta bëni vetë këtë punë duhet të keni shumë kujdes sepse kërkon shumë përqëndrim dhe profesionalizëm.
- Të dhënat duhet të analizohen në funksion të projektit dhe të përkohet më objektivat e tij. Për shembull, ju duhet të dini se sa përqind e popullsisë është në dijeni për strategjinë e çarmatimit, sa të tjerë kanë informacion për ligjin mbi amnistinë, etj. Por ju mund të doni nëse ka ndonjë lidhje midis variablave të ndryshëm, si për shembull, nëse ndonjë grup moshe ka më shumë lidhje me armët, etj. Për sqarime të mëtejshme shikoni tabelën e mëposhtme.
- Duke e përsëritur pyetësorin disa herë në kohë e në një zonë të caktuar do t'ju lejojë të shikoni nëse ka ndryshime. Nëse të dhënat do të jenë pozitive dhe në ngritje atëherë ju do të keni të drejtë të mendoni se projekti juaj është duke përjetuar rezultate, sado të vogla qofshin ato.

### **Analizimi i të dhënave të pyetësorit: një shembull sesi nxiren rezultatet duke kryqëzuar të dhënat në tabelat e ndryshme.**

Gjatë fazës së zbatimit të projektit, disa grupeve të ndryshme do tu përcillen mesazhe të ndryshme. Gjatë pyetësorit, intervistave dhe diskutimeve që do të ndjekin, disa prej këtyre të individëve të përzgjedhur në këto grupe do të pyeten:

- a) Nëse ata e kanë dëgjuar thelbin e mesazheve
- b) Dhe nëse i kanë dëgjuar mesazhet, a kanë ndryshuar dijet, sjelljet dhe jeta e përditshme e tyre.

Në pyetësorin e mëposhtëm kryqëzoni përgjigjet e pyetjeve 2 dhe 7 dhe do të kuptoni lidhjen dhe ndërthurjen midis tyre. (Shihni shembullin e mëposhtëm). Supozoni se rezultatet nga pyetësori i mëposhtëm do të ishin si më poshtë:



Nëse keni dëgjuar mesazhet e trasmetuara a mund të na thoni cilat prej tyre specifikohej ju kanë trasmetuar juve?

**“Armët në shtëpi mund tju vrasin fëmijën tuaj, shpresën tuaj për të ardhmen. Komunikoni me fqinjët tuaj, gjithashtu dhe me miqtë tuaj dhe ndihmoni dhe ju në përhapjen e këtij mesazhi.”**

Po	173	55%
Jo	103	33%
Nuk jam i sigurt	38	12%
TOTALI	314	100%

Dhe përgjigjet e pyetësorit të dytë supozojmë se mund të ishin si më poshtë:

A besoni se në familjen tuaj duke patur një armë ju bën të ndiheni më të sigurt apo më pak të sigurt?	TOTALI	%
<input type="radio"/> Më shumë të sigurt	88	28%
<input type="radio"/> Më pak të sigurt	96	31%
<input type="radio"/> Nuk përbën asnjë ndryshim	67	21%
<input type="radio"/> Nuk e di	28	9%
<input type="radio"/> Asnjë përgjigje	35	11%
	314	100%

Duke kryqëzuar përgjigjet e këtyre dy tabelave do të gjejmë rezultatin e mëposhtëm:

“Armët në shtëpi mund tju vrasin fëmijën tuaj, shpresën tuaj për të ardhmen. Komunikoni me fqinjët tuaj, gjithashtu dhe me miqtë tuaj dhe ndihmoni dhe ju në përhapjen e këtij mesazhi.”						
A besoni se në familjen tuaj duke patur një armë ju bën të ndiheni më të sigurt apo më pak të sigurt?	Ata që e kanë dëgjuar këtë mesazh	%	Ata që nuk e kanë dëgjuar këtë mesazh	%	Ata që nuk janë të sigurt nëse e kanë dëgjuar këtë mesazh	%
<input type="radio"/> Më shumë të sigurt	34	20%	44	43%	10	26%
<input type="radio"/> Më pak të sigurt	78	45%	9	9%	9	24%
<input type="radio"/> Nuk përbën asnjë ndryshim	26	15%	33	32%	8	21%
<input type="radio"/> Nuk e di	12	7%	10	10%	6	16%
<input type="radio"/> Asnjë përgjigje	23	13%	7	7%	5	13%
TOTALI	173	100%	103	100%	38	100%





Rezultate të tilla tregojnë se:

- 45 përqind e atyre që e kanë dëgjuar mesazhin se “Armët në shtëpi janë të rrezikshme” tani mendojnë se të mbash armë në shtëpi i bën ata të jenë më pak të sigurt. Por vetëm 9 përqind e atyre që nuk e kanë dëgjuar mesazhin mendojnë kështu.
- Duke vazhduar me të njëjtin arsyetim mund të shohim se vetëm 20 përqind që e kanë dëgjuar mesazhin vazhdojnë të mendojnë se armët në shtëpitë e tyre i bëjnë ata më shumë të sigurt. Gjithashtu dhe 43 përqind e atyre që nuk e kanë dëgjuar mesazhin vazhdojnë të mendojnë në këtë mënyrë.

Mbasi keni studiuar këto tabela ju mund të arrini në rezultatin se:

- Mesazhi është trasmetuar gjerësisht tek banorët, (55 përqind e të përzgjedhurve)
- Trasmetimi i këtij mesazhi ka bërë që një numër i madh banorësh të ndërrojnë mendimin e tyre në lidhje me armët. Më specifikisht, mendojnë se arma në familje e ul sigurinë e saj.

### Shënime rreth përdorimit të mbështetjes profesionale në grumbullimin e të dhënave statistikore<sup>79</sup>

Siç e përmenda dhe më lart është tepër e vështirë të arrish në konkluzione të sakta statistikore<sup>80</sup> pa përdorur ndihmën dhe suportin e një organizate që punon në fushën e mbledhjeve dhe nxjerrjen e rezultateve të tilla. Gjithashtu të gjitha anketimet nacionale në kuadër të Projektit të Armëve të Vogla dhe të Lehta do të bëhen në bashkëpunim me organizata me të cilat bashkëpunojmë dhe janë tepër të afta për të nxjerrë rezultate tepër të sakta. Pengesat më të mëdha që mund të gjeni janë:

- Identifikimi i ‘target grupit’. Organizatat nuk mund të arrijnë në anketa gjithëpërfshirëse (do të thotë që është shumë e vështirë të arrish në të gjitha rajonet demografike, të prekësh të gjithë grupin tënd të përzgjedhur, mundësisht që ky grup të jetë sa më afër një liste elektorale). Mbasi të keni kryer një përzgjedhje të ‘target grupit’ teknika të sofistikuara do të duhen për të përzgjedhur një grup i cili do të përfaqësoj; të gjithë ‘target-in’ tuaj. Zbatimi i kësaj ankete në vende të ndryshme me të njëjtat parametra kërkon gjithashtu një përgatitje profesionale të madhe<sup>81</sup>.
- Shkruani pyetjet. Kini kujdes të eliminoni paragjykimet në pyetjet tuaja dhe i ndërtoni ato në mënyrë që përgjigjet e tyre të jenë kuptimplota. Vështirësia për të shkruajtur pyetje të tilla, veçanërisht kur pyesni rreth zakoneve dhe qëllimeve të njerëzve është më e madhe seç e imagjinoni ju.
- Analizimi i të dhënave. Tek kjo fazë është e nevojshme përgatitja profesionale në fushën statistikore për të kuptuar deviancat standarte dhe gabimet standarte.

Kur në grupin tuaj të punonjësve nuk ka asnjë të tillë të specializuar është patjetër e nevojshme të bashkëpunoni me një organizatë profesionale në këtë fushë. Alternativa e dytë është që ju vetë të përdorni skema të gatshme anketash dhe të përpiqeni të analizoni rezultatet duke qënë të bindur se është e pamundur të arrihet një saktësi e madhe. Kjo mënyrë e dytë është e papranueshme sepse raporti përfundimtar nuk ka një saktësi besuese mbi të cilën do të ngrihen strategjitë e zbatimit të projektit.

### Disa pyetje të thjeshta për tu përdorur në anketa dhe pyetësor

Një grup pyetjesh të cilat stafet e Projektit të Sensibilizimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta kanë nevojë ti kenë në dispozicionin e tyre. Gjithë pyetësorët e mësipërm janë bazuar në pyetjet e mëposhtme:

<sup>79</sup> Për një shpjegim të mëtejshëm rreth kërkimeve sociale nëpërmjet anketave mund të shihni, Social Survey Methods, shkruajtur nga Paul Nichols (91), Shtëpia Botuese Oxfam.

<sup>80</sup> Saktësia statistikore ka të bëjë me vërtetësinë se ndryshimi i ndonjë të dhëne, ndryshon rezultatit real të anketës dhe ky ndryshim nuk është asgjë tjetër veçse ndryshimi që vjen nga këto të dhëna të reja.

<sup>81</sup> Për informacione të tjera rreth anketave mund të shihni: [www.stat.lsu.edu/faculty/moser/exst7012/intro.pdf](http://www.stat.lsu.edu/faculty/moser/exst7012/intro.pdf)



### Aktiviteti i programit

- A janë mesazhet e promovuara ato të duhurat?
- A arrijnë mesazhet e promovuara deri tek grupet dhe individët e përzgjedhur?

### Pritshmëria

- A ka ndonjë indikator i cili na jep sigurinë se zakonet dhe besimet po ndryshojnë?
- A ka ndonjë shenjë të ndryshimit në praktikatat e përditshme apo jo?

### Rezultati

- Cili ka qënë rezultati i ndërhyrjes? A mund ta shprehni këtë rezultat me indikatorë që shprehin ndryshmin në nivelin e sigurisë, uljen e rasteve të dhunshme, etj?

Ndërtimi i pyetjeve të ndryshme duke u bazuar te objektivat e programit mund të variojnë nga rreziku për të ndërmarrë iniciativa edukuese deri tek aktivitetet që edukojnë arritjen e rezultateve ndërmjet bashkëpunimit. Duke u bazuar tek kjo menu, drejtuesit e programit përgatisin materialet të cilat nevojiten për pyetësorët dhe anketat e ndryshme gjatë punës.

Çdo situatë është e ndryshme. Pyetjet duhen të ndërtohen duke pasur parasysh se duhen të mblidhen përgjigje rreth cilit objektivi specifik të programit janë arritur rezultate.



## Një grup pyetjesh për specialistët e ndërtimit të pyetësorëve

### Aktiviteti i programit

(Përsëritni mesazhin i cili është promovuar)

**A mendoni se ky mesazh është i rëndësishëm në rastin tuaj?**

- Shumë i rëndësishëm, plotësisht dakord
- I rëndësishëm, dakord
- As i rëndësishëm as i parëndësishëm/ nuk e di
- I parëndësishëm,
- Shumë i parëndësishëm, aspak dakord
- Asnjë përgjigje e dhënë

(Përsëritni mesazhin i cili është promovuar)

**A besoni se mesazhi i përcjellë është i rëndësishëm në rastin tuaj specifik?**

- Shumë i rëndësishëm, plotësisht dakord
- I rëndësishëm, dakord
- As i rëndësishëm as i parëndësishëm/ nuk e di
- I parëndësishëm
- Shumë i parëndësishëm, aspak dakord
- Asnjë përgjigje e dhënë

P.S. Kur mesazhet janë ndërtuar në bashkëpunim me komunitetin dhe duke u bazuar tek objektivat e programit atëherë pyetjet e mësipërme nuk janë të nevojshme.

**Vitin e fundit a keni dëgjuar diskutime rreth mbajtjes së armëve dhe përdorimit të tyre në ndonjë nga këto mjedise?**

- Në diskutimet në komunitet
- Duke biseduar me shokë ose fqinj
- I keni dëgjuar nga udhëheqës fetarë
- I keni dëgjuar nga organizatat humanitare që veprojnë në zonën tuaj
- I keni dëgjuar nga media
- Tjetër (specifiko) \_\_\_\_\_

**Nëse keni dëgjuar, çfarë mesazhi ju është trasmetuar në lidhje me armët e vogla dhe të lehta?**

(Përshkruaj mesazhin)

**Në lidhje me çfarë ishte mesazhi që keni dëgjuar?**

- Rreziku i armëve
- Pasojat që mund të kenë armët në ndërtimin e komunitetit tuaj
- Nevoja e sigurisë së lartë kur ju mbani armë
- Përfitimet nga programi i grumbullimit të armëve
- Data e fillimit dhe mbarimit të amnistisë në lidhje me armët e vogla dhe të lehta
- Tjetër (specifiko) \_\_\_\_\_



**Nëse keni dëgjuar, specifiko mesazhin që ju është trasmetuar?**

- Mesazhi A
- Mesazhi B
- Etj.

(Përsëritni mesazhin i cili është promovuar)

**Sa herë kujtoni ju se e keni dëgjuar këtë mesazh?**

- Anjëherë
- Një herë ose dy
- Disa herë
- Shumë herë

### **Pritshmëria**

**A besoni se ju si individ duke patur një armë ndiheni më pak apo më shumë i sigurt?**

- Më i sigurt
- Më pak i sigurt
- Nuk përbën asnjë ndryshim për mua
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

**A besoni se ju si familje duke patur një armë, ndiheni më pak apo më shumë i sigurt?**

- Më i sigurt
- Më pak i sigurt
- Nuk përbën asnjë ndryshim për mua
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

**A besoni se ju si komunitet duke patur armë, ndiheni më pak apo më shumë i sigurt?**

- Më i sigurt
- Më pak i sigurt
- Nuk përbën asnjë ndryshim për mua
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

**A mendoni se prania e armëve në komunitetin tuaj ka pasoja në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen e standartit të jetesës tek ju?**

- Rrisin mundësinë e zhvillimit dhe standartet e jetës
- Nuk ka asnjë influencë
- Ulin mundësinë e zhvillimit dhe standartet e jetës
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë



**A mendoni se kontrolli i armëve të vogla dhe të lehta është një çështje për tu shqetësuar në komunitetin tuaj?**

- Shumë i rëndësishëm, plotësisht dakord
- I rëndësishëm, dakord
- As i rëndësishëm as i parëndësishëm/ nuk e di
- I parëndësishëm
- Shumë i parëndësishëm, aspak dakord
- Asnjë përgjigje e dhënë

**A mendoni se është më pak legjitime mbajtja e armëve të paligjshme në komunitetin tuaj (në veçanti armë të kalibrit të lart, municione dhe eksploziv) në lidhje më mbajtjen e armëve të lejuara?**

- Shumë i rëndësishëm, plotësisht dakord
- I rëndësishëm, dakord
- As i rëndësishëm as i parëndësishëm/ nuk e di
- I parëndësishëm
- Shumë i parëndësishëm, aspak dakord
- Asnjë përgjigje e dhënë

**A jeni në dijeni se ka mundësi për të ulur rrezikshmërinë gjatë mbajtjes dhe ruajtjes së armëve të vogla dhe të lehta?**

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

**Cili është niveli që është kuptuar fushata në komunitetin tuaj në lidhje zbatimin e praktikave më të mira me rëndësinë e mbajtjes dhe ruajtjes së armëve të vogla dhe të lehta?**

- Shumë i lartë
- I lartë
- Mesatar
- I ulët
- Shumë i ulët

**Cili është niveli që është kuptuar fushata në komunitetin tuaj në lidhje me rëndësinë e sigurisë së armëve?**

- Shumë i lartë
- I lartë
- Mesatar
- I ulët
- Shumë i ulët



**Si mund ta përshkruani ju nivelin e sensibilizimit në lidhje praktikat më të mira për ruajtjen e armëve të vogla dhe të lehta?**

- Shumë i lartë
- I lartë
- Mesatar
- I ulët
- Shumë i ulët

**Cilat nga elementët e praktikave më të mira në ruajtjen e armëve kujtoni ju?**

(Ju lutem specifikoni)

**A kujtoni ndonjë nga masat e nevojshme që duhen ndërmarrë gjatë fushatës së grumbullimit të armëve?**

(Ju lutem specifikoni)

**Duke patur parasysh një vit më parë, a besoni se personat që mbajnë armë janë më të kujdesshëm?**

- Po, më shumë se më parë
- Jo, më pak se më parë
- Njësoj
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje

**A besoni se niveli i rrezikut në komunitetin tuaj është?**

- Po rritet
- Po ulët
- Njësoj
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje

**A besoni se autoritet lokale, kombëtare/rajonale po diskutojnë rreth çështjes së armëve të vogla dhe të lehta më seriozisht se më parë?**

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

## **Rezultatet**

**Sa mendoni se është numri i armëve në komunitetin tuaj?**

- Duket se të gjithë kanë nga një armë
- Shumë persona kanë një armë
- Vetëm pak persona kanë armë
- Vështirë se gjendet ndonjë armë



- Nuk ka armë
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje

**Kush janë personat që mbajnë armë në komunitetin tuaj?**

- Burrat dhe gratë njësoj, të rinjtë dhe pleqtë
- Të gjithë burrat
- Vetëm burrat në moshë
- Vetëm djemtë e rinj
- Gratë mbajnë armë kur burrat nuk janë pranë familjes

**Duke e krahasuar me një vit më parë besoni se numri i armëve në komunitetin tuaj ka ndryshuar?**

- Numri i armëve është ulur
- Numri i armëve është rritur
- Numri i armëve nuk ka ndryshuar
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

**Përafërsisht sa shpesh dëgjoni të shtëna në komunitetin tuaj?**


- Disa herë në ditë
- Disa herë në javë
- Rreth një herë në javë
- Rreth një herë në muaj
- Asnjëherë
- Asnjë përgjigje e dhënë

**Duke e krahasuar me një vit më parë a mendoni se ka ndryshuar niveli i sigurisë në komunitetin tuaj?**

- Niveli i sigurisë është rritur
- Niveli i sigurisë ka qëndruar i palëvizur
- Niveli i sigurisë është ulur
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë

**Duke e krahasuar me një vit më parë a mendoni se ka ndryshuar niveli juaj i sigurisë personale?**

- Niveli i sigurisë është rritur
- Niveli i sigurisë ka qëndruar i palëvizur
- Niveli i sigurisë është ulur
- Nuk e di
- Asnjë përgjigje e dhënë





## Aneksi D

### Përdorimi i intervistave dhe fokus grupet (grupet në studim), shembuj dhe udhëzime<sup>82</sup>

#### Kur mund të përdoren intervistat dhe fokus grupet

- Kur punoni me komunitetet lokale, ndodh shpesh që të gjitha metodat e grumbullimit të informacioneve në qoftë se mbeten të izoluara, tentojnë që relativisht të ulin cilësinë e informacionit të mbledhur. Teknikat duhen të jenë të njëjta në çdo komunitet që do të punoni, ju vetëm do të shtoni specifikat e tyre përkatëse.
- Intervistat dhe fokus grupet mund të përdoren në të gjitha fazat e mbledhjes së informacionit, që nga vlerësimi fillestar i projektit e deri te monitori dhe vlerësimi final. Me të gjithë informacionin në dispozicion dhe me teknikat e mbledhjes së të dhënave, përsëritini disa herë gjatë ciklit të programit për të parë si komuniteti po e kupton mesazhin tuaj dhe si po ndryshon njëkohësisht kur programi po ecën përpara.
- Asnjë teknikë e izoluar nuk do t'ju mundësojë të dhëna dhe informata mbi të cilat të ndërtosh gjykime që do të të ndihmojnë për të projektuar strategjinë e re të programit të sensibilizimit të armëve të vogla dhe të lehta. Çdo informacion i mbledhur duhet të përdoret në bashkëpunim me informacionet e tjera (si informacionet kualitative dhe kuantitative).

#### Disa këshilla në përdorimin e intervistave dhe fokus grupeve

Disa udhëzues për grumbullimin e të dhënave, ndërmjet këtyre teknikave po ju japim si shembuj më poshtë. Ne i kemi ndarë ato në tre faza: ndërtimi i tyre, mbledhja dhe analizimi i tyre.

##### 1. Faza e ndërtimit të intervistave

- Duke u bazuar në objektivat e projektit dhe indikatorët e tij, vendosni se çfarë lloj informacioni dëshironi të mblidhni. Në çdo rast sigurohuni të mblidhni informacione rreth të intervistuarit siç janë mosha, seksi, kombësia etj.
- Vendosni se kush do të jetë i intervistuari, ose kush do të jetë fokus grupi tuaj
  - Intervistat dhe diskutimet mund ti bëni si një nga një ashtu dhe me grupe të vogla me 4-8 persona
  - Nëqoftëse keni burime ekonomike të mjaftueshme këshillohet të ndërtoni fokus grupe homogjene që janë të ndryshem nga njëri tjetri (Psh intervista veças me grupet e grave, burrave etj.)
- Shkruani një listë me pyetje të cilat do tju ndihmojnë të përqëndroni diskutimin në fushën me më shumë interes

##### 2. Faza e mbledhjes së të dhënave

- Përzgjidhni pjestarë nga çdo target grup i identifikuar
- Rregjistroni ose mbani shënim të gjitha përgjigjet e të intervistuarve
- Siguroni lejen e të intervistuarve për të publikuar dhe përdorur të dhënat e mbledhura
- Personi që do të intervistojë duhet ta drejtoj diskutimin me pyetje të qarta, me pyetje që fillojnë dhe mbarojnë në mënyrë të qartë.

<sup>82</sup> Për sqarime të metejshme, referoju "Një Manual për përdorimin e grupe fokusi" nga Fondacioni Ndërkombëtar i Ushqimit për Vendet në Zhvillim në C-ROM-in e PMSA



### 3. Faza e analizës

Informacioni i mbledhur në këtë mënyrë ndihmon një studim më të thellë të situatës. Por sidoqoftë ka nevojë për një interpretim të kujdesshëm. Një mënyrë sistematike për të analizuar të dhënat e mbledhura mund të jetë si më poshtë:

- Mblidhni rezultatet e çdo pyetjeje të të intervistuarve ose rezultatet e çdo diskutimi
- Shënoni të gjitha vërejtjet e bëra pro ose kundër në lidhje me çështjet në diskutim
- Identifikoni ndonjë ndryshim të mundshëm midis përgjigjeve të dhëna nga grupet e ndryshme si përshembull gratë, të rinjtë etj.
- Mbasi keni mbledhur informacionin e saktë dhe të vlefshëm krijoni një përmbledhje, duke përfshirë rezultatet e dala nga pyetjet dhe diskutimet e bëra. Për pyetjet më të rëndësishme krijoni tabelë të dhënash të veçantë.

## Aneksi E

### Shembuj rreth teknikave pjesëmarrëse (ushtrimi i liderit) dhe udhëzime për përdorim

Ushtrimi i liderit është vetëm një shembull nga metodat e pjesëmarrjes. Ky ushtrim mund të kryhet individualisht dhe më pas të diskutohet në grup, ose çështjet të diskutohen në grup derisa të arrihet në një konsensus. Mbase të jetë bërë vlerësimi kjo formë mund të shërbejë si bazë më e gjerë diskutimi për të studiuar faktorët që influencuan ndryshimet dhe gjithashtu për të studiuar ndryshimet e mundshme për të ardhmen.

INDIKATORET	MË PËRPARA MË PAS	INFLUENCA E PROJEKTIT	FAKTORË TË TJERË	KOMENTE RRETH NDRYSHIMIT
Njohuritë e komunitetit reth rrezikut nga armët e vogla dhe të lehta	* <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> *	+ + + +		Atje ku fushata e armëve të vogla dhe të lehta u neglizhua shumë pak, zbatimi dhe zhvillimi i planit për një "Komunitet më të Sigurt" arriti të vihej në fokusin e audiencave të ndryshme. Përshembull gratë filluan tu thoshin burrave të tyre se një armë në shtëpi mund të vriste fëmijën e tyre. Një ndryshim i tillë mund të vihet re në fazat e ndryshme të raportimeve të incidenteve nga armët në familje para dhe pas këtij programi <sup>83</sup>
Shtrirja e sigurisë së jetës së përditshme		+ +	+ +	Aksidentet nga armët e zjarrit u zvogëluan në numër. Mbështetja nga mediat lokale për fushatën e edukimit ka dhënë gjithashtu ndihmë të vlefshme
Rritja e madhe e numrit të armëve të pakontrolluara		+ +	- -	Megjithë fushatën e madhe dhe mesazhet e qarta të transmetuara, mundësia në rritje e gjetjes së armëve në zonat përreth komunitetit, ka bërë që situata në mos ka qëndruar në vend është përkeqësuar
Niveli i sigurisë në komunitet		+ +	+	Edhe pse më shumë armë janë tani në qarkullim, fakti se fushata e armëve të vogla dhe të lehta ka ngritur dhe ndërgjegjësuar axhendat politike dhe gjithçka tani merret më seriozisht si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel local, jep qartë idenë se siguria personale dhe ajo në komunitet është ulur <sup>84</sup>

Kujdes: çdo nivel, nga poshtë-lart, paraqet një shkallë të rritjes dhe përmirësimit të situatës.

+ = suport pozitiv

- = suport negative

<sup>83</sup> Shihni komentin e "ku të përdoren" në seksionin e mëposhtëm, rreth nevojës e gjetjeve të rezultateve nga ndërthurja e tabelave të ndryshme.

<sup>84</sup> Ky konkluzion paraqet gjetjet nga ky ushtrim. Informacioni i mbledhur nga rrugë të tjera (siç mund të jenë statistikave mbi mbajtjen e armëve të vogla dhe zakonet e komunitetit) mund vetëm të forcojnë ose të kundërshtojnë këto gjetje. Përsëri këto përforcojnë nevojën e gjetjeve nga ndërthurja e tabelave të ndryshme dhe nevojën e interpretimit me shumë kujdes të tyre.



## Kur mund të përdoren teknikat e pjesëmarrjes

Vlerësimet rreth pjesëmarrjes përfshijnë nevojën e mjeteve të thjeshta të kuptueshme që do të ndihmonin për të studiuar perceptimin, prioritetet dhe marrëdhënien në një komunitet të caktuar. Ka një numër të madh teknikash dhe metoda rreth pjesëmarrjes që mund të përdoren. Disa sqarime janë dhënë më poshtë.<sup>85</sup> Të gjitha këto metoda mundësojnë njerëzit të analizojnë vetë situatat e tyre, sesa situatat e tyre ti analizojnë specialistë të jashtëm. Të tilla teknika auto-diagnostikimi u lejojnë komuniteteve të kuptojnë nga studimet e tyre çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe.

- Kur punoni në komunitete lokale, asnjë metodë për mbledhjen e informacionit nuk duhet të përdoret e izoluar sepse informacioni i mbledhur rrezikon të ketë cilësi të ulët. Megjithëse nga të gjitha teknikat e përmendura, metodat e pjesëmarrjes duhen përdorur vetëm në studime kohore të gjata të cilat do të lejonin ndërtimin e një marrëdhënie me komunitetet e fokusuar. Nëqoftëse përdoren si një rast i vetëm studimor për të kuptuar se si komuniteti funksionon do jetë shumë e vështirë të japi rezultate të kënaqshme, por nëqoftëse përdoren gjerësisht për një kohë të gjatë ato ndihmojnë në një pjesëmarrje më të madhe komunitare në programin studimor dhe e gjitha kjo pjesëmarrje do të ndodhë e shkrirë si një e vetme.
- Përdorimi i teknikave të pjesëmarrjes do të jepte rezultate shumë të kënaqshme nëse vendimet se cilat teknika duhen përdorur, merren vetë nga komuniteti dhe nuk u detyrohen nga jashtë.
- Përdorimi i teknikave të tilla mund të përdoret në të gjitha fazat e mbledhjes së informacionit, që nga faza e studimit fillestar e deri tek monitorimi dhe vlerësimi. Dhe me përsëritjen e këtyre teknikave gjatë gjithë këtyre fazave bënë të mundur që i gjithë cikli studimor të japë një ide shumë të qartë për mënyrën e të kuptuarit të problemeve dhe evolucionin e tyre në komunitet.
- Asnjë teknikë e izoluar nuk do të na vendosë në dispozicion të dhëna të sakta në mënyrë që të kemi një informacion mbi të cilin të ndërtojmë fushatën e sensibilizimit të armëve të vogla dhe të lehta ose progresin e saj për të arritur objektivat. Çdo teknikë e mbledhjes së informacioneve duhet të përdoret në bashkëpunim me informacionet e tjera (si kuantitative ashtu dhe kualitative).

## Udhëzime për përdorimin e teknikave të pjesëmarrjes

Një udhëzues të vogël për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve me këtë mënyrë, do ta gjeni më poshtë të ndarë në tre faza, ndërtimi (dizenjimi), mbledhja dhe analiza.

### 1. Faza e ndërtimit (dizenjimi)

- Pavarësisht nga pyetësorët dhe grupet e diskutimit, grupi në vetvete duhet të vendosë objektivat e programit dhe ti përdori ato në formulimin pyetjeve mbi të cilat do të bazohet këto teknika. Grupi identifikon informacionin të cilin këto teknika mundohen të mbledhin si dhe indikatorët.
- Në zgjedhjen e metodave përsëri, duhet të jetë një vendim grupi se cilat nga metodat duhen përdorur. Disa nga mundësitë janë si më poshtë:

### 2. Faza e mbledhjes së informacionit

Ka një numër të madh metodash të cilat mund të përdoren në mënyrë të suksesshme për të siguruar maksimumin në pjesëmarrjen komunitare.

<sup>85</sup> Për më shumë sqarime rreth teknikave të pjesëmarrjes shihni Aneksin D ose Guidën e Vlerësimit dhe Monitorimit të IFAD në adresën [www.ifad.org/evaluation/guide/index.html](http://www.ifad.org/evaluation/guide/index.html)



SHEMBUJ PËR TË ARRITUR REZULTATE	KOMENTE
<b>Diagrama</b> <b>Afate kohore</b> <b>Piktura</b> <b>Harta</b>	Në mënyrë individuale ose në grupe të vogla pjesëtarët e komunitetit mund të përdorin mjete jo-tekstuale për të shprehur ndjenja, opinione dhe besime në mënyrë që këto të jenë të dukshme dhe shumë lehtë të kuptueshme nga të tjerët.: <ul style="list-style-type: none"><li>• hartat mund të tregojnë mendimin që kanë grupet e vogla në lidhje me rrezikshmërinë e zonave të ndryshme</li><li>• afatet kohore mund të tregojnë sekuencat e ngjarjeve në perspektiva të ndryshme ose si gjërat kanë ndryshuar në komunitet në një periudhë të caktuar kohore</li><li>• piktura ndihmon njerëzit të shprehin ndjenjat e tyre rreth një situatë të caktuar ose ti lejojë ata të shprehin të ardhmen lirshëm sipas dëshirës së tyre</li></ul>
<b>Rradhitja dhe vlerësimet</b>	Një shembull rreth ushtrimit të radhitjes është dhe ushtrimi i liderit (shihni shembujt e mësipërm)
<b>Loja me role</b>	Gjatë lojës me role grupi ndërton skena dhe situata të problemeve dhe situatave të ndryshme sipas perceptimit të tij. Me këtë mënyrë mund të zbulohen perspektiva të ndryshme të problemeve nëse grupe të ndryshme ftohen të marrin pjesë në lojë.

### 3. Faza e analizës

- Analizimi i rezultateve duhet të bëhet në diskutime grupi
- Përsëritja e këtyre teknikave gjatë gjithë këtyre fazave bënë të mundur që i gjithë cikli studimor të japë një ide shumë të qartë për mënyrën e të kuptuarit të problemeve dhe ndryshimin e tyre në kohë. Edhe kjo teknikë duhet të jetë vendosur që më parë me komunitetin.



## Aneksi F

### Përdorimi i informacioneve dytësore shembuj dhe udhëzime

#### 1. Faza e ndërtimit (dizenjimit)

- Vendosni se për çfarë informacioni keni nevojë duke u bazuar të objektivat e programit dhe indikatorët tuaj
- Identifikoni burime të mundshme
- Merrni në konsideratë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, duke patur parasysh vërtetësinë e tyre dhe lehtësinë për tu gjetur.

#### 2. Burime të cilat duhet ti merrni në konsideratë

<b>Të dhëna nga burime spitalore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shihni Organizatën Botërore të Shëndetësisë, për më shumë informacion dhe asistencë vizitoni <a href="http://www.who.int/violence_injury_prevention">www.who.int/violence_injury_prevention</a></li> <li>• ose vizitoni Faqen e shoqatës së fizikantëve rreth parandalimit të rreziqeve nukleare <a href="http://www.ippnw.org/">www.ippnw.org/</a></li> <li>• Gjithashtu vizitoni dhe faqet e ministrive të shëndetësisë lokale</li> </ul>
<b>Institucione Qeveritare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministria e Mbrojtjes, Shqipëri: <a href="http://www.mod.gov.al/">www.mod.gov.al/</a></li> <li>• Ministria e Informacionit, Maqedoni: <a href="http://www.sinf.gov.mk">www.sinf.gov.mk</a></li> <li>• Ministrinë e Rendit</li> <li>• Ministrinë e Drejtësisë</li> <li>• Ministrinë e Çështjeve Sociale</li> </ul>
<b>Raporte të Kombeve të Bashkuara</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vizitoni Departamentin e Çarmatimit të Kombeve të Bashkuara: <a href="http://www.disarmament.un.org/">www.disarmament.un.org/</a></li> </ul>
<b>Raporte nga OJQ që merren më studime në këtë fushë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përveçse OJQ lokale janë dhe një numër i madh OJQ ndërkombëtare që merren me këto studime:</li> <li>• Saferworld: <a href="http://www.saferworld.org.uk/">www.saferworld.org.uk/</a></li> <li>• International Alert: <a href="http://www.international-alert.org/">www.international-alert.org/</a></li> <li>• Oxfam GB (<a href="http://www.oxfam.org.uk">www.oxfam.org.uk</a>)</li> <li>• Amnesty International (<a href="http://www.amnesty.org">http://www.amnesty.org</a>)</li> <li>• Human Rights Watch (<a href="http://www.hrw.org/arms/">http://www.hrw.org/arms/</a>)</li> <li>• Bonn International Centre for Conversion (BICC) – (<a href="http://www.bicc.de/">http://www.bicc.de/</a>)</li> <li>• Shumë OJQ të tjera mund ti gjeni në adresën: <a href="http://www.iansa.org/">www.iansa.org/</a></li> </ul>
<b>Komisione Hetimore Qeveritare dhe Ndërkombëtare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vizitoni Departamentin e Çarmatimit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me raportet që nxjerrin Kombet e Bashkuara: <a href="http://www.disarmament.un.org/">www.disarmament.un.org/</a></li> </ul>
<b>Raporte Shtypi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumë media, si lokale, rajonale dhe ndërkombëtare kanë faqe në internet ku mund të gjeni informacione dhe të bëni kërkime në lidhje me armët e vogla dhe të lehta. <a href="http://www.iansa.org/news/index.html">www.iansa.org/news/index.html</a></li> <li>• Instituti për Raportimet mbi Luftën dhe Paqen: <a href="http://www.iwpr.net">www.iwpr.net</a></li> <li>• Të gjitha informacionet e tjera i kërkoni në mediat lokale</li> </ul>
<b>Kërkime akademike dhe kërkime specialistësh</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Federata Amerikane e Shkencës: <a href="http://www.fas.org/">www.fas.org/</a></li> <li>• Shoqata e fizikantve rreth parandalimit të rreziqeve nukleare <a href="http://www.ippnw.org/">www.ippnw.org/</a></li> <li>• Grupi i Informacionit Jane: <a href="http://www.janes.com/">www.janes.com/</a></li> <li>• Iniciativa Norvegjeze për Trasferrat e Armëve të Vogla: <a href="http://eee.nisat.org/">eee.nisat.org/</a></li> <li>• Anketimi për armët e vogla: <a href="http://www.smallarmssurvey.org/">www.smallarmssurvey.org/</a></li> <li>• Instituti Ndërkombëtar për Kërkimet mbi Paqen në Stotkollm: <a href="http://www.sipri.org/">www.sipri.org/</a></li> </ul>
<b>Informacione në lidhje me numrin e armëve në përdorim privat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Interesohuni pranë organeve të Policisë dhe çdo organi tjetër që mundëson liçensimin e armëbajtjes.</li> </ul>



<p><b>Faqe Interneti</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shoqata e Mediave të Pavaruara Elektronike: <a href="http://www.anem.org.yu/anemnews/indexEn.jsp">www.anem.org.yu/anemnews/indexEn.jsp</a></li> <li>• Lidhja Ballkanike për të Drejtat e Njeriut: <a href="http://www.balkan-rights.net">www.balkan-rights.net</a></li> <li>• Faqje interneti të të Drejtave të Njeriut në Ballkan: <a href="http://www.greekhelsinki.gr/bhr/english/index.html">www.greekhelsinki.gr/bhr/english/index.html</a> <a href="http://www.bosporus.org">www.bosporus.org</a></li> <li>• Të dhëna rreth organizatave në Europën jug-lindore: <a href="http://www.see-database.org/">www.see-database.org/</a></li> <li>• INCORE, të dhëna konfliktesh: <a href="http://www.incore.ulst.ac.uk/cds/">www.incore.ulst.ac.uk/cds/</a></li> <li>• Vizitoni Europa.net: <a href="http://www.seeurope.net/en/">www.seeurope.net/en/</a></li> <li>• Vizitoni dhe faqet e bibliotekave të çdo vendi</li> </ul>
<p><b>Agjensi Informative dhe revista online</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• B92: <a href="http://www.b92.net">www.b92.net</a></li> <li>• Revista ballkanike: <a href="http://www.balkanfire.hypermart.net/">www.balkanfire.hypermart.net/</a></li> <li>• Qendra për Paqen në Ballkan: <a href="http://www.balkanpeace.org/">www.balkanpeace.org/</a></li> <li>• Qendra për studimet e Europës Jug-lindore: <a href="http://www.csees.net/">www.csees.net/</a></li> <li>• Agjencia e shtypit, Maqedoni: <a href="http://www.mpa.gr/?page=english">www.mpa.gr/?page=english</a></li> <li>• Qendra e Mediave, Beograd: <a href="http://www.yumediacenter.com/english/mlinkovi/mlinke.html">www.yumediacenter.com/english/mlinkovi/mlinke.html</a></li> </ul>
<p><b>Qendra në luftë kundër minave</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• BiH, Qendra kundër minave: <a href="http://www.bhmac.org/">www.bhmac.org/</a></li> <li>• Qendra për aksionin kundër minave Kroaci: <a href="http://www.hcr.hr/index.php?link=aktualnosti&amp;lang=hr">www.hcr.hr/index.php?link=aktualnosti&amp;lang=hr</a></li> <li>• Qendra e Kordinimit anti-minë e UMNİK: <a href="http://www.welcome.to/mackkosovo/">www.welcome.to/mackkosovo/</a></li> </ul>
<p><b>Organizata Ndërkombëtare</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• UNDP Albania, Projekti për armët e vogla dhe të lehta: <a href="http://www.undp.org.al/salws/">www.undp.org.al/salws/</a></li> <li>• UNDP Kosova, Projekti për armët e vogla dhe të lehta: <a href="http://www.ks.undp.org/project/ISAC/isac.htm">www.ks.undp.org/project/ISAC/isac.htm</a></li> <li>• UNDP Maqedonia, Projekti për armët e vogla dhe të lehta: <a href="http://www.smallarms.org.mk">www.smallarms.org.mk</a></li> <li>• Bankat e të dhënave të SEESAC kanë informacion mbi numrat e armëve të mbledhura dhe të shkatërruara në Europën Juglindore, dhe ofron lidhje për anketimet kombëtare dhe publikime të tjera duke përfshirë edhe Monitorin e KAVL (<a href="http://www.seesac.org">http://www.seesac.org</a>)</li> </ul>

### 3. Gjatë mbledhjes së informacioneve kini kujdes që:

- Qëndroni gjithnjë të fokusuar tek lloji i informacionit që do të donit të mblidhnit. Familjarizohuni me situatën dhe përpiquni të kuptoni sa më objektivisht përgjigjet e te intervistuarve
- Identifikoni ndryshimet midis “temës” dhe “ideve”
- Kur kontaktoni organizata të tjera përpiquni të kontaktoni me personin përgjegjës të kësaj fushe.

### 4. Gjatë fazës së analizës:

- Gjithnjë mbani shënime rreth të dhënave që kanë të bëjnë me temën e studimit.
- Verifikoni informacionet duke bërë kontroll të kryqëzuar të pyetjeve
- Organizata të ndryshme mund të kenë prioritete të ndryshme të cilat ato duan të promovojnë – Nëse keni dyshime tek konkluzionet, studioni të dhënat tek të cilat konkluzionet janë bazuar.
- Mbani një ditar me të dhënat e reja të cilat do të gjeni gjatë hulumtimeve tuaja, mos harroni gjithnjë të citoni burimin e informacionit të këtyre të dhënave.





## Aneksi G

### Shembull për përgatitjen së programit të punës gjatë fushatës edukative për rrezikun e armëve të vogla dhe të lehta.

Planifikimi i fushatës së një organizate të sajuar të quajtur “Armët e lira pa kufij” që duhet të fillojë dhe të zbatojë një fushatë edukimi për rreziqet nga armët në një shtet me shkallë të lartë konfliktualiteti me 5 rajone të ndryshme.

#### 1. Faza e studimit të situatës

- Organizata “Armët e lira pa kufij” duhet të zhvilloj një studim të shpejtë të situatës së këtij vendi, duke marrë parasysh gjithë informacionin ekzistues rreth çështjeve të armëve në këtë vend.
- Organizata identifikon partnerët lokalë në të pesta këto zona dhe punëson 5 persona përgjegjës për secilën prej tyre.
- Është gjatë fazës së përpunimit dhe një Projekt propozim kombëtar i cili përfshin:
  - Një listë të nevojave dhe kërkesave në të gjitha këto zona.
  - Faza e analizës dhe e planifikimit do të përfshijë gjithashtu dhe një trajnim për 15 persona.
  - Një buxhet për zbatimin e aktiviteteve me të rinjtë në shkollat e tyre, me adoleshentët, dhe aktivitete me burrat e gratë në 5 fshatra ose qytete të çdo zone. Për një total prej 25 fshatrash ose qytetesh.

#### 2. Identifikimi i nevojave dhe i kërkesave

- Një specialist i organizatës në një trajnim 2 ditor, trajnon 5 anëtarët e rinj të stafit se si të identifikojnë nevojat dhe kërkesat në zonat e tyre.
- Bëhet përzgjedhja e fshatrave dhe qyteteve në çdo zonë.
- Çdo pjesëtar i grupit të punës shkon pranë zonave të tyre dhe shpenzon 1 javë duke intervistuar, mbledhur informacion dhe pyetur sa më shumë pjesëtarë të komunitetit. Të kihet parasysh se pjesëtarë përfaqësues të komunitetit duhet të merren në intervistë patjetër. Në këtë fazë pyetësorët e studiuar më lart fillojnë të zbatohen për të arritur dhe mbledhur gjithë informacionet e dëshiruara.
- Specialistët e organizatës në qendër takohen me përfaqësues të ministrive përgjegjëse dhe përfaqësues të shoqatave ndërkombëtare rreth këtyre çështjeve.

#### 3. Analizimi dhe planifikimi i punës

- Një ditë takimi me të gjithë stafin i cili ka zbatuar fazën e identifikimit dhe të nevojave, të dhëna mbi të cilat do të zbatohet strategjia.
- Specialistët e organizatës përgatitin një strategji më të detajuar të projektit i cili do tu paraqitet donatorëve.
- Një trajnim një javor do të organizohet me 5 anëtarët të cilët do të zbatojnë projektin në nivel rajonal. Në këtë trajnim ftohen dhe pjesëtarë përgjegjës nga organizata të tjera dhe pjesëtarë ministrie për të dhënë mendime dhe për të ndarë eksperiencë.
- Gjatë këtij trajnimi diskutohet mbi të dhënat specifike rajonale mbi të cilat do të bihet dakord për strategjitë rajonale.
- Gjatë trajnimit do të identifikohen “target grupet”, mesazhi që do tu trasmetohet këtyre grupeve, vendoset për zonat finale të zbatimit.
- Strategjia përfundimtare përpunohet dhe shkruhet projekt propozimi përfundimtar për tu dërguar donatorëve.



- Organizata përcakton qëllimet, objektivat dhe indikatorët për monitorimin dhe vlerësimin e fushatës.
- Një autorizim nga autoritetet lokale u jepet koordinatorëve lokalë për të filluar punën në rajonet të cilat ata do të mbulojnë.
- Gjetjet e vlerësimit të nevojave i raportohen autoriteteve qendrore dhe rajonale

#### 4. Dizenjimi dhe shkrimi i aktiviteteve lokale dhe materialeve të nevojshme

- Stafit të punës i bëhen vazhdimisht trajnime rreth aktiviteteve me fëmijët (lojëra, konkurse, aktivitete të ndryshme argëtimi).
- Ushtrimet praktike kryhen në tre fshatra (tre personal për fshat) duke përfshirë Planin e Komunitetit të Sigurtë (praktikohen aktivitetet për fëmijë dhe të rritur).
- Duhet të përzgjidhni një artist lokal për tju ndihmuar në dizenjimin e aktiviteteve dhe të diskutoni së bashku rreth materialeve reklamuese të cilat do të prodhoni.
- Artisti zhvillon materialet fillestare
- Një trajnim një ditor për anëtarët e stafit për të diskutuar dhe testuar cilësinë e materialeve të cilat po përdorin.
- Testimet kryen dhe pranë zonave të përzgjedhura për të parë sesi reagon komuniteti në nivel lokal.
- Të gjitha informacionet e reja i vihen në dispozicion artistëve lokalë për të përpunuar strategjitë dhe materialet e reja.
- Ndryshimet e materialeve bëhen në çdo fazë, gjithnjë duhet të jemi të gatshëm për të evoluar dhe ndryshuar materialet tona.
- Prodhet materiali reklamues.

#### 5. Zbatimi i aktivitetit

- Ekipi që bashkëpunon është i trajnuar dhe gati për të zbatuar aktivitetet, gjithashtu dhe materialet dhe kurrikulat janë gati.
- Stafit fillon punën në nivelin lokal duke zbatuar projektin.
- Në çdo fazë të re të projektit i behën vizita autoriteteve lokale për ti informuar ato dhe për tu kërkuar mbështetjen e tyre.
- Mbas një periudhe të caktuar kohe vendoset për të kryer takime periodike me të gjithë stafin.
- Gjatë këtyre takimeve diskutohet për zgjidhjet personale të secilit prej stafeve lokale, përzgjidhen eksperiencat më të mira.
- Duhet të përzgjidhet një vullnetar nga komuniteti për të ndihmuar me konsulencë për mbarëvajtjen e projektit.
- Mbasi janë identifikuar dhjetë vullnetarët e parë trajnohen për të përpunuar së bashku me ta në strategjitë e zbatuara.
- Stafit i punës punon me vullnetarët dhe i mbështet iniciativat e tyre kur është e nevojshme. Nëse ka nevojë, ndihmohen me materiale dhe trainime.
- Takime pune mujore organizohen me vullnetarët për të diskutuar probleme të mundshme dhe për t'i mbështetur.
- Gjatë takimeve të koordinimit, u jepet informacioni organizatave dhe autoriteteve të tjera.
- Materialet dhe aktivitetet kontrollohen dhe vlerësohen.
- Të gjitha takimet kryen për të mbledhur të gjithë eksperiencën e mundshme, përpunohen strategjitë, botohen fashikujt e parë dhe OJQ shërben si lidhje midis të gjithë individëve privatë dhe shtetërorë që punojnë në këtë fushë.





## SEESAC

South Eastern Europe Clearinghouse for the  
Control of Small Arms and Light Weapons

Janka Veselinovića 13, 11 000 Belgrade, Serbia and Montenegro  
Tel. (+381) (11) 244 2902 / Fax. (+381) (11) 245 4351  
URL: [www.seesac.org](http://www.seesac.org) / Email: [info@seesac.org](mailto:info@seesac.org)

